

Berton Sulejmani
Zejnepe Alili Rexhepi

Gjuhë shqipe

PËR KLASËN E TETË
ARSIMI FILLOR

Arbëria 
Design

Berton Sulejmani
Zejnepe Alili Rexhepi

Gjuhë shqipe

PËR KLASËN E TETË
ARSIMI FILLOR

GJUHË SHQIPE

për klasën e tetë të arsimit fillor

Botues:

Arbëria Design - Tetovë

Redaktor përgjegjës:

Dashmir Ademi

Autorë:

Prof. dr. Berton SULEJMANI, profesor në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës.

Prof. dr. Zejnepe ALILI REXHEPI, profesoreshë në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës.

Recensent:

Prof. dr. Salajdin Salihu

Redaktimi gjuhësor:

Prof. dr. Hana Dardhishta

Përpunimi teknik, dizajni dhe ilustrimet:

Afrim Bulica

Valbona Halili

(ArbëriaDesign)

Shtypi:

Arbëria Design - Tetovë

Tirazhi:

6.700 copë

Me vendim të Komisionit Kombëtar për Tekstet Shkollore për Arsimin Fillor dhe të Mesëm, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 26-558/1, të datës 04.05.2026, miratohet përdorimi i këtij teksti shkollor.

PARATHËNIE

Teksti mësimor “Gjuhë shqipe” për klasën VIII të arsimit fillor është përgatitur në përputhje me programin mësimor të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja e Zhvillimit të Arsimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ky tekst mësimor i lëndës së Gjuhës shqipe është hartuar për klasën VIII. Ai synon t’u japë nxënësve njohuritë e nevojshme për gjuhën dhe letërsinë, t’i ndihmojë të zhvillojnë aftësitë e të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit e të shkruarit, si dhe ta përdorin gjuhën drejt në rrethana të ndryshme komunikimi. Përmbajtjet e tij mbështeten në kërkesat e programit dhe në nevojat mësimore të nxënësve.

Në pjesën Gjuha dhe komunikimi trajtohen çështje nga zhvillimi historik i gjuhës shqipe, fonetika, drejtshkrimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve, morfologjia, sintaksa, leksiku, rregullat drejtshkrimore dhe të lexuarit me të kuptuar. Pas njërive mësimore jepen shembuj, ushtrime dhe detyra, që i ndihmojnë nxënësit t’i kuptojnë më mirë rregullat e gjuhës dhe t’i zbatojnë ato në të folur e në të shkruar, ndërsa mësimdhënësit ta organizojnë më mirë mësimin.

Në pjesën Letërsia, të shprehurit dhe krijimtaria, nxënësit njihen me letërsinë popullore, lirikën, epikën në prozë, dramën, si dhe me forma të ndryshme të të shprehurit. Tekstet e zgjedhura nga letërsia shqiptare dhe botërore u japin mundësi të lexojnë me vëmendje, ta kuptojnë përmbajtjen, t’i dallojnë personazhet, ngjarjet dhe idetë, si dhe t’i shprehin mendimet e tyre me gojë dhe me shkrim.

Përmes letrave, ritregimit, tregimit, fjalimit, esesë, shkrimit krijues dhe debatit, nxënësit ushtrohen të ndërtojnë tekste të ndryshme, ta shprehin qartë mendimin dhe ta përdorin fjalën, sipas qëllimit dhe rrethanës. Këto përmbajtje e lidhin mësimin e gjuhës me përvojën e përditshme të nxënësit dhe me zhvillimin e shprehive të komunikimit.

Në pjesën Njohuri mediatike, nxënësit njihen me titujt që nxisin klikime, me besueshmërinë e informacionit, me hapat e kontrollit, me shpërndarjen e përgjegjshme dhe me pasojat e shpërndarjes së papërgjegjshme. Këto tema i ndihmojnë ta lexojnë me kujdes informacionin, t’i dallojnë burimet e besueshme dhe të mbajnë qëndrim të përgjegjshëm ndaj përmbajtjeve mediatike.

Jemi përpjekur që teksti të jetë i qartë, i lidhur me programin dhe i përshtatshëm për punën mësimore. Shembujt, ushtrimet dhe detyrat janë vendosur për ta bërë mësimin më të kuptueshëm dhe për t'i ndihmuar nxënësit të pasurojnë dijen gjuhësore e letrare, të lexojnë me kuptim, të shkruajnë qartë dhe të flasin drejt.

Qoftë ky tekst në të mirë të nxënësve, mësimdhënësve dhe gjuhës shqipe.

Punë të mbarë!

Autorët

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
------------------	---

GJUHË DHE KOMUNIKIM	9
---------------------------	---

SHKENCA PËR GJUHËN	13
--------------------------	----

GJUHA SHQIPE NË FAMILJEN E GJUHËVE INDOEVROPIANE.....	13
---	----

FAMILJET GJUHËSORE.....	13
-------------------------	----

GJUHËT E VDEKURA DHE GJUHËT E SHUARA.....	15
---	----

ELEMENTET INDOEVROPIANE NË GJUHËN SHQIPE	15
--	----

TEZAT PËR PREJARDHJEN E GJUHËS SHQIPE.....	16
--	----

ZHVILLIMI HISTORIK I GJUHËS SHQIPE	18
--	----

GJUHA SHQIPE NË SHEKUJT XVIII–XIX.....	18
--	----

PIKËPAMJET E RILINDËSVE PËR GJUHËN SHQIPE.....	19
--	----

FONETIKA DHE RREGULLAT DREJTSHKRIMORE TË ZANOREVE DHE BASHKËTINGËLLOREVE	21
---	----

ZANORET DHE BASHKËTINGËLLORET E GJUHËS SHQIPE: SHKRIMI DHE SHQIPTIMI I TYRE	21
--	----

DREJTSHKRIMI I FJALËVE ME ZANOREN E NË POZICIONE TË NDRYSHME.....	21
--	----

DREJTSHKRIMI I FJALËVE ME ZANOREN Ë NË POZICIONE TË NDRYSHME.....	22
--	----

DREJTSHKRIMI I FJALËVE ME ZANOREN Ë FUNDORË	24
---	----

TAKIME BASHKËTINGËLLORESH.....	28
--------------------------------	----

INTONACIONI, LLOJET E INTONACIONIT, THEKSI I FJALISË	31
--	----

MORFOLOGJIA.....	34
------------------	----

MBIEMRAT MARRËDHËNIORË.....	34
-----------------------------	----

PËREMRA DËFTORË.....	39
----------------------	----

FOLJA.....	42
------------	----

KATEGORIA GRAMATIKORE E MËNYRËS TE FOLJET	43
---	----

MËNYRA DËFTORE	43
----------------------	----

MËNYRA LIDHORE	45
----------------------	----

MËNYRA DËSHIRORE.....	46
-----------------------	----

MËNYRA URDHËRORE.....	47
-----------------------	----

PJESËT E PANDRYSHUESHME TË LIGJËRATËS	51
---	----

LIDHËZAT.....	51
---------------	----



PARAFJALËT	55
PASHTHIRRMAT	57
PJESËZAT	60
KOHËT E PËRBËRA TË FOLJEVE	64

SINTAKSA 69

KUNDRINORI – RIMARRJA E KUNDRINORIT	69
KUNDRINORI I DREJTË	70
KUNDRINORI I ZHDREJTË	72
GJYMTYRËT E DYTA – PËRCAKTORI DHE NDAJSHTIMI	75
PËRCAKTORËT ME DREJTIM DHE ME BASHKIM	77
NDAJSHTIMI	79
FJALËT DHE TOGJET E FJALËVE TË NDËRMJETME	81
FJALITË NJËKRYEGJYMTYRËSHE	84
STRUKTURA E FJALISË SË PËRBËRË (PERIUDHËS)	89
FJALITË E PËRBËRA ME BASHKËRENDITJE	92

LEKSIKU 96

LEKSIKU I GJUHËS SHQIPE SIPAS PREJARDHJES SË FJALËVE	96
--	----

RREGULLAT DREJTSHKRIMORE 100

PRESJA NË FJALINË E THJESHTË	100
PRESJA NË FJALITË E PËRBËRA ME BASHKËRENDITJE	102

TË LEXUARIT ME TË KUPTUAR 105

NARCISI	105
FABULA TË NDRYSHME	109
KOPRRACI DHE FLORIRI I TIJ	110
DJALI I MBRETIT DHE LUANI I PIKTURUAR	111
HAKMARRJA E LEOPARDIT	112
ZËRA NË PARK	114

LETËRSIA, TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA 117

LETËRSIA POPULLORE 121

LETËRSIA POPULLORE	121
PROVERBA	123
GJËEGJËZA	124
PËRSHËNDETJE	125
FOLKLORI	127
PËRFAQËSUES TË FOLKLORIT SHQIPTAR	127
POEMA	129
ANEKDOTA	133

PËRRALLA	135
FJALË TË MOÇME.....	137
MOJ E BUKURA MORE	139
KUSH E SOLLI DORUNTINËN	141
BUJKU DHE BIJT	143
FABULA.....	143
FABULA SHQIPTARE.....	146
SHITËSJA E VOGËL E SHKREPËSEVE	147
LEGJENDA.....	151
LIRIKA.....	155
LIRIKA.....	155
MË TË BUKURËS QË ËSHTË NË STRIGAR	159
BUKURIA.....	161
KOPSHTI I DASHURISË.....	163
KËNGËT E DASHURISË (EROTIKE)	165
TRINGA.....	167
MËMA.....	171
EKSTAZA PRANVERORE	173
EPIKA NË PROZË	175
TREGIMI	175
NJË MBRËMJE NË LURË	177
NËN MYSHK.....	181
FYELLI I GDHENDUR NË GUR.....	185
KËPUCËTARI.....	189
LYPËSI	193
ROMANI	197
GJERGJI, BIRI I ARBËRISË.....	197
MISTERET E SHKRIMIT TË VJETËR.....	201
VRERI I GJYSHES.....	205
NË QYTETIN E LILIPUTËVE	211
DRAMA.....	215
DRAMA	215
EMIRA	218
TRAGJEDIA	221
PROMETEU I LIDHUR	223
ANTIGONA.....	227
KOMEDIA.....	231
KOMEDIA “KOPRACI”	233
KOMEDIA “PAS VDEKJES”	237

TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA.....	241
TË SHKRUAJMË LETËR	242
TREGIMI DHE RITREGIMI.....	247
HARTIMI I NJË FJALIMI.....	253
SI TË SHKRUHET ESE.....	257
TË SHKRUARIT KREATIV	261
DEBATI.....	265

NJOHURI MEDIATIKE.....	267
TITUJT DHE MASHTRIMET PËR KLIKIME (KLIK-BEJTI)	271
BESUESHMËRIA E INFORMACIONIT.....	274
HAPAT E KONTROLLIT.....	275
SHPËRNDARJA ME PËRGJEGJËSI.....	275
PASOJAT E SHPËRNDARJES SË PAPËRGJEGJSHME	276

GJUHË DHE KOMUNIKIM

 SHKENCA PËR GJUHËN ZHVILLIMI HISTORIK I GJUHËS SHQIPE FONETIKA DHE RREGULLAT DREJTSHKRIMORE TË ZANOREVE
DHE BASHKËTINGËLLOREVE MORFOLOGJIA SINTAKSA LEKSIKU RREGULLAT DREJTSHKRIMORE TË LEXUARIT ME TË KUPTUAR

SHKENCA PËR GJUHËN

GJUHA SHQIPE NË FAMILJEN E GJUHËVE INDOEVROPIANE

Familjet gjuhësore

Në botë mendohet se ekzistojnë rreth 250 familje gjuhësore, të cilat përfshijnë afërsisht 6.800 gjuhë. Familje gjuhësore quhet grupi i gjuhëve që kanë prejardhje nga një gjuhë e përbashkët paraardhëse. Gjuha mund të jetë pjesë e një familjeje gjuhësore kur vërtetohet se ka lidhje ose ngjashmëri me gjuhë të tjera, si p. sh.: fjalë që janë të ngjashme në disa prej gjuhëve të asaj familjeje, si edhe ngjashmëri në sistemin fonetik dhe gramatikor. Këto elemente tregojnë se gjuhët e një familjeje kanë një të shkuar të përbashkët. Një ndër familjet gjuhësore më të njohura dhe njëkohësisht më të studiuarat është familja e gjuhëve indoevropiane.

Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane, një familje e madhe gjuhësh që fliten nga India e deri në Evropë.

Disa prej gjuhëve indoevropiane kanë formuar grupe gjuhësh, ku secili grup përfshin gjuhët pasardhëse të një gjuhe të lashtë të përbashkët, si:

- Gjuhët romane/italike, të cilat rrjedhin nga latinishtja (spanjishtja, italishtja, portugalishtja, frëngjishtja, rumanishtja etj.);
- Gjuhët gjermanike, që rrjedhin nga gjermanishtja e vjetër (gjermanishtja, anglishtja, danishtja, suedishtja, norvegjishtja etj.);
- Gjuhët sllave, që vijnë nga sllavishtja e vjetër e përbashkët (*rusishtja, ukrainishtja, bjellorusishtja, polonishtja, çekishtja, sllovakishtja, bullgarishtja, maqedonishtja, serbishtja, kroatishtja, boshnjakishtja, sllovenishtja etj.*);
- Grupi i gjuhëve baltike;
- Grupi i gjuhëve kelte etj.

Ndërsa shqipja, greqishtja dhe armenishtja janë gjuhë që secila përbën grup më vete, pasi nuk ndajnë një paraardhës të afërt të përbashkët me gjuhët e tjera brenda familjes indoevropiane.

Si degë më vete brenda familjes së gjuhëve indoevropiane, gjuha shqipe ruan disa tipare gjuhësore që e lidhin me një fazë të hershme të indoevropianishtes.

Përkatësia indoevropiane e gjuhës shqipe u arrit të përcaktohej dhe të vërtetohej në mesin e shekullit XIX, në periudhën kur u zhvilluan studimet e gjuhësisë historike-krahasuese. Franc Bopi (Franz Bopp) është gjuhëtari i parë që e vërtetoi shkencërisht këtë përkatësi. Ai theksonte se *“në elementet e saj themelore, gjuha shqipe nuk ka ndonjë lidhje të ngushtë ose, aq më pak, ndonjë lidhje prejardhjeje me asnjërën nga gjuhët e sotme indoevropiane të kontinentit tonë”*.



14

Në çështjen e prejardhjes së gjuhës shqipe kanë dhënë ndihmesa të rëndësishme disa studiues, si: Gustav Majeri, Holger Pedersen, Eqrem Çabej, Idriz Ajeti, Shaban Demiraj, Rexhep Ismajli etj.

Gjuhët e vdekura dhe gjuhët e shuara

Gjatë historisë, këto gjuhë kanë kaluar nëpër ndryshime të shumta, të cilat kanë ndikuar në mënyrën si janë zhvilluar e si i njohim sot. Me kalimin e kohës, disa prej gjuhëve indoevropiane nuk kanë arritur të mbijetojnë. Ato kanë humbur vazhdimësinë dhe sot konsiderohen gjuhë të vdekura, si: hetitishtja dhe tokarishtja. Në këtë kategori përfshihen edhe latinishtja, greqishtja e vjetër dhe ilirishtja.

Kur një gjuhë nuk përdoret më, sepse nuk ka më folës, ajo quhet *gjuhë e shuar*. Shumë gjuhë të tilla i përkasin fiseve të vogla të Afrikës dhe të Amerikës së Jugut, të cilat janë vazhdimisht në rrezik, sepse numri i folësve të tyre është shumë i kufizuar. Megjithatë, shumë gjuhë të tjera janë trashëguar dhe ruajtur, duke u zhvilluar në forma të reja. Për shembull, shqipja është trashëguar nga ilirishtja, ndërsa greqishtja e re nga greqishtja e vjetër.

Elementet indoevropiane në gjuhën shqipe

Gjuha shqipe ruan elemente të trashëguara nga indoevropianishtja në të gjitha nënsistemet e saj. Këto elemente shfaqen në:

a) Leksik

Shumë fjalë të gjuhës shqipe janë trashëguar nga një fazë e hershme indoevropiane. Ndër to përfshihen:

- emra: *atë, ëmë, bir, bijë, ballë, bark, dorë, gisht, dash, dele, ari, ujk, elb, dimër, mjaltë etj.*;
- mbiemra: *i bardhë, i djathtë, i zi, i gjatë, i madh, i athët, i lig, i vogël, i gjerë etj.*;
- përemra: *ti, mua, ky, kjo, imi etj.*;
- folje me ndryshime të temës: *kam–pata, bie–rashë, shoh–pashë, ha–hëngra, jam–qeshë, dal–dola, marr–mora etj.*

Gjuha shqipe ka trashëguar edhe numërorët nga një fazë e lashtë indoevropiane: *një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë*, përveç *qind* dhe *mijë*, që janë huazime nga latinishtja.

b) Fonetikë

Gjurmë të trashëguara nga indoevropianishtja konsiderohen:

- kundërvënia e zanoreve të gjata dhe të shkurtra, e dëshmuar edhe në gjuhën e vjetër shqipe, si te shembulli i Bogdanit: *e derdh për mbij dheet*;
- disa ndërrime fonetike, që vërehen te çiftet e foljeve si *marr–mora, dal–dola etj.*

c) Strukturë gramatikore

Gjurmë të indoevropianishtes shfaqen në disa prej veçorive të sistemit gramatikor të shqipes, si:

- sistemi me tri gjini (mashkullore, femërore, asnjane), i cili sot është në proces reduktimi drejt dy gjinive;
- prania e mbaresave të veçanta në lakim dhe në zgjedhim;
- forma foljore të trashëguara nga indoevropianishtja, ku disa folje ndërtohen me tema të ndryshme në kohë të ndryshme, si: *jam–qeshë, kam–pata, jap–dhashë* etj.

Gustav Majeri me studimet e tij hapi një etapë të re në përcaktimin e vendit të shqipes brenda gjuhëve indoevropiane. Duke analizuar me kujdes fjalët e trashëguara dhe duke i ndarë ato nga elementet e huazuara, ai e përfshiu shqipen në grupin e gjuhëve indoevropiane lindore dhe njëkohësisht veriore.

Tezat për prejardhjen e gjuhës shqipe

Gjuha shqipe është shumë e vjetër dhe ka kaluar një rrugëtim të gjatë historik. Studiuesit janë përpjekur të zbulojnë nga cila gjuhë e lashtë rrjedh ajo, dhe për këtë kanë paraqitur disa mendime shkencore, të quajtura teza.

Tezat kryesore janë:

- Teza ilire – sipas kësaj teze, shqipja vjen nga ilirët, populli i lashtë i Ballkanit Perëndimor.

> Sot kjo është teza më e pranuar.

- Teza trake – e lidh shqipen me trakët e Ballkanit Lindor.
- Teza dako-mize – e lidh gjuhën me dakët dhe mizët, popuj të veriut dhe verilindjes së Ballkanit.

- Teza pellazge – e lidh gjuhën shqipe me pellazgët; edhe disa përfaqësues të Rilindjes Kombëtare e mbështetën këtë tezë, megjithatë ajo ka pak dëshmi shkencore.

Shumica e studiuesve pajtohen se shqipja ka prejardhje ilire, sepse ilirët kanë jetuar në zonat ku sot flitet shqipja dhe disa emra e elemente të lashta lidhen më afër me tipare të shqipes. Ndër studiuesit që kanë mbështetur këtë mendim janë J. Tunmani, U. Liku, F. Miklosiçi, G. Majeri, H. Pedersen, P. Kreçmeri, N. Jokli, E. Çabeji, I. Ajeti, A. Buda etj.

Fjalorth

indoevropiane – gjuhë shumë të vjetra të Evropës dhe të Azisë.

gjuhë e trashëguar – e ruajtur nga lashtësia.

huazim – fjalë e marrë nga një gjuhë tjetër.

tezë – mendim shkencor që shpjegon një çështje.

autokton – popull që ka jetuar në të njëjtin vend që nga lashtësia.



Mos harro!

- Gjuha shqipe i përket familjes së gjuhëve indoevropiane.
- Shumë fjalë të përditshme janë shumë të vjetra (*atë, bir, dorë, ujk* etj.).
- Disa folje kanë dy tema: *marr–mora, ha–hëngra, jam–qeshë*.
- Një gjuhë shuhet kur nuk ka më folës që e përdorin në jetën e përditshme.
- Numërorët *një–dhjetë* janë të trashëguar.
- Gjuha shqipe vjen nga ilirishtja dhe shqiptarët janë pasardhës të ilirëve.



Detyrë për në shtëpi

1. Në cilën familje gjuhësore bën pjesë gjuha shqipe?
2. Cili gjuhëtar e vërtetoi i pari përkatësinë indoevropiane të shqipes?
3. Cilët studiues kanë dhënë ndihmesa të rëndësishme për prejardhjen e shqipes?
4. Në cilat nënsisteme të gjuhës shqipe ruhen elemente të trashëguara indoevropiane?
5. Cilat janë tri gjinitë e sistemit gramatikor të shqipes?



Ushtrime

Klasifikimi i fjalëve

Vendosi fjalët në kategoritë e duhura:

atë, gisht, mjaltë, i zi, i gjerë, ky, kjo, mua, marr–mora, jam–qeshë

- Emra të trashëguar: _____
- Mbiemra të trashëguar: _____
- Përemra të trashëguar: _____
- Folje me dy tema: _____

ZHVILLIMI HISTORIK I GJUHËS SHQIPE

Gjuha shqipe në shekujt XVIII–XIX

Gjatë shekujve XVIII dhe XIX, gjuha shqipe kaloi një periudhë të rëndësishme zhvillimi. Në këtë kohë, shumë intelektualë shqiptarë u angazhuan për ta forcuar dhe përhapur gjuhën shqipe në arsim, kulturë dhe botime.

Ëvetari i Naum Veqilharxhit (1844–1845) u përhap në shumë zona dhe ndihmoi për mësimin e shkrim-leximit në gjuhën amtare. Ky ëvetar (abetar) shënoi një hap themelor drejt arsimit shqip.



“Nuk ka këshillë më të keqe nga ajo që e shtyn njeriun të mohojë kombin e vet.”
Naum Veqilharxhi



Naum Veqilharxhi



Në fund të shekullit XIX u formuan shoqëri kulturore që punonin për përhapjen e shkrimit shqip. “Shoqëria e të shtypurit shkronja shqip” (1879) botoi libra dhe tekste mësimore në gjuhën shqipe, duke kontribuar dukshëm në zhvillimin e gjuhës së shkruar.

Gjatë kësaj periudhe u hartuan edhe gramatikat e para me qëllim vendosjen e rregullave të qarta për përdorimin e gjuhës. Ndër figurat më të rëndësishme të kësaj kohe ishte Kostandin Kristoforidhi, i cili punoi për drejtshkrimin, pasurimin e leksikut dhe afrimin e dialekteve. Vepra e tij u bë bazë për zhvillimin e mëvonshëm të gjuhës standarde shqipe.



Kostandin Kristoforidhi

Këto përpjekje, pra abetaret, shoqëritë kulturore, gramatikat dhe puna e studiuesve, krijuan themelet e gjuhës së njësuar shqipe, e cila u plotësua më vonë në shekullin XX.

Pikëpamjet e rilindësve për gjuhën shqipe



Përfaqësuesit e Rilindjes Kombëtare e shihnin gjuhën shqipe si pjesë të identitetit kombëtar dhe si mjet të domosdoshëm për arsimim dhe përparim shoqëror. Ata besonin se populli mund të përparojë vetëm duke përdorur gjuhën e vet në shkolla dhe në jetën publike.

Gjatë kësaj periudhe u theksua edhe nevoja për alfabet të përbashkët, që të kuptohej nga të gjithë shqiptarët. U kërkuan edhe rregulla të qarta shkrimi, në mënyrë që gjuha e shkruar të përdorej njësoj në të gjitha trevat shqiptare. Falë këtyre përpjekjeve, gjuha shqipe u forcua dhe u bë një nga shtyllat kryesore të zgjimit dhe bashkimit kombëtar.

Fjalorth

ëvetar – libri i parë për mësimin e shkrimit dhe leximit në gjuhën shqipe.

leksik – fjalët e një gjuhe.



Mos harro!

- “Ëvetari” i Naum Veqilharxhit është libri i parë për mësimin e shkrimit dhe leximit në gjuhën shqipe.
- “Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip” punoi për botimin dhe përhapjen e librave shqip.
- Kostandin Kristoforidhi ndihmoi në pastrimin dhe pasurimin e gjuhës, si edhe në afrimin e dialekteve.
- Rilindësit e shihnin gjuhën shqipe si mjet bashkimi dhe përparimi.
- Në shekullin XIX u kërkua alfabet i përbashkët dhe mënyrë e njëjtë shkrimi për të gjithë shqiptarët.



Detyrë për në shtëpi

1. Çfarë roli pati “Ëvetari” i Veqilharxhit?
2. Pse u krijua “Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip”?
3. Në çfarë mënyrash ndihmoi Kostandin Kristoforidhi gjuhën shqipe?
4. Pse rilindësit kërkonin alfabet të përbashkët?



Ushtrime

Zgjidh përgjigjen e saktë

1. “Ëvetari” ishte:
 - A) një fjalor
 - B) një gramatikë
 - C) libri i parë për shkrim-lexim në gjuhën shqipe
2. Kristoforidhi punoi kryesisht për:
 - A) dialektet dhe drejtshkrimin
 - B) letërsinë humoristike
 - C) muzikën popullore
3. “Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip” u krijua për:
 - A) botimin e librave shqip
 - B) botimin e librave në turqisht
 - C) hapjen e shkollave greke
4. Rilindësit kërkonin:
 - A) disa alfabetet të ndryshme
 - B) alfabet të përbashkët
 - C) vetëm dialektet lokale

FONETIKA DHE RREGULLAT DREJTSHKRIMORE TË ZANOREVE DHE BASHKËTINGËLLOREVE

Zanoret dhe bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe: shkrimi dhe shqiptimi i tyre

Fonetika merret me tingujt e të folurit. Ajo shpjegon se si formohen tingujt, si shqiptohen dhe si i dëgjojmë gjatë të folurit. Gjuha shqipe ka gjithsej 36 tinguj. Tingujt quhen fonema (nga greqishtja *phoné* – zë). Në të shkruar, çdo tingull ka shkronjën e vet dhe çdo shkronjë përfaqëson një tingull të vetëm. Për këtë arsye, shkrimi i gjuhës shqipe është i rregullt dhe i lehtë për t'u mësuar.

Gjuha shqipe ka 36 shkronja:

7 zanore: a, e, ë, i, o, u, y

29 bashkëtingëllore: b, c, ç, d, dh, f, g, gj, h, j, k, l, ll, m, n, nj, p, q, r, rr, s, sh, t, th, v, x, xh, z, zh

Nga këto shkronja, 27 janë të thjeshta (si: a, b, c, d, e, g etj.) dhe 9 janë të përbëra (si: dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh). Shkronjat e përbëra quhen edhe dyshkronjës, sepse shkruhen me dy shkronja, por shqiptohen si një tingull i vetëm.

Zanoret janë tinguj që shqiptohen pa pengesa në gojë. Bashkëtingëlloret janë tinguj që shqiptohen me pengesë në gojë, e cila krijohet nga buzët, dhëmbët, gjuha ose pjesë të tjera të aparatit të të folurit.

Drejtshkrimi i fjalëve me zanoren e në pozicione të ndryshme

🔊 Zanorja e shqiptohet me hapje mesatare të gojës, pak më të madhe se te i-ja.

Zanorja e e theksuar

Zanorja e shkruhet gjithmonë e (dhe jo ë) kur është e theksuar dhe pas saj vjen një bashkëtingëllore hundore (m, n, nj). Me e shkruhen edhe fjalët e prejardhura ose të përbëra që dalin nga këto forma, edhe kur theksi lëviz. P.sh.:

- o dhemb, dhembje; emër, emëror; femër, femëror; shembull, shembullor;
zemër, zemëroj;

- o argjend, argjendar; çmend, çmendur; qendër, qendror;
- o qen, e enjte, penj, shenjë;
- o fle, dre, fre, gdhe, pe, ngre etj.

Zanorja e e patheksuar (fundore)

Tek emrat e gjinisë femërore që përfundojnë me e të patheksuar në trajtën e pashquar njëjës, kjo e:

- hiqet tek emërorja e shquar njëjës,
- por, ruhet në rasat e tjera. Psh.:
- o artiste, artistja, artisteje
- o mësuese, mësuesja, mësueseje
- o nxënëse, nxënësja, nxënëseje
- o fitore, fitorja, fitoreje
- o lule, lulja, luleje
- o lulishte, lulishtja, lulishteje
- o anije, anija, anijeje
- o ardhje, ardhja, ardhjeje
- o çështje, çështja, çështjeje
- o rrokje, rrokja, rrokjeje

Drejtshkrimi i fjalëve me zanoren ë në pozicione të ndryshme

 Zanorja ë - goja është pak më e mbyllur se te e-ja; gjuha tërhiqet lehtë prapa.

A. Shkruhen me ë

1. Zanorja ë e theksuar

Me ë shkruhen fjalët ku kjo zanore është e theksuar dhe pas saj vjen një bashkëtingëllore hundore (*m, n, nj*). Me ë shkruhen edhe fjalët e prejardhura dhe ato të përbëra që dalin prej tyre. Psh.:

- *dëm, dhëmb, dhëndër, dhënë, e ëma, e ëmbël, ëndërr, ëndje, shkëmb, mëngë, zënë etj.*
- *i dëmshëm, dhëmbor, ëmbëltoje, shkëmbor, parathënie, shtatzënë, gojëdhënë etj.*

Fjalët me prapashtesën –llëk shkruhen me ë:
budallallëk, pazarllëk, hamallëk, gomarllëk etj.

✓ B. Shkruhen me **ë** paratheksore

1. Zanorja **ë** paratheksore

Ë-ja shkruhet kur vjen para rrokjes së theksuar, pra në rrokjen që i paraprin theksit, ose kur ndodhet në rrokjen e parë të fjalës:

a) Në fjalët e parme

*kush**ë**ri, mall**ë**ngjej, shnd**ë**rroj, trash**ë**goj; d**ë**shirë, k**ë**ndoj, k**ë**netë, m**ë**nyrë, l**ë**vozhgë, d**ë**boj, d**ë**borë, d**ë**rrasë, k**ë**shillë, i (e) k**ë**tillë, etj.*

b) Në fjalët e prejardhura

kur tema përfundon me **-ë** dhe prapashtesa nis me bashkëtingëllore: *an**ë**tar, anëtar**ë**si, bardh**ë**si, flak**ë**rimë, gjuh**ë**tar, gjuh**ë**sor, tok**ë**sor, frik**ë**soj, këmb**ë**sor, urt**ë**si etj.*

c) Në fjalët e përbëra dhe të përngjitura

kur pjesa e parë përfundon me **-ë** dhe pjesa e dytë fillon me bashkëtingëllore: *an**ë**shkrim, at**ë**herë, bashk**ë**nxënës, der**ë**bardhë, goj**ë**dhënë, gjith**ë**kombëtar, hund**ë**shkabë, goj**ë**mjaltë, v**ë**rejtje, çfar**ë**do, mbar**ë**vajtje etj.*

ç) Në fjalët e prejardhura që dalin nga tema që mbarojnë me: **-ër, -ërr, -ël, -ës, -ëz**. Psh.:

- **-ër**: arb**ë**ror, dim**ë**ror, dh**ë**lp**ë**ri, gjarp**ë**rinj, mjesht**ë**ri, urdh**ë**resë etj.;
- **-ërr**: ënd**ë**rrim, ënd**ë**rroj, pic**ë**rrimë etj.;
- **-ël**: zvog**ë**loj, zvog**ë**lim, vog**ë**limë, vegj**ë**li etj.;
- **-ës**: nëpun**ë**si, përgjegj**ë**si, gryk**ë**si rrobaqep**ë**si etj.;
- **-ëz**: bul**ë**zoj, njer**ë**zor, njer**ë**zi etj.

✓ C. Shkruhen me **ë** pastheksore

1. Emrat dhe mbiemrat që përfundojnë me: **-ës, -ësh**

Shkruhen me **ë** në të gjitha trajtat e lakimit:

- *bler**ës**, bler**ë**sin, bler**ë**sit, bler**ë**sve, i, e një bler**ë**si;*
- *nxën**ës**, i, e një nxën**ë**si, nxën**ë**sit, nxën**ë**sin, nxën**ë**sve;*
- *gjykat**ës**, gjykat**ë**sja, gjykat**ë**sit;*
- *Durr**ë**si, Durr**ë**sit, Durr**ë**sin, i, e Durr**ë**sit; Kuk**ë**si, Kuk**ë**sit, Kuk**ë**sin, i, e Kuk**ë**sit, etj.*

2. Emrat që përfundojnë me **-ësh**

- *trekënd**ësh**, trekënd**ë**shi, trekënd**ë**shat, pes**ësh**ja, qind**ësh**ja, qind**ësh**eve, tetërrok**ësh**-i;*
- *(shtëpi) dykat**ësh**e, (ndërtesë) katërkat**ësh**e, (lule) shumëngjyr**ësh**e etj.*

3. Mbiemrat që përfundojnë me –ët

- *i cekët, të cekët, të cekëtit;*
- *i lagët, i/e lagëtit, të lagëtin;*
- *i kthjellët, e kthjellët, i/e të kthjellëtit, të kthjellëtin etj.*

X Ç. Nuk shkruhet ë-ja pastheksore:

• Tek emrat me prapashtesat -ël, -ër, -ërr dhe në format me -izëm, -azëm gjatë lakimit, ku ë-ja pas theksit bie: *pupël – pupla; dhelpër – dhelpra – dhelprës – dhelprën, dhelprave; ajër – ajri; kokërr – kokrra; çiklizëm – çiklizmi, anarkizëm – anarkizmi etj.*

• Te mbiemrat me -ëm, -shëm gjatë ndërrimit të gjinisë, ku ë-ja e patheksuar nuk ruhet: *i jashtëm – e jashtme; i sotëm – e sotme, i thyeshëm – e thyeshme, i vetëm – e vetme etj.*

• Te gjymtyra e parë e trajtave të përngjitura të habitores, ku ë-ja pas theksit bie: *marrë – marrkam; zënë – zënkam; lënë – lënkam etj.*

Drejtshkrimi i fjalëve me zanoren ë fundore

Zanorja ë fundore shkruhet në këto raste:

1. Tek emrat e gjinisë femërore

Zanorja ë shkruhet në fund të emrave të gjinisë femërore në të gjitha trajtat e lakimit: *bukë, bukës, bukën, fjalë, fjalës, dhjetë, dhjetës, dhjetën, dhjetëra, punë, punës, zhurmë, zhurmës etj.*

2. Te disa emra të gjinisë mashkullore që lakohen si femërore në trajtën e shquar, si:

babë, dajë, gegë, toskë, Kolë, Lekë etj.

3. Te disa emra të gjinisë mashkullore që kanë temë me ë, si:

atë, burrë, djallë, gjumë, lëmë, lumë, brumë, djathë, mjaltë, ujë etj.

4. Te mbiemrat e formuar me prapashtesën –të, kur krijohen nga emra njërrrokësh ose nga tema me theks në rrokjen e fundit:

(ar) *i/e artë*, (dru) *i/e drunjtë*, (gur) *i/e gurtë*, (lesh) *i/e leshtë*, (thaj) *i/e thatë*, (mpij) *i/e mpijtë*, etj.

5. Te numërorët rreshtorë:

(përveç i/e katërt):

(dy) *i/e dytë*, (pesë) *i/e pestë*, (tre) *i/e tretë*, (milion) *i/e njëmiliontë*, (njëzet) *i/e njëzetë* etj.

6. Te trajtat e shumësit të emrave dhe mbiemrave mashkullorë, si:

afrikanë, amerikanë, francezë, grekë, kilogramë, përtacë, maturantë, romakë, rosakë, shoferë, shqiptarë, kroatë, lejlekë etj.

7. Tek emrat e formuar me prapashtesën –zë, si:

qelizë, syzë, vezë, dorezë, librezë, varrezë, kokrrizë etj.

8. Tek emrat e gjinisë femërore që përfundojnë me –më, si:

dasmë (dhe jo: dasëm), *diafragmë, gjysmë* (dhe jo: gjysëm), *krismë, nismë* etj.

9. Te pjesoret e foljeve, si:

qarë, blerë, fryrë, vjelë, mbjellë, sjellë, marrë, ngrirë, bërë, pirë, larë etj.

10. Te çiftet mbiemër–ndajfolje, mbiemri shkruhet me **ë** në fund, ndërsa ndajfolja pa **ë**:

i/e drejtë – drejt (☞ *njeri i drejtë* → ☞ *flet drejt*);

i/e kotë – kot (☞ *ide e kotë* → ☞ *flet kot*);

i/e lartë – lart (☞ *mur i lartë* → ☞ *ngre zërin lart*);

i/e plotë – plot (☞ *gotë e plotë* → ☞ *e mbush plot*);

i/e shpejtë – shpejt (☞ *makinë e shpejtë* → ☞ *ecën shpejt*);

i/e thjeshtë – thjesht (☞ *detyrë e thjeshtë* → ☞ *e shpjegon thjesht*) etj.

Ushtrime

1. Plotëso me **e** ose **ë**:

1. më dh__mb dora;
2. sh__mbull;
3. zem__r;
4. q__ndër;
5. sh__një.

2. Formo trajtën e shquar njëjës (p. sh.: lindje → lindja):

1. mësuese → _____
2. nxënëse → _____
3. çështje → _____
4. anije → _____
5. ardhje → _____

3. Mbiemër–ndajfolje (plotëso sipas modelit):

Modeli: ☞ *njeri i drejtë* → ☞ *flet drejt*

1. ☞ *mur i lartë* → ☞ _____
2. ☞ *detyrë e thjeshtë* → ☞ _____
3. ☞ *gotë e plotë* → ☞ _____
4. ☞ *makinë e shpejtë* → ☞ _____
5. ☞ *ide e kotë* → ☞ _____

Zanorja **u**

 Zanorja **u** shqiptohet duke tërhequr gjuhën prapa dhe duke e ngritur shpinën e saj; buzët rrumbullakosen.

Me -u- shkruhen emrat dhe mbiemrat me -ull dhe -ur, si edhe fjalët e formuara prej tyre, si: *akull, kukull, kumbull, mjegull, nofull, petull, rrotull, sqetull, shembull, shpatull, vetull*, si edhe: *mashkull, flutur, hekur, lepur, i bukur, bukuri, bukuroshe etj.*

 Me u dhe jo me y shkruhen edhe fjalë si: *bulmet – bulmetore, fruta – frutore, gjurmë – gjurmoj, tunel, temperaturë, turk – turqisht, turli, duzinë, kurbet etj.*

 Me y dhe jo me u (as me i) shkruhen fjalë si: *byrek, dyshek, fryt – i frytshëm, gjynah – gjynahqar, mysliman – myslimane, myshteri, natyrë – natyror, qymyr – qymyror, tyrbe, yndyrë – yndyror, virtyt etj.*

Grupet e zanoreve në gjuhën shqipe

Mbani mend: Kur dy zanore vijnë pranë njëra-tjetrës dhe secila shqiptohet si rrokje më vete, kemi të bëjmë me grup zanor. P.sh.:

ftua → ftu-a

mësuam → më-su-am

Në gjuhën shqipe më të shpeshta janë këto grupe të zanoreve: ua, ue, ie, ye.

ua: *ftua, grua, muaj, përrua, thua, bluaj, druaj, quaj, ruaj, mësuam, punuam;*

ue: *dëgjues, edukues, mësues, i dëgjueshëm, i gëzueshëm;*

ye: *arsye, dyer, krye, kryesor, lyej, ngjyey, i pëlqyeshëm, pyes, i shkëlqyeshëm;*

ie: *diell, qiell, miell etj.*

 **KUJTOJMË:** Rrokje quajmë një tingull ose grup tingujsh, që shqiptohet me një të nxjerrë të frymës.

Te grupet e zanoreve, secila zanore formon rrokjen e vet. P.sh.: *py-es, di-ell, mi-ell, dë-gju-es*. Në grupet e zanoreve, theksi bie te zanorja e parë. Këto grupe duhet të shkruhen dhe të shqiptohen të plota, si p.sh.: *dua, shkruaj, punuar, mësues, dëgjues, shikues, diell, miell.*

Duhet shmangur përdorimin e formave: **du* (për *dua*), **shkruj* (për *shkruaj*), **punu* (për *punuar*), **mësus* (për *mësues*).

Diftongjet në gjuhën shqipe

Diftong kemi kur dy tinguj zanorë shqiptohen së bashku brenda një rrokjeje të vetme. Në këtë rast, njëri prej tyre nuk shqiptohet si zanore e plotë, por merr vlerën e një gjysmëzanoreje. Prandaj diftongu nuk ndahet në dy rrokje. P.sh.:

- ai → *babai, vëllai;*

- au → *kau, lau, thau*;
- oi → *shkoi, ftoi, punoi*;
- ia → *ia tha, ia mori etj.*

Shembuj të tjerë: *vais, kloun, kuintal, kuotë* etj.

Kujdes!

Jo çdo takim zanoresh formon diftong. Diftong kemi kur dy tinguj zanorë shqiptohen në një rrokje. Grup zanor kemi kur dy zanore vijnë pranë njëra-tjetrës, por shqiptohen veçmas dhe u përkasin dy rrokjeve të ndryshme, si te: *di-ell, mi-ell, dë-gju-es, py-es*.



Fjalorth

vais – përkulet nga njëra anë, anon, p.sh.: vaisi peshorja.

kloun – artist cirku që vishet, maskohet e bën lëvizje për të qeshur.

kuintal – njësi e madhe e peshës, e barabartë me njëqind kilogramë.

kuotë – lartësi e një vendi, e shënuar me një numër në hartë, p.sh.: jemi në kuotën 1935.



Mbani mend!

Në pajtim me shqiptimin e sotëm të gjuhës shqipe, disa fjalë shkruhen me ç: *i moçëm, pesë vjeç*. Por në trajta të tjera të fjalës vit shkruhet t: *para dhjetë vjetësh, pas dhjetë vjetësh*.



Sa kuptove?

Plotëso fjalitë:

1. Kur dy zanore shqiptohen si dy rrokje, kemi _____.
2. Kur dy zanore shqiptohen si një rrokje, kemi _____.
3. Te diftongjet, zanorja e mbyllur është _____.



Shihni fjalët me shkronja të zeza dhe shkruajini drejt.

1. Du të lexoj → _____;
2. Do të shkruj → _____;
3. Kam punu → _____;
4. Ai është mësues → _____.



Nënvizo grupin e zanoreve të fjalëve të mëposhtme:

1. grua
2. diell
3. mësues
4. arsyë
5. punuam

Sfidë gjuhësore

Gjej dhe shkruaj:

- një fjalë me diftongun au: _____
- një fjalë me grupin zanor ye: _____
- një fjalë me diftongun oi: _____
- një fjalë me grupin zanor ie: _____

Punë në çift

Në mëngjes, sapo doli dielli, nxënësit u mbledhën në oborrin e shkollës. Një grua kaloi pranë portës dhe i përshëndeti me buzëqeshje. Ata po flisnin për një arsye të vogël që i kishte shqetësuar dje. Në klasë, mbi tryezë ishte hedhur pak miell për një punë praktike. Pak më vonë, pranë shkollës kaloi një automobil, ndërsa nxënësit vazhduan bisedën për fjalët me grupe zanoresh dhe diftongje. Gjatë një prove, peshorja vaisi pak nga njëra anë dhe të gjithë qeshën. Në fund të orës, secili e kuptoi më qartë dallimin mes tyre.

Detyra: Nga teksti i dhënë, njëri nxënës gjen një fjali në të cilën ka një fjalë me grup zanor, ndërsa tjetri gjen një fjali në të cilën ka një fjalë me diftong. Më pas, i lexoni para klasës.

TAKIME BASHKËTINGËLLORESH

Takimi i g-së ose i n-së me j-në

Kur në një fjalë takohen g-ja ose n-ja me j-në, ndërmjet tyre shkruhet i, që fjala të shqiptohet saktë dhe të mos dalë tingulli gj ose nj. Prandaj shkruajmë: *djegie, lagie, shmangie, shtangie*, si edhe: *biologe – biologia, filologe – filologia, gjeologe – gjeologia, kirurge – kirurgia, pedagoge – pedagogia, radiologe – radiologia*. Po sipas këtij rregulli shkruhen: *(unë) lagia – (ti) lagie, (unë) shmangia – (ti) shmangie*; fjalët: *dhënie, lënie, marrëdhënie, ngrënie, qenie, rënie, thënie, zënie*, si edhe emrat: *dibrania, indiania, italiania, koreania, partizania, shkodrania* etj.

Takimi i d-së me t-në

Kur në një fjalë vjen d-ja pranë t-së, të dyja shkruhen, pra nuk hiqet as d-ja, as t-ja. Këtë e shohim te fjalë si: *(i, e) argjendtë, (i, e) njëmendtë, (i, e) njëqindtë, (i, e) pesëqindtë, i treqindtë*, si edhe te trajtat foljore: *ai po e bindte, në e bindte, po endte, lindte, në lindtë djalë, nuk mundte, rendte, shkundte, tundte* etj.



Mbani mend!

Në pajtim me shqiptimin e sotëm të gjuhës shqipe, disa fjalë shkruhen me ç: *i moçëm, pesë vjeç*.

Por në trajta të tjera të fjalës vit shkruhet t: *para dhjetë vjetësh, pas dhjetë vjetësh*.

Takimi i t-së me sh-në

Te mbiemrat e formuar me prapashtesën -shëm dhe te trajtat e dëshirores, kur sh-ja e prapashtesës takohet me -t-në e temës, shkruhen të dyja bashkëtingëlloret, pra pa u asimiluar në ç. Në këtë mënyrë shkruhen mbiemrat, si: *i begatshëm, i çuditshëm, i mërzitshëm, i ndritshëm, i përbotshëm, i përditshëm, i përbotshëm, i përshtatshëm, i përvitshëm, i sotshëm, i vjetshëm* et., si edhe trajtat e dëshirores: *arritsha, arritsh, arritshim, arritshi, arritshin; ditsha, fjetsha, goditsha, gjetsha, këputsha, matsha, mbetsha, ndritsha, ngritsha, ngutsha, pritsha, shëtitsha, tretsha, vërtitsha, vërvitsha* etj. Përfundimisht bëjnë format: *paça dhe vajça (m. dëshirore e foljes vajt-/vete-: shkofsha)*.

Takimi i d-së, s-së, t-së ose i z-së me h-në

Kur në një fjalë takohet d-ja, s-ja, t-ja ose z-ja me h-në që vjen pas tyre, këto shkronja shkruhen bashkë, pa shenjë ndarëse, por shqiptohen veç e veç. Kështu shkruajmë: *i herëpashershëm, meshollë, moshapje, moshyrje, shtathedhur, brezhumbur, gazhedhëse* etj. Sipas këtij rregulli shkruhen edhe disa emra të përveçëm, si: *Bethoven, Ethem, Mithat* etj.

Grupet e bashkëtingëlloreve: mb, nd, ng, ngj

💡 Ta dini se grupet bashkëtingëllore mb, nd, ng, ngj shkruhen gjithmonë të plota, si në fillim, në mes dhe në fund të fjalës.

mb: *mbaj, mbaroj, mbjell, mbush, dhëmbë, i ëmbël, këmbë, kumbull, shkëmb* etj;

nd: *ndaj, ndez, ndërtoj, ndihmoj, ndjek, ndiej, ndodhem, fund, mend, vend, mund* etj;

ng: *nga, ngarkoj, ngroh, ngrihem, ngushtë, peng, shmang* etj;

ngj: *ngjaj, ngjall, i ngjashëm, ngjitem, ngjyra, engjëll* etj.

Takimi i dy bashkëtingëlloreve të njëjta

💡 Ta dini se kur gjatë formimit të fjalëve takohen dy bashkëtingëllore të njëjta, ato shkruhen të dyja. P.sh.: *kënddrejtë, nëndarje, mossulmim, zëvendëssekretar, i kujdesshëm, shpeshherë, mishshitës, veshshkurtër, në arritë, e gjettë e mira, në pyettë, në më prittë* etj.

 Mbani mend!

- Kur takohen r me rr ose l me ll, shkruhet vetëm rr ose ll: *përreth, dembellëk, hamallëk, jeshillëk* etj.
- Lidhëza *pasi* (*mbasi*) shkruhet me një s, sepse është formuar nga bashkimi i fjalëve *pas + si* (ose *mbas + si*). Prandaj nuk shkruhet me dy s. P. sh.: *Pasi u kthye nga shkolla, filloi detyrat.* (jo: *passi*)
- Në disa forma foljore shkruhet -st dhe jo -tt: *(do të) fliste, (do të) maste, (do të) priste, (do të) shëtiste, (do të) vriste* etj.

 Ushtrime

-  1. Ndaji fjalët sipas grupeve të bashkëtingëlloreve: *mbaj, ndez, ngrihem, ngjall, shkëmb, vend, shmang, engjëll.*

mb – *mbaj*,

nd –

ng –

ngj –

-  2. Provoje veten! Rretho fjalën e shkruar saktë:

djegje / djegie

i njëmendë / i njëmendtë

përditçëm / përditshëm

passi / pasi

-  3. Plotëso fjalët me shkronjat që mungojnë.

djeg()e _____;

shmang()e _____;

njëmend()ë _____;

i përdi()shëm _____;

kën()drejtë _____.

-  4. Në fjalitë e mëposhtme nënvizo fjalën e shkruar gabim:

Ai ishte i përditçëm në punë.

Passi u kthye nga shkolla, i filloi detyrat.

Nëse të pyet shoku për librin, thuaji se e kam unë.

Zjarri shkaktoi djegje të madhe të pyllit.

INTONACIONI. LLOJET E INTONACIONIT. THEKSI I FJALISË

Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni si ndryshon kuptimi i tyre vetëm nga shenja e pikësimit dhe intonacioni i zërit:

Pohim:  Pi çaj çdo mëngjes.

Pyetje:  Pi çaj çdo mëngjes?

Habi:  Pi çaj çdo mëngjes!

Urdhër:  Pi çaj çdo mëngjes!

 Çfarë vërejtët gjatë shqiptimit të fjalive? A ishte toni i zërit i njëjtë apo ndryshonte? Si e shënojmë këtë ndryshim në të shkruar?

 Fjalët janë të njëjta, por fjalia merr kuptime të ndryshme, sepse ndryshon intonacioni.

Intonacioni

Kur flasim, zëri ynë herë ngrihet, herë ulet. Ky ndryshim i tonit të zërit gjatë shqiptimit të fjalisë quhet intonacion. Falë intonacionit dallojmë nëse fjalia shpreh pohim, pyetje, habi ose urdhër.

Edhe një fjalë e vetme mund të jetë fjali, nëse shoqërohet me intonacionin e duhur:

 Mëson.

 Mëson?

 Mëson!

Një fjali quhet e plotë vetëm kur ka intonacion të mbaruar.

Llojet e intonacionit sipas kumtimit

Fjalitë dallohen edhe sipas mënyrës së kumtimit të mendimit. Këtë dallim e bëjmë me ndihmën e intonacionit. Llojet e intonacionit i përdorim çdo ditë në të folur. Tani të shohim se si intonacioni na ndihmon të dallojmë llojet e fjalive sipas kumtimit.

Fjalia dëftore

Fjalia dëftore shërben për të kumtuar një mendim. Ajo ka intonacion zbritës në fund të fjalisë. Psh.:

Sot kemi test.

Nxënësit janë në klasë.

Fjala pyetëse

Fjala pyetëse përdoret për të pyetur për diçka që nuk e dimë ose kur duam të sigurohemi për diçka. Ajo ka intonacion ngjitur. P. sh.:

A erdhi në shkollë sot?

Kush e ka librin tim?

Fjala nxitëse

Fjala nxitëse shpreh vullnetin e folësit për të nxitur dikë të kryejë ose të mos kryejë një veprim të caktuar. P.sh.:

Dëgjo me vëmendje!

Mos fol gjatë orës!

Intonacioni i këtyre fjalive është zbritës si te fjalitë dëftore. Në fillim të tyre toni është më i lartë se në fjalitë dëftore, kështu që zbritja është më e madhe. Sa më i prerë të jetë urdhri, aq më i lartë është toni në fillim të fjalisë.

Shkruani bukur! Mos kaloni shumë kohë para telefonit! Nxitoni!

Theksi i fjalisë

Çdo fjali ka theksin e saj. Zakonisht theksi bie mbi fjalën e fundit, sepse aty jepet informacioni kryesor. P. sh.:

Sot është një ditë e bukur.

Ne po shkojmë në palestër.

Theksi logjik

Kur duam të veçojmë një fjalë të caktuar, përdorim theksin logjik, pavarësisht vendit të saj në fjali. P. sh.:

- Shoku erdhi sot në shkollë.
- Shoku erdhi sot në shkollë.
- Shoku erdhi sot në shkollë.
- Shoku erdhi sot në shkollë.

Në çdo fjali theksohet një pjesë tjetër e kumtimit.

 Ushtrime


1. Gjej llojin e intonacionit

Shëno me  llojin e saktë të fjalisë:

1. A erdhi mësuesi sot? ☐ pohim ☐ pyetje ☐ urdhër
2. Mos flisni gjatë orës! ☐ pohim ☐ pyetje ☐ urdhër
3. Sot kemi test. ☐ pohim ☐ pyetje ☐ urdhër



2. Dëgjo dhe përcakto llojin e fjalisë (sipas intonacionit)

(Arsimtarja/Arsimtari i lexon fjalitë me zë. Nxënësit shënojnë në kllapa: Pohim, Pyetje, Habi, Urdhër.)

1.  Rri në korridor çdo mëngjes. (_____)
2.  Rri në korridor çdo mëngjes? (_____)
3.  Rri në korridor çdo mëngjes! (_____)
4.  Rri në korridor çdo mëngjes! (_____)



3. Rregullo intonacionin. Vendos shenjën e duhur të pikësimit: (●. ●? ●!)

1. Mos fol gjatë orës ____
2. Sot kemi test ____
3. A erdhi në shkollë sot ____



4. Sfidë e shpejtë. Mësuesi lexon fjalinë:

Rri në karrige drejt.

Njëri nxënës, të njëjtën fjalë, e lexon si:

- pohim 
- tjetri si pyetje 
- tjetri si urdhër 
- tjetri si habi 

Kush e lexon më saktë, merr një plus për lexim të mirë.



5. PROVO VETEN. Rretho përgjigjen e saktë:

1. Fjalja: "Mos fol gjatë orës!" është:
 - a) pohore b) pyetëse c) nxitëse
2. Fjalja: "A erdhi mësuesi?" është:
 - a) pyetëse b) pohore c) nxitëse
3. Theksi i fjalisë zakonisht bie mbi:
 - a) fjalën e parë b) fjalën e fundit c) mes fjalive

MORFOLOGJIA

MBIEMRAT MARRËDHËNIORE



Çfarë janë mbiemrat marrëdhëniorë?

Mbiemrat marrëdhëniorë janë mbiemra që nuk shprehin cilësi të drejtpërdrejta, por tregojnë marrëdhënien e emrit me një send tjetër, me një rrethanë, me një veprim ose me një numër.



Ndryshe nga mbiemrat cilësorë, të cilët tregojnë tipare që mund të maten e krahasohen (*i bukur, i madh, i fortë*), mbiemrat marrëdhëniorë tregojnë vetëm lidhje dhe përkatësi. P. sh.:

- derë e hekurt,
- bluzë e pambuktë,
- shtëpi shtetërore,
- gazetë e sotme,
- program televiziv;
- tekst mësimor.



Çfarë marrëdhëniesh shprehin mbiemrat marrëdhëniorë?

Mbiemrat marrëdhëniorë shprehin disa lloje marrëdhëniesh:



a) Marrëdhënie lëndore (tregojnë nga çfarë lënde përbëhet sendi):

- bankë druri,
- derë hekuri,
- unazë e artë.



b) Marrëdhënie përkatësore (tregojnë se kujt i përket sendi):

- shkollë shtetërore,
- pronë familjare,
- pasuri kombëtare.



c) Marrëdhënie me një veprim (tregojnë lidhjen e sendit me një veprim):

- makinë korrëse,
- makinë mbjellëse,
- gisht tregues.

- ◆ ç) Marrëdhënie me një çast kohor (tregojnë lidhjen me kohën):
 - detyrë e djeshme,
 - gazetë e sotme,
 - orët e vona.
- ◆ d) Marrëdhënie me një pikë hapësinore (tregojnë lidhjen me vendin):
 - dhoma e sipërme,
 - kati i poshtëm,
 - pamja e jashtme.

⚙️ Mënyra e formimit të mbiemrave marrëdhëniorë.
Mbiemrat marrëdhëniorë formohen kryesisht nga:

- ◆ Nga emra:
 - shtet → shtetëror,
 - familje → familjare,
 - qelizë → qelizor,
 - shkollë → shkollor.

- ◆ Nga ndajfolje:
 - dje → i djeshëm,
 - sot → i sotëm,
 - sipër → i sipërm.

- ◆ Nga folje:
 - mbjell → mbjellëse
 - korr → korrëse
 - tregoj → tregues

🗨️ Përdorimi i mbiemrave marrëdhëniorë si emra

Në disa raste, mbiemrat marrëdhëniorë përdoren si emra dhe në fjali kryejnë rolin e emrit. Në këto raste mbiemri përdoret si emër. Kështu, nga mbiemrat marrëdhëniorë *i/e dërguar*, *i ri* / *e re* etj., mund të formohen përdorime emërore, si:

- i dërguari i shkollës,
- i riu i lagjes.

✅ Nga këta shembuj shohim se mbiemrat nuk përcaktojnë më një emër, por përdoren vetë si emra. Prandaj themi se ata janë mbiemra të emëruar.

⚠ Veçoritë kryesore të mbiemrave marrëdhëniorë

Mbiemrat marrëdhëniorë dallohen për këto veçori:

- ✓ nuk tregojnë zakonisht cilësi të drejtpërdrejtë, por lidhje ose përkatësi me diçka tjetër;
- ✓ tregojnë me çfarë lidhet emri, p.sh.: vit shkollor, pushime verore, vendim qeveritar, program televiziv, garë sportive;
- ✓ dallohen nga mbiemrat cilësorë, sepse mbiemrat cilësorë tregojnë si është dikush ose diçka, p.sh.: çantë e bukur, djalë i zgjuar, ditë e ftohtë. Këtu mbiemrat e bukur, i zgjuar, e ftohtë tregojnë cilësi, ndërsa te vit shkollor ose pushime verore, mbiemrat shkollor dhe verore tregojnë lidhje, jo cilësi;
- ✓ zakonisht nuk krahasohen dhe nuk marrin shkallë, kur përdoren me kuptim marrëdhënior. Prandaj nuk themi: më shkollor, më veror, shumë qeveritar, tepër televiziv.

 Shembuj fjalish me përdorimin e mbiemrave marrëdhëniorë:

1. Gjatë vitit shkollor, nxënësit zhvillojnë shumë aktivitete. 2. Pushimet verore fillojnë në qershor. 3. Nxënësit ndoqën një program televiziv për gjuhën shqipe. 4. Ata mësojnë në një shkollë shtetërore. 5. Makina korrëse po punonte në arë. 6. Mjeku bëri një kontroll mjekësor të përgjithshëm.

 Kujdes!

I njëjti mbiemër, sipas kuptimit që merr në fjali, mund të jetë si marrëdhënior, ashtu edhe cilësor. P. sh.: mbiemri *i artë*

- unazë e artë → mbiemër marrëdhënior (*tregon lëndën*),
- nxënës i artë → mbiemër cilësor (*tregon vlerë*).

✓ Pra, kuptimi në fjali (konteksti) vendos nëse mbiemri është marrëdhënior apo cilësor.

 Ushtrime


1. Gjej dhe shëno

Nënvizo vetëm mbiemrin marrëdhënior në secilën fjali:

1. Nxënësit lexuan gazetën e sotme.
2. Dhoma e sipërme ishte e ndriçuar mirë.
3. Nxënësit morën njohuri gjuhësore në orën e shqipes.
4. Nxënësit vizituan muzeun historik të qytetit.
5. Në shkollë u organizua një veprimtari kulturore.



2. Zgjidh sa më shpejt! (M ose C)

Shëno M (marrëdhënior) ose C (cilësor):

- unazë e artë (☐)
- nxënës i artë (☐)
- orë mësimore (☐)
- vajzë e zgjuar (☐)
- gazeta e sotme (☐)



3. Plotësim me kuptim:

Zgjidh mbiemrin e duhur marrëdhënior nga lista dhe plotëso fjalitë:
(e sipërme, kulturor, shtetërore, e sotme)

1. Në shkollë u mbajt një aktivitet _____.
2. Nxënësit lexuan gazetën _____.
3. Ata mësojnë në një shkollë _____.
4. Dhoma _____ ishte më e ndriçuar.



4. Sfidë e shpejtë në klasë

Arsimtarja/Arsimtari zgjedh një nga emrat e mëposhtëm, e thotë me zë ose e shkruan në tabelë. Nxënësit duhet t'i shtojnë një mbiemër marrëdhënior dhe ta lexojnë togfjalëshin e formuar. Mund të përdorin mbiemrat e dhënë, por mirë është të gjejnë edhe shembuj të tjerë të përshtatshëm.

Emra për ushtrim:

ushtrim, rregull, konkurs, vizitë, garë, orar, hartë, punë.

Mbiemra të mundshëm:

gramatikor, drejtshkrimor, letrar, mjekësore, sportive, javor, gjeografike, krijuese.

Shembull:

Arsimtarja/Arsimtari → ushtrim

Nxënësja/Nxënësi → ushtrim gramatikor ✓

Arsimtarja/Arsimtari → rregull

Nxënësja/Nxënësi → _____

Arsimtarja/Arsimtari → konkurs

Nxënësja/Nxënësi → _____

Arsimtarja/Arsimtari → vizitë

Nxënësja/Nxënësi → _____

Arsimtarja/Arsimtari → garë

Nxënësja/Nxënësi → _____

Arsimtarja/Arsimtari → orar

Nxënësja/Nxënësi → _____

Arsimtarja/Arsimtari → hartë

Nxënësja/Nxënësi → _____

Arsimtarja/Arsimtari → punë

Nxënësja/Nxënësi → _____

Ushtrime



5. Mini-test për vlerësim të shpejtë

Rretho përgjigjen e saktë:

1. Cili është mbiemër marrëdhënior?

a) i bukur; b) shtetërore; c) i madh.

2. Mbiemri “profesionale” te togfjalëshi “shkollë profesionale” shpreh marrëdhënie me:

a) kohën; b) drejtimin e shkollës; c) vendin.

3. Në cilin grup fjalësh mbiemri përdoret si emër?

a) klasa e tetë; b) i pesti në radhë; c) nxënës i mirë.

PËREMRA DËFTORË

 Lexoni me kujdes fjalinë e mëposhtme dhe diskutoni për fjalët e theksuara.

 *Këtë libër e lexova sot, po ata të tjerët kur do t'i lexojmë?*

◆ Në këtë fjali, fjala këtë shoqëron emrin libër. Kjo fjalë e veçon këtë libër nga librat e tjerë dhe tregon se ai ndodhet pranë folësit.

◆ Ndërsa fjala ata tregon për libra të tjerë që ndodhen larg folësit.



Mbani mend!

Fjalët që shërbejnë për të veçuar një frymor ose një send nga frymorët ose sendet e tjerë të së njëjtës klasë, quhen përemra dëftorë. Ky lloj përemri tregon frymore ose sende që janë pranë ose larg folësit.

Përemrat dëftorë në gjuhën shqipe

 Përemrat dëftorë janë:

 ky, kjo, këta, këto

— tregojnë frymore ose sende që ndodhen pranë folësit;

 ai, ajo, ata, ato

— tregojnë frymore ose sende që ndodhen larg folësit;

 i tillë, e tillë, të tillë, të tilla

 i këtillë, e këtillë, të këtillë, të këtilla

 i atillë, e atillë, të atillë, të atilla

— tregojnë një tipar të frymorit ose të sendit, për të cilin është folur ose do të flitet më pas.



Mbani mend!

Këta përemra dalin me forma të veçanta:

- për gjininë mashkullore dhe femërore,
- për numrin njëjës dhe shumës,
- në secilën rasë.

Lakimi i përemrave dëftorë (ky, kjo, këta, këto)

Rasa	Njëjës M	Njëjës F	Shumës M	Shumës F
E.	ky	kjo	këta	këto
Gj.	i/e këtij	i/e kësaj	i/e këtyre	i/e këtyre
Dh.	këtij	kësaj	këtyre	këtyre
K.	këtë	këtë	këta	këto
Rr.	këtij	kësaj	këtyre	këtyre

 Përemrat *i tillë, i këtillë, i atillë* lakohen njësoj si mbiemrat e nyjshëm pas emrit, pra ndryshojnë vetëm nyjën.

Trajta e pashquar

Rasa	Njëjës M	Njëjës F	Shumës M	Shumës F
E.	një libër i tillë	një fjalë e tillë	libra të tillë	fjalë të tilla
Gj.	i/e një libri të tillë	i/e një fjale të tillë	i/e librave të tillë	i/e fjalëve të tilla
Dh.	një libri të tillë	një fjale të tillë	librave të tillë	fjalëve të tilla
K.	një libër të tillë	një fjalë të tillë	libra të tillë	fjalë të tilla
Rr.	prej një libri të tillë	prej një fjale të tillë	prej librash të tillë	prej fjalësh të tilla

Trajta e shquar

Rasa	Njëjës M	Njëjës F	Shumës M	Shumës F
E.	libri i tillë	fjala e tillë	librat e tillë	fjalët e tilla
Gj.	i/e librit të tillë	i/e fjalës së tillë	i/e librave të tillë	i/e fjalëve të tilla
Dh.	librit të tillë	fjalës së tillë	librave të tillë	fjalëve të tilla
K.	librin e tillë	fjalën e tillë	librat e tillë	fjalët e tilla
Rr.	prej librit të tillë	prej fjalës së tillë	prej librave të tillë	prej fjalëve të tilla

Dallimi i përemrave vetorë nga përemrat dëftorë

 Përemrat *ai, ajo, ata, ato* përdoren si përemra vetorë dhe si përemra dëftorë, por dallohen sipas përdorimit në fjali.

Përemrat vetorë

-  zëvendësojnë një emër të përmendur më parë;
-  nuk përdoren pranë tij;
-  mund të përdoren pa zanoren nistore a-:

 *fol me ata / fol me ta.*

- ✓ Përemrat dëftorë
- ✓ mund të qëndrojnë në të njëjtën fjali pranë emrit që përcaktojnë:
 ato këngë, ata nxënës;
- ✓ nuk mund të përdoren pa zanoren nistore a-:
 *erdhën ata, i pashë ato*, e assesi: **erdhën ta, *i pashë to*;
- ✓ mund të zëvendësohen nga:
 ky, kjo, këta, këto;
- ✓ mund të shoqërohen me ndajfoljet:
 këtu (*ky këtu*) dhe atje (*ajo atje*).

Ushtrime

-  1. Gjej dhe nënvizo përemrin dëftor
 Nënvizo vetëm përemrin dëftor në secilën fjali:
 1. Kjo fletore është e re. 2. Ata nxënës janë nga klasa e tetë. 3. Ky laps nuk shkruan mirë. 4. Ato libra janë në raftin e sipërm. 5. Një gabim i tillë nuk duhet përsëritur.
- ✓ 2. Zgjidh sa më shpejt! (Pranë apo larg)
 Shëno P (*pranë*) ose L (*larg*):
 • kjo vajzë (_____); • ata djem (_____);
 • ky ushtrim (_____); • ato shtëpi (_____);
 • këta nxënës (_____).
-  3. Plotësim me kuptim:
 Zgjidh përemrin e duhur dëftor nga lista dhe plotëso fjalitë:
 (ajo, ky, këto, kjo, ata)
 1. _____ libër është shumë interesant.
 2. _____ nxënëse është nga klasa jonë.
 3. _____ djem po luajnë në oborr.
 4. _____ fletore janë në çantë.
 5. _____ shtëpi ndodhet në fund të rrugës.
-  4. Përemër vetor apo dëftor?
 Shëno V (vetor) ose D (dëftor).
 1. Fola me ata dje. (_____); 2. Ata nxënës janë shumë të zellshëm. (_____); 3. I pashë ato në bibliotekë. (_____);
 4. Ato libra janë të rinj. (_____).

FOLJA

1. Çfarë është folja?

Folja është pjesë e ligjëratës që tregon veprim, gjendje ose ndodhi. Ajo është bërthama e fjalisë, sepse pa folje nuk mund të kemi fjali. P. sh.:

- Unë lexoj një libër.
- Nesër do të lexoj përsëri.
- Ne shkojmë në shkollë.

Folja dallohet nga pjesët e tjera të ligjëratës, sepse ka disa kategori gramatikore që pjesët e tjera nuk i kanë. Këto janë: diateza, koha dhe mënyra.

Foljet, sipas funksionit dhe kuptimit, ndahen në:

- ❖ Folje me kuptim të plotë leksikor, si: *lexoj, shkruaj, punoj, etj.*;
- ❖ Folje ndihmëse, të cilat shërbejnë për të ndërtuar forma analitike, pra kohë të përbëra¹. Në gjuhën shqipe folje ndihmëse janë *kam* dhe *jam*, kur i paravendosen pjesores së foljes themelore ose para përcjellores, si: *jam duke larë*, si edhe në ndërtimin e së ardhmes me forma të tipit: *kam për të larë, kisha për të larë*.
- ❖ Folje gjysmëndihmëse janë folje që përdoren me kuptim leksikor të zbehur, duke e humbur mëvetësinë e tyre si folje të zakonshme. Të tilla janë:
 - Folja këpujore *jam* – përdoret për të lidhur pjesën emërore të kallëzuesit emëror me kryefjalën, pra shërben si këpujë: *Unë jam i mirë*.
 - Foljet me vlerë modale – folja mund e ndjekur nga një folje në lidhore, folja duhet (a lipset) e ndjekur nga një folje në mënyrën lidhore ose pjesore, folja do e pasuar nga një pjesore e foljes dhe foljet *kam* dhe *jam* të ndjekura nga forma e pashtjellueshme e tipit për të larë.
- ❖ Foljet që shprehin mënyrën e veprimit:
 - a) Folje që përdoren për të shprehur fillimin e një veprimi – filloj, nis, zë, bëj, marr, vihem, të ndjekura nga lidhësi, si: *Dielli filloi të perëndonte pas maleve. Në mbrëmje zuri të binte shi i imët*.
 - b) Folje që tregojnë vazhdimin e një veprimi – vazhdoj, vijoj, të ndjekura nga një folje në mënyrën lidhore, si: *Vazhdoja ta kërkoja edhe pse s'më përgjigjej. Ajo vijonte të qëndronte e qetë*.
 - c) Folje që tregojnë rritjen progresive të një veprimi – folja vij mund të përdoret për të treguar se një veprim ose një gjendje zhvillohet gradualisht, pra shtohet ose pakësohet shkallë-shkallë. Në këtë përdorim, ajo ndiqet zakonisht nga një folje në përcjellore, si: *Temperatura vinte duke u ulur. Zhurma vinte duke u shtuar*. Kur folja vij paraprihet nga lidhëza *sa*, ajo shoqërohet me një folje tjetër të lidhur me *e*, si: *Era sa vinte e forcohej. Zëri sa vinte e dobësohej. Shiu sa vinte e shtohej*.
 - d) Folje që shprehin mbarimin e një veprimi – përdoren foljet *mbaroj* ose *pushoj*, të ndjekura nga forma e ngurosur e rrjedhores së një emri prejpjesor asnjans në trajtën e pashquar, si: *Mbarova së shkruari. Pushova së studiari*.

¹ ➡ Për shpjegimin e kohëve të përbëra, shih kapitullin *Kohët e përbëra të foljes* në këtë libër.

KATEGORIA GRAMATIKORE E MËNYRËS TE FOLJET

Mënyra është një nga kategoritë gramatikore më të rëndësishme të foljes në gjuhën shqipe. Ajo tregon mënyrën se si folësi e paraqet veprimin, pra nëse veprimi jepet si i sigurt, si i dëshiruar apo si i papritur. Sipas mënyrës, ne kuptojmë edhe qëndrimin e folësit ndaj asaj që thotë.

Në jetën e përditshme, zakonisht tregojmë veprime reale dhe të zakonshme. P.sh.: *Çdo mëngjes vij herët në qytet, sepse babai, rrugës për në punë, më afron pranë bibliotekës.* Në këtë fjali, me përdorimin e foljeve vij dhe afron, veprimi paraqitet si i vërtetë dhe real, prandaj foljet janë në mënyrën dëftore.

Por, ndonjëherë ngjarjet na duken të papritura dhe ne i tregojmë me habi. P.sh.: *Kur arrita në shtëpi, pashë dritat ndezur dhe thashë: Sot mysafiri paska ardhur shumë herët.* Në këtë rast, folja paska ardhur është përdorur në mënyrën habitore, sepse shpreh çudi dhe befasi për një veprim të papritur.

Në raste të tjera, ne shprehim dëshira, urime ose shpresa. P.sh.: *Kur e pashë nxënësin që ndihmoi një të moshuar të kalonte rrugën, i thashë me përkëdheli: "U rritsh!"* Në këtë fjali, folja u rritsh është në mënyrën dëshirore, sepse shpreh një urim dhe jo një veprim real të kryer.

Gjuha shqipe ka gjashtë mënyra të foljes: *dëftore, lidhore, habitore, dëshirore, kushtore dhe urdhërore*. Ndër më të veçantat janë mënyra dëshirore dhe mënyra habitore, sepse shumë gjuhë të tjera nuk i kanë këto mënyra në këtë formë si gjuha shqipe. Në gjuhët e tjera, këto kuptime shprehen kryesisht me mjete të tjera gramatikore dhe strukturë më të ndërlikuar fjalish.

Përdorimi i drejtë i mënyrave të foljes e bën komunikimin më të qartë dhe më të saktë, sepse ndihmon që dëgjuesi ta kuptojë më mirë qëllimin dhe kuptimin e asaj që thuhet.

MËNYRA DËFTORE

Mënyra dëftore përdoret për të treguar veprime të vërteta, që:

- kanë ndodhur,
- po ndodhin,
- ose do të ndodhin në të ardhmen.

Me këtë mënyrë ne tregojmë ngjarjet ashtu siç ndodhin në jetën e përditshme.

P.sh.:

- Unë *shkoj* në shkollë çdo ditë.
- Mbrëmë *lexova* një tregim.
- Nesër *do të shkoj* në ekskursion.

Kohët e mënyrës dëftore

Mënyra dëftore ka këto kohë:

1. Koha e tashme

Foljet në kohën e tashme tregojnë veprime që ndodhin në çastin kur flasim ose që përsëriten rregullisht, p.sh.: Ne mësojmë. Nxënësit lexojnë çdo ditë.

2. Koha e kryer

Foljet në kohën e kryer tregojnë veprime që kanë ndodhur para çastit kur flasim.

Në këtë grup përfshihen:

- e pakryera;
- e kryera e thjeshtë;
- e kryera;
- më se e kryera;
- e kryera e tejshkuar.

3. Koha e ardhme

Foljet në kohën e ardhme tregojnë veprime që pritet të ndodhin pas çastit kur flasim. Në këtë grup përfshihen:

- e ardhmja;
- e ardhmja e përparme;
- e ardhmja e së shkuarës;
- e ardhmja e përparme e së shkuarës.

Për shkak të dy dialekteve dhe të folmeve të shumta të shqipes, disa forma kohore kanë përdorim të kufizuar dialektor. Me këto përdorime do të njiheni më hollësisht gjatë shkollimit të mëtejshëm.

Tani të shohim shkurt se si zgjedhohet folja *mësoj* në kohët e mënyrës dëftore:

Koha	Forma
E tashme	(unë) mësoj, (ti) mëson, (ai/ajo) mëson / (ne) mësojmë, (ju) mësoni, (ata/ato) mësojnë
E pakryer	(unë) mësoja, (ti) mësoje, (ai/ajo) mësonte / (ne) mësonim, (ju) mësonit, (ata/ato) mësonin
E kryer e thjeshtë	(unë) mësova, (ti) mësove, (ai/ajo) mësoi / (ne) mësuam, (ju) mësuat, (ata/ato) mësuat
E kryer	(unë) kam mësuar, (ti) ke mësuar, (ai/ajo) ka mësuar / (ne) kemi mësuar, (ju) keni mësuar, (ata/ato) kanë mësuar
Më se e kryer	(unë) kisha mësuar, (ti) kishe mësuar, (ai/ajo) kishte mësuar / (ne) kishim mësuar, (ju) kishit mësuar, (ata/ato) kishin mësuar
E kryer e tejshkuar	(unë) pata mësuar, (ti) pate mësuar, (ai/ajo) pati mësuar / (ne) patëm mësuar, (ju) patët mësuar, (ata/ato) patën mësuar
E ardhme	(unë) do të mësoj, (ti) do të mësosh, (ai/ajo) do të mësojë / (ne) do të mësojmë, (ju) do të mësoni, (ata/ato) do të mësojnë
E ardhme e përparme	(unë) do të mësoja, (ti) do të mësoje, (ai/ajo) do të mësonte / (ne) do të mësonim, (ju) do të mësonit, (ata/ato) do të mësonin
E ardhme e së shkuarës	(unë) do të kem mësuar, (ti) do të kesh mësuar, (ai/ajo) do të ketë mësuar / (ne) do të kemi mësuar, (ju) do të keni mësuar, (ata/ato) do të kenë mësuar
E ardhme e përparme e së shkuarës	(unë) do të kisha mësuar, (ti) do të kishe mësuar, (ai/ajo) do të kishte mësuar / (ne) do të kishim mësuar, (ju) do të kishit mësuar, (ata/ato) do të kishin mësuar



Mbani mend!

Mënyra dëftore përdoret më së shumti në të folur dhe në të shkruar, sepse me të tregojmë ngjarje reale.

MËNYRA LIDHORE

Kjo mënyrë shpreh modalitetin e mundësisë, pra tregon veprime që varen nga një mundësi, një supozim ose një rrethanë që nuk është e sigurt. Me këtë mënyrë nuk shprehet një veprim i kryer me siguri, por një veprim që mendohet, supozohet ose shihet si i mundshëm.

Ashtu si mënyra urdhërore, edhe mënyra lidhore ka katër kohë. Ato janë:

-  Koha e tashme (të shkoj)
-  Koha e pakryer (të shkoja)
-  Koha e kryer (të kem shkuar)
-  Koha më se e kryer (të kisha shkuar)

Modaliteti i mundësisë

Modaliteti i mundësisë shprehet duke ua paravënë foljeve të lidhore folje modale (të cilat i keni mësuar para këtij mësimi), si: mund, do, duhet, si edhe me disa folje të tjera, si: mendoj, dua, shpresoj etj. Këto folje, në fjali të caktuara, tregojnë qëndrimin e folësit ndaj veprimit. Në gjuhësi ato mund të quhen edhe folje me vlerë modale ose folje modaloide. P.sh.:

Unë nuk mund të vij me ju në ekskursion.

Duhet të ketë ardhur tashmë, pasi ashtu u morëm vesh.

Do të kishte ardhur edhe Zana me ne, por i ka ardhur gjyshja nga Suedia.

Mendova të vija edhe unë, por më pas e pashë se ishte e pamundur.

Dua të marr pjesë në konkurs.

Shpresoj të fitojmë garën.

(Në tre shembujt e fundit, foljet: mendova, dua dhe shpresoj kanë vlerë modale, sepse tregojnë qëndrimin e folësit ndaj foljeve në mënyrën lidhore: të vija, të marr, të fitojmë. Në trajtimet gjuhësore, siç u përmend edhe më lart, quhen edhe folje modaloide.)

Lidhorja pa folje modale

Edhe pse më rrallë, lidhorja mund të përdoret edhe pa u paraprirë nga folje modale ose nga folje të tjera me vlerë modale. Në këto raste, ajo shpreh hamendje, dyshim ose pohim të pasigurt. P.sh.:

Të ketë ardhur tashmë?

Të jesh a të mos jesh – kjo është çështja.

Pjesëza **të** dhe trajtat e shkurtra të përemrave

Pjesëza të e lidhore lidhet natyrshëm me trajtat e shkurtra të përemrave. Në këto raste formohen trajta të tilla si: ta, t'i, t'u, t'ua. Psh.:

Do **ta** thërras mësuesen dhe do **t'i** kërkoj leje për sot.

Nuk e dija nëse ishte më mirë **t'u** tregoja apo jo, ama në fund vendosa **t'ua** tregoja të vërtetën.

Bashkimi i pjesëzës **të** me trajtat e shkurtra të përemrave

Nga shembujt e mësipërm shohim se pjesëza TË bashkohet me trajtat e shkurtra të përemrave dhe formon këto ndërtime, të cilat po i ilustruam edhe me shembuj të tjerë:

- **të + e = ta** – Dua **ta** pyes për projektin para se të largohet.
- **të + u = t'u** – Mendova **t'u** shkruaja nxënësve për njoftimin e ri.
- **të + i = t'i** – Duhet **t'i** shpjegoj rregullat para se të fillojmë punën.
- **të + u + e = t'ua** – Premtova **t'ua** dërgoja detyrat pas mësimit.

MËNYRA DËSHIRORE

Mënyra dëshirore përdoret për të shprehur dëshira, urime ose mallkime për një veprim që pritet të ndodhë. Kjo mënyrë nuk tregon një veprim real të kryer, por atë që ne dëshirojmë, urojmë ose paraqesim si të mundshëm. Psh.: Paç fat! U gëzofsh! Qofsh i lumtur! Ardhsh shëndoshë e mirë! Mos paç fat! U pendofsh! Paç fituar! Qofsh gëzuar! etj.

Kohët e mënyrës dëshirore

Mënyra dëshirore ka dy kohë. Ato janë:

- Koha e tashme → *ardhsh, u gëzofsh, u rritsh etj.*
- Koha e kryer → *pastë ardhur, qofsh bekuar, etj.*

Fjalitë me folje në mënyrën dëshirore zakonisht përfundojnë me pikëçuditëse (!), sepse shprehin emocion.

Për çfarë përdoret mënyra dëshirore?

1. Ajo përdoret për të shprehur dëshira dhe urime të mira:
– U bëfsh njëqind vjeç!

- U gëzofsh!
- U rritsh!
- Paç të mirat e jetës!
- Pastë ardhur me këmbë të mbarë!

 2. Ajo përdoret për të shprehur mallkime:

Edhe mallkimi shpreh një dëshirë, por për diçka të keqe. P.sh.:

- Mos pastë ditë të bardhë!
- Thefsh qafën!

 3. Ajo përdoret për të shprehur një veprim të mundshëm që varet nga një kusht:

Ndonjëherë, folja në mënyrën dëshirore, përdoret thjesht për të treguar një mundësi të kushtëzuar, pa urim dhe pa mallkim. P.sh.:

- Në ardhsh para orës katër, çelësin e gjen te tapeti para derës.

Këtu, pra te fjalia e mëposhtme, dëshira nuk shprehet. Forma dëshirore përdoret si lidhje kushtore, sepse veprimi varet nga një rrethanë e ardhshme. P.sh.:

- Mos ardh të edhe dhjetë minuta, nisni lojën!

MËNYRA URDHËRORE

Mënyra urdhërore shpreh urdhra, kërkesa, këshilla ose ftesë. Ka vetëm kohën e tashme dhe foljet përdoren vetëm në vetën e dytë njëjës dhe shumës. P.sh.:

- Shko merr librin!
- Ruaje tabelën e klasës!
- Eja te mësuesja!
- Mos u merr me telefon gjatë mësimi!
- Nesër vishuni njësoj për fotografinë e klasës!
- Këndoma edhe një herë refrenin e këngës!

Trajtat e bashkuara në mënyrën urdhërore

Mënyra urdhërore mund të përdorë edhe trajta të bashkuara, si te *këndo-ma*. Në këtë ndërtim, *këndo* është folja në urdhërore, ndërsa *ma* është trajta e bashkuar e *mua më + atë e*, që jep formën *ma*.

këndo-ma = këndo (urdhërore) + ma (mua më + atë e)

Pikësimi

Fjalitë në të cilat folja kryesore është e mënyrës urdhërore, zakonisht përfundojnë me pikëçuditëse (!).



Mos harro!



1. Përkufizimin e foljes

- Folja është pjesë e ligjëratës që tregon veprim, gjendje ose ndodhi.
- Ajo është pjesa kryesore e fjalisë, sepse pa folje fjalia nuk formohet.



2. Llojet kryesore të foljeve

a) Folje me kuptim të plotë

Shprehin vetë veprimin:

lexoj, shkruaj, punoj, etj.

b) Folje ndihmëse

Përdoren për të ndërtuar kohët e përbëra dhe forma të tjera analitike:

kam mësuar, jam duke lexuar, kam për të shkruar, etj.

c) Folje gjysmëndihmëse (modale)

Tregojnë mundësi, domosdoshmëri ose synim, prandaj përdoren bashkë me një folje tjetër për ta plotësuar kuptimin:

mund të vij; duhet të largohet; do të lexoj; ka për të ardhur.

ç) Folja këpujore “jam”

Shërben për të lidhur kryefjalën me pjesën emërore të kallëzuesit emëror:

Unë jam i qetë.

Ajo është nxënëse.



3. Foljet që tregojnë zhvillimin e veprimit

- Fillimin e veprimit: *filloj, nis, zë, etj.*
→ *Zuri të binte shi.*
- Vazhdimin: *vazhdoj, vijoj, etj.*
→ *Ajo vijonte të qëndronte e qetë.*
- Rritjen progresive: *vij duke..., sa vinte e..., etj.*
→ *Zhurma sa vinte e shtohej.*
- Mbarimin: *mbaroj, pushoj së..., etj.*
→ *Pushova së studiuar.*

 Mos harro!

 4. Mënyrat e foljes në gjuhën shqipe.

Gjuha shqipe ka gjashtë mënyra:

Dëftore

Shpreh veprime reale: *shkoj, lexova, do të vij, etj.*

Lidhore

Shpreh mundësi ose supozim: *të vij, të kem shkuar, etj.*

Habitore

Shpreh çudi për një veprim të papritur: *Paska ardhur! Qenka vonuar!*

Dëshirore

Shpreh urime, dëshira ose mallkime: *U rritsh! Mos pastë!*

Kushtore

Shpreh një veprim të varur nga një kusht: *Do të vija, po të kisha kohë. Do të lexoja më shumë, po ta kisha librin.*

Urdhërore

Shpreh urdhra, kërkesa dhe këshilla: *Shko! Mos fol! Lexoni me kujdes!*

 Ushtrime

 1. RIKUJTO – Çfarë është folja?

Plotëso fjalitë me njërën nga fjalët e dhëna: ndodhi – veprim – gjendje.

1. Folja tregon një _____.
2. Në fjalinë *Unë jam i qetë*, folja shpreh një _____.
3. Në fjalinë *Mbrëmë ra një shi i imët*, folja shpreh një _____.

 Zgjedhimi i foljes “lexoj” -  Plotëso vendet bosh me format e sakta të foljes lexoj, sipas kohëve të mënyrës dëftore.

E tashme:

(unë) lexoj – (ti) lexon – (ai/ajo) lexon /

(ne) lexojmë – (ju) lexoni – (ata/ato) lexojnë

E pakryer:

(unë) lexoja – (ti) _____ – (ai/ajo) _____;

E kryer e thjeshtë:

(unë) lexova – (ti) lexove – (ai/ajo) _____;

Më se e kryer:

(unë) kisha lexuar – (ti) _____ – (ai/ajo) _____;

E ardhme:

(unë) do të lexoj – (ti) do të lexosh – (ai/ajo) do të _____.

 Ushtrime


3. Plotëso vendet e zbrazëta. Shëno me shkronjën përkatëse se çfarë shprehin foljet e theksuara me shkronja të zeza:

- **M** – mbarimin e veprimit;
- **F** – fillimin e veprimit;
- **P** – rritjen progresive;
- **V** – vazhdimin e veprimit;

1. *Dielli filloi të perëndonte pas maleve.* (_____)
2. *Në mbrëmje zuri të binte shi i imët.* (_____)
3. *Ajo vijonte të qëndronte e qetë.* (_____)
4. *Temperatura vinte duke u ulur.* (_____)
5. *Unë mbarova së shkruari.* (_____)
6. *Ai pushoi së studiuar.* (_____)



4. Mini-kuiz – Rretho përgjigjen e saktë.

1. Cila fjali përmban folje këpujore?

- a) Unë lexoj një libër.
- b) Unë jam i qetë.
- c) Mbarova së shkruari.

2. Cila fjali e ka foljen në mënyrën habitore?

- a) U rritsh!
- b) Paskam harruar detyrat!
- c) Nesër do të shkoj në shkollë.

3. Cila folje shpreh fillim veprimi?

- a) vazhdoj.
- b) filloj.
- c) vijoj.

4. Cila folje është modale?

- a) vij.
- b) mund.
- c) pushoj.

5. Cila fjali e ka foljen në mënyrën urdhërore?

- a) Do të mësoj sonte.
- b) Mos fol gjatë orës!
- c) Do të kem mësuar detyrat.

PJESËT E PANDRYSHUESHME TË LIGJËRATËS

Vështrojmë

Lexoni tekstin dhe shihni fjalët me shkronja më të zeza.

Kur u zgjua, djali dëgjoi zhurmën e dallgëve, por nuk u besoi veshëve. Iu duk sikur ishte në ëndërr. Djali vrapoi drejt plazhit, sepse atë ditë nuk e kishte paralajmëruar askush. Kishte shumë dallgë dhe deti ishte i trazuar. Ai ndaloj pak dhe vështroi ujin me frikë. Qëndroi aty deri te trugu i kalbur, por nuk dinte nëse duhej të largohej.

Fjalët me shkronja më të zeza janë pjesë të pandryshueshme të ligjëratës, sepse nuk ndryshojnë formë gjatë përdorimit në fjali. Ndryshe nga to, pjesët e ndryshueshme të ligjëratës ndryshojnë formë gjatë lakimit dhe zgjedhimit. P.sh.:

emri (ndryshon gjatë lakimit): *djali* → *këmbëve të djalit* → *takoi djalin*;

folja (ndryshon gjatë zgjedhimit): *vrapon* → *vrapoi* → *do të vrapojë*.

Këto ndryshime tregojnë se disa fjalë (emri, mbiemri, numërori, përemri, folja) janë pjesë të ndryshueshme, ndërsa disa fjalë nuk ndryshojnë dhe quhet pjesë të pandryshueshme.

 Në gjuhën shqipe, pjesët e pandryshueshme janë:

-  Ndajfoljet → *këtu, atje, shumë, larg, sot* etj.
-  Parafjalët → *në, me, nga, deri, për* etj.
-  Lidhëzat → *dhe, por, sepse, ose* etj.
-  Pjesëzat → *nuk, mos, ja, më, do të* etj.
-  Pasthirrmat → *ah, oh, moj, more* etj.

LIDHËZAT

 Lexoni tekstin dhe vëreni fjalët me shkronja më të zeza.

Liqeni i Prespës

Populli thotë se në një fshat, aty rrëzë malit, gjendej një çezmë e madhe. Në këtë çezmë mbushnin ujë të gjithë njerëzit e fshatrave përreth. Çezma e kishte ujin e kulluar si argjendi e të ftohtë brisk. Një mbrëmje, një nuse që sapo ishte martuar në këto fshatra, mbushi ujë e fundit në këtë çezmë dhe harroi që ta mbyllte, kështu që për gjithë natën rrodhi shumë ujë, saqë e mbushi fushëgropën plot me ujë. Prej kësaj çezme u formua liqeni dhe, sipas emrit të vendit, Prespë, u quajt Liqeni i Prespës.

(Legjendë popullore)

PYESIM

1. Çfarë tregojnë këto fjalë në fjali?
2. A mund t'i ndryshojmë ose t'i heqim pa e prishur kuptimin e fjalisë?
3. Çfarë janë këto fjalë sipas gramatikës?

MËSOJMË

Nga tregimi “Liqeni i Prespës” vërejmë se fjalët: se, si, e, dhe, që, kështu që, saqë shërbejnë për të lidhur fjalë, togfjalësha ose fjali midis tyre. Këto fjalë quhen lidhëza.

TIPARET E LIDHËZAVE

- Lidhëzat janë fjalë të pandryshueshme.
- Ato shërbejnë për të lidhur pjesët e fjalisë dhe fjalitë ndërmjet tyre.

NDARJA E LIDHËZAVE

1. Lidhëzat bashkërenditëse

Lidhin dy elemente të të njëjtës natyrë ose të të njëjtit funksion sintaksor. Psh.:
Prej kësaj çezme u formua liqeni dhe u quajt Liqeni i Prespës.

Sipas kuptimit, lidhëzat bashkërenditëse ndahen në:

- shtuese: e, dhe, edhe, si edhe, as... as..., hem... hem, si... si, jo vetëm... por (edhe), le që... por (edhe) etj.;
- veçuese: a, apo, ose, daç... daç, ja... ja, qoftë... qoftë, o... o... etj.;
- kundërshtore: po, por, kurse, megjithatë, megjithëkëtë, mirëpo, ndërsa, teksa, veç, veçse, vetëm se etj.;
- përmbyllëse: andaj, ndaj, prandaj, domethënë etj.

2. Lidhëzat nënrenditëse

Lidhin dy njësi gjuhësore, ku njëra varet nga tjetra. Psh.:

Populli thotë se në një fshat, aty rrëzë malit, gjendej një çezmë e madhe.

Sipas kuptimit, lidhëzat nënrenditëse ndahen në:

- fthilluese: se, që, në, nëse;
- vendore: ku, tek, nga, kudo, deri ku, gjer ku, nga ku, kudo që etj.;
- kohore: kur, sapo, derisa, pasi (mbasi), ndërsa, teksa, para se, posa që etj.;
- shkakore: se, sepse, ngaqë, meqë, nga shkak se, për shkak se etj.;
- qëllimore: që, me qëllim që, në mënyrë që etj.;
- krahasore: sa, aq sa, sesa, se ç', nga sa etj.;

- mënyrore: si, siç, sikurse, ashtu si(ç) etj.;
- kushtore: nëse, po, sikur, në qoftë se, në është se, me kusht që etj.;
- rrjedhimore: sa, saqë, aq sa, kështu që etj.;
- lejore: megjithëse, ndonëse, edhe pse, sado që.



Mbani mend!

- ◆ Lidhëzat janë fjalë të pandryshueshme.
- ◆ Ato ndahen në bashkërenditëse dhe nënrenditëse.
- Lidhëzat bashkërenditëse
 - ◆ Lidhin dy fjalë ose fjali të barabarta.
- ↓ Lidhëzat nënrenditëse
 - ◆ Lidhin dy fjali, ku njëra varet nga tjetra.

LIDHËZAT SIPAS STRUKTURËS

Sipas strukturës (formimit), lidhëzat ndahen në të thjeshta, të përngjitura dhe shprehje (lokucione) lidhëzore.

1. Lidhëza të thjeshta

◆ Janë lidhëza që përbëhen nga një fjalë e vetme, si: e, dhe, ose, por, po, as, që, se, kur, ku, si, etj.

Shembuj të përdorimit të tyre në fjali:

- *Nxënësit lexuan librin dhe bënë ushtrimet.*
- *Do të vij kur të mbarojë mësimi.*
- *A e di se sot kemi test?*

2. Lidhëza të përngjitura

◆ Janë lidhëza të formuara nga bashkimi i dy fjalëve, por që përdoren si një fjalë e vetme. Të tilla janë: mirëpo, megjithatë, ndërsa, veçse, kurse, ndonëse, pasi, meqë etj.

Shembuj në fjali:

- *Desha të vij, mirëpo nuk pata kohë.*
- *Ishte ftohtë, megjithatë dolëm shëtitje.*
- *U largua pasi mbaroi ora.*

3. Shprehje (lokucione) lidhëzore

◆ Janë lidhje të përbëra nga dy ose më shumë fjalë, që së bashku kryejnë funksionin e një lidhëze.



a) Shprehje lidhëzore me bashkërenditje:

jo vetëm që ... por edhe, ose ... ose, as ... as, dhe ... dhe etj.

Shembuj në fjali:

- Jo vetëm që *mësoi*, por edhe *ndihmoi shokët*.
- Ose *vjen sot*, ose *nesër*.
- As *flet*, as *dëgjon*.

b) Shprehje lidhëzore me nënrenditje:

në qoftë se, me qëllim që, edhe pse, nga shkak që, për arsye se, në rast se etj.

Shembuj në fjali:

- Në qoftë se bie shi, nuk dalim.
- Erdhi herët, me qëllim që të mos vonohej.
- Edhe pse ishte i lodhur, vazhdoi punën.



Mbani mend!

- ✓ Lidhëzat lidhin fjalë dhe fjali.
- ✓ Sipas strukturës, ato ndahen në:
 - të thjeshta,
 - të përngjitura,
 - shprehje (lokucione) lidhëzore.
- ✓ Shprehjet lidhëzore mund të jenë me bashkërenditje ose me nënrenditje.



Detyrë për në shtëpi

Lexoni tekstin e mëposhtëm. Gjeni lidhëzat dhe tregoni llojin e tyre sipas strukturës (*të thjeshta, të përngjitura ose shprehje lidhëzore*).

Qytetet e reja rriten dhe zbukurohen, por për ne mbeten gjithmonë të dashura pamjet e tyre të para, kur ato ishin ende qytete-foshnja, ashtu siç mbeten të dashura në jetën e njeriut fotografitë e fëmijërisë.

Ismail Kadare

PARAFJALËT

 Lexoni tekstin dhe vëreni fjalët me shkronja më të zeza.

Bukuria që vret

Hëna duket e zbehtë lart në kupën e qiellit. Drita e saj ka rënë mbi malet e veshura me borë e përbri kasollet e ngrira të fshatit. Çdo gjë është veshur në të bardhë. Dhe të vret sytë kjo bukuri e bardhë e ndritshme.

Në një kasolle, që kërcet nën peshën e rëndë të borës, duken dy ngjyra: kuq e zi. I kuq është zjarri i vatrës në mes të kasolles dhe i zi terri përqark tij. Nëpër skutat e zeza dhe të errëta të kasolles dëgjohet blegërima e ndonjë deleje ose këmbora e lopës. Avulli që del nga goja e kafshëve ngrihet në ajër dhe bie i ngrirë si brymë mbi qimet e tyre. Heshtje. Çdo gjë është ngrirë. Një dorë shtrihet, kap një urë, ngacmon zjarrin dhe shtrin prushin. Flaka ndriçon errësirën dhe shkëndijat kërcejnë deri në tra e nëpër fytyrat rreth vatrës. Njerëzve u dridhet trupi e nëpër kurriz u shkon të ftohtit, që vjen nga skutat andej nga errësira. Brr!... uf!... Andej mbrapa shpine të përpin errësira bashkë me të ftohtit.

Sipas Migjenit

PYESIM

1. Çfarë kategorie gramatikore i përkasin fjalët me ngjyrë më të zezë?
2. Për se shërbejnë fjalët me ngjyrë më të zezë të vendosura para fjalëve të nënvizuara?
3. Çfarë janë fjalët me ngjyrë më të zezë?

MËSOJMË

Për çfarë shërbejnë parafjalët?

Parafjalët janë fjalë të pandryshueshme. Ato vendosen përpara emrave, përemrave, numërorëve ose ndajfoljeve dhe shërbejnë për të shprehur marrëdhënie varësie ndërmjet fjalëve në fjali. Prandaj, parafjalët quhen edhe fjalë shërbyese lidhëse. P.sh.:

Hëna duket e zbehtë lart në kupën e qiellit. Drita e saj ka rënë mbi malet e mbuluara me borë dhe përbri kasolleve të ngrira të fshatit. Çdo gjë është veshur në të bardhë. Dhe kjo bukuri e ndritshme të lodh sytë.

Si parafjalë përdoren edhe disa ndajfolje dhe shprehje ndajfoljore, si: afër, larg, brenda, gjatë, jashtë, rrotull etj.; si edhe: anekënd, rreth e rrotull, mes për mes etj. P.sh.:

Banesa e Yllit ndodhet shumë afër godinës së Teatrit Kombëtar.

Njerëzit ishin mbledhur rreth e rrotull vatrës.

Edhe disa emra dhe lokucione emërore përdoren me vlerë parafjale, si: anë, ballë, buzë, faqe, rrëzë, për arsye, nga shkak, për hir, në krahasim me, në lidhje me, në përputhje me. P.sh.:

Me shokët e tij, Joni shëtiste buzë detit.

Në mbledhje u diskutua gjatë në lidhje me zgjedhjet e reja.

KLASIFIKIMI I PARAFJALËVE SIPAS STRUKTURËS MORFOLOGJIKE

Sipas ndërtimit të tyre morfologjik, parafjalët ndahen në: parafjalë të thjeshta, të përngjitura dhe shprehje parafjalore.

- Parafjalë të thjeshta janë ato që përbëhen nga një fjalë e vetme, si: *në, për, afër, brenda, larg, para* etj.
- Parafjalë të përngjitura janë formuar nga bashkimi i dy elementeve gjuhësore, si: *nëpër, përmbi, përveç, sipas* etj.
- Shprehje parafjale janë grupe fjalësh që përdoren me vlerë parafjale, si: *ballë për ballë, rreth e qark, bashkë me, në kundërshtim me, në lidhje me* etj.



Ushtrime

Ushtrimi 1. Lexoni listën e mëposhtme të parafjalëve dhe klasifikojini sipas strukturës. Pra, parafjalët e dhëna më poshtë renditini sipas klasifikimit përkatës: *afër, bashkë me, brenda, nëpër, përmbi, në, për, përveç, sipas, ballë për ballë, rreth e qark, në lidhje me*.

Plotësoni:

Parafjalë të thjeshta: *në*, ... _____;

Parafjalë të përngjitura: *nëpër*, ... _____;

Shprehje parafjalore: *ballë për ballë* ... _____.

Ushtrimi 2. Nënvizoni parafjalën dhe tregoni llojin e saj sipas strukturës.

1. *Librat janë vendosur në raft.*
2. *Nxënësit kaluan nëpër oborr.*
3. *Ai qëndroi ballë për ballë me shokun.*
4. *U fol gjatë në lidhje me projektin.*
5. *Shtëpia ndodhet afër shkollës.*

PASHTHIRRMAT

Vështrojmë:

Në vargjet e shkëputura nga poezia “Lamtumira” e Gjergj Fishtës, përdoret shpesh fjala *lamtumirë*:

*Lamtumirë, vendet e mia,
qe po zhduken dalëkadalë!
Gjëmon deti, ushton duhia,
lkundet barka valë mbi valë;*

*Lamtumirë, atdhe i bekue!
Lamtumirë, për sa t'jet jeta!*

*Lamtumirë, ti, shpija e t'parvet,
ku ma s'parit m'agoi drita,
Lamtumirë, ti, nanë e motër!
Lamtumirë, për sa t'jet jeta!*

Në këto vargje, fjala *lamtumirë* përsëritet për të shprehur ndarjen, mallin dhe ndjenjën e fortë emocionale të folësit.

PYESIM 🗣️

1. Çfarë shpreh fjala *lamtumirë* në vargjet e mësipërme?
 2. A ndryshon ajo formë gjatë përdorimit?
 3. Cilës kategori gramatikore i përket kjo fjalë?
- 👉 Fjala *lamtumirë* shpreh ndarje dhe ndjenjë emocionale, që nuk ndryshon formë dhe bën pjesë te pasthirrmat.

MËSOJMË 📖

Pasthirrmat janë tinguj ose fjalë të pandryshueshme që shërbejnë për të shprehur ndjenjat e folësit ose për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesve. Psh.:

O, sa mirë që erdhe!

Pasthirrmat janë karakteristike për gjuhën e folur dhe kuptimi i tyre shpesh qartësohet nga intonacioni.

NDARJA E PASTHIRRAVE SIPAS PREJARDHJES

Sipas prejardhjes, pasthirrmat ndahen në dy grupe:

Pasthirrma të parme, që janë tinguj të thjeshtë:

a, e, ë, i, o, u, y, au, eu, ua, ba, hë

Pasthirrma jo të parme, që formohen prej pjesësh të tjera të ligjëratës dhe shprehin emocion të fortë:

o burra, forca, qyqja, e zeza, të keqen etj. P.sh.: Qyqja, e shkreta!

NDARJA E PASTHIRRMAVE SIPAS KUPTIMIT

Sipas kuptimit, pasthirrmat ndahen në dy grupe të mëdha:

Pasthirrma emocionale që shprehin ndjenja të ndryshme, si gëzim (*o, oh, urra, sa mirë etj.*), frikë ose tmerr (*kuku, ububu, qyqja etj.*), habi (*au, eu, ua etj.*), si edhe keqardhje ose dhimbje (*ah, of, uf etj.*).

Pasthirrma urdhërore që shprehin dëshirën ose vullnetin e folësit. Ato përdoren për thirrje (*ej, ore, moj etj.*), për urdhër, nxitje ose lutje (*o burra, forca, hopa, hë, sus etj.*) si dhe për përsëritje, mirënjohje, mallkime, sharje, ngushëllime etj. (*faleminderit, lamtumirë, mirëmëngjesi, mirëdita, mirëmbërë, mirupafshim, mirë se erdhe, mirë mbeç, ditën e mirë, tungjatjeta, udha e mbarë etj.*). P.sh.:

Moj, ty po të flas!

Hopa, edhe pak!

Faleminderit, për ndihmën që më dhe!

Mirëmëngjesi, nxënës të dashur!

Mirë se erdhe, në shkollën tonë!

Tungjatjeta, o mik i vjetër!

E zeza, çfarë fatkeqësie!

VENDI I PASTHIRRAVE NË FJALI

Pasthirrmat zakonisht përdoren në fillim të fjalisë, sepse me to shprehet menjëherë ndjenja ose thirrja e folësit. Në këtë rast, ato veçohen me presje:

Oh, sa m'u bë qejfi!

Ej, a po vjen?

Lamtumirë, atdhe i dashur!

Më rrallë, pasthirrmat përdoren në mes të fjalisë, të ndara me presje, kur folësi ndërpret për një çast ligjërimin për të shprehur një ndjenjë:

Ai, ah, nuk foli më.

Shumë rrallë, pasthirrmat përdoren në fund të fjalisë, për të theksuar ndjenjën që shoqëron thënien:

Sa keq u mbyll kjo punë, kuku!

Kur pasthirrmat përdoren më vete dhe shqiptohen me forcë të veçantë, pas tyre vihet pikëçuditëse: *Ah! Ua!*



Mbani mend!

Pasthirrmat janë fjalë të pandryshueshme që shprehin ndjenja ose thirrje. Ato shprehin:

😊 gëzim / përshëndetje: *mirëmëngjesi, mirëdita, mirëmbërëma, mirë se erdhe, tungjatjeta* etj.;

🙏 mirënjohje: *faleminderit, të lumtë* etj.;

👐 ndarje: *lamtumirë, mirupafshim, mirë mbeç, ditën e mirë* etj.;

📢 thirrje ose nxitje: *ej, moj, ore, hopa, forca* etj.;

😞 keqardhje ose dhimbje: *ah, of, uf, e zeza* etj.;

🙄 habi: *au, ua, pa* etj.;

🙌 frikë: *kuku, ububu* etj.



Ushtrime

Nënvizoni pasthirrmat dhe tregoni llojin e tyre.

– *Të kam falur, Sid, të kam falur për gjithçka. Oohh! Gjithçka më ke bërë. Kur të vdes unë...*

– *Po pse, do vdesësh ti? Vërtet, Tomi, vërtet do vdesësh?! Mos, jo, jo, mos!*

– *I kam falur të gjithë. Ooh! Të gjithë, Sid. Thuaju një çikë se i kam falur. Kurse kornizën e dritares dhe macen me një sy do t'ia japësh asaj vajzës së re që ka ardhur në qytetin tonë dhe do t'i thuash...*

Por Sidi kish rrëmbyer rrobat dhe qe bërë erë, Tomi po vuante tani vërtet, aq bukur i kish punuar fantazia, gjer dhe rënkimet nuk i dilnin më të shtirura, por nga fundi i shpirtit.

Sidi fluturoi shkallëve tëposhtë;

– *Teto Poli, hajde, teto Poli! Tomi po vdes!*

– *Po vdes?!*

– *Po, po, po na lë. Ejja shpejt!*

– *Dokrra! Nuk e besoj kurrën e kurrës!*

Megjithatë, ajo i kaptoi shkallët me një frymë, me Sidin e Merin nga pas. Buza zuri t'i dridhej, gjaku i shkoi në fund të këmbëve. Sa erdhi te shtrati, foli zëmekur:

– *Oh, Tom! Ç'ke, Tom!*

Mark TUEN

PJESËZAT

👉 Lexoni tekstin dhe vëreni fjalët me *shkronja më të zeza*.

I humburi

Mars 1991

Vjen një ditë kur njeriut i duket se i ka larë hesapet me botën, i është mbyllur cikli dhe nuk ka më kuptim të ripërthypë të kaluarën. Për më tepër kur në jetën e tij nuk ka diçka që do t'u vlente të tjerëve. Atëherë ç'kërkon, do të pyesni ju.

Asgjë. Thjesht një rrëfim.

Para dy muajsh, miku im Dorian Kamberi, inxhinier mekanik, baba i dy fëmijëve, një mëngjes i hipi transoqeanikut "Partizani" dhe kapërceu detin familjarisht. Sikur të mos pendohesha çastin e fundit, mbase edhe unë sot do të gjendesha diku në ndonjë kamp refugjatësh në atë vend të ëndërruar të quajtur Itali, ose gjetkë, nëpër Evropë, andej-këndeje, së bashku me turmat e bashkatdhetarëve të mi. Por çastin e fundit, tek rrinim rrasur pas njëri-tjetrit, i thashë Dorianit se do të zbrisja. Dori mbase as që e ka marrë vesh ç'i thashë... Mirëpo Dori heshti. Më vështroi me sytë e zbrazur, e ndërkaq unë ndjeva në zverk ngrohtësinë e lagësht të urinës së djalit të tij të vogël, të cilin vazhdoja ta mbaja kalaqafë.

Fatos Kongoli

PYESIM 🗣️

1. A ndryshojnë formë fjalët e shkruara me më të zeza?
2. Çfarë kuptimi shprehin fjalët e shkruara me më të zeza?
3. Çfarë janë fjalët e shkruara me më të zeza?

MËSOJMË 📖

Pjesëzat janë fjalë të pandryshueshme që shprehin nuanca kuptimore, qëndrim ose ndjenja të folësit dhe që plotësojnë kuptimin e një fjale, të një grupi fjalësh ose të një fjalie të tërë.

Fjalë, si: nuk, më, të, do të, mos, mbase etj., janë pjesëza.

Llojet e pjesëzave. Sipas kuptimit, pjesëzat ndahen në:

💠 Pjesëza kuptimore

Përdoren për të saktësuar, përforcuar ose përafruar kuptimin dhe janë:

- dëftuese: *ja*

Ja ku është.

- përcaktuese: *mu, pikërisht, porsa (sa, sapo), që, qysh, deri (gjer), plot* etj.

Pikërisht ai nuk ishte përgatitur.

- përforcuese: *vetëm (veç, veçse), sidomos, veçanërisht, edhe (dhe), madje, bile, sa, si, o, moj, mor* etj. Psh.:

Të gjithë qeshnin me të madhe, sidomos Rroji.

- përfruese: *afro, nja, mbi, gati, rreth, (po) thuaj (se), desh, mend* etj. Psh.:

mbi dhe rreth janë pjesëza kur tregojnë sasi të përafërt:

Erdhën mbi 100 veta. / Erdhën rreth 50 veta.

Por janë parafjalë kur tregojnë vend:

Libri është mbi tavolinë. / Ecëm rreth shtëpisë.

Në këtë grup përfshihet edhe pjesëza për, kur përdoret me kuptimin si për të shprehur vlerësim:

E mbante për njeri të mirë.

◆ Pjesëza modale

Shprehin qëndrimin e folësit ndaj asaj që thuhet dhe janë:

- pohuese: *po, posi, po se po, si urdhëron* etj.

– A do të vish me ne? – Posi.

- mohuese: *jo, nuk, s', mos, jo se jo, as që* etj.

Nuk mund të vij.



Dy pjesëza mohuese mund të japin kuptim pohues:

Të mos mendojmë se nuk kemi mundësi.



Pjesëza jo mund të përdoret me kuptim pohues kur ndodhet para një gjymtyre me parafjalë me kuptim mohues:

Ai foli jo pa dhimbje.

- pyetëse: *a, ë, e* etj.

A mos jam vonuar?

– Shkove? – E?

- dyshuese: *ndoshta, mbase, kushedi, vallë* etj.

Mbase edhe unë sot do të gjendesha diku tjetër.

- zbutëse: *pa, as, le, s'para (nuk para), dot* etj.

Pa dil njëherë e shih kush erdhi.

Le të shkojnë edhe fëmijët.

◆ Pjesëza emocionale 😞 😊 😞

Shprehin ndjenja, reagime ose vlerësime emocionale.

Pjesëza emocionale janë: *epo, ç', se, seç, pa le, le që, ja që, pra* etj.

Epo, Ylli e mori vendimin më në fund.

Epo, Jon, kështu qenkan gjërat!

Seç u mendua Edoni për një çast.

*Pa le Rroni, sa u gëzua!
 Le që Eda nuk e priste fare këtë lajm.
 Ja që Leona doli më e përgatitura!
 Pra, Rea paskësh pasur të drejtë!
 Edhe Lumi, pa le si reagoi!
 Epo, Rroji, tani gjithçka u sqarua.*

Pjesëza dhe pjesë të tjera të ligjëratës
 Disa fjalë mund të përdoren si pjesëza, por edhe si pjesë të tjera të ligjëratës, varësisht nga kuptimi dhe përdorimi në fjali:

- përemra dhe pjesëza: *ç', sa, që*;
- ndajfolje dhe pjesëza: *gati, vetëm, rreth, plot*;
- parafjalë dhe pjesëza: *pa*;
- lidhëza dhe pjesëza: *porsa, që, vetëm, edhe (dhe), a, e, as*;
- pasthirrma dhe pjesëza: *o, e, a*.

Pjesëza gramatikore 

Pjesëzat gramatikore shërbejnë për të formuar trajta gramatikore:

- u – formon trajta pësore/vetvetore të foljes: u *lodha*, u *hap dera*;
- të – formon mënyrën lidhore: *të punojmë*;
- duke – formon përcjelloren: *duke punuar*;
- pa – formon trajtën e pashtjelluar mohore: *pa punuar*;
- më – formon shkallën krahasore: *më i mirë, më mirë*;
- shumë – formon shkallën sipërore: *shumë mirë*.

Mbani mend!

◆ Pjesëza është fjalë e pandryshueshme që nuk emërton sende, cilësi a veprime, por i jep fjalës, togfjalëshit ose fjalisë kuptim më të saktë, më të plotë ose ngjyrim të veçantë.

◆ Ajo mund të lidhet me një fjalë, me një togfjalësh ose me një fjali të tërë.

◆ Sipas kuptimit, pjesëzat ndahen në kuptimore, modale dhe emocionale.

◆ Pjesëzat kuptimore ndihmojnë për ta bërë kuptimin më të saktë: dëftim (*ja* etj.), përcaktim (*pikërisht, mu* etj.), përforsim (*vetëm, sidomos* etj.), përafrim (*afro, rreth, gati* etj.).

◆ Pjesëzat modale tregojnë qëndrimin e folësit ndaj asaj që thuhet: pohim (*po, posi* etj.), mohim (*jo, nuk, mos* etj.), pyetje (*a, ë* etj.), dyshim (*mbase, ndoshta* etj.), zbutje (*pa, le* etj.).

◆ Pjesëzat emocionale shprehin ndjenja, reagime ose vlerësime emocionale (*epo, ç', se, seç, pa le, le që, ja që, pra* etj.).



Ushtrime

Gjej pjesëzën dhe trego llojin e saj.

- a) Ja ku është fletorja jote.
- b) Nuk e di përgjigjen.
- c) Mbase do të takohemi nesër.
- ç) Pa le, çfarë surprize!
- d) A po vjen edhe ti?



Mini-kviz (rretho të saktën)

1. Cila pjesëz shpreh reagim emocional?
a) nuk b) ja c) pa le
2. Cila fjalia ka pjesëz dyshuese:
a) Nuk erdha sot.
b) Ja ku është libri.
c) Mbase vij nesër.
3. Cila pjesëz përdoret për pyetje?
a) po b) a c) pa le



Pyetje për detyrë shtëpie

1. Çfarë është pjesëza?
2. Në cilat grupe ndahen pjesëzat sipas kuptimit?
3. Çfarë tregojnë pjesëzat kuptimore?
4. Përmend dy pjesëza modale dhe shpjego çfarë tregojnë.
5. Kur përdoren pjesëzat emocionale?

KOHËT E PËRBËRA TË FOLJEVE

👉 Lexoni tekstin dhe vëreni fjalët me *shkronja më të zeza*. Në tekst, fjalët e theksuara janë forma foljore të përbëra.

Në fund të fshatit ndodhej një kullë e vjetër, për të cilën thuhej se kishte ruajtur kujtime të shumta nga e kaluara. Banorët kanë treguar shpesh se aty janë fshehur histori që koha nuk i ka fshirë. Nxënësit kishin dëgjuar për këtë kullë dhe kishin vendosur prej kohësh ta vizitonin. Një pasdite, pasi patën përfunduar mësimet, u nisën drejt saj me kureshtje.

Kur hynë brenda, panë se dikush kishte ndezur një qiri dhe se ishte larguar pak çaste më parë. Askush nuk ka pranuar se kishte qenë aty, por gjurmët flisnin vetë. Më vonë, mësuesi u tha se shumëkush ka kërkuar sekrete në atë kullë dhe disa kanë gjetur më shumë sesa kishin menduar. Ai shtoi se nxënësit do të mësonin edhe më tepër, po të ktheheshin sërish. Nxënësit menduan se, deri në fund të vitit shkollor, do të kenë kuptuar se jo çdo thesar është i dukshëm. Ata e dinin se, po të mos hynin atë ditë në kullë, do të humbnin një përvojë të veçantë dhe se ajo përvojë do të kishte mbetur vetëm një tregim i dëgjuar.

(Tekst i përshtatur për qëllime didaktike)

PYESIM 🤔

- Çfarë vëreni te fjalët e theksuara në tekst?
- A shprehen këto forma foljore me një fjalë të vetme apo me më shumë fjalë?
- Me cilat fjalë ndihmëse janë ndërtuar këto forma?
- Cilën kohë dhe mënyrë tregojnë format e theksuara?

MËSOJMË 📖

Kur flasim, jo gjithmonë na mjafton një fjalë për të treguar kur ndodh një veprim. Shpesh duam të themi se diçka ka mbaruar, se ka ndodhur më herët, ose se do të ndodhë më vonë. Për këtë arsye, në gjuhën shqipe përdorim edhe forma foljore që shprehen me më shumë se një fjalë.

Kur themi *lexoj* ose *erdha*, veprimi shprehet me një fjalë të vetme. Por kur themi *kam lexuar* ose *jam nisur*, kuptimi i veprimit plotësohet me ndihmën e një fjale tjetër. Këto quhen forma të përbëra, sepse veprimi nuk shprehet vetëm me foljen kryesore.

Format e përbëra të foljes në gjuhën shqipe formohen me ndihmën e foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam* + pjesoren e foljes kryesore, si dhe me ndërtime analitike me do të. Psh.: *kam mësuar*, *jam nisur*, *kisha lexuar*, *isha kthyer*, *do të mësonin*, *do të humbnin*, *do të kem kuptuar*, *do të kishte mbetur* etj. Me këto forma tregohet nëse

veprimi ka mbaruar, ka ndodhur më herët ose pritet të ndodhë. Ja edhe disa shembuj për ta kuptuar më mirë:

-  mësoj (*formë e thjeshtë*) → kam mësuar (*formë e përbërë*);
-  lexoj (*formë e thjeshtë*) → kam lexuar (*formë e përbërë*);
-  bëj detyrat (*formë e thjeshtë*) → i kam bërë detyrat (*formë e përbërë*);
-  nisem herët (*formë e thjeshtë*) → jam nisur herët (*formë e përbërë*);
-  luaj futboll (*formë e thjeshtë*) → kam luajtur futboll (*formë e përbërë*).

VËREJMË

Në tekstin e mësipërm vërejmë se fjalët e theksuara janë forma të përbëra të foljes që tregojnë veprime të shkuara dhe veprime që lidhen me të ardhmen. Më poshtë paraqiten këto forma, të sistemuara sipas kohëve të mënyrës dëftore.

Veprime të shkuara (kohë të përbëra)

Koha e foljes	Forma foljore nga teksti
Koha e kryer	kanë treguar, janë fshehur, ka fshirë, ka pranuar, ka kërkuar, kanë gjetur
Më se e kryera	<i>kishte ruajtur, kishin dëgjuar, kishin vendosur, ishte larguar, kishte ndezur</i>
E kryera e tejshkuar	<i>patën përfunduar</i>

Veprime që lidhen me të ardhmen

Koha e foljes	Forma foljore nga teksti
E ardhmja e së shkuarës	<i>do të mësonin, do të humbnin</i>
E ardhmja e përparme	<i>do të kenë kuptuar</i>
E ardhmja e përparme e së shkuarës	<i>do të kishte mbetur</i>

⌚ DISA KOHË TË PËRBËRA TË MËNYRËS DËFTORE

Kohët e përbëra të mënyrës dëftore përdoren për të shprehur veprime të përfunduara, veprime që kanë ndodhur para një veprimi tjetër ose veprime që lidhen me të ardhmen. Ato ndërtohen me folje ndihmëse (*kam, jam*) në trajta të ndryshme, së bashku me pjesoren e foljes kryesore; disa forma ndërtohen edhe me do të. Më poshtë janë paraqitur disa kohë të përbëra të mënyrës dëftore, të ilustruara me foljen mësoj.

⏮ Veprime të shkuara

Koha	Çfarë tregon	Zgjedhimi (folja <i>mësoj</i>)
Më se e kryera	<i>Tregon një veprim që ka ndodhur para një veprimi tjetër të së shkuarës.</i>	unë kisha mësuar, ti kishe mësuar, ai/ ajo kishte mësuar, ne kishim mësuar, ju kishit mësuar, ata/ato kishin mësuar
E kryera e tejshkuar	<i>Tregon një veprim të kryer plotësisht në të kaluarën, zakonisht të mbyllur dhe të përfunduar.</i>	unë pata mësuar, ti pate mësuar, ai/ ajo pat(i) mësuar, ne patëm mësuar, ju patët mësuar, ata/ato patën mësuar

⏭ Veprime që lidhen me të ardhmen

Koha	Çfarë tregon	Zgjedhimi (folja <i>mësoj</i>)
E ardhmja e së shkuarës	<i>Tregon një veprim që pritej të ndodhte në të ardhmen, duke u nisur nga një çast i së shkuarës.</i>	unë do të mësoja, ti do të mësoje, ai/ ajo do të mësonte, ne do të mësonim, ju do të mësonit, ata/ato do të mësonin
E ardhmja e përparme	<i>Tregon një veprim që do të jetë i përfunduar në një çast të caktuar të së ardhmes.</i>	unë do të kem mësuar, ti do të kesh mësuar, ai/ajo do të ketë mësuar, ne do të kemi mësuar, ju do të keni mësuar, ata/ato do të kenë mësuar
E ardhmja e përparme e së shkuarës	<i>Tregon një veprim që do të ishte i përfunduar në të ardhmen, duke u nisur nga një çast i së shkuarës.</i>	unë do të kisha mësuar, ti do të kishe mësuar, ai/ajo do të kishte mësuar, ne do të kishim mësuar, ju do të kishit mësuar, ata/ato do të kishin mësuar

Kohët e përbëra të foljeve KAM dhe JAM

Edhe foljet kam dhe jam kanë kohë të përbëra të mënyrës dëftore. Ato nuk shërbejnë vetëm si folje ndihmëse, por zgjedhohen edhe vetë në këto kohë, duke shprehur veprime të shkuara dhe veprime që lidhen me të ardhmen.

Folja KAM

Veprime të shkuara

Koha	Zgjedhimi
Më se e kryera	<i>unë kisha pasur, ti kishe pasur, ai/ajo kishte pasur, ne kishim pasur, ju kishit pasur, ata/ato kishin pasur</i>
E kryera e tejshkuar	<i>unë pata pasur, ti pate pasur, ai/ajo pat(i) pasur, ne patëm pasur, ju patët pasur, ata/ato patën pasur</i>

Veprime që lidhen me të ardhmen

Koha	Zgjedhimi
E ardhmja e së shkuarës	<i>unë do të kisha, ti do të kishe, ai/ajo do të kishte, ne do të kishim, ju do të kishit, ata/ato do të kishin</i>
E ardhmja e përparme	<i>unë do të kem pasur, ti do të kesh pasur, ai/ajo do të ketë pasur, ne do të kemi pasur, ju do të keni pasur, ata/ato do të kenë pasur</i>
E ardhmja e përparme e së shkuarës	<i>unë do të kisha pasur, ti do të kishe pasur, ai/ajo do të kishte pasur, ne do të kishim pasur, ju do të kishit pasur, ata/ato do të kishin pasur</i>

Folja JAM

Veprime të shkuara

Koha	Zgjedhimi
Më se e kryera	<i>unë kisha qenë, ti kishe qenë, ai/ajo kishte qenë, ne kishim qenë, ju kishit qenë, ata/ato kishin qenë</i>
E kryera e tejshkuar	<i>unë pata qenë, ti pate qenë, ai/ajo pat(i) qenë, ne patëm qenë, ju patët qenë, ata/ato patën qenë</i>

Veprime që lidhen me të ardhmen

Koha	Zgjedhimi
E ardhmja e së shkuarës	<i>unë do të isha, ti do të ishe, ai/ajo do të ishte, ne do të ishim, ju do të ishit, ata/ato do të ishin</i>
E ardhmja e përparme	<i>unë do të kem qenë, ti do të kesh qenë, ai/ajo do të ketë qenë, ne do të kemi qenë, ju do të keni qenë, ata/ato do të kenë qenë</i>
E ardhmja e përparme e së shkuarës	<i>unë do të kisha qenë, ti do të kishe qenë, ai/ajo do të kishte qenë, ne do të kishim qenë, ju do të kishit qenë, ata/ato do të kishin qenë</i>

 Fjalorth

Formë foljore e përbërë – formë e foljes që shprehet me më shumë se një fjalë (p.sh. *kam mësuar, do të mësonte*).

Folje ndihmëse – folje që ndihmon në ndërtimin e formave të përbëra (kam, jam).

Pjesore – formë e foljes që përdoret në kohët e përbëra (p.sh. *mësuar, lexuar, qenë*).

 Mbani mend!

- Kohët e përbëra të foljes shprehen me më shumë se një fjalë.
- Ato formohen me foljet ndihmëse kam, jam së bashku me pjesoren (kam mësuar, jam nisur), si edhe me ndërtime me do të, që mund të dalin pa pjesore ose me pjesore (do të mësonte, do të ketë mësuar).
- Me këto kohë tregojmë:
 - o *veprime që kanë ndodhur më herët,*
 - o *veprime që kanë ndodhur para një veprimi tjetër,*
 - o *veprime që priten të ndodhin në të ardhmen.*
- Edhe foljet kam dhe jam kanë kohë të përbëra.

 Ushtrime

Ushtrimi 1. Nënvizoni format e përbëra të foljes në fjalitë e mëposhtme.

1. *Nxënësit kishin mësuar mësimin para orës së provimit.*
2. *Ajo pati përfunduar detyrat e shtëpisë herët.*
3. *Mësuesi tha se nxënësit do të mësonin më mirë.*
4. *Deri nesër, ata do të kenë kuptuar rregullat e lojës.*
5. *Ai mendoi se do të kishte mbetur pas shokëve.*

Ushtrimi 2. Plotësoni me formën e duhur të foljes mësoj në kohët e përbëra të mënyrës dëftore.

1. (Më se e kryera) *Nxënësit _____ rregullat më herët.*
2. (E kryera e tejshkuar) *Ajo _____ mësimet dhe u largua.*
3. (E ardhmja e së shkuarës) *Ai tha se nxënësit _____ më mirë.*
4. (E ardhmja e përparme) *Deri në fund të vitit, ne _____ gjithçka.*
5. (E ardhmja e përparme e së shkuarës) *Mësuesi mendoi se nxënësit _____ më mirë vjershën.*

SINTAKSA

KUNDRINORI – RIMARRJA E KUNDRINORIT

 Lexoni tekstin dhe vëreni fjalët me shkronja më të zeza.

Djali dalloi dorashkën e grisur dhe e mori menjëherë. I tensionuar, ai u besoi këmbëve dhe u hodh pa menduar. Pastaj lëshoi hapat dhe i shpejtoi drejt rrugës. Trupi iu përplas me asfaltin dhe i mbeti i ftohtë për një çast. Kishte humbur ndjenjën e kohës dhe e ndiente hutimin thellë brenda vetes. Kur u përmend, i ndjeu djersët mbi ballë. Djalit nuk i erdhi marre për frikën që po e ndiente. U ngrit, mori xhaketën dhe e veshi, pastaj kapi çantën dhe e hodhi në shpinë.

Në tekstin e mësipërm, fjalët me shkronja më të zeza (*dorashkën e grisur, këmbëve, hapat, me asfaltin, ndjenjën e kohës, hutimin, djersët, Djalit, për frikën, xhaketën dhe çantën*) janë kundrinorë, ndërsa ato të shënuara me ngjyrë të kuqe (*e, i*) janë rimarrje të kundrinorëve.

Në tekst, vërejmë se veprimi i shprehur nga folja bie mbi një fjalë tjetër të fjalisë. Në shembujt: *dalloi dorashkën e grisur, lëshoi hapat, ndjeu djersët, mori xhaketën, (atë) e veshi dhe kapi çantën*, veprimi bie drejtpërdrejt mbi këto fjalë. Në rastet e tjera, si: *u besoi këmbëve, u përplas me asfaltin, Djalit nuk i erdhi*, veprimi bie në mënyrë të tërthortë. Këta fjalë janë kundrinorë.

 Çfarë është kundrinori?

Kundrinori është fjala që tregon mbi kë ose mbi çfarë bie veprimi i foljes.

Kundrinori është gjymtyrë e dytë e fjalisë. Sipas kuptimit dhe formës së shprehjes, kundrinori është i drejtë dhe i zhdrejtë. Kundrinori i zhdrejtë mund të jetë pa parafjalë ose me parafjalë. Shembuj nga teksti:

dalloi dorashkën e grisur (çfarë dalloi?) — kundrinor i drejtë

u besoi këmbëve (kujt u besoi?) — kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë

u përplas me asfaltin (me çfarë u përplas?) — kundrinor i zhdrejtë me parafjalë

KUNDRINORI I DREJTË

Kundrinori i drejtë është gjymtyrë e dytë e fjalisë që shënon objektin tek i cili kalon drejtpërdrejt veprimi i shprehur nga folja. Objekti mund të jetë frymor ose jofrymor.

Kundrinori i drejtë u përgjigjet pyetjeve:
kë? cilin? cilën? çfarë?

Nxënësit përgatitën projektin për orën e shkencës. (çfarë?)
Ajo dërgoi mesazhin në grupin e klasës. (çfarë?)
Mësuesja thirri nxënësin. (cilin?)
Ajo takoi shogën pas mësimit. (cilën?)
Prindërit pritën fëmijët pas shkolle. (kë?)

Kundrinori i drejtë plotëson kuptimin e foljes. Në shumë fjali, pa kundrinorin e drejtë, mendimi nuk del i plotë.

Provo dhe vëzhgo ☆

Provoni të hiqni kundrinorin e drejtë nga fjalitë e mësipërme.
A mbetet fjalia e plotë dhe e qartë? P.sh.:
Ata përgatitën një prezantim të bukur. (çfarë?)
**Ata përgatitën xxxxxxxx të bukur. (Pa kundrinorin, fjalia nuk e tregon qartë çfarë përgatitën.)*

Me çfarë shprehet kundrinori i drejtë

Kundrinori i drejtë shprehet me emër, përemër ose grup emëror në rasën kallëzore.

a) Me emër

- në trajtë të shquar
Nxënësja hapi fletoren (çfarë?).
Ai mbylli kompjuterin (çfarë?).
- në trajtë të pashquar
Ne blemë libra (çfarë?) për bibliotekën.
Ata ndërtuan një model (çfarë?) prej kartoni.

b) Me përemër

Kundrinori i drejtë mund të shprehet me përemra vetorë ose dëftorë. P.sh.:
Mësuesja thirri atë (kë?).

*Unë i pashë këta (kë?) dje.
Ajo takoi të gjithë (kë?).*

c) Me trajtë të shkurtër të përemrit vetor

Kundrinori i drejtë shprehet edhe me trajta të shkurtra të përemrave
vetorë, të cilat lidhen ngushtë me foljen. Psh.:

Mësuesja më lavdëroi para prindërve.

Prindërit na përgëzuan.

Dje i ftuam në futboll.

ç) Me grup emëror

Kundrinori i drejtë mund të shprehet me grup emëror. Psh.:

Familja organizoi një udhëtim të paharrueshëm (çfarë?).

Nxënësit vizituan muzeun e qytetit (çfarë?).

*Nxënësit vizituan Liqenin e Ohrit (çfarë?) dhe mësuan çdo gjë (çfarë?) për
ngjallat.*



Mbani mend!

- Kundrinori është gjymtyrë e dytë e fjalisë.
- Kundrinori i drejtë tregon objektin mbi të cilin bie drejtpërdrejt veprimi.
- Mund të shprehet me emër, përemër, trajtë të shkurtër të përemrit vetor ose grup emëror në rasën kallëzore.
- Në shumicën e rasteve është gjymtyrë e domosdoshme e fjalisë.

KUNDRINORI I ZHDREJTË

Lexoni tekstin dhe vëreni gjymtyrët e theksuara.

Një nxënës i kërkoj shokës ndihmë. Ekipit të tij i mungonte një lojtar. Ai kishte biseduar edhe me mësuesen për nxënësen. Vendimi i tij u vlerësua shumë prej mësueses. Më pas ekipit iu bashkua një anëtar i ri. Ekipi u përkushtua ndaj ushtrimeve të rregullta. Suksesi varet nga përpjekjet.

Gjymtyrët e theksuara në këtë tekst janë kundrinorë të zhdrejtë. Ata mund të jenë pa parafjalë ose me parafjalë.

Kundrinori i zhdrejtë është gjymtyrë e dytë e fjalisë, që tregon objektin ndaj të cilit veprimi nuk bie drejtpërdrejt, por realizohet në mënyrë të tërthortë. Ai varet nga folja dhe shprehet në rasën dhanore ose me parafjalë.

Sipas formës së shprehjes, kundrinori i zhdrejtë ndahet në:

- kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë
- kundrinor i zhdrejtë me parafjalë

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë lidhet drejtpërdrejt me foljen dhe përdoret zakonisht i shoqëruar me trajtë të shkurtër të përemrit vetor. Ai shprehet në rasën dhanore dhe u përgjigjet pyetjeve: kujt? cilit? cilës? cilëve? cilave?. Psh.:

I tregova shokut (kujt?) lajmin.

Nxënëseve (cilave?) u pëlqeu ora e sportit.

Asaj (cilës?) i fola për detyrën.

Miqve (cilëve?) u dërguam ftesë.

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë shprehet me emër, përemër ose grup emëror në rasën emërore, kallëzore ose rrjedhore, gjithmonë me parafjalë. Psh.:

Me emër:

Biseduam për librin. (për çfarë?)

U takuam me mësuesin. (me kë?)

Mendova për shokun. (për kë?)

Me përemër:

A do të vish me mua? (me kë?)

Të gjithë flasin mirë për të. (për kë?)

U interesuam shumë për ta. (për cilët?)

Me grup emëror:

Ne reagojmë ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë. (ndaj kujt?)

Do të diskutojmë për këtë temë të rëndësishme. (për cilën?)



Mbani mend!

- Kundrinori i zhdrejtë është gjymtyrë e dytë e fjalisë.
- Ai mund të jetë pa parafjalë ose me parafjalë.
- Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë vihet në rasën dhanore.
- Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë ka përdorim më të gjerë dhe më të larmishëm.



Fjalorth

u besoi këmbëve = u mbështet te këmbët; vazhdoi me nxitim.

rimarrje = përsëritje e një fjale me trajtë të shkurtër (e, i, ia, ua).

trajta e shkurtër = trajtë e shkurtuar e përemrit vetor që zëvendëson një emër.

P.sh.:

Ajo mori librin. → Ajo e mori.

(e = librin)



Ushtrime

1. Emërto llojin e kundrinorit

Shkruani në kllapa: (kundrinor i drejtë / kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë / kundrinor i zhdrejtë me parafjalë)

1. Ai lexoi artikullin me kujdes. (_____);
2. Nxënësve u pëlqeu ora e muzikës. (_____);
3. Ajo u kujdes për qenin e vogël. (_____);
4. Prindërit i besuan mësueses organizimin e udhëtimit. (_____).

2. Rimarrja e kundrinorit

Plotësoni fjalitë me trajtën e shkurtër të duhur (e, i, ua, u, ia, më).

1. Nxënësit morën librat dhe _____vendosën në raft.
2. Nuk _____flihej atij.
3. Mësuesja shpjegoi rregullat, ndërsa nxënësve të saj _____përsëriti edhe një herë.
4. Prindërit blenë biletat dhe _____dërguan nxënësve me email.
5. Nxënësi përgatiti projektin dhe _____dorëzoi mësueses.
6. Mua _____ kërkuar në klasë.

○ Provo veten - Rretho përgjigjen e saktë

1. Në fjalinë “Ajo i dërgoi shoqes një mesazh”, fjala shoqes është:
 - a) kundrinor i drejtë
 - b) kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë
 - c) kryefjalë
2. Në fjalinë “Nxënësit lexuan librin”, fjala librin është:
 - a) kundrinor i drejtë
 - b) kundrinor i zhdrejtë
 - c) rrethanor
3. Në fjalinë “U folën nxënësve për udhëtimin”, fjala nxënësve është:
 - a) kryefjalë
 - b) kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë
 - c) kundrinor i drejtë
4. Cila nga trajtat e mëposhtme është rimarrje e kundrinorit të drejtë?
 - a) u
 - b) e
 - c) i
5. Në cilën fjali ka kundrinor të zhdrejtë me parafjalë?
 - a) Mësuesja lavdëroi nxënësin.
 - b) Nxënësve u pëlqeu filmi.
 - c) Ata biseduan për udhëtimin.

GJYMTYRËT E DYTA – PËRCAKTORI DHE NDAJSHTIMI

ÇFARË DO TË MËSOJMË?

Në fjali, përveç kryefjalës dhe kallëzuesit, përdoren edhe gjymtyrë të dyta.

Gjymtyrët e dyta janë gjymtyrë plotësuese të fjalisë.

Ato plotësojnë grupin e kryefjalës ose grupin e kallëzuesit.

Një nga gjymtyrët e dyta është përcaktori.

 Lexoni tekstin dhe vëreni fjalët me shkronja më të zeza dhe me hijezim.

Shkupi i vjetër shtrihet përgjatë lumit Vardar. Në lagjet e ulëta të qytetit, ndërtesat e hershme dëshmojnë për zhvillimin e dikurshëm urban. Në pjesët e reja, dy rrugët e tij kryesore lidhin zona të ndryshme të qytetit. Hapësirat publike përdoren për veprimtari të përditshme.

Çfarë vëreni?

Në grupet emërore të tekstit, fjalët e theksuara lidhen me emra dhe i saktësojnë ose i përshkruajnë ato. Këto fjalë janë përcaktorë.

Përcaktori është gjymtyrë e dytë e fjalisë, e cila saktëson, sqaron ose përshkruan emrin bërthamë të një grupi emëror. Ai lidhet gjithmonë me emrin dhe varet prej tij.

Llojet e përcaktorëve

Sipas mënyrës se si lidhen me emrin, përcaktorët ndahen në:

- përcaktorë me përshtatje,
- përcaktorë me drejtim,
- përcaktorë me bashkim.

Me çfarë pjese të ligjëratës shprehen përcaktorët?

Në tekstin e mësipërm, përcaktorët shprehen në këto mënyra:

emër + emër

→ *lumi Vardar*

emër + mbiemër

→ *Shkupi i vjetër*

→ *ndërtesat e hershme*

emër + mbiemër + emër

→ *lagjet e ulëta të qytetit*

→ *zona të ndryshme të qytetit*

numëror + emër + përemër

→ *dy rrugët e tij*

Përcaktori me përshtatje

Përcaktori me përshtatje është ai përcaktor që përshtatet me emrin në gjini, numër dhe rasë. Ai shërben për të shprehur cilësi, përkatësi ose sasi. P.sh.:

Në gjini

Banesa e re është e ndriçuar.

Objekti i ri u përfundua këtë vit.

Në numër

Banesat e reja janë të ndriçuara.

Objektet e reja u përfunduan këtë vit.

Në rasë

I kushtuam vëmendje banesës së re.

U bë përrurimi i objektit të ri.

Me çfarë shprehet përcaktori me përshtatje?

Përcaktori me përshtatje shprehet zakonisht me:

◆ Mbiemër

- i nyjshëm: *shtëpia e re, qyteti i vjetër*;
- i panyjshëm: *djalë besnik, i fola vajzës besnike*;

◆ Përemër

- dëftor: *ky kompjuter, kjo çantë*;
- pronor: *shokët e tij, shtëpia e saj*;
- përemra të pacaktuar: *të gjithë mësuesit, të gjitha nënat*;

◆ Numëror

- *tri fletore me vija, tre lapsa të ri*.

PËRCAKTORËT ME DREJTIM DHE ME BASHKIM

Lexoni tekstin dhe tregoni çfarë funksioni kanë gjymtyrët me shkronja më të zeza.

Biblioteka e qytetit ndodhet pranë sheshit Skënderbe. Në katine dytë është vendosur salla e leximit, ku nxënësit gjejnë libra të autorëve shqiptarë dhe revista të sportit. Gjatë pasdites, nxënësit e klasës qëndrojnë aty me materialet e tyre. Për lexuesit e rinj, kjo hapësirë ofron mundësi nga më të mirat për studim.

Përcaktori me drejtim

Një nga llojet e përcaktorëve që kanë një përdorim të gjerë është përcaktori me drejtim. Quhet me drejtim, sepse gjymtyra prej së cilës varet drejton rasën e përcaktorit. Ky lloj përcaktori shprehet zakonisht me emër ose grup emëror në rasa të ndryshme.

- **rasa gjinore**
*Biblioteka e qytetit është e pasur me libra.
Salla e leximit ishte e qetë.
Nxënësit e klasës u ulën në heshtje.*
- **rasa rrjedhore pa parafjalë**
Ai ndërtoi një raft druri.
- **rasa rrjedhore me parafjalë**
Fjalët kundër rregullave nuk lejohen.
- **kallëzore pa parafjalë**
(gjithmonë në trajtën e pashquar)
*Nxënësi lexoi një libër historie.
Ma jep një fletë letre.*
- **kallëzore me parafjalë**
*Kjo është fjalë me vend.
E kam shok për zemër.*
- **emërore me parafjalë**
*Disa nga nxënësit e kuptuan detyrën.
Ai punon në një shkollë nga më të mirat.*

Kujdes!

Mos i ngatërroni kundrinorët me përcaktorët.
Shikoni gjithmonë nga cila gjymtyrë varet.
Përcaktori varet nga një emër.

Përcaktori me bashkim

Përcaktori me bashkim ka një përdorim më të kufizuar. Ai shprehet me gjymtyrë që nuk ndryshojnë formë gjatë përdorimit, si:

- **përemra pyetës të palakueshëm: ç', çfarë, sa**
Çfarë plane ke bërë!
Sa ditë të bukura ishin!
- **përemra të pacaktuar: asnjë, ndonjë, çdo, ca, shumë, pak, aq**
Në bibliotekë nuk mungoi asnjë nxënës.
Në sallë kishte shumë libra.
- **numërorë që tregojnë sasi sendesh**
Nxënësi rrinte me pesë libra në duar.
Në raft u vendosën katër-pesë fletore.
- **me numërorët dy, tre me kuptim përmbledhës**
të dy nxënësit, të dyja fletoret, të tre shokët
- **me ndajfolje**
Salla përballë është e madhe.

Kujdes!

Bën përjashtim vetëm numërori tre, tri, që janë me përshtatje.

Mbani mend!

- Përcaktori me drejtim merr rasën sipas emrit nga i cili varet.
- Përcaktori me bashkim shprehet me fjalë të palakueshme.
- Në të dy rastet, përcaktori lidhet gjithmonë me një emër.

NDAJSHTIMI

Çfarë dimë dhe çfarë do të mësojmë?

- Në fjali, përveç kryefjalës dhe kallëzuesit, përdoren edhe gjymtyrë të dyta.
- Një nga këto gjymtyrë të dyta është ndajshtimi, i cili është lloj përcaktori.
- Në këtë mësim do të mësojmë si ta dallojmë dhe ta përdorim ndajshtimin në fjali.

 Lexoni tekstin dhe vëreni ndajshtimet

Për herë të parë për figurën epike shqiptare dëgjova nga gjyshe Meli. Shkrimtari Ismail Kadare ka trajtuar motive të shumta nga epika jonë. Rapsod Luani i këndonte trimërisë me lahutë. Studiuesi Zymer Neziri botoi një studim për ciklin “Këngët e Kreshnikëve”. Teatri Kombëtar vuri në skenë dramën “Gjaku i Arbërit”.

Çfarë vëreni?

Fjalët me shkronja të zeza janë ndajshtime. Ato i japin informacion shtesë emrit bërthamë dhe e përcaktojnë më saktë atë.

Çfarë është ndajshtimi?

Ndajshtimi është gjymtyrë e dytë e fjalisë dhe një lloj përcaktori. Ai shërben për të emërtuar, sqaruar ose cilësuar më mirë një emër ose grup emëror.

Me se shprehet ndajshtimi?

Ndajshtimi shprehet zakonisht me emër në trajtë të pashquar dhe përshtatet në numër me emrin që përcakton. P.sh.:

vend mik → dy vende miq

shtet fqinj → shtete fqinje

Çfarë shënon ndajshtimi?

Ndajshtimi mund të shënojë:

a) **profesion, titull, marrëdhënie farefisnie**

Në këto raste, ndajshtimi qëndron para emrit që përcakton.

- *Mësues Vehbiu është shumë i përkushtuar.*
- *Teze Elira na viziton shpesh.*

- *Profesor Iliri botoi një libër historie.*

b) gradë, detyrë, shkallë shoqërore

- *Po lexoj një libër për gjeneral Agim Çekun.*
- *Mbrojtja e qytetit iu besua kapiten Arbenit.*

c) vend gjeografik, titull libri, emër institucioni, rrugë, sheshi etj.

Në këto raste, ndajshtimi qëndron pas emrit dhe shprehet zakonisht me emër të përveçëm.

- *Lumi Vardar është një nga lumenjtë më të mëdhenj të vendit.*
- *Lexova librin "Prilli i thyer".*
- *Mësojmë në shkollën "Ismail Qemali".*
- *Banoj në rrugën "Zef Lush Marku"*



Kujdes!

Për ta dalluar ndajshtimin nga emri bërthamë që përcakton, vini re se:

👉 kur ndryshon rasa e emrit, ndajshtimi zakonisht nuk ndryshon.



Mbani mend!

- Ndajshtimi është gjymtyrë e dytë e fjalisë.
- Ai është lloj përcaktori.
- Shprehet zakonisht me emër në trajtë të pashquar.
- Mund të qëndrojë para ose pas emrit që përcakton.
- Jep informacion shtesë për person, vend, titull, profesion etj.

FJALËT DHE TOGJET E FJALËVE TË NDËRMJETME

 Lexoni tekstin dhe vëreni fjalët me shkronja më të zeza

Zakonisht, nxënësit hyjnë në klasë para se të bjerë zilha. Me siguri, shumica e tyre janë gati për orën e mësimit. Ora e parë, sipas orarit, fillon në 7:30. Arsimtari, si zakonisht, u kërkon nxënësve të përqendrohen. Gjatë mësimit, për fat të mirë, nxënësit marrin pjesë aktive. Për habi, edhe ata që flasin më pak japin mendimin e tyre. Në fund të orës, natyrisht, nxënësit e shënojnë detyrën dhe përgatiten për pushim.

   Çfarë dimë dhe çfarë do të mësojmë?

Në ndërtimin e fjalisë, përveç gjymtyrëve kryesore dhe gjymtyrëve të dyta, përdoren edhe disa fjalë e togje fjalësh që qëndrojnë jashtë lidhjeve sintaksore. Këto quhen fjalë dhe togje fjalësh të ndërmjetme.

  Çfarë janë fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme?

Fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme janë fjalë ose shprehje që nuk lidhen gramatikisht me gjymtyrët e fjalisë, por shërbejnë për të shprehur qëndrimin e folësit ndaj kumtimit. Me anë të tyre folësi:

- vlerëson atë që thotë,
- tregon sa i sigurt është për një fakt,
- shpreh ndjenja,
- tregon burimin e informacionit.

  Vendi dhe shqiptimi në fjali

Fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme mund të qëndrojnë:

- në fillim të fjalisë,
- në mes të saj,
- më rrallë në fund të fjalisë.

Ato shqiptohen me ton më të ulët dhe ritëm më të shpejtë, duke ndërprerë vijën intonacionore të fjalisë. Në të shkruar ndahen gjithmonë me presje. P.sh.:

- *Zakonisht, drejtori vjen herët.*
- *Drejtori, zakonisht, vjen herët.*
- *Drejtori vjen herët, zakonisht.*

🔗 Lidhja me kuptimin e fjalisë

Edhe pse nuk lidhen gramatikisht me gjymtyrët e fjalisë (as me përshtatje, as me drejtim), fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme lidhen me kuptimin e saj. Ato mund t'i referohen:

- një gjymtyrë të veçantë të fjalisë, p.sh.: *Nxënësit, për fat të mirë, e kuptuan mësimin.*
- ose gjithë fjalisë, p.sh.: *Natyrisht, nxënësit do të përgatiten për testin.*

💡 Çfarë shprehin fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme?

Fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme shprehin:

1. ✅ Shkallën e sigurisë ose të vërtetësisë (tregojnë sa i sigurt është folësi për atë që thotë). P.sh.:
 - *Me siguri, nxënësit do ta përfundojnë detyrën në kohë.*
 - *Pa dyshim, ajo e ka kuptuar mësimin.*
 - *Natyrisht, kjo është zgjidhja më e mirë.*
2. ❤️ Vlerësim emocional (shprehin ndjenja si gëzim, keqardhje, habi, zemërim). P.sh.:
 - *Fatmirësisht, gjithçka përfundoi mirë.*
 - *Për fat të keq, shfaqja u anulua.*
 - *Për habi, askush nuk mungoi në orën e fundit.*
3. 🎯 Rëndësinë ose theksimin e një fakti (tregojnë se çfarë është më e rëndësishme në kuptimin e fjalisë). P.sh.:
 - *Para së gjithash, duhet të mësojmë rregullisht.*
 - *Suksesi i klasës, në përgjithësi, është i mirë.*
 - *Sidomos, duhet t'i kushtojmë vëmendje drejtshkrimit.*
4. 🗨️ Burimin e kumtimit (tregojnë nga vjen informacioni). P.sh.:
 - *Sipas kujdestares së klasës, testi do të zhvillohet nesër.*
 - *Sipas njoftimeve, moti do të përmirësohet.*
 - *Sipas mendimit tim, kjo është zgjidhja e duhur.*

📌 Vërejtje

Fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme:

- nuk janë gjymtyrë të fjalisë,
- nuk varen nga asnjë gjymtyrë tjetër,
- nuk ndryshojnë formë,
- përdoren për të qartësuar dhe vlerësuar kumtimin, jo për ta ndërtuar gramatikisht fjalinë.

 Mbani mend!

- Fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme janë elemente jashtë lidhjeve sintaksore.
- Ato shprehin qëndrimin e folësit ndaj asaj që thotë.
- Në të shkruar ndahen gjithmonë me presje.

 Ushtrime

Ushtrime (punë në klasë)

Ushtrimi 1. Nënvizoni fjalët dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme në fjalitë e mëposhtme.

- Me siguri, nxënësit do të vijnë në kohë.*
- Yllka, zakonisht, e përfundon detyrën herët.*
- Për fat të mirë, gjyshja erdhi pa probleme.*
- Sipas orarit, ora e parë fillon në orën tetë.*

  Ushtrimi 2. Tregoni çfarë shprehin fjalët e ndërmjetme në fjalitë e mëposhtme: (vlerësim emocional, siguri, rëndësi / theksim apo burim informacioni).

  Kthejeni librin përmbys për të kontrolluar përgjigjet.

- Pa dyshim, ky është shpjegimi i duhur.*
(i mungon çfarëdës)
- Fatkeqësisht, shfaqja u shty.*
(shpreh vlerësim emocional)
- Para së gjithash, duhet të respektojmë rregullat.*
(shpreh rëndësi / theksim)
- Sipas arsimtares, detyra do të kontrollohet nesër.*
(shpreh burim informacioni)

FJALITË NJËKRYEGJYMTYRËSHE

👁️ Vështrojmë

Lexoni tekstin dhe vëreni si janë ndërtuar fjalitë.

Pranverë. Ajër i freskët. Në rrugë kishte lëvizje e gjallëri. Tej, nga kodra, dukej dielli i mëngjesit. Shikoni sa bukur ndriçon! Të gjithë po vështronin të mahnitur. Po ngryset ngadalë.

🟡 Vini re:

- disa fjali kanë kryefjalë dhe kallëzues,
- disa të tjera kanë vetëm një pjesë kryesore.

📖 Fjalorth

🔹 ngryset ➡ fillon të bjerë mbrëmja;
errësohet ngadalë.

🧐 Çfarë dimë

🔸 Dimë se fjalia zakonisht ndërtohet nga dy gjymtyrë kryesore: kryefjala dhe kallëzuesi. Dimë se:

- kryefjala tregon kush ose çfarë e kryen veprimin;
- kallëzuesi tregon veprimin ose gjendjen e kryefjalës. Psh.:

Nxënësit punojnë me kujdes.

Motra ime po lexon.

🔸 Këto janë fjali dykryegjymtyrëshe, sepse i kanë të dyja gjymtyrët kryesore.

🌸 Çfarë mësojmë

Nga vëzhgimi i tekstit kuptojmë se jo të gjitha fjalitë janë të ndërtuara njësoj.

🔸 Ka fjali që shprehin një mendim të plotë edhe pse kanë vetëm njërin nga gjymtyrët kryesore, si: *Pranverë. Ajër i freskët. Po ngryset ngadalë.* Këto quhen fjali njëkryegjymtyrëshe.

Fjalitë njëkryegjymtyrëshe

Fjalitë njëkryegjymtyrëshe janë fjali që kanë vetëm një gjymtyrë kryesore: ose kallëzuesin, ose një emër / grup emëror. P.sh.:

Po errësohet.

Qetësi.

Pranverë e hershme.

Llojet e fjalive njëkryegjymtyrëshe

Fjalitë njëkryegjymtyrëshe ndahen në:

- ◆ fjali njëkryegjymtyrëshe foljore,
- ◆ fjali njëkryegjymtyrëshe emërore.

Fjalitë njëkryegjymtyrëshe foljore

Këto fjali e kanë kallëzuesin të shprehur, ndërsa kryefjala nuk shprehet, por kuptohet nga forma e kallëzuesit ose nga situata.

a) Fjali njëkryegjymtyrëshe foljore vetore

Kallëzuesi është zakonisht në vetën e parë ose të dytë. P.sh.:

Shikoni qiellin!

Nisim mësimin.

Hajde, vazhdojmë punën.

Mos u vono!

 Pra, në këto fjali kryefjala nuk shprehet, por nënkuptohet.

b) Fjali njëkryegjymtyrëshe me veprues të papërcaktuar

Kallëzuesi është në vetën e tretë shumës, por nuk dihet kush e kryen veprimin.

P.sh.:

Në qytet flisin për motin.

Te rruga e vjetër kishin hapur dyqane të reja.

Në shkollë thonë se do të ketë pushim.

c) Fjali njëkryegjymtyrëshe në vetën e dytë njëjës (me kuptim të përgjithësuar)

Këto fjali nuk i drejtohen një personi të caktuar, por shprehin përvojë ose të vërtetë të përgjithshme. Psh.:

*Njeriun e njeh nga puna.
Kur flet pak, kupton më shumë.
Punën e sotme mos e lër për nesër.*

🕒 Përdoren shpesh në fjalë të urta dhe këshilla.

ç) Fjali njëkryegjymtyrëshe pavetore

Në këto fjali nuk ka kryefjalë dhe nuk mund të vendoset kryefjalë. Psh.:

*Më flihet. Më vjen keq. Po ngryset.
Jashtë po ftohej.
S'i dihet kësaj pune.*

Fjalitë njëkryegjymtyrëshe emërore

Këto fjali nuk kanë kallëzues. Ato ndërtohen nga emra ose grupe emërore dhe shprehin prani, gjendje ose atmosferë. Psh.:

*Mbrëmje vere.
Natë vjeshte.
Qetësi e plotë.
Qieël i kthjellët.
Heshtje.
Dimër.*

📖 Këto fjali përdoren shpesh në përshkrime dhe në letërsinë artistike.



Lexojmë dhe vështrojmë (poezinë)

Fshati im

*Malet me gurë
fushat me bar shumë,
arat me grurë
me tutje një lumë.*

*Fshati për karshi,
me kishë e me varre,
rrotull ca shtëpi
të vogla fare.*

Andon Zako Çajupi

🕒 Vini re përdorimin e fjalive emërore dhe rolin e tyre në përshkrimin e fshatit.



Mbani mend!

- Fjalitë njëkryegjymtyrëshe kanë vetëm një gjymtyrë kryesore.
- Ato mund të jenë foljore ose emërore.
- Kryefjala mund të nënkuptohet ose të mos ekzistojë fare.



Ushtrime

Ushtrime (punë në klasë)

Ushtrimi 1. Lexoni fjalitë dhe tregoni cilat janë fjali njëkryegjymtyrëshe dhe cilat dykryegjymtyrëshe.

- a) *Pranverë.*
- b) *Nxënësit punojnë me kujdes.*
- c) *Po ngryset ngadalë.*
- ç) *Motra ime po lexon.*
- d) *Qetësi e plotë.*

Ushtrimi 2. Tregoni llojin e fjalisë njëkryegjymtyrëshe (foljore / emërore).

- a) *Qetësi.*
- b) *Nisim mësimin.*
- c) *Po ftohej jashtë.*
- ç) *Qie!l i kthjellët.*
- d) *Mos u vono!*

STRUKTURA E FJALISË SË PËRBËRË (PERIUDHËS)

 Lexojmë tekstin.

Nxënësit u mblodhën në klasë pas pushimit. Ata dëgjuan shpjegimin dhe shënuan pikat kryesore. Nxënësit u gëzuan, sepse mësimi ishte i qartë.

 Vëzhgojmë

Nga teksti dallojmë:

fjali me një kallëzues;

fjali me dy kallëzues, ku njëra ndërtohet me lidhëzën bashkërenditëse (*dhe*), ndërsa tjetra me lidhëzën nënrenditëse (*sepse*).

 Çfarë di?

Di se fjalia e thjeshtë ka një kallëzues, të shprehur me folje në një nga format e shtjelluara.

Di gjithashtu se fjalia e thjeshtë mund të jetë e zgjeruar, kur përveç kryefjalës dhe kallëzuesit, ka edhe gjymtyrë të dyta.

 Si fjalia e thjeshtë, ashtu edhe fjalia e përbërë kumtojnë një informacion të caktuar dhe kanë intonacion të mbaruar. Psh.:

Nxënësit pastruan oborrin e shkollës. (fjali e thjeshtë e zgjeruar)
Nxënësit mbanin fshesa në duar, ndërsa nxënëset mbanin qese të zeza. (fjali e përbërë)

 Çfarë do të mësoj?

Do të mësoj çfarë janë fjalitë e përbëra dhe si ndërtohen ato. Do të dalloj fjalitë e përbëra:

- me bashkërenditje;
- me nënrenditje.

Fjalia e përbërë

Fjalia e përbërë është fjali që ka dy ose më shumë kallëzues, të shprehur me folje në forma të shtjelluara. Pjesët e fjalisë varen nga numri i kallëzuesve. Ndërtohet nga dy fjali të thjeshta, të lidhura ndërmjet tyre në një tërësi kuptimore.

 Fjalitë e përbëra quhen edhe periudha.

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje përbëhen nga dy ose më shumë fjali të pavarura,, të cilat:

- janë të barabarta për nga kuptimi;
- mund të qëndrojnë më vete;
- lidhen me lidhëza bashkërenditëse (*dhe, por, ose, ndërsa, prandaj* etj.). Psh.:

Joni e përfundoi detyrën dhe u largua.

Ylli u përgatit mirë, por nuk ishte i kënaqur me rezultatin.

Fjalitë e përbëra me nënrenditje

Fjalitë e përbëra me nënrenditje përbëhen nga një fjali kryesore dhe një ose më shumë fjali të nënrenditura, të cilat quhen edhe fjali të varura.. Fjalja e nënrenditur varet nga fjalia kryesore dhe nuk mund të qëndrojë më vete. Fjalitë lidhen me lidhëza nënrenditëse, si: *se, sepse, që* etj. Psh.:

Ai u gëzua, se e kuptoi mësimin.

Ne qëndruam në shtëpi, sepse binte shi.



Dallimi kryesor

Në fjalitë e përbëra me bashkërenditje, fjalitë janë të pavarura dhe të barabarta. Në fjalitë e përbëra me nënrenditje, një fjali është kryesore, ndërsa tjetra e varur.

Mbani mend!

- Fjalja e thjeshtë ka një kallëzues.
- Fjalja e përbërë ka dy ose më shumë kallëzues..
- Si fjalja e thjeshtë, ashtu edhe fjalja e përbërë kumtojnë një informacion të caktuar dhe kanë intonacion të mbaruar.
- Fjalitë e përbëra mund të jenë:
 - me bashkërenditje;
 - me nënrenditje.

 Ushtrime

Ushtrimi 1. Tregoni nëse fjalitë janë të thjeshta, të thjeshta të zgjeruara apo të përbëra.

- a) *Mbrëmja zbriti ngadalë mbi qytet.* _____
- b) *Drita u shua dhe rruga mbeti në heshtje.* _____
- c) *Ai u ndal, sepse dëgjoi hapa pas vetes.* _____
- ç) *Era e malit sillte freski të lehtë.* _____
- d) *Qielli u mbulua me re, por shiu nuk ra.* _____
- dh) *Treni u nis.* _____

Ushtrimi 2. Ndani fjalitë e përbëra në pjesë. Shkruani sa pjesë ka secila fjali. Ndani sipas shembullit të mëposhtëm.

Fjalja:

Tek po mendonte kështu, dëgjoi zërat e shokëve që e thërritnin nga rruga.

Ndarja në pjesë:

Tek po mendonte kështu / dëgjoi zërat e shokëve / që e thërritnin nga rruga.

(tre kallëzues: mendonte; dëgjoi; thërritnin = tri fjali)



Udhëzim për nxënësin:

- Ndani fjalinë sipas numrit të kallëzuesve.
- Vendosni vijën e pjerrët (/) ndërmjet pjesëve të fjalisë.
- Numëroni pjesët e secilës fjali të përbërë.

- a) *Në rrugë ishin mbledhur disa nxënës dhe po prisnin shokun e tyre.*
- b) *Ata ishin ngritur herët, sepse donin të përfundonin punën në kohë.*
- c) *Kur u hap dera e klasës, nxënësit u qetësuan menjëherë.*
- ç) *Mësuesja e biologjisë shpjegoi mësimin dhe nxënësit e dëgjuan me vëmendje.*
- d) *Ne atë ditë shkuam në kodrat e qytetit, që të mbillnim pemë.*
- dh) *Ai ndaloi për një çast, sepse kishte dëgjuar një zhurmë të lehtë.*

Ushtrimi 3. Riformuloni fjalitë e mëposhtme sipas kërkesës.

a) Kthejeni në fjali të përbërë me bashkërenditje:

Ai u ngrit herët. Ai doli në rrugë.

b) Kthejeni në fjali të përbërë me nënrenditje:

Ajo heshti. Ajo nuk donte të fliste.

FJALITË E PËRBËRA ME BASHKËRENDITJE

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje janë fjali që përbëhen nga dy ose më shumë pjesë të pavarura, të cilat lidhen ndërmjet tyre me lidhëza bashkërenditëse. Këto lidhëza, jo vetëm që bashkojnë pjesët e fjalisë, por edhe tregojnë marrëdhëniet kuptimore ndërmjet tyre. Sipas këtyre marrëdhënieve, fjalitë e përbëra me bashkërenditje ndahen në:

- + shtuese (këpujore),
- ↔ kundërshtore,
- ⊗ veçuese,
- ✓ përmbyllëse.

+ Fjalitë e përbëra me bashkërenditje shtuese (këpujore)

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje shtuese përdoren kur pjesa e dytë e fjalisë shton, vazhdon ose plotëson atë që thuhet në pjesën e parë. Këto fjali janë shumë të shpeshta në përdorim.

👁 Pjesët e fjalisë bashkohen me lidhëzat: as, dhe, e, edhe, si (edhe), hem... hem, si... si, si... ashtu (edhe), si dhe, në disa raste, pa lidhëz. Psh.:

Mësimi kishte filluar dhe nxënësit dëgjonin me vëmendje.
Ai nuk ishte i përgatitur, si edhe nuk kishte përfunduar detyrat.
As nxënësit nuk pyetën, as mësuesi nuk sqaroi më tej.
Ajo fliste qetë, shpjegonte qartë e mbante shënime.

Nuancat kuptimore të fjalive

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje shtuese shprehin edhe nuanca të ndryshme kuptimore. Edhe pse zakonisht lidhen me të njëjtën lidhëz (*dhe*), marrëdhënia ndërmjet pjesëve të fjalisë mund të ndryshojë: ato mund të tregojnë renditje ose numërim të veprimeve, marrëdhënie shkak–pasojë, ose shtesë informacioni. Këto nuanca dallohen duke u mbështetur në kuptimin që krijohet ndërmjet pjesëve të fjalisë. Psh.:

◆ Rënditje ose numërim

Nxënësit hynë në klasë dhe zunë vendet e tyre. Ai lexoi tekstin dhe u përgjigj në pyetje.

◆ Marrëdhënie shkak–pasojë

Qielli u mbulua me re dhe drita u zbeh. Nxënësit u përgatitën me kujdes dhe puna doli e suksesshme.

◆ Shtesë informacioni

Nxënësit përfunduan detyrën dhe mësuesja dha një vërejtje shtesë. Detyra u shpjegua qartë dhe u kuptua nga të gjithë.

↔ Fjalitë e përbëra me bashkërenditje kundërshtore

Këto fjali zakonisht përbëhen nga dy pjesë. Në pjesën e dytë thuhet diçka që kundërshton atë që është thënë në pjesën e parë. Me këto fjali tregohet se dy veprime ose gjendje janë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Prandaj quhen fjali kundërshtore.

🌀 Pjesët e fjalisë bashkohen me lidhëzat: por, kurse, mirëpo, ndërsa, po, pa, veç, vetëm se. P.sh.:

*Vjeshta kishte ardhur herët, por shirat nuk kishin filluar ende.
Të gjithë u drejtuan nga oborri, kurse ai u kthye në klasë.
Ushqimi ishte gati, vetëm se ende nuk ishte vendosur në tryezë.*

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje veçuese

Këto fjali përdoren kur duhet të zgjidhet një mundësi mes dy ose më shumë të tjerave. Ato tregojnë se nga disa veprime ose gjendje realizohet vetëm njëra, ndërsa tjetra / të tjerat nuk ndodhin. P.sh.:

🌀 *O do të vazhdojmë mësimin, o do të bëjmë pushim.*

Në këtë fjali paraqiten dy mundësi:

- të vazhdojmë mësimin,
- të bëjmë pushim.

Nga këto dy mundësi realizohet vetëm njëra, jo të dyja njëkohësisht. Prandaj kjo është fjali e përbërë me bashkërenditje veçuese.

🌀 Pjesët e fjalisë bashkohen me lidhëzat e thjeshta: o, a, ose, apo, si dhe me lidhëzat e përsëritura: ndo... ndo..., qoftë... qoftë..., herë... herë..., ose... ose... etj. P.sh.:

*Ose do të qëndrojmë në klasë, ose do të dalim në pushim.
A po flet me shaka, apo po e ke seriozisht?
Herë dëgjonte me kujdes, herë shpërqendrohej.*

✓ Fjalitë e përbëra me bashkërenditje përmbyllëse

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje përmbyllëse shprehin përfundimin ose pasojën e asaj që është thënë në pjesën e parë të fjalisë.

🌀 Pjesët e fjalisë bashkohen me lidhëzat: **pra, prandaj, ndaj**. P.sh.:

*Qyteti është zgjeruar shumë vitet e fundit, prandaj janë ndërtuar banesa të reja.
Ora kaloi shpejt, ndaj nuk u trajtuan të gjitha temat.
Detyrat nuk ishin përfunduar, pra mësuesja dha më shumë kohë.*

🧠 Mbani mend!

- Fjalitë e përbëra me bashkërenditje përbëhen nga dy ose më shumë pjesë të pavarura.
- Pjesët e fjalisë lidhen me lidhëza bashkërenditëse.
- Sipas kuptimit, ato ndahen në:
- + shtuese, ↔ kundërshtore, ✕ veçuese, ✓ përmbyllëse.
- Në fjalitë veçuese realizohet vetëm njëra nga mundësitë.
- Në fjalitë përmbyllëse, pjesa e dytë shpreh përfundimin ose pasojën.

📝 Ushtrime

Ushtrimi 1. Nënvizoni lidhëzën dhe tregoni llojin e fjalisë së përbërë me bashkërenditje.

a) Nxënësit dëgjuan shpjegimin dhe morën shënime.

b) Mësuesja shpjegoi me kujdes, por disa pjesë mbetën të paqarta.

c) Ose do të përgatishim projektin sot, ose do ta shtyjmë për nesër.

ç) Detyra ishte e vështirë, pra kërkonte më shumë përqendrim.

Ushtrimi 2. Plotësoni fjalitë me lidhëzën e duhur (*prandaj, por, ose..., ose..., dhe*).

- a) Nxënësit punuan në grup _____ detyra u përfundua në kohë.
- b) Ajo donte të merrte pjesë, _____ nuk kishte kohë.
- c) _____ do të punojmë në grup, _____ do të punojmë individualisht.
- ç) Ora përfundoi, _____ nxënësit u larguan nga klasa.

🕒 Rrethoni përgjigjen e saktë

1. Cila fjali është veçuese?
 - a) Nxënësit e dëgjuan dhe menjëherë e kuptuan porosinë e drejtorit.
 - b) Mësimi ishte i gjatë, por shumë interesant.
 - c) Ose do të punojmë tani, ose do të presim pushimin.
 - ç) Koha kaloi shpejt, pra ora mbaroi.
2. Lidhëza ndaj shpreh:
 - a) shtesë;
 - b) kundërshtim;
 - c) zgjedhje;
 - ç) pasojë / përfundim.
3. Në cilën fjali pjesa e dytë kundërshton të parën?
 - a) Dielli perëndoi dhe rrugët u zbrazën.
 - b) Ai u përgatit mirë, ndaj u vlerësua lart.
 - c) Mësimi ishte i qartë, por disa nxënës kishin pyetje.
 - ç) Ose do të lexojmë, ose do të shkruajmë.

✍️ Detyrë shtëpie

Shkruani nga një fjali për secilin lloj të fjalive të përbëra me bashkërenditje: **+** shtuese,  kundërshtore,  veçuese dhe  përmbyllëse.

LEKSIKU

LEKSIKU I GJUHËS SHQIPE SIPAS PREJARDHJES SË FJALËVE



Nxënësi:

kupton nocionin leksik;

- dallon fjalët e burimit të shqipes nga fjalët e huazuara;
- identifikon ndërkombëtarizmat, anglicizmat, orientalizmat dhe barbarizmat;
- përdor me vetëdije fjalë me prejardhje të ndryshme në fjali.



Çfarë quajmë leksik?

■ Leksiku është pasuria e fjalëve të një gjuhe. Me anë të tij, njeriu emërtot botën që e rrethon, shpreh mendimet dhe ndjenjat e veta, përshkruan veprimet, sendet dhe dukuritë e jetës. Leksiku nuk është i ngrirë: ai ndryshon dhe pasurohet vazhdimisht, duke ruajtur njëkohësisht bërthamën e vet më të qëndrueshme.

Leksiku i gjuhës shqipe është ndërtuar gjatë një historie shumë të gjatë. Në të bashkëjetojnë fjalë të trashëguara nga periudha shumë të hershme me fjalë të reja, të marra nga gjuhë të tjera. Këto shtresa nuk e dëmtojnë gjuhën, përkundrazi, dëshmojnë jetën, zhvillimin dhe aftësinë shprehëse të saj.



Sipas prejardhjes, leksiku i shqipes ndahet në dy grupe të mëdha:

- fjalë të burimit të shqipes (vendëse, autoktone)
- fjalë të huazuara



Fjalët e burimit të shqipes

 Fjalët e burimit të shqipes janë fjalë shumë të vjetra, të trashëguara brez pas brezi, që përbëjnë thelbin e gjuhës shqipe. Me to emërtohen realitetet më themelore të jetës njerëzore dhe të natyrës. Këto fjalë lidhen ngushtë me njeriun, me jetën e tij të përditshme, me natyrën që na rrethon dhe me veprimet themelore, pa të cilat komunikimi nuk do të ishte i mundur. Ato janë fjalë të thjeshta, të qarta, që i përdorim çdo ditë. Prandaj, këto fjalë shërbejnë si bazë mbi të cilën ndërtohet gjithë leksiku tjetër i gjuhës.

 Ja disa fjalë të shtresës autoktone të gjuhës shqipe: *ditë, natë, diell, dimër, ujë, tokë, mal, njeri, dorë, gjak, zemër, burrë, motër, bir; jam, kam, ha, pi, shkoj, vij; i mirë, i madh, i vogël; një, dy, tre* etj.

Dije edhe këtë

Fjalët e burimit të shqipes nuk janë vetëm fjalë të thjeshta, por edhe fjalë të prejardhura dhe fjalë të përbëra, të formuara brenda vetë shqipes, si: *dimërak, dimëror, punëtor, punishte, shtegtar, zemërmirë, përmirësoj* etj.

 Një pjesë e fjalëve të shqipes formohet edhe nga onomatopetë, të cilat imitojnë tingujt e natyrës dhe të jetës së përditshme, si: *çuçurit, mërmërit, gurgullon, shushurin, tringëllin, zukat, belbëzoj, bubullon* etj.

 Këto mënyra fjalëformimi tregojnë aftësinë e shqipes për të krijuar fjalë të reja nga mjetet e veta gjuhësore dhe për të ruajtur trashëgiminë e saj të lashtë indoevropiane.

Fjalët e huazuara

 Fjalët e huazuara janë fjalë që gjuha shqipe i ka marrë nga gjuhë të tjera gjatë historisë. Ato kanë hyrë përmes kontakteve politike, kulturore, shoqërore dhe ekonomike. Me kalimin e kohës, këto fjalë janë përshtatur sipas rregullave të gjuhës sonë dhe përdoren sot si pjesë e saj.

Ndërkombëtarizmat

Ndërkombëtarizmat janë fjalë që përdoren pothuajse njësoj në shumë gjuhë të botës. Ato lidhen ngushtë me zhvillimin e shkencës, sepse emërtojnë nocione të përgjithshme shkencore; me politikën, për shkak të organizimit shtetëror dhe shoqëror; me kulturën dhe artin, ku përdoren terma të përbashkët; me sportin, i cili ka rregulla dhe emërtime të njëjta kudo; si dhe me teknologjinë, që zhvillohet në nivel global. Andaj, sipas fushave të përdorimit, ndërkombëtarizmat hasen:

- në jetën shoqërore dhe politike: *demokraci, republikë, kushtetutë, parti, kapital* etj.;
- në shkencë dhe arsim: *gramatikë, histori, gjeografi, medicinë, metodikë* etj.;
- në teknikë dhe komunikim: *telefon, laser, traktor, radio, televizor, internet* etj.;
- në sport: *futboll, basketboll, tenis, pingpong* etj.

● Këto fjalë janë bërë pjesë e përditshme e gjuhës sonë dhe përdoren gjerësisht në komunikim.

🇬🇧 Anglizmat

Anglizmat janë fjalë të marra nga gjuha angleze. Në gjuhën shqipe ato janë futur në mënyrë graduale. Prania dhe përdorimi i tyre është rritur dukshëm gjatë dekadave të fundit, sidomos pas viteve 1990, me zhvillimin e teknologjisë moderne, mediave dhe komunikimit global. Kjo lidhet me ndikimin e anglishtes në fusha të tilla si teknologjia, media, sporti dhe ekonomia. Ja disa anglicizma: *biznes, kompjuter, internet, film, gol, draft, flesh, brifing, biftek, trolejbus, spiker, bucing, onlajn, marketing, video, klik, çet, link etj.*

🏠 Orientalizmat

Orientalizmat janë fjalë të marra kryesisht nga turqishtja, arabishtja dhe persishtja. Ato kanë hyrë në gjuhën shqipe gjatë periudhës osmane dhe janë përdorur gjerësisht në jetën e përditshme dhe shoqërore. P.sh.: *penxhere, jorgan, oxhak, mysafir, zanat, pashë, bajrak, bilur, qiraxhi, çorape, hesap, mixhë, teze, enishte etj.*

⚠️ Barbarizmat

Barbarizmat janë fjalë ose shprehje të huaja që përdoren pa nevojë, edhe pse gjuha shqipe ka fjalë të përshtatshme për to. Dëgjohen shpesh në të folmen e të rinjve dhe në rrjetet sociale. P.sh.:

🔔 Në gjuhën standarde
dhe në të shkruar,
barbarizmat duhen shmangur.

⚠️ Barbarizëm	✅ Fjala shqipe
cool	i bukur / i mirë
chilloj	pushoj
like (e bëra like)	pëlqej
story (në rrjete sociale)	postim / rrëfim (ngjarje)
update	përditësim
aprovoj	miratoj
mrezhë	rrjet (interneti) / rrjetë (peshkimi)
kreativ	krijues
fundamental	themelor
event	ngjarje (rast) / veprimtari (aktivitet i organizuar)
kontinuitet	vazhdimësi
ekspanzion	zgjerim
brutal	i ashpër / i dhunshëm (sjellje) / i vrazhdë (fjalë, qëndrim)
adapt	i përshtasshëm
aman	të lutem
aplikoj	zbatoj (rregullin) / paraqitem, bëj kërkesë (për punë)

 Shembuj ku në një fjali hasen fjalë të burimit të shqipes, fjalë të huazuara dhe barbarizma:

- Nxënësit (*fjalë e burimit të shqipes*) përdorën kompjuterin (*ndërkombëtarizëm*) për projektin (*anglicizëm*).
- Mysafiri (*orientalizëm*) pa filmin (*ndërkombëtarizëm*) në televizor (*ndërkombëtarizëm*).
- Nxënësi e preku mrezhën (*barbarizëm*) e volejbollit (*ndërkombëtarizëm*).
- Familja (*fjalë e burimit të shqipes*) pa një program (*ndërkombëtarizëm*) në televizor (*ndërkombëtarizëm*).
- Vajza (*fjalë e burimit të shqipes*) bëri një update (*barbarizëm*) të profilit (*ndërkombëtarizëm*).
- Shokët (*fjalë e burimit të shqipes*) bënë një selfie (*anglicizëm*).
- Trajneri (*ndërkombëtarizëm*) mbajti një briefing (*anglicizëm*) para ndeshjes (*fjalë e burimit të shqipes*).

RREGULLAT DREJTSHKRIMORE

PRESJA NË FJALINË E THJESHTË

Presja (,) është shenjë pikësimi që shënon një pauzë të shkurtër në të folur dhe ndihmon që fjalia të lexohet e të kuptohet më qartë. Në fjalinë e thjeshtë, presja përdoret për të veçuar:

- gjymtyrët homogjene,
- fjalët që përsëriten,
- gjymtyrët e veçuara,
- thirrërorin dhe fjalët e ndërmjetme.

◆ 1. Gjymtyrët homogjene

Gjymtyrë homogjene quhen fjalët ose togfjalëshat që kryejnë të njëjtin funksion sintaksor në fjali dhe renditen njëra pas tjetrës. Ato ndahen me presje. P.sh.:

Në funksion të kryefjalës:

Burra, gra, pleq, fëmijë dolën në shesh.

Në funksion të kundrinorit:

Bujku mbolli grurë, misër, thekër, elb.

Në funksion të rrethanorit:

Bukuria ishte në qiell, në tokë, në det.

Në funksion të përcaktorit:

Një vajzë e qetë, e sjellshme, e buzëqeshur hyri në klasë.

2. Fjalët e përsëritura

Me presje ndahen fjalët ose togfjalëshat që përsëriten për të shprehur theksim, ndjenjë ose vazhdimësi. P.sh.:

Bilbili, bilbili këndon në degë.

*I bukur, i bukur sa s'bëhet.
Ngadalë, ngadalë po afrohej nata.*

◆ 3. Gjymtyrët e veçuara

Me presje veçohen gjymtyrët që japin një sqarim shtesë për një emër dhe që nuk janë pjesë e domosdoshme e fjalisë. P.sh.:

*Beni, vëllai më i vogël i Burimit, u nis i pari.
Krenari, i mahnitur nga pamja e bukurisë, u ndal të sodiste kodrinat.*

◆ 4. Thirrori dhe fjalët e ndërmjetme

Me presje veçohen edhe thirrori dhe fjalët e ndërmjetme që shprehin ndjenjë, qëndrim ose vlerësim të folësit. P.sh.:

Lumja ti, moj Korçë, që i le pas shoqet e tua.
Bobo, ç'e gjeti!
Besimi, me një fjalë, i plotëson të gjitha kushtet.

Mbani mend!

Në fjalinë e thjeshtë, presja përdoret për të veçuar:

- ✓ gjymtyrët homogjene që renditen njëra pas tjetrës,
- ✓ fjalët e përsëritura,
- ✓ gjymtyrët e veçuara,
- ✓ thirrurin dhe fjalët e ndërmjetme.

PRESJA NË FJALITË E PËRBËRA ME BASHKËRENDITJE

Në fjalitë e përbëra me bashkërenditje, presja përdoret për të ndarë pjesët e fjalisë në raste të caktuara. Pjesët e fjalisë janë njësi të barabarta kuptimore dhe gramatikore, që bashkohen në një fjali të vetme.

◆ 1. Me lidhëzat e përsëritura

Me presje ndahen fjalitë që lidhen me lidhëza të përsëritura si: edhe... edhe, hem... hem, as... as, o... o, ose... ose, ja... ja, herë... herë etj. Psh.:

Edhe nxënësit erdhën, edhe mësuesit u përgatitën.

As Ylli nuk foli, as Blerta nuk reagoi.

Ose do të nisesh sot, ose do të presësh nesër.

◆ 2. Me lidhëzat dyshe

Me presje ndahen fjalitë që lidhen me lidhëza dyshe si: jo vetëm..., por edhe; le që..., por edhe etj. Psh.:

Jo vetëm që ra shi, por edhe u ftoh shumë.

Le që u vonuam, por edhe na u prish autobusi.

◆ 3. Me lidhëzat kundërshtore

Me presje ndahen fjalitë që lidhen me lidhëza kundërshtore si: po (por), kurse, ndërsa, veçse, veç, vetëm se etj. Psh.:

Ai u përgatit mirë, por nuk fitoi.

Në mëngjes ishte diell, kurse në mbrëmje u ftoh.

Unë u nisa herët, ndërsa ai vonoi.

◆ 4. Me lidhëzat përmbyllëse

Me presje ndahen fjalitë që lidhen me lidhëza përmbyllëse si: prandaj, andaj, ndaj etj. Psh.:

Ishte shumë ftohtë, prandaj nuk dolëm.

U lodh shumë, andaj u kthye herët.

◆ 5. Me lidhëzën pa

Me presje ndahen edhe fjalitë e bashkërenditura që lidhen me pa. P.sh.:

Ta kisha parë edhe një herë, pa ç'të ishte!

Mbani mend!

Në fjalitë e përbëra me bashkërenditje, presja vendoset:

- ✓ me lidhëzat e përsëritura,
- ✓ me lidhëzat dyshe,
- ✓ me lidhëzat kundërshtore,
- ✓ me lidhëzat përmbyllëse,
- ✓ me lidhëzën pa.

Ushtrime

Ushtrimi 1. Vendos presjen aty ku duhet në fjalitë e mëposhtme.

1. Nxënësit mësuesit prindërit u mbledhën në sallë.
2. Rea bleu libra fletore dhe lapsa.
3. Ec ec se po na ikën autobusi.
4. Joni shoku im i bankës fitoi çmimin.
5. Eh sa shpejt kaloi vera.

Ushtrimi 2. Në librin tuaj, ndani fjalitë e mëposhtme në pjesë duke përdorur vizën e pjerrët (/). Pastaj, shkruajini sërish fjalitë në fletore ose në tabelën e klasës dhe vendosni presjen vetëm aty ku e kërkon rregulli drejtshkrimor. P.sh.:

Dielli perëndoi /dhe/ qielli u errësua.

→ Dielli perëndoi dhe qielli u errësua. *(te fjalitë e bashkërenditura me dhe presja nuk përdoret).*

Shiu pushoi dhe dielli doli.

Ai u përgatit mirë por nuk fitoi.

Ose do të nisemi sot ose do të presim nesër.

Ishte shumë ftohtë prandaj nuk dolëm.

○ Rrethoni përgjigjen e saktë

1. Në cilën fjali presja është vendosur saktë?
 - a) Nxënësit mësuesit, prindërit u mbloodhën.
 - b) Nxënësit, mësuesit, prindërit u mbloodhën.
 - c) Nxënësit mësuesit prindërit, u mbloodhën.

2. Cila fjali ka fjalë të përsëritura?
 - a) Ajo lexon libra, fletore, revista.
 - b) Ngadalë, ngadalë po zbardhte dita.
 - c) Lumi, shoku im i bankës, erdhi.

3. Në cilën fjali ka gjymtyrë të veçuar?
 - a) Nxënësit hynë në klasë.
 - b) Besa, shoqja ime, erdhi herët.
 - c) Larg, larg u dëgjua një zë.

4. Në cilën fjali përdoret thirrori?
 - a) O shokë, mos u vononi!
 - b) Nxënësit u ulën në banka.
 - c) Dita ishte e bukur.

5. Në cilën fjali presja përdoret para lidhëzës kundërshtore?
 - a) Ai erdhi dhe u ul.
 - b) Ai erdhi, por u vonua.
 - c) Ai erdhi sot.

6. Në cilën fjali presja përdoret para lidhëzës përmbyllëse?
 - a) Ishte ftohtë, prandaj nuk dolëm.
 - b) Shiu pushoi dhe dielli doli.
 - c) Nxënësit erdhën herët.

TË LEXUARIT ME TË KUPTUAR

NARCISI

■ Para leximit

Narcisi paraqitet zakonisht si një personazh i dashuruar me veten dhe me bukurinë e tij. Miti i Narcisit ka mbërritur deri në ditët tona në forma të ndryshme: i përshtatur, i ripërpunuar ose i gërshtuar me elemente të reja letrare. Fragmenti që do të lexoni është shkëputur nga romani “Alkimisti”, vepër e shkrimtarit të njohur brazilian Paulo Coelho (Paulo Coelho), ku miti i Narcisit rrëfëhet në një mënyrë origjinale dhe me një këndvështrim të veçantë filozofik.

Alkimisti mori një libër, që dikush nga karvani e kishte sjellë me vete. Libri ishte pa kapak, megjithatë ai mund të lexonte emrin e autorit: Oskar Uajlld. Teksa shfletonte faqet, gjeti një tregim për Narcisin.

Alkimisti e njohte legjendën e Narcisit, një djaloshi të hijshëm që përditë shkonte të sodiste bukurinë e tij të pasqyruar në ujërat e një liqeni. Ishte kaq shumë i magjepsur pas vetes, sa që një ditë ai ra në liqen dhe u mbyt. Aty ku ai u mbyt, mbiu një lule, që e quajtën narcis.

Megjithatë, kjo nuk ishte ashtu siç Oskar Uajlldi e përfundonte tregimin. Ai tha se kur vdiq Narcisi, erdhën Oreadat – nimfa të maleve – dhe panë se liqeni ishte shndërruar nga një liqen me ujë të pastër në një poçë me ujë të kripur.

– Pse po qan? – e pyetën Oreadat.

– Po qaj për Narcisin, – u përgjigj liqeni.

– Oh, nuk habitemi që ti qan për Narcisin, – shtuan ato. – Në fund të fundit, sado që ne e ndiqnim nëpër pyll, ti ishe i vetmi që kishte fatin të sodisje nga afër bukurinë e tij.

– Pra, Narcisi ishte i bukur? – pyeti liqeni.

– E kush më mirë se ti do t'i përgjigjej kësaj pyetjeje? – iu përgjigjën, të habitura,



Oreadat. – Në fund të fundit, në ujërat e tua vinte e përkulej çdo ditë.

Liçeni qëndroi në heshtje një cope herë. Më në fund, ai tha:

– Vërtet unë po derdh lot për Narcisin, por kurrë s'vura re se ai ishte i bukur. Unë qaj për Narcisin, sepse sa herë që ai përkulej në brigjet e mia, arrija të shikoja të pasqyruar në sytë e tij bukurinë time.

– Ç'tregim i bukur! – tha Alkimisti.

Alkimisti mori një libër, që dikush nga karvani e kishte sjellë me vete. Libri ishte pa kapak, megjithatë ai mund ta lexojë emrin e autorit: Oskar Uajlldi. Teksa shfletonte faqet, gjeti një tregim për Narcisin.

Alkimisti e njihte legjendën e Narcisit, një djaloshi të hijshëm që përditë shikonte të sodiste bukurinë e tij të pasqyruar në ujërat e një liçeni. Kaq i magjepsur aq shumë pas vetes, sa që një ditë ai ra në liçen dhe u mbyt. Aty ku ai u mbyt, mbiu një lule, që e quajtën narcis.

Megjithatë, kjo nuk ishte ashtu siç Oskar Uajlldi e përfundonte tregimin. Ai tha se kur vdiq Narcisi, erdhën Oreadat – perëndesha të pyllit – dhe panë se liçeni ishte shndërruar nga një liçen me ujë të pastër në një poçe me ujë të kripur.

– Pse po qan? – e pyetën Oreadat.

– Po qaj për Narcisin, – u përgjigj liçeni.

– Oh, nuk habitemi që ti qan për Narcisin, – shtuan ato. – Në fund të fundit, sado që ne shkonim pas nëpër pyll, ti ishe i vetmi që kishte fatin të sodisje nga afër bukurinë e tij.

– Pra, Narcisi ishte i bukur? – pyeti liçeni.

– E kush më mirë se ti do t'i përgjigjej kësaj pyetjeje? – iu përgjigjën, të habitura, Oreadat. – Në fund të fundit, në ujërat e tua vinte e përkulej çdo ditë.

Liçeni qëndroi në heshtje një cope herë. Më në fund, ai tha:

– Vërtet unë po derdh lot për Narcisin, por kurrë s'vura re se ai ishte i bukur. Unë qaj për Narcisin, sepse sa herë që ai përkulej në brigjet e mia, arrija të shikoja të pasqyruar në sytë e tij bukurinë time.

– Ç'tregim i bukur! – tha Alkimisti.

Fjalorth

narcis – lule që mban emrin e personazhit mitologjik Narcisi.

i magjepsur – shumë i tërhequr; i mahnitur.

pasqyruar – i shfaqur si në pasqyrë.

oreadat – qenie mitologjike; nimfa të maleve dhe shpellave.

nimfë – qenie mitologjike femërore, që sipas mitologjisë greke e romake banonte në ujëra, pyje ose male.

sodiste – shikonte me vëmendje dhe kënaqësi.


karvan – grup njerëzish që udhëtojnë së bashku.

poçe – enë prej balte për ruajtjen e ushqimit ose të lëngjeve.

Paulo Coelho (Paulo Coelho) ka lindur më 24 gusht 1947 në Rio de Janeiro (Rio de Janeiro), Brazil.

Ai është shkrimtar i njohur brazilian.

Romani i tij më i njohur është *"Alkimisti"*, nga i cili është shkëputur edhe tregimi "Narcisi".



Paulo Coelho (Paulo Coelho)

Kuptojmë tekstin

1. Kush është personazhi kryesor i tregimit?
2. Çfarë bënte Narcisi çdo ditë pranë liqenit?
3. Çfarë i ndodh Narcisit në fund të tregimit?
4. Kush janë Oreadat dhe çfarë bëjnë në tregim?
5. Pse qante liqeni?
6. Çfarë kuptimi ka rrëfimi i liqenit në fund të tregimit?

Rretho përgjigjen e saktë

1. Teksti "Narcisi" është:
 - a) përrallë,
 - b) poezi,
 - c) tregim filozofik,
 - ç) dramë.
2. Narcisi ishte i magjepsur nga:
 - a) natyra,
 - b) njerëzit,
 - c) pasuria,
 - ç) bukuria e vet.
3. Ku e shihte Narcisi pasqyrimin e tij?
 - a) në pasqyrë,
 - b) në liqen,
 - c) në lumë,
 - ç) në det.



Rretho përgjigjen e saktë

4. Pse u bë i kripur uji i liqenit?
 - a) sepse ra shi,
 - b) sepse u mallkua,
 - c) sepse liqeni qau,
 - ç) sepse u ndot.

5. Oreadat janë:
 - a) njerëz të zakonshëm,
 - b) kafshë mitologjike,
 - c) nimfa të maleve,
 - ç) lule.

6. Çfarë simbolizon liqeni në tregim?
 - a) natyrën,
 - b) dashurinë e singertë,
 - c) përqendrimin te vetja,
 - ç) trishtimin.

Mesazhi i tekstit

Tregimi na tregon se ndonjëherë njerëzit mendojnë se i duan të tjerët, por në të vërtetë shikojnë vetëm veten e tyre.

FABULA TË NDRYSHME

Para leximit

Pyetje

1. Çfarë quajmë fabul?
2. Pse në fabula personazhet paraqiten shpesh si kafshë ose si sende?
3. Çfarë mund të mësojmë nga tregime të shkurtra ku kafshët sillen si njerëz?
4. Çfarë quhet mësimi moral i një fabule?

Çelësi i përgjigjeve

1. Fabula është një tregim i shkurtër që përmes kafshëve, njerëzve ose sendeve jep një mësim për jetën.
2. Sepse nëpërmjet tyre paraqiten më qartë sjelljet dhe tiparet e njerëzve.
3. Mund të mësojmë se si duhet të sillemi dhe cilat gabime duhet të shmangim.
4. Mësimi moral është mesazhi ose këshilla që na jep fabula.



KOPRRACI DHE FLORIRI I TIJ (Ezopi)

Një koprrac shiti gjithçka që kishte dhe bleu një kallëp floriri, të cilin e groposi rrëzë një muri të vjetër. Çdo ditë shkonte për ta parë. Një nga punëtorët e tij e pikasi që ai po shkonte aty shpesh në atë vend dhe vendosi ta përgjonte. Shumë shpejt, punëtori e zbuloi thesarin e fshehur, gërmoi dhe gjeti kallëpin e floririt dhe e vodhi. Kur shkoi të nesërmen dhe e gjeti gropën të zbrazët, koprraci filloi të shkulte flokët e të qante sa zë kishte. Kur e pa të pushtuar nga hidhërimi dhe kur mësoi shkakun e këtij hidhërimi, një fqinj i tha:

– Mos u mërzit kështu, por shko e merr një gur, gropose dhe shtiru sikur floriri është ende aty. Njësoj ka për të të shërbyer. Kur ishte aty, ti në të vërtetë nuk e kishe, sepse nuk e përdore as edhe një herë.



Pyetje

1. Çfarë bëri koprraci me pasurinë e tij?
2. Ku e fsheh ai kallëpin e floririt?
3. Kush e gjen dhe e merr floririn?
4. Cili është mësimi i kësaj fabule?

Mësojmë nga fabula: *Pasuria që nuk përdoret nuk ka vlerë.*

DJALI I MBRETIT DHE LUANI I PIKTURUAR (Ezopi)

Një mbret, djali i vetëm i të cilit ishte i dhënë pas ushtrimeve luftarake, pa një ëndërr sikur të birin ia vrau një luan. Nga frika se ëndrra mund të bëhej realitet, ai ndërtoi për të birin një pallat të bukur. Për ta zbavitur, muret e pallatit i zbukuroi me piktura të të gjitha llojeve të kafshëve dhe, midis tyre, ishte edhe piktura e një luani. Kur princi i ri pa pikturën e luanit, zemërimi ngaqë e kishin mbyllur brenda shpërtheu sërish dhe, duke qëndruar pranë luanit, tha:

– Egërsirë e mallkuar, për shkakun tënd dhe të ëndrrës gënjeshtare të tim ati, jam mbyllur këtu, në këtë pallat, si në një burg! E ç'mund të të bëj?

Me të thënë këto fjalë, ai zgjati duart drejt një ferre. Donte të këpuste një nga degët e saj që ta gjuante pikturën me të. Por një gjemb u fut në gisht dhe ai nuk mundi ta nxirrte dot. Plaga iu përkeqësua, i shkaktoi ethe të forta dhe iu ënjt jashtë mase. Ethet ishin aq të forta, saqë djaloshi humbi jetën prej tyre.



Pyetje

1. Çfarë ëndrre sheh mbreti?
2. Pse e mbyll ai djalin në pallat?
3. Çfarë përpiqet të bëjë princi me pikturën e luanit?
4. Cili është mësimi i fabulës?

Mësojmë nga fabula: *Frika e tepruar mund të sjellë fatkeqësi.*

HAKMARRJA E LEOPARDIT (fabul afrikane)

Një ditë, një këlysh leopardi ia mbathi nga shtëpia dhe u kuturis mes një tufe elefantësh. Prindërit e kishin paralajmëruar që t'u rrinte gjithmonë larg atyre kafshëve gjigante, por ai nuk i dëgjoi. Befas elefantët ia dhanë vrapit dhe njëri prej tyre e shkeli këlyshin e pa e vënë re. Pak më vonë, një hienë e gjeti trupthin pa jetë dhe shkoi e u rrëfeu prindërve.

– Lajm të kobshëm po ju sjell, – tha.
– Gjeta trupin e birit tuaj pa jetë, në mes të një fushe.

Dy leopardë, mëmë e babë, lëshuan klithma të mprehta dhimbjeje e mllëfi.

– Si ndodhi? – pyeti i ati.

– Më thuaj, kush ia bëri këtë gjëmë birit tonë? S'do të gjej prehje derisa t'ia marr hakun!

– Ishin elefantët, – iu përgjigj hiena.

– Elefantët? – pyeti babai leopard disi i habitur. – Ishin elefantët, the?

– Po, – tha hiena, – i pashë gjurmët e tyre.

Leopardi nisi të ecte poshtë e përpjetë një copë herë, duke ulëritur e duke tundur kokën.

– Jo, gaboresh, – tha më në fund. – Nuk e kanë bërë elefantët, por dhitë. Dhitë e vranë tim bir!

Dhe, pa e bërë të gjatë, u lëshua tatëpjetë kodrës dhe iu vërsul një tufe dhish që po kullotnin në luginë. Me një shpërthim të dhunshëm zemërimi, në shenjë hakmarrjeje, sulmoi ç'gjeti përpara.



Fjalorth

koprrac – njeri shumë dorështrenguar, që nuk do të shpenzojë asgjë.

ferrë – bimë me gjemba.

ethe – gjendje me temperaturë të lartë dhe dridhje.

ia mbathi – iku shpejt, u largua me vrap.

u kuturis – shkoi diku pa menduar mirë rrezikun.

mllëf – zemërim i madh.

gjëmë – fatkeqësi e madhe.

prehje – qetësi, pushim.

Pyetje

1. Çfarë i ndodh këlyshit të leopardit?
2. Kush ua sjell lajmin prindërve?
3. Kë fajëson babai leopard për vdekjen e të birit?
4. Cili është mësimi i fabulës?

Mësojmë nga fabula: *Hakmarrja pa e ditur kush është fajtor sjell padrejtësi.*

ZËRA NË PARK - (Antoni Broun)

Para leximit

Në shumicën e tregimeve, ngjarjet rrëfohen nga një narrator i vetëm. Por ndonjëherë, e njëjta ngjarje mund të shihet dhe të tregohet nga këndvështrime të ndryshme. Në librin *Zëra në park*, katër personazhe tregojnë të njëjtën shëtitje në park, por secili sipas mënyrës së vet.

👉 Kjo e bën leximin e tekstit jolinear: nuk ka një rrugë të vetme të kuptimit, por disa zëra që duhet të krahasohen.

Si është ndërtuar teksti

Ngjarja është e thjeshtë: dy fëmijë dhe dy prindër shkojnë në park me qentë e tyre. Por historia ndahet në katër pjesë:

Pjesa Kush flet

- | | |
|-----|-------|
| I | Nëna |
| II | Babai |
| III | Vajza |
| IV | Djali |



Secili tregon të njëjtën shëtitje, por me ndjenja, fjalë dhe pamje të ndryshme.

Pse ky është tekst jolinear?

Sepse:

- ngjarja nuk rrëfëhet nga një zë i vetëm,
- lexuesi duhet të krahasojë versionet,
- kuptimi ndërtohet nga bashkimi i këndvështrimeve.

📖 Teksti i mëposhtëm është një përshtatje didaktike e bazuar në librin *Zëra në park* të Antoni Brounit. E njëjta shëtitje në park, rrëfyer nga katër zëra.

1. ZËRI I NËNËS

Sot e çova vajzën time në park. Më pëlqen kur çdo gjë është e rregulluar dhe e pastër. Nuk më pëlqen kur njerëzit nuk dinë të sillen si duhet. Edhe qeni im duhet të sillet mirë, ashtu si vajza ime.

2. ZËRI I BABAIT

Shkuam në park për të larguar pak mendjen nga hallet. Nuk kemi shumë, por ajri i pastër dhe shëtitja na bëjnë mirë. Djali im u gëzua shumë kur pa një fëmijë tjetër.

3. ZËRI I VAJZËS

Në fillim u ndjeva pak e vetmuar. Pastaj pashë një djalë që donte të luante. Qentë tanë u bënë miq dhe ne filluam të qeshnim.

4. ZËRI I DJALIT

Sot parku më dukej vendi më i bukur. Luajtëm, vrapuam dhe u ndjeva shumë i gëzuar. Nuk më bënte përshtypje kush ishim, rëndësi kishte vetëm loja.

Kuptojmë tekstin

1. Çfarë ngjarjeje përshkruhet në të katër pjesët?
2. Sa persona e tregojnë të njëjtën ngjarje?
3. Çfarë dallimesh vëren midis mënyrës si e përjeton shëtitjen nëna dhe si e përjeton babai?
4. Pse vajza dhe djali e përjetojnë shëtitjen ndryshe nga prindërit?
5. Cili personazh duket më i lumtur? Pse?

ANALIZOJMË

1. Çfarë na tregon ky tekst për mënyrën se si njerëzit e përjetojnë të njëjtën ngjarje?
2. Si na ndihmon krahasimi i katër zërave për ta kuptuar më plotësisht situatën?

Përgjigje

1. Ky tekst na tregon se e njëjta ngjarje mund të përjetohet dhe të kuptohet ndryshe nga njerëz të ndryshëm.
2. Krahasimi i katër zërave na ndihmon ta shohim situatën nga këndvështrime të ndryshme dhe ta kuptojmë më të plotë.



MBANI MEND!



Teksti letrar jolinear është ai tekst ku ngjarja nuk rrëfëhet nga një narrator i vetëm, por nga disa zëra, ndërsa kuptimi ndërtohet duke i krahasuar këndvështrimet e tyre.



Detyrë

Përshkruaj një moment nga pushimi i madh i shkollës nga dy këndvështrime të ndryshme: ai i arsimtarit (ose i arsimtares) dhe ai i nxënësit (ose i nxënëses).

Orientime

- Arsimtari ose arsimtarja përqendrohet te rregulli, siguria dhe mënyra si sillen nxënësit.
- Nxënësi ose nxënësja përqendrohet te loja, shokët dhe ndjenjat e veta.
- Të dyja përshkrimet tregojnë të njëjtin moment, por nga këndvështrime të ndryshme.

LETËRSI, TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA

 LETËRSIA POPULLORE LIRIKA EPIKA NË PROZË DRAMA TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA

Letërsia popullore

Mëso se...

Letërsia popullore është panoramë e të gjitha epokave kohore, e cila në formë shtresimesh kronologjike dëshmon për ecurinë e letërsisë dhe ndërveprimin e saj me rrethanat e kohës kur është krijuar. Ajo mbetet ndër burimet kryesore për njohjen e begatisë shpirtërore të popullit dhe identitetit kombëtar shqiptar, duke e lidhur të kaluarën me brezat e sotëm.

Letërsia popullore është thesar kombëtar.

Letërsia popullore përfshin krijime gojore artistike, që populli i ka krijuar, ruajtur dhe përcjellur brez pas brezi.

Ajo ka karakter njohës dhe edukues, pra krijimtarisë shpirtërore i jep vlerë të përgjithshme artistike dhe shoqërore.

Letërsia – arkiv kalendarik i ngjarjeve.

Gruni e mjedra

Një njeri qi enbiell fare të mirë end arë tëh tij. E sih enfjetnë njerëzitë, vjen anëniku i tij dhe enbiell manë mjedhëra (mjedra) endër për drithët. Kur u rrit drithëtë e zuu meh zanë frujt, ashtu atëh herrë u dëftuonë dhe manëmjedhëratë. E shërbëtorëtë e atit (të) fëmijësë (e zotit të shtëpisë) thanë: Zot as enbolle tihdrithë tëh mirë end arë tënde; Sih tash u enbush plot manëmjedhëra? E aih u tha atyne: Nierii qii anshtë anëmik banih atëh. Shërbëtorëtë hi thoshnëh: A doh (që) nah tëh vemte tih qërojmë? E aih u thah: Joh për seh ju tue dëllirunë manëmjedhëratë mos shkulinjitë edheh drithëtë. Le të ritetë njani e tjetëri djerjeendë e korrë, e ende mot tëh korrët (të korrjeve) u tëh thoem korrëset (korrësve): Emblidhni parë manëmjedhëratë e hi bani fashë për tëh djegunë e drithëtë enbasandajh enbëlidhnieh endë sojnicët teme.

Prozë e shkurtër: “Meshari”, Gjon Buzuku (1555).

Fjalorth


are (ë) - farë për mbjellje;
manëmjedhëratë - mjedra;
dëllirunë - dëllirë, pastruar;
djerje - deri, gjer;
sojnicë - grunar, drithnik, hambar.



Populli shqiptar, përgjatë lashtësisë mijëra vjeçare i ka krijuar dhe ruajtur doket dhe zakonet, si vlerë shpirtërore, të cilat i ka bartur brez pas brezi. Kjo trashëgimi shpirtërore dhe artistike e popullit e përbën kategorinë e veçantë të folkloristikës, që quhet krijimtari gojore.

Letërsia gojore është pasuri e rëndësishme për një popull. Edhe pse është letërsi pa autor, pra krijues është vetë populli, ajo u paraprin të gjitha letërsive tjera të krijuara në kohët e mëvonshme.

Letërsia gojore është e pranishme kudo, prandaj duhet të mësohet në shkolla, që nxënësit të fitojnë njohuri për të. Letërsia gojore shqipe është e pasur me: proverba, gojëdhëna, legjenda, gjëegjëza, këngë, fabula, anekdota, përralla etj.




PROVERBA

Proverba njihet si urti popullore
(fjalë të mençura, fjalë të arta).

*Proverba nga “Meshari” i Gjon Buzukut (1555)

- *Qish mos do të jetë bam ty, ti mos e bajnsh kunjaj.*
(Çfarë nuk do që të të bëhet ty, mos ia bëj askujt).
- *Mos del dëshmi reshim, askujnaj.*
(Mos dil dëshmitar i rrejshëm, i askujt).
- *Gjithëkush të jetë i drejtë me zemër,*
e gjithkush atë të ndjekë.
(Gjithkush të jetë i drejtë me zemër,
e gjithkush atë ta ndjekë).
- *Mos ini të pritem me xanë.*
(Mos përtori me nxënë).
- *Kush rall mbiell, rall kuorën.*
(Kush rrallë mbjell, rrallë korr).
- *Populli it mbë vend të vet.*
(Populli yt, në vend të vet).



*Proverba nga “Fjalori” i Frang Bardhit (1635)

- *Kush nuk ashtë mbusuem s'di me urdhënuem.*
(Kush nuk është i ditur s'di të urdhërojë - udhëheqë).
- *Ma mirë me heshtunë se shumë me folë.*
(Më mirë të heshtësh se sa të flasësh shumë).
- *Peshku maa parë qelbët ëndë kryet.*
(Peshku më parë qelbet në krye).
- *Molla nuk rrëzohet larg mollet.*
(Molla nuk bie larg mollës - Molla bie ndër mollë).
- *Grueja e bukurë dhe vena e ambëlë janë helm.*
(Gruaja e bukur dhe vera e ëmbël janë helm).
- *Nja gur s'ban mur.*
(Një gur s'bën mur).
- *Dhei i zi ban bukënë e bardhë.*
(Dheu i zi e bën bukënë e bardhë).
- *S'duhet me zanë besë as ujkut, as turkut.*
(S'duhet zënë besë as ujkut, as turkut).

GJËEGJËZA



Mendje s'ka, por të mëson,
gojë s'ka, me ty flet,
ditë për ditë me të jeton,
mik të ngushtë e ke për jetë.



Për ju shkruaj, për vete vuaj!



Kam qytete, por jo shtëpi,
kam male, por jo dhe pemë,
kam ujë, por jo peshk.
Çfarë jam unë?



Udhëton në tërë botën,
prapë në vend mbetet.



Natë e ditë pa zë numëron,
askush punën s'ia mohon!



Punon pandërprerë tik e tak,
natë - ditë pa u ndalë aspak,
s'lodhet kurrë, kurdiset prapë.



Jam lot që pikon nga qielli,
mund të më thajë veç dielli!



Duket si një shtëpi,
me katër mure, një çati,
njëmijë veta brenda ka
që punojnë pa ia da.

PËRSHËNDETJE

Përshtëndetje të moçme shqiptare

- *Mirë se të gjanj o zot shpie!*
- *Mirë se u gjanj o fisnikë!*
- *Mirë se u gjanj trimatë e mirë!*
- *U gëzofhtë zemra jote!*
- *Nata e mirë të qoftë!*
- *Urdhno me paqe!*
- *Paç shëndet e hire!*
- *Kandë e paqe mbi shtëpinë tuej!*
- *Ndo ende tyj të dashtë paq i lumi Zot!*



Përshtëndetjet tradicionale shqiptare janë pjesë e trashëgimisë sonë kulturore.

Shprehjet, si: “Tungjatjeta”!, “Mirë se vini”!, “Punë e mbarë”!, “Qofsh i lumtur”!, “Paç bekime”!, “T’u gëzofhtë zemra”!, “Qofshi të nderuar” dhe shumë të tjera, shprehin respekt, mirësjellje dhe dëshirën për të mirën e tjetrit. Duke i përdorur në jetën e përditshme, ne e ruajmë bukurinë e gjuhës shqipe dhe vlerat e traditës sonë.

Letërsia gojore është letërsi artistike, në të cilën populli është krijuesi i të gjitha historive, të gjitha epopeve të tokës.



♦ **Detyrë:** shënoni disa përshtëndetje, të cilat i përdorni në familje dhe në mjedisin tuaj jetësor!

ANALIZË

“Arti përpiqet të nxjerrë në pah dhe në mënyrë sa më të plotë aspekte të botës, ashtu që secili si përmes një velloje të hollë, ta lexojë kuptimin që kanë gjërat dhe që filozofia e kërkon”.

(Jeronim de Rada.)

◇ **Krijimet gojore arrihen duke përdorur (rretho fjalitë e sakta):**

- përmbajtje tematiko-shoqërore;
- kompozicion mjeshtëror;
- strukturë ideore dhe tematike të mirëhartuar;
- figuracion të pasur artistik;
- porosi (mesazh) ku përshkohet tërë realiteti i kohës.

◇ **Urti popullore - shpjego kuptimin dhe porosinë e tyre:**

- “Rrëfen puna, s’rrëfen guna”.
- “Më mirë të dish sesa të kesh”.
- “Trimëria pas luftës dhe mençuria pas kuvendit nuk vlejnë më”.
- “Dora me baltë, buka me mjaltë”.
- “Të varfrit i mungojnë shumë gjëra, koprracit i mungon gjithçka”.
- “Kullote dhinë, të të mbushë kusinë”.
- “Koprraci s’të jep as gur e jo më bukë”.

◇ **Detyrë:**

- Shëno proverba me përmbajtje edukuese!
- Duke i përdorur proverbat që di krijo një tekst me to!
- Nënvizto se cilat nga proverbat e dhëna flasin për punën, diturinë, gjendjen shoqërore dhe virtyte të tjera të njeriut!
- Shkruaj disa proverba që përdoren në mjedisin tënd jetësor!
- Trego një ngjarje të shkurtër, duke dhënë një përfundim proverbial!
- A ke lexuar libër me proverba?
- Bëni një përshkrim të shkurtër me disa nga përshëndetjet e dhëna më sipër!

◇ **Fjalë dhe shprehje:**

- Përmes ndarjes në çifte, nxënësit i thonë njëri-tjetrit proverba.
- Nxënësit (individualisht) tregojnë nga një gjëegjëzë.

FOLKLORI

Mëso se...

Pasuria gojore, e ngritur në periudha të shumta kohore, si tërësi e krijimeve artistike popullore quhet folklor. Folklori bën pjesë në jetën e gjallë të popullit. Pra, është krijimtari që zë vend të rëndësishëm në letërsinë popullore.

Folklori është thesar popullor.

- Folkloristikë, quhet shkenca që merret me studimin e folklorit.
- Folklorist, quhet mbledhësi dhe studiuesi i folklorit.

Letërsia gojore është përplot pasuri materiale dhe shpirtërore, të cilat shpesh përbëjnë fakte për llojet tjera të krijimtarive, si: letërsia, etnografia, muzika, vallja, kënga..., që e kanë prejardhjen te ngjarjet dhe dukuritë që pasqyrohen në folklor.

“Gurrë e pashtershme popullore”, studiuesit e quajnë pasurinë e madhe të krijimtarisë gojore, e cila është ruajtur brez pas brezi në kujtesën e popullit.

Për nga përmbajtja dhe mënyra e pasqyrimit ndahet në dy gjini: gjinia e lirikës gojore dhe gjinia e epikës gojore.

**Folklori përshkruhet përmes:
tiparit individual dhe tiparit kolektiv.**



PËRFAQËSUES TË FOLKLORIT SHQIPTAR

Vëmendja për folklorin, njohjen, mbledhjen dhe studimin e tij vihet re qysh në fillim të shek. XVII, kur Frang Bardhi botoi disa proverba dhe përshëndetje të vendosura në “Fjalorin italisht-shqip” (1635).

Në shekullin XVIII, me zhvillimin e jetës kulturore të arbëreshëve të Italisë, lindi letërsia artistike në gjuhën amtare, ndërkaq përpjekja e tyre për ta ruajtur traditën dhe gjuhën e nxitën edhe mbledhjen e folklorit. Ndër të parët që mblodhën këngë arbëreshe shquhen: Nikolla Filja (“Këngë të pleqërisë”), Gavril Dara Plaku, Gavril Dara i Riu, Françesko Avati, etj.

Në fillim të shekullit XIX, si mbledhës të folklorit shqiptarë njihen: Anton Santori, Jeronim de Rada (“Rapsodi të një poemi arbëresh”, 1866); Dhimitër Kamarda, Thimi Mitko (“Bleta shqiptare”, 1878); Zef Jubani (“Përlindja e Shqipnisë”) etj.

♦ **Detyrë:** tregoni cilin lloj të folklorit e njihni më mirë dhe përshkruajeni atë sipas shembujve të dhënë!

Shembuj:

Vallja e Shotës - Është valle që dallohet për ritmin e shpejtë, hapat e lehtë dhe lëvizjet plot gjallëri. Valltarët kërcejnë të kapur dorë për dorë ose krah për krah, duke buzëqeshur dhe duke përcjellë gëzim, energji dhe bashkim. Në mes të valltarëve kërcejnë çift me njëri-tjetrin, një djalë dhe një vajzë. Kjo valle është njëra nga më të dashurat në traditën shqiptare.

Vallja e Shpatave - Është valle, e cila realizohet me përdorimin e shpatave. Valltarët kryejnë lëvizje të sakta dhe ritmike, duke i afruar dhe kryqëzuar shpatat me kujdes. Vallëzohet kur valltarët kërcejnë në çift, pra dy nga dy, duke i tundur shpatat dhe duke lëvizur me ritmin e muzikës. Kjo valle simbolizon trimërinë, forcën dhe gatishmërinë për ta mbrojtur vendin.

POEMA


Mëso se...

Poema është vepër e gjatë lirike ose epike e shkruar në vargje. Zakonisht është formësuar si këngë, ku trajtohet një temë e gjerë: historike, mitologjike, heroike, lirike, filozofike... Karakterizohet, me formë të përpunuar poetike, nga ritmi dhe figuracioni artistik.

Poema – krijim epik, i gërshetuar me mjaft elemente lirike.

KONSTANDINI I VOGËLTH

Kostandini i vogëlith,
dhëndër vetëm për tri ditë,
e si shkuan ato tri ditë
me nusen të re, të re,
i erdh karta e Zotit të madh,
të nisej në ushtri.
Atëherë Kostandini,
shkoi në dhomën e të atit,
të atit e të ëmës,
dhe uratën u kërkoi,
duke u puthur dorën.
Pastaj çoi të dashurën,
hoq unazën e ja dha.
– Më jep timen, zonja ime,
se më thirri zoti i madh,
të nisem për në ushtri,
të luftoj për nëntë vjet.
Si të shkojnë nëntë vjet,
nëntë vjet e nëntë ditë,
e në mos u kthefsha,
vashë të më martohesh.
- S'pipëtiu fare vasha.
Shtangu dhe qëndroi në shpi
gjersa shkuan nëntë vjet,
nëntë vjet e nëntë ditë.
Pastaj plaku, vjehëri i saj,
(shumë trima bujarë
çonin lajm se e donin)
“bija ime, i tha, martohu”.



As që foli vasha e bardhë.
 E m'i bënë krushqi të lumtur.
 Te pallati i Zotit të madh
 në mesnatë Kostandinit,
 i vete në gjumë një ëndërr,
 aq e frikur ëndrra ish
 sa i trembi gjumin.
 Zgjuar dhe i brengosur,
 rënkoi e dha një psherëtimë,
 sa e dëgjoi dhe Zoti i madh,
 mbyllur në shatorre
 nga lagështi e natës.
 Si u ngre mëngjesit herët,
 vuri e u ranë dauilleve,
 mblodhi bujarë edhe roje
 e i thirri tek rreshti.
 -O ju ushtarët e mi,
 të vërtetën të më thoni,
 kush menate psherëtiu?
 Gjithë thanë se nuk dëgjuan,
 vetëm Kostandini foli:
 -Psherëtiva unë, i mjeri.
 -Kostandin, besniku im,
 -ç'ishte psherëtimja jote?
 -Psherëtimja ish e thellë,
 se martohet zonja ime.
 -Kostandin, o biri im,
 shko në grazhdet e mia,
 zgjidh ti kalin më të shpejtë,
 të shpejtë si skifteri.
 I hipi dhe u shpoi mamuzet.
 Pak u prë ditën e natën,
 gjersa ra në dhe të tij.
 Sa m'u gdhi e diela,
 më takon të anë e plakur.
 -Ku vete ti, o tatë loshi?
 -Vete ku shkretimi im
 më çon të gremisem,
 se pata një bir të hijshëm,
 e martova shumë të ri
 me vashën që deshi vet;
 tri ditë ndenji dhëndër,
 sa erdh karta e Zotit të madh,
 që e thirri për në luftë,
 biri im i mbushur helm,
 atëherë vashës i dha unazën:

"Do të nisem për ushtri,
 të luftojë për nëntë vjet,
 kur të shkojnë nëntë vjet
 nëntë vjet e nëntë ditë,
 edhe unë të mos kthehem,
 mbaj unazën e martohu,
 se do jem unë nën dhe."
 Medet, sot vasha martohet
 dhe dufeqet që po shkrehen
 thonë vdekjen e tim biri
 dhe unë shkoj për t'u gremisur.
 – Shko nga erdhe ti tatë losh,
 se yt bir vjen për njëmend.
 – Më ruash, i bukuri djalë,
 që më dhe lajmin e mirë
 se Kostandini vjen njëmend.
 – Trimi ngau mamuzet
 të arrijë pa vënë kurorë.
 Në orën e meshave
 mbërriti në katund
 mu në derë të kishës.
 Kur erdhi nusja,
 dhëndëri e dasmorët
 e nguli flamurin.
 -O ju krushq e ju bujarë,
 merrmëni mua për nun
 tek nderi i kësaj nuseje.
 -Mirëse vjen, ti trim i huaj,
 trim i huaj e i hijshëm.
 U hap kisha e brenda hynë.
 Dhe më pas erdhi radha
 t'i ndërrojë çiftit unazat.
 Por e ndërroi e i la te gishti
 nuses unazën e tij.
 Zonjës si m'i vanë sytë,
 e pa mirë dhe e njohu,
 lotët çurg ju rrokullisën,
 sumbulla faqeve të kuqe,
 pikë, pikë gjirit të bardhë.
 -O ju priftër e bujarë,
 ndaleni atë kurorë,
 Kostandin kurorë e parë,
 lidhur me vashën për jetë,
 Kostandini është ndër të gjallë.

Jeronim de Rada

Poema “Konstandini i vogëlth” e Jeronim de Radës e përshkruan fatin e një djali të ri, duke e pasqyruar botën shpirtërore të arbëreshëve, dashurinë për familjen, vendlindjen dhe lirinë. Përmes ngjarjeve dhe personazheve, poeti shpreh ideale të larta njerëzore dhe ndjenjën e sakrificës dhe qëndresës, duke ndërthurur elemente historike, lirike dhe romantike.

Kjo vepër ka rëndësi të veçantë në letërsinë shqipe, sepse e pasqyron identitetin kombëtar të arbëreshëve, i ruan traditat e tyre dhe e dëshmon mjeshtërinë artistike të De Radës, njërit prej themeluesve të letërsisë sonë romantike.

“Atë që bëri Skënderbeu me shpatë,
Ti e bëre me pendë, o i madhi De Radë”!

Fjalorth

i vogëlith - i vogël;
karta - letra;
uratën - bekimin, miratimin;
s'pipëtiu - nuk bëri zë;
shatorre - tenda;
grazhd (et) - vend i rrethuar me gardh brenda një stalle, ku hidhet ushqimi i ndonjë kafshe;
skifteri - shpend grabitqar, fajkua;
mamuzet - kllapë hekuri në trajtë patkoi që e përdorin kalorësit të çizmet për të ngacmuar kalin që të ecë më shpejt;
u gdhi - u zbardh, agoi;
dufeqet - dyfeqet, pushkët;
nun - kumbarë;
sumbulla - kokrra (lotësh).

Jetëshkrim

Jeronim de Rada njihet si përfaqësues i parë i Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Lindi më 29 nëntor 1814, në katundin Maki të Kozencës, në një familje arbëreshe të Kalabrisë (Itali).

U shkollua në Kolegjin e Shën Adrianit, ku mori dije dhe kulturë të përgjithshme.

Ishte poet, gjuhëtar, publicist, folklorist.

Më 1883 e botoi revistën “*Fiamuri Arbërit*”.

Përmes folklorit e zbuloi shpirtin e arbëreshëve. I botoi poemat: “Skanderbeku i pafaan”, “Këngët e Milosaos” (1836); “Serafina Topia” (1840); “Rapsodi të një poeme arbëreshe” (1866) etj.

De Rada ndërroi jetë më 28 shkurt 1903, në vendlindje.



Jeronim de Rada
(1814 - 1903)

ANALIZË

◇ Interpretoto përmbajtjen e poemës:

- Në cilën periudhë vendoset ngjarja?
- Identifiko personazhet e poemës!
- Çfarë lajmi mori personazhi kryesor?
- Përshkruaj gjendjen shoqërore dhe shkaktarin e tyre!
- Si përfundon ngjarja?

◇ Bën përshkrimin e personazhit kryesor:

- Cili ishte problemi i Konstandinit dhe çfarë iu kërkua atij?
- Sa ndikon në realizimin e ngjarjes prania e kafshëve?
- Çfarë figure stilistike paraqet personifikimi?
- Ku është kulminacioni i ngjarjes?
- A ka elemente fantastike në poemë?
- Cila është porosia (mesazhi) e autorit?

◇ Rretho alternativat e sakta të gjuhës në krijimet popullore:

- | | |
|---------------------|----------------------|
| - gjuhë e zakonshme | - gjuhë artistike |
| - e folme popullore | - e folme dialektore |
| - gjuhë e thjeshtë | - gjuhë e ndërlikuar |

◇ Detyrë:

- Kërko ndonjë rrëfim të ngjashëm (në internet ose libra) dhe përshkruaj personazhet dhe ngjarjen!

(Shëno në fletore detyrën e dhënë!)



ANEKDOTA

Mëso se...

Thimi Mitko filloi të shfaqë interesim për folklorin rreth vitit 1859, kur ishte në Vjenë. Nga Spiro Dine (1846 - 1922) mësojmë se Mitkoja kishte nisur të regjistronte material folklorik para vitit 1866. Ai i dha Dhimitër Kamardës këngë popullore, gjëegjëza dhe përralla për përmbledhjen e tij.

Anekdotë - është formë e rëndësishme e trashëgimisë gojore, e përdorur për të përçuar mençuri popullore, përmes shakave ose ndodhje të mençura. Ato janë tregime të shkurtra që e përdorin humorin dhe satirën për të kritikuar padrejtësitë shoqërore dhe të metat e njerëzve, si: koprracia, mendjelehtësia dhe gënjeshtria.



E RREMA E KAMËSIT DHE E DREJTA E DORËHOLLIT

Mbë një vënt, tek përralloseshin katër a pesë veta, u hoth e tha një kamës se miu i hëngri umin' e hekurtë të plugut edh'e mbesuanë të gjithë si të vërtetë, ndonëse e rrëme.

E dorëhollin që tha të drejtën se i hëngri miu një çyrek bukë, e quajtin për rrenës.

Mbani mend!

Thimi Mitko ka mbledhur dhe një shumëllojshmëri këngësh:

- Kënga të moçme (alegorike dhe komike);
- Kënga që këndohen ndër disa ditë të shënuara;
- Kënga shqype dasmore;
- Kënga shqype trimërishte;
- Kënga shqype trimërishte gegërishte.



GËNJESHTARI



“Njëherë, një i varfër iu ankua Ali Pashës se një bej i fshatit ia kishte rrëmbyer kopënë e dhenve.

Aliu e thirri beun dhe i tha: - Pse ia more dhentë këtij të mjerit?

Beu iu përgjigj: - janë të miat, o Pashë.

Atëherë, Aliu urdhëroi t'i sillnin një shportë me rërë dhe, pasi e vuri përpara të dyve, tha: - Le të mbajë dorën sipër shportës ai që thotë të vërtetën.

I pari e vuri dorën i varfri, e pastaj edhe beu. Kur beu e preku rërën, ai u drodh e u zverdh.

Aliu tha: - E mora vesh: dhentë janë të këtij të varfrit. Rrëmbeni dhe jepjani pronarit! Dhe shtoi: - Gënjeshitari ka gjithnjë zjarr ndër duar”.

Jetëshkrim

Thimi Mitko lindi në Korçë, në vitin 1820. Mësimet i ndoqi në shkollën vendore.

Për shkak të veprimtarisë atdhetare iu desh të largohet nga vendlindja. Në vitin 1866 mërgoi drejt Egjiptit, ku iu përkushtua lëvizjes kombëtare, si dhe mbledhjes së burimeve të folklorit shqiptar.

Ai kishte lidhje me personalitetet e mëdha të letrave shqipe, si: Jeronim de Rada, Dhimitër Kamarda, Dora d'Istria, Kostandin Kristoforidhi, etj.

Njihet për mbledhjen e këngëve popullore, gjëegjëzave, proverbave e tregimeve të moçme

Veprën “Bleta Shqiptare” e botoi në vitin 1878, në Aleksandri të Egjiptit, si një koleksion përmes të cilit do ta ndihmonte Bashkësinë shqiptare në Egjipt, duke e ushqyer me të dhëna mbi kulturën shqiptare.

Thimi Mitko ndërroi jetë më 22 mars 1890, në Egjipt.



Thimi Mitko
(1820 - 1890)

PËRRALLA

Përralla - është tregim i shkurtër, në të cilin përshkruhen ngjarje të trilluara, që zakonisht paraqesin, magjepsje dhe qenie mitike ose fantastike.

Përrallat përmbajnë të dhëna sipërfaqësore për njerëzit, vendet, ngjarjet, botëkuptimet, fenë, pa saktësinë kohore, pra zhvillohen “një herë e një kohë”, “na ishte një herë”, që nënkuptojnë histori të largëta pa elemente vërtetësie.

PESHKATARI DHE E BUKURA E DHEUT

Qe një peshkatar, kish edhe të shoqen.

Një ditë i thotë e shoqeja atij;

-Ore burrë, ti ngaherë shet peshk, nuk do të na sjellç edhe neve njëherë ndonjë?

Edh' ay vate nesëret të gjuanjë për ndë shtëpi edhe tek hodhi mërezhënjën ndë ujt, zuri një peshk të mirë.

Po ay peshk i tha peshkatarit:

-Mos më trazo mua, se s'jam fati jyt, po lëshomë mua, pa eja nesërë të zësh një tjetërë, që do të jetë për ty.

Edh' ay lëshoi e vate zbrazurë ndë shtëpi, tuke qën' e shoqëja po priste peshk me tiganë vënë ndë zjarrit.

E pyeti e shoqeja:

-Për se nuk solle peshk, o burrë?

Ay i tha se “kështu e kështu më ngjau, o grua”.

Mbë të nesërmen vajti përsëri aty dhe zu një peshk të math, i cili i tha ati:

-Mirë më zure, po të më bësh tetë fela. Dy nga ato t'i shtijesh ndë portë tënde, dy të ia shtijesh pelës, dy bushtërës, edhe dy të ia japësh sat shoqe.

Edhe ay, me të vaturit ndë shtëpi, e ndau atë me vërtet ashtu siç ish porositur. E pa diturë fare gjë ay, namëta te porta mbinë dy selvi, pelëza polli dy harmëshorë, të mirë paanë, bushtëra polli dy leonë të çuditçimë, edhe e shoqeja lindi dy djelmë trima, edhe të bukur shumë.

Ndë një fshat atje pranë këtyrevet rrinte e bukur' e dheut e djal' i math i peshkatarit, posa e nxu atë, u shti kaqe pas asajë, sa taksi të vejë e ta marr' atë për gru.

I jati i djalit edh'e ëma rrahën me gjith udhët që ta prapsën atë, sa gjith'



i rrëfyen edhe rrezikun e krejt që do të hiqte mbë të vajturit atje, po ay, s'qe memundë të bindetë.

Mbësëfundi u tha djai se, ndë qoftë se selvia e tijë të zërë të mfishket edhe të mpshonjë tatëpjetë, ta dinë se atëhere është i humbur' ay.

Edhe u nis, e shkoi.

Pasi u sos në fshat të së bukurës së dheut, vate me gjithë luan' e tijë drejt' e ndë shtëpi të saj.

Atje i doli përpara një plak' e asaj e e pyeti:

-Çë do?

E posa tha ky se "do të bukurën e dheut", me të parët plaka, e bëri gur këtë, ndë çast edhe selvia e tij ndek'i ati u mfishk, edhe mvari qafën e saj e prinjit' e mjerë ia dhanë të qarët, pasi pikasën nga selvia që djali u ka humbur.

E kur pa këto djali i vogëlë, kërcen e thirri:

-Do të vete unë hem tim vëlla, të shpëtonj, hem të bukurën e dheut të marr. Po i ati edh' e ëma zunë të qarët e po i luten ati tuke u lebetiturë, që të mos gënjehet të vejë, përse do ta gjenj' edhe atë, ajo, që gjet të vëllanë.

Po me gjithë këtë gërgule, ay s'desh të gjegjet as gjë nga ato fjalë, edhe u nis e shkoi bashkë me luan' e tijë.

Luan' ama e porositi fort tuke thënë që, posa të sosem te shtëpija e së bukurës dheut, e posa të dalë plaka (përse djali i kish nxënë të tëra ato që plaka u punonte djelmavet), ta rrëmbenj ay sa pa marr' as edhe firom' ajo, edhe ta shtrëngonjë aqe fort sa, ja të ngjallënjë ajo të vëllanë, t'i jap' edhe të bukurën e dheut, ja të vritetë.

Arrinë pra ate port' e asaj e kur panë vëllanë me gjithë leonë, të ngrirë, e të bërë gurë, lëshuan lotët si breshërë nga sytë.

E leoni, siç ishte porositurë, e rrëmbeu sakaqë plakën edhe kaqe fort e shtrëngo, sa gadish e bëri kruspullë.

Ashtu ajo, pasi pa vetëhen e saj mbë të keqe, i tha djalit të hapënjë një dollap q'ish atje pranë e të marrë që brënda dy qelqe, që kishin njëra ujë si të bardhë e tjetra ujë të kuqe, edhe u rrëfeu se, me ujën si të bardhë i ngrinte njerëzit e me të kuqen i ngjallte.

Ata pra ndë çast shtinë ujë të kuqe mbi vëllanë edhe leonin edhe sakaq, u ngjallën.

I vëllai tuke fshirë syt' e tij tha:

-Oji, sa shumë fjeturkam.

-Nuku fjete, i tha ajy, o vëlla, po kështu, kështu...

Ndë çast edhe selvia ndë shtëpi u ngrejt e u krehkua.

Ia dhanë gazit edhe prinjtë tue pikasurë se u është ngjallur djali.

As përrallë s'ju rëfeva, po desha e ju gënjeva.

Fjalorth

leonë - luanë;
taksi - ngulmoi, këmbënguli;
prinjit' - prindërit;
firom' - frymë;
gluha - gjuha.

FJALË TË MOÇME

(mbledhur nga Thimi Mitko)

- _ Atë që s'të pëlqen të ta bënjë njeri, mos ja bën tjetëritë.
- _ Ay korr atje ku s'ka mbjellë.
- _ Bëjmë me baht, po hithmë ndë plehë.
- _ Behari s'shkon me një lule.
- _ As pula kemi, as me dhelpërë zihemi.
- _ Ay të shtron ujë nënë rrogost.
- _ Ç'sjell një orë, s'e siell viti.
- _ Dielli bije për gjith' dynjanë.
- _ Duaje mikunë me të mira e të këqija.
- _ E mira s'humbet kurrë.
- _ Gluha eshtra s'ka e eshtra thyen.
- _ Guri ndë vend të tijë është i rëndë.
- _ Hidhu përtej hendekut, pastaj thuj "hopa".
- _ I riu, si veriu.
- _ Kujdo i ka pëlqyer mendëja e tij.
- _ Ja fito të kesh, ja vdis të mos jesh.
- _ Kur s'ka grurë, i mirë është edhe thekëri.
- _ Kur s'kam faj, as perëndisë s'i trëmbem.



Fjalorth

baht - fat;
behari - vera - pranvera;
rrogost - shtrojë, rruginë, thurimë e
gjatë;
dynjanë - botën;
gluha - gjuha.

ANALIZË

◇ Shpjego:

- Në anekdotën “Gënjeshtari”, pse i kërkohet Ali Pashës që të vendosë drejtësi?
- Çfarë synon beu në lidhje me kopenë e dhenve?
- Çfarë mënyre përdori Ali Pasha për ta zbuluar të vërtetën?
- Si reagues i varfri dhe beu, kur e vunë dorën mbi rërë?
- A ishte i drejtë vendimi i Ali Pashës në fund të ngjarjes?

◇ Interpreto:

- Si u vendos drejtësia në këtë anekdotë?
- Pse Ali Pasha e zgjodhi si provë, pikërisht rërën e nxehtë?
- Përshkruaj karakterin e beut, duke u bazuar në sjelljen e tij!
- Çka nënkupton shprehja “Gënjeshtari ka përherë zjarr në duar”?

◇ Rikrijo:

- Si do ta zgjidhje këtë çështje, sikur të ishe në vend të pashait?
- Shkruaj një version të shkurtër të anekdotës nga këndvështrimi i të varfrit!
- Shpik një provë tjetër simbolike, që mund të përdorte pashai, për ta zbuluar të vërtetën!

◇ Analizo:

- Në ç’mënyrë, kjo përrallë e pasqyron mendësinë dhe jetën shoqërore të kohës?
- Çfarë roli luan figura e gruas: gruaja e peshkatarit dhe plaka?
- Kush e sfidon plakën e ligë?
- Cila është porosia morale e përrallës?
- Analizo marrëdhënien midis njeriut dhe ëndrrës së tij, si dëshira për pasuri?

◇ Detyrë:

- Shkruaj dhe ritrego anekdotë të rrëfyer nga ndonjë pjesëtar i familjes!
- Rrëfe një përrallë që mbani mend nga fëmijëria!

Mëso se...

Kënga “Moj e bukura More”, është një ndër lirikat më të bukura të shkruara ndonjëherë për atdheun. Pas këtyre vargjeve fshihet një histori e rrallë, e trishtë dhe e shprehur aq bukur sa rrallë herë mund të haset në këngët e asaj kohe.

Elegjia - poezi lirike e shkurtër, me nota vajtuese, që njihet qysh nga kohët më të lashta. Kuptimi i saj vjen nga fjala greke **elegos**, që do të thotë: **gjëmë, vajtim**.

Tematika e kësaj lirike përshkohet me ndjenjë të hollë pikëlluese, përmes së cilës shprehej: melankoli, pikëllim, dëshpërim ose vajtim për humbjen e njeriut të dashur.

MOJ E BUKURA MORE

Moj e bukura More,
si të lash e më s'të pash!
Si të lash, si të lash,
siç të gjeta ngë të lash!
Atje kam unë zotin At',
atje kam unë zonjën Mëmë,
atje kam dhe tim vëlla,
gjithë mbuluar,
të gjithë mbuluar,
të gjithë mbuluar nën dhe!
Ah e bukura More!

Këngët për atdheun janë lajtmotivi i dhimbjes shqiptare ndër shekuj.



Dokumenti më i hershëm i këngës “Moj e bukura More” gjendet në të ashtuquajturin “Dorëshkrimi i Kieutit” (Chieuti - vendbanim arbëresh në Italinë e Jugut), një dorëshkrim arbëresh i fillimit të shekullit XVIII. Më vonë, tekstin e këngës e ribotoi studiuesi dhe mbledhësi i folklorit arbëresh, Dhimitër Kamarda, në veprën e tij (1866).

Gjatë shekullit XVI, një pjesë e banorëve të trojeve arbërore u detyruan të largoheshin drejt bregut tjetër të Adriatikut, për shkak të dhunës së pushtuesit osman. Vështirësitë dhe vuajtjet e tyre ishin të mëdha. Papa Piu II i shkruante Dukës së Burgonjës, Filipit: *“Nuk mund t'i shohë njeriu pa derdhur lot këta refugjatë nëpër limanet e Italisë të uritur e të zhveshur. Të shpërngulur nga vatrat e tyre që rrinë anës detit e ngrenë në qiell duart, qajnë e vajtojnë në një gjuhë që s'ua marrim dot vesh.”*

Nga kjo dhimbje e shpirtit të arbërve, që u larguan nga Moreja, lindi një ndër elegjitë më të bukura, lirikat më të ndjeshme të shprehura në disa vargje të magjishme “Moj e bukura More”.

Jetëshkrim

Dhimitër Kamarda lindi më 23 tetor 1821, në Horë të Arbëreshëve (Piana degli Albanesi). Mësimet i ndoqi në Seminarin italo-arbëresh të Palermos, ku edhe dha mësim për disa vite.

Njihet si gjuhëtar e historian, poet dhe mbledhës e botues i folklorit shqiptar.

Vepra kryesore, “Provë e Gramatikës Krahasese mbi Shqipen”, vlerësohet si punim i parë shkencor në fushën e studimit historiko-krahases të shqipes. Ka shkruar edhe: “Alfabeti i përgjithshëm shqiptaro - epirot”, “Tri këngë popullore shqipe të Epirit”, etj.

Kamarda njihet edhe për kontributin e tij në përhapjen e alfabetit të përbashkët të shqipes në vitin 1869.

Ndërroi jetë në vitin 1882, në Livorno të Italisë.



Dhimitër Kamarda
(1821 - 1882)

ANALIZË

◇ Interpretu përmbajtjen e këngës “Moj e bukura More”:

- Në cilën periudhë është krijuar kënga?
- Përshkruaj gjendjen shoqërore dhe shkaktarin e vuajtjes së tyre!
- Analizo përmbajtjen dhe mesazhin e këngës!

◇ Reflekto rreth përmbajtjes së vargjeve:

- Bashkëbisedo lidhur me shkaktarët e shpërnguljes së shqiptarëve nga trojet e tyre!
- Diskuto për formën poetike, nënvizo karakteristikat e elegjisë!

◇ Bashkëbisedo:

- Shpreh mendimin tënd rreth këngës, gjithashtu dëgjo me vëmendje mendimet e nxënësve të tjerë!
- Shkruaj këngë me tematikë të ngjashme!

Mëso se...

Balada e “Besës”, njihet balada e moçme shqiptare “Kush e solli Doruntinën”, në të cilën trajtohen rrëfime nga legjendat e traditës sonë popullore. Në të, rrëfihen ngjarje të pazakonshme me elemente mitologjike, por që lidhen ngushtë me virtytet jetike njerëzore, si: nderi, besa, forca e gjakut dhe e lidhjeve familjare.

Balada është formë e veçantë e letërsisë gojore, në të cilën janë të gërshetuara elementet epike e dramatike, por me zotërim të elementeve lirike. Tema qendrore e baladës, nuk është tema kolektive e heroike, por më tragjika individuale, pasi koncept themelor e ka pasur nderin dhe besën e dhënë. Përmbajta e baladës nuk strukturohet nga rendi kronologjik i përshkallëzimit epik, por përqendrimin në situata të zhvillimeve psikologjike.

KUSH E SOLLI DORUNTINËN

Vajta mora një okë mish
dhe e hodha në kusi
me vrap dolla në avlli,
të marr një kërcu të zi,
Të më shpiket një stëhi
me vrap m'u hodh në kusi,
më helmoi djemt e mi -
nëntë djem e nëntë nuse,
të nënta me djem në duar!
Nëntë djepe ç'm'i përmbyste,
nëntë pajë ç'm'i zhurite
nëntë dyfeqe ç'm'i shite!
Kostandin, të ardhte gjëma
martove Doruntinën larg,
larg e larg mërguar
tri male kaptuar!
Kostandini u ngrit nga varri:
rrasa iu bë kalë,
balta iu bë shalë!
Vrap e vrap e te Doruntina
– Mirë se erdhe, o im vëlla!
Në ke ardhur për të mirë,
të vishem si gjeraqinë,
në ke ardhur për të keq,

të vishem si kallogre.
– Jo, motër, sikundër je!
E hipi në vithe të kalit,
zogjtë udhës seç po thoshin:
“Cili-viu, viu-viu,
kush ia bën, ia bën vetiu!
Keni parë a s'keni parë?
Shkon një zogës bishtbardhë,
I vdekuri me të gjallë”!
Vete gjer te dera e kishës
- Ik tani, o moj Doruntinë,
se kam punë në ajodhimë,
se aty e kam shtëpinë.
Mos je bushtër a murtajë?
A mos je zonja murtajë,
që më hëngre djemt' e mi?
– Hap, moj nënë, derën,
jam Doruntin' e vetëm!
– Me cilë erdhe, moj Doruntinë?
– Unë ardhsh me Kostandinë!
Kostandin i vdekur,
ç'bën tre vjet pa tretur?!
Një në prak e një në derë
plasën si qelqe me verë.

Fjalorth

okë - masë, peshë;
 stëhi - qenie mitologjike;
 zhurit - përvëlloj, djeg;
 gjëma - fatkeqësi, lajm i keq;
 rrasa - guri i varrit;
 gjeraqinë - shpend i madh grabitqar, petrit;
 kallogre - grua e vetmuar, murgeshë;
 ajodhimë - vend gjysmërrethi brenda kishës (ku bëhet kungimi);
 bushtë - fig.: qenie (grua e lig) e përfytyruar si kuçedër;
 murtajë - sëmundje ngjitëse, vdekjeprurëse.

ANALIZË

◇ Rishpjego përmbajtjen e baladës përmes pyetjeve ndihmëse:

- Në cilën periudhë është krijuar balada?
- Çka i premton vëllai motrës së vet, para se ajo të martohej?
- Cili është mallkimi i nënës?
- Me kë udhëtoi Doruntina për në shtëpinë e nënës, kush e shoqëroi atë?

◇ Në tabelën e dhënë shëno personazhet!

(Shëno në fletore detyrën e dhënë!)

Shëno emrat e personazheve	Përkruaj karakteristikat e tyre

◇ Bashkëbisedo:

- Si ndërthuren realiteti dhe elementi fantastik në baladë?
- Rikujto rrëfime të ngjashme!

◇ Detyrë:

- Shkruaj një paragraf ku i imagjinon mendimet e Doruntinës gjatë udhëtimit!
- Shkruaj një monolog të nënës së Doruntinës, pas zbulimit të së vërtetës!
- Rishkruaj fundin e baladës, duke dhënë një zgjidhje ndryshe, më reale!

◇ Ese: "Besa - vlerë thelbësore e traditës së familjes shqiptare"

Mëso se...

Fabulisti i madh, La Fonteni, e deshi të vërtetën dhe këtë të vërtetë e përshkroi me fjalë të përpikta, shpesh edhe popullore, plot ngjyra, me një stil të veçantë në të gjitha tonet: serioz dhe lozonjar, modest dhe madhështor, elegant, fisnik dhe orator i lartë.

Fabula është tregim i shkurtër si përralla (e shkruar në vargje, më rrallë edhe në prozë) me përmbajtje edukuese. Ky zhanër ka si personazhe më së shumti kafshët ose bimët, të cilat sillen si njerëz. Këto tregime ofrojnë mësimet morale për sjelljen e duhur, duke promovuar vlera si e vërteta, drejtësia dhe virtyti dhe duke kritikuar të këqijat: si gënjeshtrenë, egoizmin dhe arrogancën.

Miqësia është hija e mbrëmjes,
e cila rritet duke perënduar dielli i jetës.

La Fonteni

BUJKU DHE BIJT

Punoni, djema, mos përtoni,
Se veç nga puna do fitoni.

Një bujk i kamur vdekjen kur ndjeu se e kishte pranë
Thërret të bijtë e u flet pasi i merr mënjane:
"Shikoni mirë, u thotë, - mos shitni trashëgimnë
që na kanë lënë të parët tanë,
se brenda një thesar na lanë.
Unë vendin nuk e di, por, me pak guxim,
Për besë do ta gjeni, punoni pa përtim.
Lëroni arën krejt, gërmoni, anëmbanë,
Sa gushti të ketë kaluar;
Mos lini një pëllëmbë toke pa e punuar."
Babai sa mbylli sytë, të bijt më t'iu përveshën
Punës me hov të madh: gërmuan, deshën, s'deshën,
Aty, këtu, aq shumë sa, kur u mbush një vit,
Një grurë i bukur aty u rrit.
Të holla asnjë dysh, por babai, një ditë,
u kish treguar plot urti,
Se puna është flori.



“Fabulat e La Fontenit janë një shportë me qershi. Kërkon të zgjedhësh më të bukurat dhe shporta mbetet bosh”!

Madame de Sevigne

“Në pamundësi t’i hani të gjitha, shijoni, të paktën këto pak kokrra që këputa për ju”!

Vedat Kokona

Molla e La Fontenit

Poeti francez La Fonteni e kishte zakon të hante çdo mëngjes nga një mollë të pjekur. Kështu, një ditë, ai e lë mollën që të ftohet mbi oxhak dhe vetë shkon në bibliotekë për të gjetur një libër. Në këtë kohë, një mik i tij hyn në dhomë, e sheh mollën, e merr dhe e ha. Kur kthehet La Fonteni e vëren se molla nuk është në vendin ku e ka lënë dhe e kupton se çfarë ka ndodhur.

Atëherë i drejtohet me mallëngjim mikut:

- Ah, kush e paska ngrënë mollën që gjendej mbi oxhak?
- Unë jo! - përgjigjet miku. - Aq më mirë, miku im, sepse, - shtoi La Fonteni, - kam futur helm brenda në të për të helmuar minjtë.
- Ah, i gjori unë, arsenik? - klithi miku, qenkam helmuar!
- Mos u frikësoni, mik i dashur, - tha La Fonteni - duke qeshur, kjo nuk është e vërtetë! Desha të di kush e ka ngrënë mollën.

Jetëshkrim

Zhan de la Fonten lindi më 8 korrik të vitit 1621. Ai ishte poeti kombëtar i Francës, njëri ndër krijuesit më prodhimtar në botë, që shkroi pothuajse në të gjitha gjinitë. Shkëlqeu me fabulat e mrekullueshme.

Përmbledhja “Fabula”, e botuar në vitin 1678, iu cilësua si hyjnore.

Në vitin 1684 hyri në Akademinë Franceze.

Vepra e tij e përshkruan shoqërinë franceze të shekullit XVII, ku rrëfimtari, nëpër këto rrëfenja të shkurta, vë në gojën e kafshëve fjalë që askush në atë kohë nuk do të kishte guxuar t’i shprehte.




La Fonteni
(1621 - 1695)

ANALIZË

◇ Përdor fjalët e dhëna më poshtë - si fjalë kyçe, për ta ritreguar fabulën!

- plaku, bijt, bujk, thesar, gushti, punë, tokë, një ditë, guxim, besë, grurë, urti, puna, flori, arën, një vit, vdekje.



◇ Detyrë:

◇ Shkruaj fabul, duke e përdorur ndonjërin nga fjalitë e dhëna:

- Vreshti është plot me rrush.
- Vreshta të shumta shtrihen në luginë.
- Vreshtat u mbushën me rrush të pjekur.

- Pse figura e babait simbolizon - URTINË në rrëfimet popullore?
- Rrëfe një fabul të ngjashme nga letërsia jonë popullore!



FABULA SHQIPTARE

PLAKU DHE MOLLA

Një plak po mbillte një pemë molle.

Dikush i tha plakut: "Ç'të duhet ajo mollë? Do shumë kohë që të rritet, dhe ti s'ke për t'ia ngrënë kokrrat!"

Plaku iu përgjigj: "Po s'i hëngra unë, do t'i hanë të tjerët dhe mua do të më thonë faleminderit".

BRESHKA DHE SHQIPONJA

E luti breshka shqiponjën që ta mësojë të fluturojë. Shqiponja nuk deshte, por ajo kërkonte me këmbëngulje. Atëherë, shqiponja e rrëmbeu me kthetrat, e ngriti shumë lart dhe pastaj e lëshoi.

Ra breshka dhe u copëtua.

VRESHTARI DHE DJEMTË

Një vreshtar plak kishte dëshirë të madhe, që djemtë e tij të bëheshin të mbarë e punëtorë. Ai dëshironte që ata edhe pas vdekjes së tij të vazhdonin të merreshin me vreshtari, të kujdeseshin për vreshtin njëllor si ai.

Kur po vdiste, i thirri dhe u tha:

- Dëgjoni, bijtë e mi! Pasi të më keni varrosur, shkoni në kopsht dhe kërkoni atë që kam fshehur aty.

Djemtë, duke menduar se i ati kishte fshehur ndonjë thesar dhe, pasi e varrosën plakun, nuk lanë qoshe e anë të vreshtit pa e lëruar e gërmuar. Thesar nuk gjetën, por tokën e vreshtit e punuan si s'kishte më mirë. Rrushi u bë për merak, nxorën verë e raki si kurrë ndonjëherë, e shitën dhe u bënë të pasur.

Mëso se...

Rrëfimi “Shitësja e vogël e shkrepëseve” si personazh kryesor e ka vajzën e vogël, të cilën e njohim kur *“bënte i ftohtë i madh, dëbora binte dendur dhe ishte pothuajse errësirë, teksa po binte mbrëmja, mbrëmja e fundit e vitit. Në gjithë atë të ftohtë dhe errësirë, në rrugë ecte një vajzë e vogël, e ngratë, kokëjashtë dhe këmbëzbathur. Flokët e dëborës i binin mbi flokët e gjatë ngjyrëkashte, të cilat i vareshin në kaçurrela të bukura gjer në gushë. Ajo nuk e kishte fare mendjen as te bukuria e saj e as te i ftohti. Të gjitha dritaret rrëzëllenin nga dritat, e te ajo vinte aroma e patave të pjekura, sepse ishte pragu i Vitit të Ri. Pikërisht për këtë mendonte ajo...”*

**S’më pëlqen të shoh një të ri, që bën
karrierë falë një mbiemri të njohur”!**

H.K. Andersen

SHITËSJA E VOGËL E SHKREPËSEVE

Bënte acar i madh. Binte dëborë dhe nata po afrohej. Ishte nata e fundit e vitit, nata e Vitit të Ri. Një vogëlushe e gjorë, kokëjashtë e këmbëzbathur, po ende rrugëve në mes të territorit e të ftohtit. Vërtet që kur kishte dalë nga shtëpia ajo kishte pasur shapka në këmbë, po sa para bënë! Kishin qenë një palë shapka shumë të mëdha, ato të s’ëmës, kështu që e merrni me mend vetëm se sa të mëdha i rrinin, po dhe ato e gjora vajzë e kishte humbur tek ngutej të kapërcente rrugën, që të mos e shtypnin dy karroca që kaluan të rropamë me një shpejtësi të tmerrshme. Ç’është e vërteta vetëm njëra nga shapkat i kishte humbur kurse tjetrën ia kishte marrë një çun, që u largua me vrap; dhe ai i tha se do të bëhesh si djep, një ditë kur të bëhet dhe ai me fëmijë.

Kështu që vajza e vazhdoi rrugën duke u zbavitur me ato këmbët e saja të vockëla, që i ishin mavijosur nga të ftohtit. Në përparësen e vjetër mbante një tufë me shkrepëse, një tufë tjetër e kishte në dorë. Kurrkush s’i kishte blerë gjithë këto ditë, prandaj s’kishte nxjerrë dot as edhe një grosh. E shkreta fëmijë, dukej aq e dëshpëruar, teksa me zor ecte, duke u dridhur nga të ftohtët dhe nga uria. Flokët e borës i binin mbi flokët e gjatë e të verdhë, që i derdheshin mbi supe kaçurrela - kaçurrela të bukura, po ajo me siguri s’e kishte mendjen aty. Të gjitha dritat shkëlqenin nga dritat, në rrugë ndihej aroma e mrekullueshme e patave të pjekura. Ishte nata e Vitit të Ri, ja përse mendonte ajo.

Në një qoshe, mes dy shtëpive, njëra nga të cilat vinte ca si më e dalë se tjetra përmbi rrugë, ajo u ul e u mblodh e tëra kruspull, duke i mbledhur të dyja këmbët nën vete; por të ftohtët sa vinte e shtohej. Në shtëpi s’shkonte dot, ngaqë e dinte se i ati do ta rrihte, sepse ajo s’kishte shitur dot as edhe një

shkrepëse e s'kishte nxjerrë asnjë grosh. Pastaj dhe në shtëpi njëloj ishte ftohtë si këtu. S'kishin veçse një çati mbi kokë dhe era hynte e dilte në shtëpi si të donte, megjithëse vrimat më të mëdha i kishin zënë me leckë dhe me kashtë. Duart i ishin tharë fare nga të ftohtët, po mbase ndonjë shkrepëse e vogël do t'i bënte mirë. Sikur të guxonte të merrte një fije shkrepëse nga tufa, vetëm një ta fërkonte pas murit që të ngrohete ca gishtërinjtë!

Nxori një... Krrc! Si hovi flaka e si e shkëlqente! Dhe ç'flakë e qartë dhe e ngrohtë, kur, njëloj si një qiri i vogël mbaje duart përmbi të dhe ç'dritë të çuditshme që bënte! Vogëlushes iu bë sikur po rrinte ulur pranë një sobe të madhe të shndritshme, ku digjej një zjarr që të ngrohete aq mirë. Po, ç'kishte kështu? Vajza zgjati gishtat e këmbët që t'i ngrohete dhe ato, kur, tamam atëherë flaka e shkrepëses u shua, dhe soba u zhduk. Ajo mbeti me shkrepësen e djegur në dorë.

Fërkoj një shkrepëse tjetër pas murit. Ajo lëshoi një flakë aq të shndritshme, sa që kur ndriçimi i saj ra përmbi mur, ky u bë i tejdukshëm si një pëlhurë e hollë. Dhe në të ajo pa një dhomë ku qe shtruar një tryezë me një mbulesë borë të bardhë dhe enë prej porcelani të hollë dhe aty na qe një patë e pjekur e mbushur me mollë e kumbulla të thata, që akoma nxirrte avull të erëkëndshëm Mrekullia më e madhe ndodhi pastaj, kur pata kërceu që nga pjatanca dhe, me një thikë e një pirun të ngulur sipër ra mbi dysHEME dhe çapiti drejt vajzës... Po shkrepësja u fik dhe s'dukej më asgjë tjetër veç murit.

Ndezi një shkrepëse tjetër. Tani qe ulur nën një pemë të bukur të Vitit të Ri. Pema ishte shumë më e madhe dhe më e bukur nga ajo që kishte parë për krishtlindje, përmes portës prej xhami në shtëpinë e një tregtari të pasur. Mijëra qirinj digjeshin mbi degëzat e gjelbra dhe figurat plot ngjyra gazmore, si ato që varen nëpër vitrinat e dyqaneve, e vështrojnë atë që është sipër. Vogëlushja zgjati të dyja duart... po shkrepësja u shua. Të gjithë qirinjtë e ndezur u ngjitën lart e më lart, derisa ajo kuptoi se s'ishin veçse yjtë e shndritshëm.

Njëri prej tyre u vërvit nëpër qiell, duke lënë pas një vijë të gjatë të zjarrtë.

-Dikush vdiq, tha vajza e vogël, sepse gjyshja që i kishte vdekur e që kishte qenë e vetmja që ishte e sjellë mirë me të, i kishte rrëfyer se një yll është shpirti i një njeriu që po ngjitet lart në qiell.



Fërkoi një tjetër shkrepëse pas murit. Përsëri u bë dritë, e mu në mes të ndriçimit, por rrinte gjyshja, e cila dukej aq e ndritshme, e mirë dhe e dashur.

-Oh, gjyshe! - thirri vajzë e vogël. -Oh, merrmë me vete! E di që do të zhdukesh sapo të shuhet shkrepësja, njëllor si soba e ngrohtë, si ajo pata e pjekur aq e mirë dhe pema e madhe e mrekullueshme e Vitit të Ri!

Dhe me nxitim ajo fërkoi pas murit gjithë tufën e shkrepëseve, sepse donte aq shumë që ta mbante gjyshen aty. Dhe shkrepëset flakëruan me një dritë më të ndritshme se drita e diellit. Dhe asaj kurrë s'i ishte dukur gjyshja kaq e madhe dhe e bukur. Ajo e mori vajzën e vogël në krahët e saj dhe të dyja bashkë fluturuan të gëzuar e në shkëlqim, lart lart, aty ku s'kishte më të ftohtë, uri, as frikë.

Por në orët e të ftohta të mëngjesit aty në qoshe, e strukur mes dy shtëpive, rrinte vogëlushja me faqe të trëndafilta e buzë në gaz, e ngrirë nga të ftohtët, në mbrëmjen e fundit të vitit të vjetër. Viti i Ri agoi mbi trupin e vogël pa jetë, të ulur, me shkrepëset në dorë, shumë nga të cilat qenë djegur.

- Ka dashur të ngrihet, - thanë njerëzit.

Askush s'e dinte se ç'gjëra të bukura kishte parë ajo e me ç'shkëlqim të madh kishte hyrë në Vitin e Ri, bashkë me gjyshen e saj.

- "Jeta është përralla më e bukur".
- "Të udhëtosh do të thotë të jetosh".
- "Aty ku fjalët nuk mjaftojnë, flet muzika".

H. K. Andersen

Jetëshkrim

Hans Kristian Andersen lindi më 2 prill 1805, në Odense të Danimarkës.

Ai shkroi disa drama, kujtime udhëtimesh, romane, poezi, por më së shumti mbahet mend për përrallat e tij.

Përrallat e Andersenit përbëhen nga 156 tregime të ndara në nëntë vëllime, të përkthyer në 125 gjuhë të botës. Ato janë lehtësisht të kuptueshme nga fëmijët, por duke prezantuar mësim të virtyteve dhe qëndrueshmërisë përballë fatkeqësive edhe për lexuesit e rritur.

Përrallat e famshme: "Rrobat e reja të Perandorit", "Sirena e vogël", "Ushtari i Tinit të qëndrueshëm", "Këpucët e kuqe", "Princesha dhe bizelet", "Mbretëresha e borës", "Rosaku i shëmtuar", "Gishtëza", "Shitësja e vogël e shkrepëseve, janë frymëzim për krijimin e dramave, baletit e filmave të animuar, filmave aksion etj.

Andersenin ndërroi jetë më 4 gusht 1875.



H. K. Andersen
(1805 - 1875)

ANALIZË

◇ Bashkëbisedo rreth ngjarjes, fatit të personazhit dhe porosisë së shkrimtarit:

- Përshkruaj gjendjen shoqërore të vogëlushes në këtë rrëfim!
- Në cilën periudhë është krijuar tregimi?
- Cila është dëshira e vogëlushes?
- Çka shiste vajza e vogël dhe për çfarë arsye?
- Çka ëndërroi shitësja e vogël?
- Pse ajo gjeti prehje dhe siguri në prehërin e gjyshes?

◇ Shkruaj tregim me tematikë të ngjashme!

(Shëno në fletore detyrën e dhënë!)



LEGJENDA

Mëso se...

Legjenda është rrëfim (tregim) i shkurtër popullor, që flet për një ngjarje ose figurë historike mbështetur në imagjinatën e popullit, por me nuanca vërtetësie. Rrëfimet, në këtë zhanër, përshkruajnë vlera e cilësi njerëzore, të cilat i japin vërtetësi rrëfimit të ngjarjes, edhe pse ajo përmban elemente fantastike.

Legjendat, sipas tematikës, janë dy llojesh: me përmbajtje mitologjike dhe historike.

Legjenda e prillit

Legjenda e mbështetur në gojëdhënat shqiptare rrëfen se një plakë shkoi në mal për të kullotur bagëtitë dhe duke parë motin e ngrohtë e me diell, ajo i drejtohet qiellit dhe thotë: *“Tani unë do t’i kulloj për qejf bagëtitë. Lamtumirë dimër, shkojsh në djall!”*


Në një moment, prilli tha: *“Mars, o vëlla, më jep tri ditë hua, ta ngrij plakën me gjithë çka ka!”*

Pas kësaj, sipas legjendës thuhet se u bë aq ftohtë, saqë plaka ngriu me gjithë bagëtitë në mal, duke u kthyer në shkëmb, pra duke u gurëzuar.

Mali Sharr është vendi ku plaka ngriu me bagëtitë, ndërsa sipas gojëdhënës, në atë vend sot gjendet një gur në formën e një plake, dhe gurë të vegjël përreth.

Atëherë e sot, aty buron ujë, ndërkaq thuhet se janë “lotët e plakës”.

Kjo legjendë njihet edhe në rajone tjera shqiptare, me ndryshime të vogla.



Legjenda e Rozafës

Motit të motit, tre vëllezër vendosën të ndërtonin një kala në majë të një kodre, pranë qytetit të Shkodrës, aty ku bashkohen lumenjt Buna, Drini dhe Kiri. Ata punuan gjithë ditën, por kur vinte nata, gjithçka që kishin ndërtuar rrëzohej. Kështu ndodhi për tri net me radhë.

Të dëshpëruar, ata kërkuar ndihmën e një plaku të urtë. Plaku tha:

-kjo kala nuk do të qëndrojë në këmbë, po nuk flijuat një qenie të gjallë në themelet e saj. Duhet të murosni gruan e njerit prej jush, por pa ia treguar asaj qëllimin.

Vëllezërit ranë dakord që, të nesërmen në mëngjes, të murosesh ajo grua që do t'ua sillte e para bukën. U betuan që të mos i tregonin askujt për marrëveshjen.

Të nesërmen në agim, erdhi gruaja e vëllait më të vogël - ishte Rozafa. Në duar mbante bukën dhe djathin, dhe fëmijën e saj të vogël e kishte lënë në djep, në shtëpi.

Kur pa që burrat ndaluan punën dhe fytyrat u mbushën me trishtim, Rozafa kërkoi të dinte ç'kishte ndodhur. Kur ia treguan të vërtetën, ajo nuk bërtiti, as nuk qau. Veçse tha:

-Nëse ky është fati im, e pranoj. Por kam një lutje: kam një djalë të vogël në djep. Ju lutem, lëmë një sy jashtë që ta shoh, një dorë që ta përkund, një gji që ta ushqej, dhe një këmbë që t'i dal përpara kur të qajë.

Vëllezërit e dëgjuan me lot në sy. Ashtu bënë: ngritën muret rreth saj, duke lënë jashtë gjërat që kërkoi.





Personazhet

Përrallat janë tregime popullore të përfshira me elemente mitologjike, të cilat lidhen me tre faktorë kryesorë: personazhin, vendin dhe ngjarjen e caktuar. Këto tregime kanë origjinë të hershme, të cilat dëshmohen nga fryma mitologjike dhe fantastike që i karakterizon. Ato u krijuan në një kohë kur njeriu pësonte shumë nga fenomenet natyrore, si: tërmetet, përmbytjet, thatësitat, epidemitë dhe fatkeqësitë, pa pasur mundësinë t'i kuptonte shkaqet e tyre. Më vonë, shoqëria u bë një faktor shkatërrues, duke shfaqur forma të shtypjes dhe padrejtësisë që u prinin njerëzve drejt lirisë, jetës dhe lumturisë, prandaj thelbi i përrallave është lufta e së mirës kundër së keqes, qoftë natyrore apo shoqërore.

Personazhet në përralla janë të ndarë në dy kategori: të mirët dhe të këqijtë. Ata pozitivë, mbajnë cilësi të pandryshuara nga fillimi deri në fund, të tilla si: guximi, trimëria dhe mençuria, ndërsa negativët karakterizohen nga frika, pasiguria, egërsia dhe arroganca. Midis këtyre personazheve zhvillohet një luftë e përhershme, e cila përfundon gjithmonë me triumfin e së mirës dhe së drejtës. Personazhet pozitive shërbejnë si simbole të virtyteve, ndërsa ata negativë përfaqësojnë intrigën dhe ligësinë.

Hiperbola dhe personifikimi janë figura të shpeshta që i bëjnë këto tregime më të pasura.

Përrallat kanë një rëndësi të madhe edukative, duke i mësuar lexuesit se si të luftojnë për të mirën dhe ta kundërshtojnë të keqen.

ANALIZË

◇ Shpjego:

- Çka janë legjendat, si janë krijuar ato?
- Në gojëdhënë "Legjenda e prillit" përshkruaj personazhin e plakës?
- A veproi mirë plaka, pse u ndëshkua ajo?
- Cila është porosia e rrëfimit, çka kupton me fundin e legjendës?

- Në "Legjendën e Rozafës, cilët janë personazhet?
- Përshkruaj brengën e tre vëllezërve dhe karakterin e tyre?
- Çka nënkupton shprehja: *"Duhet të flijoni një qenie të gjallë"*?
- Pse duhej murosuar nusja e re?
- Çfarë kërkoi Rozafa për foshnjën e saj?

◇ Rikrijo:

- Si do ta zgjidhje këtë çështje, sikur të ishe në vend të tre vëllezërve?
- A ke dëgjuar ndonjë legjendë të ngjashme, shkruaj për të!
- Si shpjegohet flijimi i gruas në raport me të mirën e familjes dhe shoqërisë?
- Cila është porosia morale e gojëdhënës?

◇ Detyrë:

Shkruaj temën: "Porositë e të mençurve janë pasuria më e madhe"

- Pse Rozafa u bë simbol i flijimit?
- Cila ishte kërkesa e saj para murosjes, portretizo figurën e saj si nënë!
- Njeriu i mençur a duhet të gjykojë me nxitim?
- Trego një përrallë nga treva yte?
- Pse njeriu i pa aftë shpesh e përçmon atë që nuk e arrin?
- Sa janë edukative fabulat, rrëfe një fabul që di!
- Pse dituria dhe puna duhen të jenë në bashkëveprim?
- Përshkruaj disa veçori të anekdotave, si rrëfenja edukuese!
- Nënvizat: personazhet, fabulën, temën dhe idenë, në këto krijime epike!
- Shkruaj diçka të ngjashme dhe bën krahasim midis tyre!
- Përshkruaj dallimin midis legjendës, përrallës dhe fabulës?
- Cilat janë elementet fantastike dhe karakteri mitologjik i krijimeve epike?

Lirika

Mëso se...

Lirika, qysh në fillet e paraqitjes, e ka shfaqur qëllimin përmes tematikës së caktuar.

Tema e lirikës është një realitet i veçantë që lidhet me botën shpirtërore, me subjektiven, ose me gjërat thelbësore të jetës së njeriut, si: jeta - dashuria - vdekja.

Lirika arti që realizohet përmes fjalës dhe figurshmërisë së saj.

Origjina e lirikës është te këngët korale, të cilat i shprehnin ndjenjat shpirtërore, sikurse gëzimet dhe hidhërimet, që janë e përbashkëta e njerëzve. Në këtë lloj të poezisë nuk ka personazhe, por poeti i flet vetes dhe botës përmes emocioneve, përjetimeve apo mendimeve të tij më intime.

Fjala “lirikë” rrjedh nga greqishtja “lyra”, një vegël muzikore me tela me të cilën grekët e lashtë i ekzekutonin këngët e tyre.

Lirika realizohet përmes gjuhës poetike.

Gjuha poetike/artistike nuk është vetëm mjet shprehës, por edhe mjet krijimi dhe përjetimi i së bukurës.

Fjala, në një tekst poetik, nuk është vetëm bartëse kuptimesh, por edhe burim muzikaliteti, tingujsh dhe ritmesh, që ngjallin ndjesi dhe imazhe të fuqishme të lexuesi apo dëgjuesi.



Llojet letrare të poezisë lirike

Tipari themelor i poezisë lirike është lidhja e fuqishme e elementeve të të gjitha shtresave: tingullore, leksikore, kuptimore.

Poezia lirike shkruhet nga pozicioni i unit poetik të krijuesit. Ajo hartohet në forma të shkurta, prandaj edhe ndryshon në pikëpamje të kompozicionit nga llojet e ndryshme të poezisë epike dhe dramatike.

Lirika është më shumë se një mënyrë shprehjeje; ajo është pasqyrim i shpirtit njerëzor, i kthyer në art përmes fjalës së bukur dhe ritmit. Lexuesi, për të kuptuar një vepër të tillë, duhet të ketë njohuri, jo vetëm mbi gjuhën - si normë e gjuhës artistike letrare, por edhe mbi emocionet e njeriut dhe ndjeshmërinë që kërkon ky lloj arti.

Mjetet e formësimit të krijimit lirik

Mjetet e formësimit të krijimit lirik, përveç fjalës si element kyç, janë vargu dhe strofa.

Vargu është elementi bazë i lirikës, si forma më e përhapur poetike, që përbëhet nga fjalë të vendosura në mënyrë të rregullt, prej një numri të caktuar rrokjesh.

P.sh.: O Flamur gjak, o flamur shkabë
(F. Noli).

Strofa përbëhet nga dy e më shumë vargje që bashkohen në njësi më të mëdha, si rezultat i *sistemimit të ideve* dhe ndjenjave në *njësi kuptimore*. Strofa mund të ketë numër të ndryshëm vargjesh e si forma më të zakonshme janë: katërvargëshi, gjashtëvargëshi, tetëvargëshi, por sigurisht nuk mungojnë as llojet tjera të vargjeve.

P.sh.: O Flamur gjak, o flamur shkabë,
O vënd e vatr' o nën' e babë,
Lagur me lot, djegur me flagë,
Flamur i kuq, flamur i zi.
(F. Noli).

Poezia lirike ndjek rregulla ritmike që lidhen me theksin dhe rrokjen.





LIRIKA

Llojet e lirikës

himni, oda, ditirambi, elegjia, epigrami, epitafi, epigrafi, gnoma, idila, epitalami, ekloga dhe epistula.

Temat/motivet

- lirika peizazhiste (e natyrës);
- lirika sociale (shoqërore);
- lirika erotike (e dashurisë);
- lirika patriotike (atdhetare);
- lirika refleksive - filozofike (mendimtare).

Struktura

strofa, vargu, rrokja

RIMA

Në vargjet lirike shpesh përdoret rimimi, sidomos në rastet kur poezia ruan një ritëm të rregullt, duke i dhënë muzikë dhe bukuri shprehjes.

Rimë quhet përputhja e tingujve në fund të dy a më shumë vargjeve, andaj njihen si vargje të rimuara ose me rimë.

Sipas vendit, kemi disa lloje rimash:

Rimë e puthitur:

Mëmëdhe quetë toka	a
u m'ka rënurë koka,	a
ku kam dashur mëm' e atë,	b
ku më nje dhe gur' i thatë.	b

(Poezia: "Mëmëdheu", Çajupi).

Rima e alternuar:

Veç zemrat e njerzve të lanun	a
me të rektuni prralla rrfejnë:	b
mbi barrat e jetës së namun	a
që shpirt dhe korriz thejnë.	b

(Poezia: "Lagja e varfun", Migjeni).

Rima e kryqëzuar:

Jakë, mejtim, jakë,	a
Dua të mejtohem,	b
Të rri të qetohem,	b
Edhe të qanj pakë.	a

(Poezia: "Të vdekunit", Naim Frashëri).

Rimë e brendshme (kur rimojnë fjalët brenda një vargu)

O i zhgrryer, i zhyer, i vyer për hu,
Turp-e-ndot-kundërmonjës të krusen mbi gju,
Dallkaukët, kopukët e turmat pa tru,
Zëmër-krund-e-gërdhu: Hosanna, Barabba!

(Poezia: "Marshi i Barabbajt", F. Noli).

Mëso se...

Lirikat e Zef Serembes burojnë nga një ndjenjë e pastër dhe e singërtë, ku përgjithësisht është mbështetur në traditën e pasur të folklorit arbëresh. Poezitë e tij janë pjesë e antologjive të lirikës shqipe.

Poeti i këndon me shpirt “Më të bukurës që është në Strigar”, vashës së tij, që s’ka shogë mbi faqe të dheut, nga e cila mund ta ndajë vetëm lufta për liri.

“Zef Serembe që njëri prej kolosëve të Rilindjes, që e ktheu poezinë n’atdheun e mirëfilltë të saj, në brigjet e Epirit”, aty ku e gjeti gjeniu francez Lamartini.

MË TË BUKURËS QË ËSHTË NË STRIGAR

Nga katundi u largova posi i bjerrë,
Vajta në luftë e u gjeta i vetmuar:
Atje, larg nga ty, rrinja zemërcjerrë,
Midis të huajve u gjeta i shkretuar:
E zëmra ty keq fort të dëshironte
Edhe pika më ra se s’të takonte.

Gjaku rridhte në truall si ujë kroi
Dhe fare jetën time s’e mendova,
Mbi mua vapa e madhe e bora shkoi,
Me nxitim tërë honet i kaptova
Dhe dënuar si hutaq në gjithësi
Për ty mendonja plot me dashuri.

Përnatë, tash që u mblodha në shtëpi,
Te dera jote si bilbili këndoj.
O faqemollë, o vash’ me synë e zi,
Ta shkoj jetën me ty un’ dëshiroj,
O mollë e ëmël, që në degëz rri,
O gozhdëz ari, që më vjen në gjji.

E pse më bën të qaj me psherëtime?
Vërtet, zemër nuk ke, o ti moj vashë?
Mbaje, se lule e rrallë është zëmra ime,
Dhe mirë e di se tyja krejt ta dhashë.
Shumë e keqe më duket mua kjo jetë,
Po jetova pa ty me të vërtetë.

O vashëz faqekuqe, qysh aherë
Unë po qaj me lot e me dënësë,
Se pa ty e ndjej veten krejt të mjerë,
Nuk di ç’është paqa dhe po rroj pa
shpresë,
Dhe vetëm varri do më jetë i lehtë,
Kur i harruar do të jem në jetë.

Fjalorth

i bjerrë - i humbur,
honet - greminat, humnerat.

Krahasimi (lat. comparatio - krahasim) është figurë shumë e përdorur në krijimtarinë artistike, dhe në komunikimin e përditshëm, përderisa krahasojmë një mendim, një send apo një dukuri, me një tjetër, duke i vënë në pah tiparet e tyre të përbashkëta.

Metafora (nga greq. *metaphorá* - bartje, ndërrim kuptimi) është figura më e njohur, që sajohet kur një send apo një dukuri e emërojmë me emrin e një sendi a dukurie tjetër.

Si *metaforë* mund të përdoren emri, mbiemri, folja dhe një shprehje e tërë.

Metaforë emër (buzë mali, grykë pushkësh), metaforë mbiemër (qielli i trishtuar, dashuri e pastër), metaforë folje (rruga gjarpëron, deti tërbohet).

Jetëshkrim

Zef Serembe lindi më 6 mars të vitit 1844, në Strigari të krahinës së Kozencës.

Studioi në Kolegjin e Shën Adrianit, por për shkak të shëndetit të keq u detyrua ta ndërpresë shkollën dhe të kthehet në fshatin e lindjes, në Strigari.

Ishte poet lirik arbëresh. Ra në dashuri në moshë të re me një bashkëfshatare të tij, e cila më vonë u shpërngul familjarisht në Brazil dhe vdiq pak kohë pasi kishte arritur atje. Përrjetoj shumë dhimbje nga kjo humbje, andaj disa poezi ia kushtoi asaj.

Udhëtoi shumë, mirëpo në vitin 1866 shkoi në Horën Arbëreshe, ku u lidh më tepër me zakonet, folklorin, të folmen arbëreshe, ëndërrimet e tyre dhe me ndjenjën e madhe të çlirimit të atdheut të të parëve.

Shkroi shumë poezi, disa prej të cilave qarkulluan si poezi popullore. Arriti ta botonte veprën me 42 sonete.

Ndërroi jetë në vitin 1901, në vendbanimin Shën Pali, në Brazil.



Zef Serembe
(1844 - 1901)

ANALIZË

Lexo dhe kupto poezinë

◆ Interpreto:

- Portretin e poetit me pak fjalë!
- Brengën shpirtërore apo shqetësimin e tij!
- Përshkrimin e natyrës në përafrimin e gjendjes emocionale të autorit!
- Domethënien/kuptimin e vargut: "*Vërtet, zemër nuk ke, o ti moj vashë!*"
- Ç'virtyte të vajzës vihen në dukje?
- Ndjenjat që shprehen në vargje!

◆ Analizo:

- Kohën kur është shkruar poezia, duke u bazuar në gjuhën e përdorur!
- Figurat letrare/stilistike të përdorura në vargje!
- Mallin dhe gjendjen shpirtërore të poetit, pas humbjes së vashës/ më të bukurës në Strigar!

◆ Detyrë:

- Përshkruaj vendlindjen tënde, duke e menduar përshkrimin për Strigarin - vendlindjen e Zef Serembes!

Mëso se...

Poezia “Bukuria” është poezia më e fuqishme e Naim Frashërit. Në mënyrë simbolike, poeti shpalos ndjenjën e tij të zjarrtë, adhurimin dhe shpresën që sjell dashuria. Me mjete të përzgjedhura artistike - me pjalmin e fjalës, ai krijoi vargjet plot ndjesi e bukuri të rrallë. Në përshkrim, megjithëse poeti shfaqet idealist, e dashuria për të është një ndjenjë platonike, ai entuziazmohet teksa e përcjell këtë ndjenjë gëzimi e lumturie.

Stili poetik është harmonia e përsosur midis **formës dhe përmbajtjes**. Ai e fiton hijeshinë e duhur kur stoliset me fjalë e shprehje të **fytyrzueme a konkrete** dhe me **gjallni a lëvizje**.

BUKURIA

Do të këndonj Bukurinë
E të lëvdonj Perëndinë,
Perëndin' e bukurisë,
Q'i dha shijë gjithësisë!
Perëndija bukuroshe!

Në fytyrët tënde gjeta Bukurinë,
Si ajy që gjeti në malt Perëndinë
Lulezët e Majit sa janë të mira!
Po përpara teje m' erdhë të pështira.

Edhe yjt' e hëna si të shëmëtuat
M'u duknë, kur pashë atë syn' e shkruar,
Purtek' e florinjtë! shigjet' e ergjëntë!
Zemrënë m'a dogje, m'i përndave mëntë!

Ty të falem e të lutem
Më vjen në gji të të futem
O Zonja përkëdheloshe!
Që më je si mbretëreshë,
Të keqen o pëllumbeshë.

Kur shoh faqezët' e tua,
Ç' vleft' i mbetet trëndafil, i
Zëri yt shpirt më jep mua,
Nuk' i le shijë bilbilit.

Do të vdisnja me shumë gas,
Të paskështa pakë shpresë,
Se do të thuash ti më pas,
Vdiq, për mua, pastë ndjesë.

Fjalorth

malt - malet;
lulezët - lulet/lulezat;
purtek - thupër e hollë.

Simboli (greq. symbolon - shenjë) sajohet kur një ide abstrakte ose një dukuri e konkretizojmë, duke e zëvendësuar me një gjësend, i cili merr një kuptim të caktuar.

Jetëshkrim

Naim Frashëri lindi më 25 maj të vitit 1846, në Frashër të Përmetit.

Mësoi në Gjimnazin “Zosimea”, në Janinë.

Gjatë qëndrimit në Stamboll, ku u bë një nga veprimtarët më aktiv të Shoqërisë së Shkronjave dhe të Lëvizjes së atdhetarëve shqiptarë dha kontribut të fuqishëm në zgjimin dhe ngritjen e ndjenjës kombëtare.

Ishte dijetar që punoi për ngritjen e shkollës shqipe.

Hartoi: abetaren shqipe, gramatikën, përktheu, shkroi vjersha dhe vepra të tjera letrare: “Lulet e verës”, “Bagëti e Bujqësi”, “Vjersha për mësonjëtoret e para”, “Historia e Skënderbeut”, “Qerbelaja” etj.

Vlerësohet si simbol i letërsisë shqiptare të Rilindjes Kombëtare dhe dijetar i rëndësishëm i ideologjisë kombëtare shqiptare.

Ndërroi jetë më 20 tetor të vitit 1900, në Turqi.



Naim Frashëri
(1846 - 1900)

ANALIZË

◆ Kuptimi i tekstit poetik:

- Shpjego në formë individuale idenë kryesore të poezisë “Bukuria”!
- Çfarë simbolizon “bukuria” në këtë poezi?
- Gjej dhe shpjego disa vargje ku poeti e përshkruan bukurinë si forcë / dhunti e natyrës!
- Cili është këndvështrimi i poetit për bukurinë?
- Në vargun: “Q’i dha shije gjithësisë”, fjala shije është përdorur në kuptimin e parë apo të figurshëm? Si e kuptoni atë?


◆ Detyra krijuese:

Nënvizo fjalët me ngarkesë emocionale dhe shpjego ndikimin e tyre!

- Në një paragraf (5-6 rreshta) përshkruani se çfarë do të thotë “bukuria” për ju!
- Analizo vargun: “Purtek’ e florinjtë! shigjet’ e argjente” dhe trego figurën e përdorur stilistike!
- Ç’virtyte i përshkruan vajzës së bukur?

◆ Detyrë:

Krijë një hartim me fjalët: bukuri, gjithësi, shije, perëndi, shpresë, shigjetë e argjente, purtekë e florinjtë, lulezë, yjet, syri, mbretëreshë, pëllumbeshë..., kushtuar “Bukurisë” (sipas modelit poetik)!



Mëso se...

Poezia “Kopshti i dashurisë” e Andon Zako Çajupit është si një këngë plot dritë e ngazëllim. Ky kopsht i magjishëm, për poetin, ndodhet në atdhe, ku do ta sjellë miken për gëzimet e dashurisë, bukurisë dhe mirësitë e vendlindjes, të jetës së thjeshtë baritore të mëmëdheut. Çajupi e zbriti lirikën e dashurisë nga qiejt në tokë, me përshkrimin e jetës së përditshme të shqiptarit.

KOPSHTI I DASHURISË

O pëllump'i shkruar,
do t'të marr në duar
dhe duke kënduar
gjetkë do t'të shpie:

afër tek një lumë
ku ka lule shumë,
të biem në gjumë,
hëna të na ndrijë;

yjtë të shukojnë,
zoqtë të këndojnë
edhe të na zgjojnë
dita kur të vijë.

Pa ngrën' e pa pirë
s'metemi moj Mirë,
se u'ndaj të gdhirë
dërgoj e na sjellin:

në një vënt t'uruar
dhe të lulëzuar
në uj' të kulluar
edhe nënë hie;

qumështë të d'hirë
dhe djathë të mirë,
pa uj' e pa hirë
dhe rrush kur të vjelin;

Ngjalë nga Janina,
Mjaltë nga Kanina,
Verë nga Voshtina,
Ujë nga Sopot;

mollë nga Horia,
mish nga dhënt' e mia,
desh nga Labëria, -
na e faltë Zoti!

Fjalorth

pëllumb - pëllumb;
s'metemi - s'mbetemi, nuk mbetemi;
të gdhirë - të aguar, të zbardhur dita.

Personifikimi (greq. persona + facere = person, njeri + të bësh - të bësh, të veprësh si njeri) është figurë e përfytyrimit. Sajohet kur gjërave të pashpirt u japim gjallëri e i shpirtëzojmë, pra sendeve a dukurive në natyrë, botës bimore e shtazore u mvishen veti njerëzore.

Jetëshkrim

Andon Zako Çajupi lindi më 27 mars të viti 1866, në Sheper të Zagorisë.

Studioi për drejtësi në Egjipt, ku edhe e kaloi pjesën më të madhe të jetës.

Ishte poet, dramaturg dhe veprimtar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Njihet për veprat letrare me frymë atdhetare, satirike e realiste, ndër të cilat spikatin: “Baba Tomorri”, “Burri i dheut”, “Pas vdekjes”, “Katërmëdhjetë vjeç dhëndër”.

Kotriboi fuqishëm në përhapjen e gjuhës shqipe dhe përkrahjen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Ndërroi jetë më 11 korrik 1930, në Kajro (Egjipt).



Andon Zako Çajupi
(1866 - 1930)

ANALIZË

◆ Lexo poezinë dhe përgjigju:

- Pse poezia titullohet “Kopshti i dashurisë”, si e kupton këtë gjetje?
- Cili është simboli kryesor i poezisë dhe çfarë përfaqëson ai?
- Si ndërlidhen kopshti real në natyrë dhe bota e brendshme e dashurisë së poetit?
- Çfarë ndjenjash përshkruhen në vargje?
- Nënvizto toponimet (vendbanimet), të cilat i ka përmendur poeti!

◆ Analizo këtë poezi të Çajupit, me poezinë e ndonjë autori bashkëkohor, duke krahasuar:

- titullin;
- një varg të veçantë;
- gjuhën poetike;
- mesazhin përmbledhës.

1. Gjej figurat stilistike në poezi dhe përcakto:

- metaforën: me emër, mbiemër dhe folje;
- epitetin;
- personifikimin.

2. Krahaso mënyrën:

- si përshkruhen lulet;
- si përshkruhet ndjenja e dashurisë;
- arsyeto me fjalë karakterizuese ngjashmëritë midis tyre.

◆ Detyrë:

Provo të shkruash dy strofa, sipas modelit poetik të Çajupit!

Mëso se...

Këngët e dashurisë (erotike) janë këngë me motive për ndjenjat e të rinjve, lidhjeve emocionale të çiftëve gjinësh të ndryshme, që u këndohen atyre me singëritet e dëlirësi ndjenjash. Këto janë këngë të lashta, andaj edhe janë të përshtatura me ambientin real ku edhe janë krijuar, si: fshati, ambientet blegtorale, natyra idilike, baritore..., gjithçka që ofron origjinalitetin e një ndjenje të lindur dashurie.

TI JE YLL E TI JE HANË

Ti je yll e ti je dritë
 yll që del ndaj të gdhirë,
 Zot' ynë të dhëntë dritë!
 flasën bukurinë tënde, o shpirt!
 Edhe zogjtë kur këndojnë,
 shoq me shoq po ligjërojnë,
 me gjuhë të tyre thonë;
 flasën bukurinë tënde, o shpirt!
 M'atë përçe fije - fije,
 Seç m'i mban gushës hije,
 Porsi dielli kur bie.
 Flasën bukurinë tënde, o shpirt!
 Me atë përçe laqe – laqe,
 Kur ma derdh, ma hedh mbi faqe,
 Posi lule manushaqe.
 Flasën bukurinë tënde, o shpirt!

(këngë popullore)



BUKURINË E BALLIT

Bukurinë e ballit,
 Moj, do ta marr
 Dhe gushën e bardhë,
 si margaritar.
 Se ç'ta pashë faqen,
 Në dritë të kandilit,
 Më të vinin lotët
 Sumbulla pas gjirit.
 Bukurinë e ballit,
 Moj, do të ta marr
 Dhe gushën e bardhë,
 Si margaritar.

(këngë popullore)



ANALIZË


♦ Analizë e tekstit:

- Përshtkruaj dhe analizo poezinë “Ti je yll e ti je dritë”!
 - Shpjego përmbajtjen kuptimore të këngës popullore!
 - Si ju duket gjuha e këngës dhe figuracioni poetik?
 - Çfarë e karakterizon lirikën e dashurisë?
 - Diskuto mbi vargjet më mbresëlënëse!
- Përshtkruaj dhe analizo poezinë “Bukurinë e ballit”!
 - Me çka krahasohet bukuria e vajzës?
 - Çka simbolizon vargu “Në dritë të kandilit”?
 - Cilat nga vargjet janë më të veçanta dhe pse?
 - Zgjidh vargjet më të pëlqyera dhe trego porosinë e tyre!

♦ Detyrë:

- Shkruaj ese për dashurinë, si ndjenja më e çiltër e njeriut!

(Shkruaj në fletore detyrën e dhënë!)



Mëso se...

“Tringa” e vendosur si kënga XXII në poemën “Lahuta e Malcis” pasqyron origjinalitetin e frymëzimit dhe forcën krijuese të Gjergj Fishtës, me shtrirje në tërë veprën, herë si realitet jetësor, herë si subjekt e episod mitologjik ku përshkruhet eposi artistik i popullit shqiptar.

Tringa e Grudës (e bija e Smajl Martinit) tipizon malësoren shqiptare, që vihet në mbrojtje të vëllait të plagosur dhe fisit e atdheut, e ndihmuar nga Ora e Shqipërisë dhe Zana e Madhe, ku konflikti ndërmjet shqiptarëve dhe malazezëve (shek. XIX) e ka fatin e vet historik.

Gjergj Fishta, shkëmb i tokës
dhe shkëmb i shpirtit shqiptar!

Lasgush Poradeci

TRINGA

Kanga XXII

*Vetëm në shtëpinë e Curr Ulës ka qetësi.
Curri ka mbetur prej një viti i plagosur rëndë.
Për të kujdeset e motra, Tringa:*

Veç, po, një vashë unë jam tue pa,
Vashë të re n'xhubletë të bardhë,
Me një rube rreth ballit ardhë
Që derr n'vetulla m'i ka ra;
E derdhë flokët jashta shamisë,
Dalë më paska n'derë të shpisë,
Njenin brryl n'ballnik ngujue,
Ndejtka e kqyrka n'kambë harru,
Si Nokshiqi rri t'u kale,
Plaçkë si bahet gjaja e gjallë:
Si n'për prroska, rrëgallë e zall
Mbesin vdekë gra e fëmij'
Për nën plumba t'Malit t'Zi.



Por se prap kurrkund neshtrasha
 Mue sm'a dan, ka' e shoh n'atë derë,
 Se ka mendjen me ikë vasha
 E me u ba ajo me shokë tjerë,
 Për t'shpëtue vetë edhe bagëtia,
 Pa t'cilat s'ka t'gjallë Malcia.
 A thue, Zanë, mos qoftë premtue!
 E re vasha tue qillue,
 Mos të ketë ajo gabue
 Me ndo'i shkja me u miqësue;
 E prandaj n'uzdajë të mikut,
 S'ndahet shpisë as çarranikut
 E harru m'rri mbështet' ke tbana?
 Pse edhe t'mirë po e kish ba nana:
 Ardhë shtatit si breshana,
 Synin yll, ballin si hana,
 Diçka njeth si molla n'rrem,
 Si ajo lulja shpërthye n'gem,
 Që ke dale m'ka ashtu te dera,
 Sikur ban me çilë pranvera;
 Sikur ban dielli me dale
 Nëpër aha, brej e hale
 Kaq gja t'mirë Zoti e ka falë!



Fjalorth

xhubletë - veshje popullore (fustan), që mbahet në malësi të madhe;
 rubë - shami e lidhur ballit;
 n'ballnik ngujue - e shtangur, e ngrirë në ballë të derës;
 n'kambë haru - ngrirë, pa lëvizur;
 rrëgallë - gurishtë, pìrg gurësh të rrëkullisur nga mali;
 n'uzdajë të mikut - në shpresë të mikut;
 çarranik - dollap për të ruajtur bulmetin (në hajat ose në oborr);
 diçka njethë si molla n'rrem - bulëzuar (lulëzuar) si molla në gem.

Fryma krijuese artistike dhe atdhetare e Gjergj Fishtës

Gjergj Fishta është poet i rëndësishëm i periudhës së Rilindjes Kombëtare, i cili përmes vargjeve i këndoi atdheut, lirisë dhe trimërisë së shqiptarëve.

Përmes krijimtarisë artistike i lartësoi vlerat njerëzore dhe kombëtare, dashurinë për gjuhën shqipe dhe krenarinë për historinë e popullit tonë.

Në veprat e tij pasqyrohet heroizmi, drejtësia dhe besimi në të ardhmen e kombit. Me talentin dhe përkushtimin e tij, Gjergj Fishta, u bë një nga zërat më të fuqishëm të letërsisë shqiptare dhe një frymëzues i idealeve atdhetare.

Epiforë (greq: *epiphora* - përmbyllje, përfundim) është figurë, që krijohet kur përsëritja e fjalëve apo e shprehjeve të njëjta, në fund të dy a më tepër vargjeve, vijnë njëra pas tjetrës. Pra, epifora është e kundërta e anaforës. Edhe kjo figurë i jep fuqi të madhe shprehëse dhe shton forcën emocionale të vargjeve.

Paronomaza (greq: para - pranë dhe onoma - emër) është figurë stilistike e tingullit, që krijohet duke vënë afër në një fjali ose në një varg dy fjalë me përbërje tingujsh të ngjashëm, por që në vetvete janë me kuptim të ndryshëm/të kundërt. Paronomaza bazohet në përdorimin e fjalëve me tingëllim të ngjashëm.


Jetëshkrim

Gjergj Fishta lindi më 23 tetor 1871, në Fishtë të Zadrimës. Kolegjin e kreu në Troshan, ndërsa studimet për filozofi e teologji, në Bosnjë. Dallohej në punimet filozofike, teologjike e letrare; lexonte letërsi klasike.

Fishta, shquhej si frat (klerik), mësues, shkrimtar, përkthyes, publicist, politikan, diplomat. Ishte personalitet i gjithanshëm, që e vuri në shërbim të Shqipërisë e shqiptarëve tërë potencialin e vet intelektual e shpirtëror.

Veprat letrare: "Lahuta e Malcís", "Anzat e Parnasit", "Gomari i Babatasit", "Mrizi i Zanavet", "Juda Makabë", "Jerina ose Mbretnesha e luleve" etj.

Ndërroi jetë më 30 dhjetor 1940, në Shkodër.



Gjergj Fishta
(1871 - 1940)

ANALIZË

♦ Interpreteto:

- Mbi situatën dramatike në këngën “Tringa”!
- Çfarë figure paraqet “Tringa” në poemë?
- Motivet e nderit dhe familjes në sjelljen e Tringës.
- Ç’virtyte të vajzës vihen në dukje?
- Çfarë mënyrash artistike përdor Gjergj Fishta për ta rritur gjendjen emocionale të personazhit dhe lexuesit?
- Si paraqitet mjedis jetësor/malësor dhe shoqëror në këngë?

♦ Bashkëbisedo:

- Për kundërshtinë (kontrastin) midis bukurisë së Tringës dhe botës së egër që e rrethon!
- Në pjesët e këngës gjej figurat letrare: krahasimin, hiperbolën, epitetin, metaforën... dhe flisni për funksionin e tyre!
- Shpjego ndikimin e gjuhës popullore - dialektore në ndërtimin e atmosferës epike!

♦ Detyrë:

- Ese 1. Tringa, figura e vajzës/gruas shqiptare dhe rezistenca e saj, në letërsinë shqiptare.
- Ese 2. Tringa - ideali i një sfide të vështirë që shpie në tragjedi.
- Ese 3. Ndjenja atdhetare dhe dashuria për tokën stërgjyshore a është krenari apo një barrë e domosdoshme trashëgimie.



Mëso se...

Poezia e mëposhtme i kushtohet një prej njerëzve më të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm në jetën e njeriut: NËNËS. Poezia përcjell cilësitë më karakterizuese të një nëne, si: dhembshuria, përkujdesja, dashuria dhe flijimi për bijtë. Përmes metaforave dhe fjalëve të zgjedhura me kujdes na përcillet një ndjesi ngrohtësie dhe ndërgjegjësimi për të rritur vlerësimin ndaj NËNËS - qenie e çmuar në jetë dhe në letërsi.

MËMA

Fjal' e bukur, fjal' e shenjtë
thellë zemrës që tingëllon,
s'ka në botë gjë m'e shtrenjtë,
s'ka si mëmë kur kujton!

Mëmë, mëmë, frym' e lartë,
rreze drite, yll qiellor,
plot mëshirë e mall të zjarhtë
engjëll roje madhështor.

Që nga gjinjtë e saj të *dli*rë
*vile*t jeta pa shterim.
Që nga zemra e saj ka mbirë,
dashuri dhe mallëngjim.

Si në gaz dhe në vojtje,
veç një mëmë të larton.
Sa ka frym' e sa ka rrojtje,
mendjes kurrë s'të harron.

Çdo rreziku rri të ruan
bën detyrë si luftar.
Si dëshmori heq e vuan
për të zemrës saj thesar.

Kush s'di vlerën e një nëne,
është pa ndenjë e shpirtmizor,
bir skëterre e frymë *në*me,
është i vetes tradhëtor!

Fjalorth

të *dli*rë - të dëlirë, të pastër;
jeta - buron jeta;
nëmë - mallkim.

Epiteti (greq. epitheton - e shtuar/ndajshtim) është figurë stilistike që përdoret për të përshkruar më mirë një personazh apo ngjarje. Shton ngjyrë dhe emocione në rrëfim, duke i dhënë lexuesit përshtypje më të gjallë për atë që po përshkruhet.

Anafora (greq. *anaphora* - bartje përpara, përsëris) është figurë që krijohet kur fjala, e cila ndodhet në fillim të vargut, përsëritet edhe në fillim të vargut pasues (vijues). Pra, anafora është përsëritja (vendosja) e fjalëve ose e shprehjeve të njëjta në fillim të vargjeve.

Jetëshkrim

Aleksandër Stavre Drenova lindi më 11 prill 1872, në Drenovë të Korçës.

Mësimet e para i mori në Korçë. Që në moshën trembëdhjetë vjeçare emigroi në Rumani, ku e vazhdoi shkollën e mesme dhe më vonë Fakultetin e Shkencave Politike. I lidhur me atdhetarët shqiptarë që jetonin në Bukuresht, të cilët ishin organizuar në formën e një shoqate, Asdreni u bë një nga përfaqësuesit më të shquar të saj.

Shkroi disa vepra, si: “Rreze dielli”, “Ëndërra dhe lotë”, “Psallme murgu”.

Ndërroi jetë më 11 dhjetor 1947.



Aleksandër Stavre Drenova
(1872 - 1947)

ANALIZË

◆ Interpreteto:

- Përshkruaj me fjalë portretin e nënës!
- Veço vargjet më të bukura të poezisë dhe analizo përmbajtjen e tyre!

◆ Detyrë:

(Shëno në fletore detyrat e dhëna më poshtë)!

- Ç’virtyte të nënës vihen në dukje, përshkruaj figurën e saj!
- Shëno disa epitete dhe metafora për nënën!

NËNA

epitete:

.....
.....

metafora:

.....
.....

- ◆ Gjej fjalët sinonime të përdorura në poezi dhe shkruaj çiftet e tyre, p.sh.: heq - vuan.
- ◆ Shkruaj një poezi të shkurtër, prej tri strofash (me rimë), kushtuar nënës!
- ◆ Shkruaj një letër - NËNËS (në mënyrë individuale), duke pasur ndërmend përshkrimin e bukur të poetit Andon Zako Çajupi!

Mëso se...

Poezia “Ekstaza pranverore” është poezi lirike, e vendosur në ciklin “Kangët e rinisë”, në të cilën përshkruhet ndjenja e singertë e poetit me tërë frymëzimin rinor dhe talentin e veçantë.

Migjeni ishte poeti me bindje më përparimtare të kohës, këtë edhe e reflektoi në veprën e tij “Vargjet e lira”, me një përmbajtje dhe formë novatore (të re).

EKSTAZA PRANVERORE

...dhe pranvera erdhi...

Nepër ftyra tona rrëshqiti një gëzim
dhe ndër zemra tona ngrehi një fole,
e një jetë e bukur, e një jetë e re,
me dëshira të shumta po buzqesh në lulzim.

...dhe dallndysha erdhi...

si shpirti n'ekstazë, në hovin e shejt shtri;
me qiellën rroket, me diellin puthet,
dridhen krahët në hare - mandej poshtë vërsulet
tu' dhurue në cicrim përshndetje një mijë.

...triumfon bylbyli...

kangëtar plot magji në gemb të trandafiles,
në një tempo të marrë përkdheljet po shfre
e kanga kumbuese, kang' e tij pa fre,
asht si kangë Orfeji ndër telat e lyres.

...dhe vesa shkëlqen...

në një pikë t'argjent' pasqyrohet jeta
tërheqse si andrra dhe si vijzatimi
ndër orët e hyjzimit, kur shpërthen agimi
e rrezet e arta rrëshqasin ndër fleta.

... dhe pranvera erdhi...

Nepër ftyra tona rrëshqiti një gëzim
dhe ndër zemra tona ngrehi një fole
e një jetë e bukur, e një jetë e re
me dëshira të shumta po buzqesh në lulzim.

Stil poetik, quhet ajo mënyrë e të shkruarit, që ka një harmoni të përsosur ndërmjet formës dhe përmbajtjes.

Jetëshkrim

Millesh Gjergj Nikolla lindi më 13 tetor 1911, në Shkodër. Mësimet e para i mori në vendlindje, pastaj në qytetin e Manastirit. Gjimnazin e ulët e kreu në Tivar.

Punoi si mësues në vendbanimet Vrakë dhe Pukë, në Malësinë e Shkodrës. Ishte një i ri entuziast dhe intelektual me ide përparimtare. Edhe në krijimtarinë letrare shfaqte qëndrime rebeluese me ide thellësisht të reja.

Vepra poetike “Vargjet e lira” përshkohej nga humanizmi dhe frymëzimi kundër padrejtësive shoqërore, ashtu sikurse edhe proza e tij në “Novelat e Qytetit të Veriut”, ku shkruhej kritikë e rreptë ndaj aktualitetit të hidhur dhe dëshira e zjarrtë për ditë më të bukura.

Ndërroi jetë më 26 gusht 1938, në Torre Pelice (Itali).



Millesh Gjergj Nikolla
(1911 - 1938)

ANALIZË

◆ Interpreto:

- Përmbajtjen e poezisë “Ekstaza pranverore!
- Me çka lidhet lumturia e poetit?
- Çka simbolizon pranvera?
- Shpjego kuptimin e strofës së fundit:

... dhe pranvera erdhi...

Nepër ftyra tona rrëshqiti një gëzim

dhe ndër zemra tona ngrehi një fole

e një jetë e bukur, e një jetë e re

me dëshira të shumta po buzqesh në lulzim.

◆ Analizo:

- Pse poeti flet për lumturinë, shpresën, këngën...?
- Pse pranvera shpesh është simbol i rilindjes, ripërtëritjes!
- Cilat janë metaforat e përdorura në poezi?

◆ Shkruaj ese:

- “Ekstaza pranverore është kulmi i lumturisë”.
- “Poezia mund të jetë një metaforë, por jeta ...”.

◆ Detyrë:

Lexo veprën “Vargjet e lira” të Migjenit, për të kuptuar më mirë: frymëzimet, vështirësitë dhe synimet e poetit.

Epika në prozë

Mëso se...

Tregimi është vepër e shkurtër në prozë, në të cilën përshkruhet një ngjarje ose një varg ngjarjesh me rëndësi nga jeta e heroit. Në të përfshihen: vendi dhe koha e ngjarjes, ngjarja kryesore, personazhet, konflikti, mesazhi etj.

Për shembull: *“Një ditë, Andrra gjeti një mace të humbur. U prek shumë kur e pa duke bredhur nëpër rrugë e duke mjaullitur me trishtim. Pasi e ledhatoi pak dhe i dha të hante, në qafë i pa një varëse me emrin dhe adresën e saj. Falë kësaj e ktheu në shtëpi dhe kuptoi se një vepër e mirë mund të sjellë shumë gëzim”.*

Epika rrjedh nga greqishtja e vjetër “epos”, që do të thotë “fjalë” apo “tregim”.

Epika në prozë - përbëhet nga veprat, në të cilat autori rrëfen ngjarje (vetë ose nëpërmjet personazheve), siç janë: skica, tregimi, novela, romani, legjenda, përralla, etj.

Në letërsinë artistike, subjektet janë të ndryshme dhe varen nga: tematika, koha dhe zhanri i krijimtarisë.

Ngjarjet mund të jenë aktuale ose nga e kaluara.

Mbështeten mbi fakte reale ose imagjinare.


Një vepër letrare nuk është vetëm një tregim i bukur, por edhe një përpjekje për ta kuptuar jetën dhe botën.

Tregimet, për nga tematika, janë disa llojesh:

- realist (ngjarje e vërtetë, me personazhe të zakonshme, konflikte të përditshme);
- fantastik (ngjarje e imagjinuar, e pabesueshme, magji, krijesa të jashtëzakonshme);
- psikologjik (përqendrim në mendimet dhe ndjenjat e personazheve, konflikte të brendshme);
- misterioz (karakterizohet me të panjohurat dhe befasitë, duke kërkuar që lexuesi të jetë i lidhur me ngjarjen, sikurse vetë protagonistin e tregimit);
- historik (ngjarje që lidhen me periudha të kaluara ose personazhe heroike);
- moralizues (didaktik) - (jep porosi edukuese dhe të qartë për jetën);
- policor (bazohet në një ngjarje konfliktuale/krim, në të cilën përfshihen për sqarime ose zgjidhje edhe personazhe si policë ose detektivë);
- romantik (ngjarja e tregimit si temë kryesore e ka dashurinë midis dy personazheve);
- humoristik (ngjarje qesharake, situata komike, satirë, ironi e lehtë);
- fantastiko - shkencor (krijohet me mjete ose teknologji të imagjinuar të së ardhmes dhe trajton çështje morale).

Përshkruani tregimin tuaj të pëlqyer

(Shkruaj në fletore detyrën e dhënë)!



Mëso se...

“Një mbrëmje në Lurë” është tregim i shkrimtarit Ismail Kadare, në të cilin përshkruhen bukuritë natyrore të Lurës me pamjet piktoreske të saj. Aty janë të shumta edhe kullat e gurta malësore, bashkë me dramën e malësorit, edhe pse dukej sikur përbindëshi i gjakmarrjes po qetësohej. Nuk ke se si të mos e mendosh historinë deri sa udhëton nëpër Malësinë e Lurës.

Subjekti i tregimit përbëhet nga një rrjedhë ngjarjesh të lidhura me njëra - tjetrën, pra shënon përmbajtjen e temës (kuptimi i subjektit është i ngjashëm me atë të fjalës “temë”).

Fjala “subjekt” rrjedh nga latinishtja subjektus, që do të thotë “i vendosur poshtë”, që nënkupton përmbajtjen që shpreh dhe ndërton vepra letrare, nga pika e lidhjes deri në pikën e zgjidhjes.

NJË MBRËMJE NË LURË

Udhëtojmë drejt Lurës. E vërteta është që, zakonisht prapa fjalës tingëlluese “Lurë”, shtrihen të pestë liqenet e saj me tërë bukurinë dhe magjinë e tyre. Askush nuk mund ta ndajë Lurën nga liqenet e saj. Prandaj, kush udhëton drejt Lurës, udhëton drejt liqeneve të saj. Por, këtë muaj të nxehtë vere, Lurën është vështirë ta ndash edhe nga diçka tjetër. Këtë muaj, gati dyqind studentë po hapin atje një rrugë pyjore. Ata kanë ardhur nga larg, në fushën e vogël midis maleve, me kazmat, lopatat, humorin dhe të folurin e tyre të ndryshme nga ajo e vendasve. Lura e vogël, e largët, ka këtë muaj dyqind mysafirë. Dyqind mysafirë nuk janë pak. Dhe këta janë dyqind studentë, pak të çutidshëm, pak rrëmujaxhinj, ashtu siç janë studentët.

Rruga kalon midis kodrinave të buta, të gjelbra. Majë kodrave ngrihen kullat e gurta malësore, dritare të vogla të ngushta, frëngji, sharapllore për të luftuar. Duket sikur horizontet e hapura u vrisnin sytë këtyre kullave, ndaj i kanë zvogëluar fare dritaret. Këtë gjë e kishte diktuar logjika e jetës. Për derisa nga jashtë mund të hynte bashkë me rrezet e diellit edhe plumbi, atëherë sa më pak diell në jetën e zymtë të malësorëve.

Kullat ngrihen në të gjitha drejtimet. Herë përballë njëra-tjetrës, herë të vetmuara fare.

Kulla dhe frëngjitë e saj. Drama e gurtë e jetës së malësorit. mbi ato frëngji ka shtirë ai që ndodhej përjashta, nga ato frëngji është mbrojtur ai që ndodhej brenda. Dhe të dy ndodheshin mbi të njëjtën tokë, mbi tokën amëtare.

Tani frëngjitë heshtin. Krismat gjakmarrëse po zhyten dalëngadalë në harresë. Ato nuk janë fshehur në ndërgjegjen që të shpërthejnë një ditë përsëri, ato po shkullen një herë e përgjithmonë nga zemra e malësorit tonë. Asnjë forcë nuk mundi ta shkulte nga ndërgjegja e malësorit gjakmarrjen. As ligjet, as arti, as përpjekjet e intelektualëve të ndershëm. U desh një tërmet i tillë si Lufta Nacionalçlirimtare për të shkundur këtë zakon të tmerrshëm.

Ndonjë fshatar i Lurës na tregon, jo pa njëfarë krenarie të lehtë, se në krahinën e tyre gjakmarrja kishte qenë më e butë se te ata, si do qoftë, kishin vendosur disa rregulla, të cilat i respektonin me rreptësi. Kështu, p.sh. në Lurë ishte e ndaluar që t'i prishje gjakësit kafenë e mëngjesit (d. m. th. të qëlloje me pushkë në kullën e tij, kur ai pinte kafenë). Ishte e ndaluar, gjithashtu, të qëlloje në katin e kullës ku ishin gratë. Në qoftë se ndodhte kjo, atëherë një komision nga fshati e hetonte çështjen dhe shkelësit e rregullave dënoheshin rëndë. Kishte edhe rregulla të tjera. Të gjitha këto tregojnë se arsyeja e shëndoshë popullore, jeta mundohej ta luftonte këtë vetasgjësim. Mundohej, por më kot. Qëllonte që përbindëshi i gjakmarrjes, qetësohej, për ca kohë, ose më mirë dukej sikur qetësohej, sepse, pa pritur, një mëngjes ai sulej përsëri edhe më me tërbim, që të bënte kërدينë mbi jetën njerëzore. Derisa lodhej dhe prapë strukej që të shpërthente një ditë prapë, dhe kështu vazhdonte kjo histori. S'ka sesi të mos i mendosh të gjitha këto kur udhëton nëpër malësitë tona.

- Mirëdita!

Përsëritet çdo njeri ose të panjohur, përsëritet me seriozitet dhe me zë të fortë. Ata të vegjlit, (po me atë tingull dhe seriozitet madje ndoshta me më shumë seriozitet) na përsëritet me një fjalë që nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë.

- Mirëdreka!

Përsëritetja e mirditorëve të vegjël është e dashur dhe kurioze për udhëtarin. Ne gëzoheshim kur i shihnim që larg dy ose tre bashkë, të vegjël fare, gëzoheshim sikur të gjenim një hije ose një burim përpara. Dhe mezi prisnim sa të na afroheshin dhe të na përsëritet të parët.

- Mirëdita!

- Mirëdreka!

Ne pyesim ku janë studentët vullnetarë, dhe ata na tregojnë. Përmes fushës së Lurës shtrihet rruga e re, vende-vende hapur, vende-vende jo. Vullnetarët janë shpërndarë në një vijë të gjatë. Puna është e vështirë dhe dielli djeg. Megjithatë, fshatarët na thonë se ata punojnë mirë. Madje nuk e prisnim të punonim kështu. Njerëz me shkollë të lartë, mendonin, kazma do t'i dërrmojë.

Rruga e hapur, si çdo rrugë e hapur ka historinë e saj të vogël të përditshme. Këtu toka është e fortë, aty duhen prerë ca plepa të bukur e të lartë në një vend thonë se fshatari ka mundësi të ketë lëvizur natën piketat, në mënyrë që të shpëtojë njëzet e pesë centimetra tokë nga ana e tij. Veçanërisht të vjen keq për plepat. Për një shirit toke dy pëllëmbë, që duhet marrë nga ana e një fshatari, priten këta viganë të bukur.

Dhe kështu rruga vazhdon të hapet. Ndoshta do ta quajmë më vonë "Rruga e studentëve". Por kjo s'ka rëndësi. Lurasit do t'i kujtojnë për shumë kohë mysafirët e zhurmshëm, që erdhën nga larg, që punuan, kënduan, thanë anekdoda, dhe pastaj ikën duke lënë prapa rrugën, këtë kujtim të madh e të drejtë mospërmasë.

Mbasdite, ndërsa vullnetarët pushojnë, ne vendosim të shkojmë te liqenet. Liqenet janë lart, në mal. Rruga gjer tek ata është e gjatë.

Ne ecim midis pishave që zhurmojnë mbi kokat tona me një shushurimë të fuqishme, të freskët. Befas na shfaqen liqenet, njëri pas tjetrit, ma tepër të gjelbër se të kaltër të rrethuar nga malet dhe pishat. Si gjithmonë, kur ndodhesh përpara gjërave të bukura, është vështirë t'i përshkruash. Fjalët janë të zbehta përpara ujit dhe gjelbërimit që përbëjnë gjithë ato nuanca të kësaj bukurie të gjallë. Piktori ulet në heshtje te një gur. Nxjerr bojërat dhe fillon të hedhë në akuarel një pjesë të pamjes. Është ora e muzgut. Tonet e ngjyrave ndryshojnë me shpejtësi. Në akuarelin e tij, bashkë me ujin

e pastër, blerimin e pishave dhe copat e trungjeve të kalbura, nis e shfaqet muzgu. Edhe pak, dhe nëpër fushë do të duket errësira e dobët, e dridhshme. Por piktori e mbaron akuarelin përpara se të bjerë mbrëmja. Ne vërtitemi një copë herë brigjeve, unë mundohem të fut në kamerën e fotoaparatit diçka nga ky muzg dhe pastaj nisën të zbresim.

Te vullnetarët arritëm vonë. Tani ata kanë ngrënë darkën dhe po rrinë nën tendën e mensës, në gjysmëerrësirë. Njëri i bie kitarës. Të tjerët dëgjojnë. Shkëlqejnë në errësirë cigaret. Një vajzë ka mbështetur kokën te dora. Është ora kur njeriu qëllon të bëhet ndonjëherë i heshtur. Ç'nuk të kujtohet në këtë orë.

Ismail Kadare

Fjalorth

frëngji-a - një e çarë (si dritare e vogël në kulla e kështjella);
sharapoll-i - pjesë e dalë në murin e një kulle, si një ballkon i mbyllur me frëngji
diktoj - zbuloj, hetoj, gjej, pikas;
kurioze – kureshtare;
piketë-a - kunj i shkurtër druri që ngulet në tokë;
pllajë-a – rrafshnaltë;
akuarel-i - pikturë e bërë me ngjyra uji;
ton-i - fig. hollësi.

Jetëshkrim


Ismail Kadare lindi më 28 janar 1936, në Gjirokastrë.

Është ndër shkrimtarët më të mëdhenj bashkëkohorë. Shquhet kryesisht në prozë, si dhe në dramaturgji, poezi dhe përkthime. Nisi të shkruajë kur ishte ende i ri, fillimisht poezi, me të cilat u bë i njohur, e më pas edhe prozë, duke u bërë prozatori më i pëlqyer shqiptar.

Veprat letrare: “Frymëzime djaloshare” (poezi), 1954; “Ëndërrimet” (poezi), 1957; “Shekulli im” (poezi), 1961; “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (roman), 1963; “Kështjella” (roman), 1970; “Ura me tri harqe” (roman), 1978; “Prilli i thyer” (roman); “Kush e solli Doruntinën” (novelë) etj.

Për vlerat e krijimtarisë së tij është shpërblyer me shumë çmime kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndërroi jetë më 1 korrik 2024, në Tiranë.



Ismail Kadare
(1936 - 2024)

ANALIZË

◇ Bisedë rreth tekstit:

- Si e përshkruan shkrimtari territorin e Lurës!
- Çka i kujtohej nga historia e dikurshme rreth këtij vendbanimi?
- Si përshkruhen kullat e malësorëve? Trego si janë ndërtuar ato!
- Pse autori e krahason kullën e gurtë me fatin e gurtë të malësorëve?
- A ruhen ende këto zakone të vjetra?
- Cilat janë bukuritë më mahnitëse, me të cilat përshkruhet Lura dhe liqenet e saj?

◇ **Trego** më shumë rreth idesë së autorit, duke e analizuar fjalinë: *“...atë muaj të nxehtë vere Lurën nuk mund ta ndash, as nga liqenet e saj, as nga vullnetarët”!*◇ **Detyrë:**

Shkruaj përmbledhjen e tregimit me disa fjali, duke i përdorur grupet e mëposhtme të fjalëve:

- udhëtimi drejt Lurës,
- kullat e malësorëve,
- studentët vullnetarë,
- ujërat e liqenit,
- malet dhe pishat,
- piktori ulet në heshtje te një gur,
- ora e muzgut,
- njëri i bie kitarës.

◇ **Shkruaj ese:**

- “Përshkruaj natyrën e vendbanimit tënd”!
- “Përshkruaj panoramën mahnitëse të Malësisë së Sharrit”!

Mëso se...

Tregimi “Nën myshk”, i shkrimtari Hivzi Sulejmani, paraqet dy faza të ndryshme të rrjedhës së jetës së njeriut. *Fëmijëria* - periudha më e bukur e jetës, ndonëse e mbushur me ëndrra e lojëra, është ndikuese në krijimin e karakterit dhe *pjekuria* - kur njeriu nga mësimet dhe përvoja ka mundësinë për të reflektuar mbi jetën.

Fragmenti i dhënë është shkëputur nga tregimi “Nën myshk”.

Me fjalën **temë**, kuptojmë një rreth të caktuar dukurish, që shkrimtari zgjedh nga realiteti dhe që i përgjithëson në vepër.

Me fjalën **ide**, kuptojmë mendimin kryesor që buron prej ngjarjeve, të cilat i përshkruan shkrimtari në veprën e vet.

NËN MYSHK

- Nuk dua më! - Hajt, tash ti bëhu kalë!...

Ngojca u hoq nga goja dhe u qit për tokë. Mandej edhe të tjerët i hodhën veglat e lojës. Të gulshuar prej vrapimit të hovshëm nëpër rrugët me pluhur të qytetit, fëmijët u rreshtuan nëpër bar të vyshkur.

- Tash e tutje, unë do t'i marr frenjt e t'i mbaje ngojcën, - bërtiti ai që pak parandej ishte kalë.

- E unë do ta shtyj këtë rrotën tënde, - i tha tjetri fqiu të vet dhe e muar veglën.

U bë një zhurmë e madhe, ndërsa po merreshin vesh ndër vete se çka do të ndiqte secili prej tyre. Më në fund çdo gjë u zgjidh. U ndërruan rolet dhe veglat e lojës. Vargu i hasharinjve rishtas vrapon. Me hov e potere. Me sy të ngulur në veglat e tyre, sikur të donin t'ua cikin tërë ëmbëlsinë e lojës.

Kur pak më vonë u gjetën pranë dyqanit të pemëshitësit Ymer, papritmas fryu një erë e furishme. Malli i tij, i rregulluar për bukuri, përpara lugajës së vogël, fluturoi rrugës teposhtë...

Shportat e vjetra, arkat e luhatshme dhe teneqetë e ndryshkura, bënë të qeshë bota me rrokullisjet e tyre buçitëse.

- Të vraftë Zoti që të bëri! - e mallkoi erën pemëshitësi bablok, duke shikuar mallin e vet të mjerë nëpër kalldrëmin e çarshisë. ...

Ndërsa ai shtrëngonte dëshpërueshëm grushtet nga e keqja që e gjet dhe pa mundur të bëjë gjë, fëmijët e muarën situatën në dorë. Me shkathtësi i fërfëlluan veglat e lojës dhe si anza u turrën në pemët e derdhura duke grabitur sa më shumë që mundën. Duke i parë se si po shtyhen për tokë duke ia rrëmbyer mallin si grykës, u nguros prej mjerimit.

- Leni aty, bre shejtana! - u bërtiti me hidhërim. - Mos ma prekni mallin...

Fëmijët u trembën dhe menjëherë ikën. Ikën, por me xhepa dhe gji plot. Duke e

parë në hall, pemëshitësit plak iu afruan dyqanxhinjtë fqinjë. Ndërsa i mblidhnin enët, perimet dhe pemët, fëmijët qëndronin anash dhe shikonin veglat e tyre të lojës, të cilat kishin mbetur atje ku filluan të grabisinin pemë.

- S'ka hajr prej fëmijëve të sodit! - pikllueshëm i ankohej Ymeri fqiu, që e ndihmonte për rregullimin e mallit. Gjysmën e pemëve ma kanë rrëmbyer, bre hajnat që janë!...

Duke i ndëgjuar këto fjalë, fëmijët shikuan njëri-tjetrit. Duart u shkuan pavetëdijsëm kah xhepat, kah gjinjt. U erdh keq për të shkretin bablok.

- T'ia kthejmë! - tha njëri gjallërisht dhe u hodhi shokëve një shikim pyetës.

- Por tash s'guxojmë t'i afrohem! - tha tjetri mendueshëm. - Unë po shkoj i pari! - shtoi më i guximshmi dhe u nis me hapa të vendosur. Ndërsa ai kalonte rrugën në anën tjetër, sytë e të tjerëve e shoqëronin ngultas. Me frigë pritej momenti kur do ta kapte pemëshitësi për ta rrahur. Por babloku ishte i qetë dhe mirrej me rregullimin e mallit të mbledhur.

- Qe pemët tuaja, mixhok! - i tha fëmija gazmueshëm dhe filloi t'i shprazë xhepat.

Plaku ktheu kryet dhe e shikoi me bisht të syrit. Mandej buzëqeshi miqësisht dhe shtoi i kënaqur:

-Ashtu, ashtu, biri im! Duket se je prej shtëpisë së mirë, fisnik... Hajde, mbama këtë shportë që t'i rregulloj specat njëherë. Gjithçka është përzjerë dhe pluhuruar...

Duke parë shokun se si po punonte me pemëshitësin, ata si të urdhëruar vrapuan kah ai.

- Gjysh, ku t'i qesim pemët? - bërtiti me zhurmë e gjallëri, ndërsa sytë i shkëlqenin gëzueshëm.

E pemëshitësi plak, njeri shtatshkurtër dhe pak i çalë në njëren këmbë, me pabesim dhe tashmë krejt i hutuar, u hodhi një shikim të zgurdhuar.

- Edhe ju keni prurë, a?! ... Sa të mirë janë fëmijët e sodit!... Qe, qitni këtu sugarët e mi. Vetëm jo të gjitha në një vend. Dardhat veç, mollat veç. Të gjitha veç e veç.

- E kalamaj! - u mahniti plaku dhe buzëqeshi. - Kush është më punëtor, unë apo ju?

- Ti, mixhë! - bërtitën fëmijët gëzueshëm e sikur një zë.

- Jo, jo! - vazhdoi plaku. - Edhe ju jeni të zellshëm. Po edhe djem të mirë. Hajdeni pra dhe secili merrni nga dy kokrra pemë! Mollë, dardhë... çka t'ju dojë zemra.

Të hutuar pak, fëmijët vetëm shikuan shoqi-shoqin. Mandej lëshuan sytë teposhtë dhe mbetën si qirinj.

- Hajt, hajt!... S'keni çare pa marrë. E keni hak.

Pasi asnjëri nuk u afrohej pemëve, plaku kapi të parin përdore, i priu kah shportat dhe i urdhëroi:

- Merr babo! Merr prej cilave të duash!

Dora më në fund lëvizi dhe kapi ngurrueshëm një kokërr dardhë. Mandej ju desht' të marrë edhe të dytën.

- Ashtuuuu! - bëri pemëshitësi i kënaqur. - Hajt, tash dhe ju!

Njëri pas tjetrit të gjithë bënë kështu e pastaj vrapuan fluturim kah lodrat e tyre.

Tashmë janë duke kërcyer nëpër rrugë. Pemët e dhuruara i kafshojnë me ëndje.

Kush është më i shpejtë, era apo fëmijët?...

* * *

Shumë vjet kanë kaluar prej atyre ditëve. Krejt një jetë e plotë. Një jetë me brenga, përpjekje të rënda, luftëra. Jetë në shtangim e përpëlitje...

E njëri prej fëmijëve të atëhershëm rri sot para hotelit. Rri i pikëlluar pranë tavolinës dhe i kundron kalimtarët mu prej këtij vendi ku dikur ishte hani i famshëm i Hasan Agës. I kundron njerëzit e rinj dhe pleq. I kundron me dëshirë që të njohë ndokënd. Që të gjejë pamjen e tjetrit, të heqë perden e së kaluarës... Por, pas kaq vjetësh, pas dyzet vjetëve të jetuara gjetiu, ai është tash i huaj në vendlindjen e tij. Kurrkund nuk janë më as pemëshitësi bablok, as teneqexhiu plak. Po as vargu i gazmueshëm i fëmijëve. Tashmë nuk janë edhe shumë dyqane e shtëpi, shumë rrugë e rrugica. Rri fëmija i dikurshëm dhe shikon botën që ecën. Shikon njerëzit dhe mendon. E lumi gurgullon, gurgullon... Mu ashtu si dikur - plot hare dhe gjallëri. Në lumin që natë e ditë rrjedh në amshueshmëri. [...]

Çlodhet fëmija i dikurshëm dhe mendon. Çlodhet dhe përpiket të përtërijë kujtimet, të pasqyrohet në të kaluarën.

Hivzi Sulejmani

Fjalorth

rerit - gojëza prej metali/druri, që i vihet në gojë një bagëtie, një kali;
dugajë - shitore;
babëlok - emër përkëdhelie/dashurie, me të cilin i drejtohem babait ose gjyshit;
hajnat - vjedhësit;
mixhok - xhaxha;
sugar - djali më i vogël;
çare - zgjidhje.

Jetëshkrim


Hivzi Sulejmani lindi më 5 korrik të vitit 1910, në Mojstir të Sanxhakut.

Është ndër shkrimtarët e parë të Kosovës që i vuri bazat e prozës, por kontribuoi edhe në publicistikë, përkthime, etj.

Veprimtaria e tij letrare përfshin: poezi, tregime, novela, romane dhe krijime në dramaturgji.

Veprat letrare më të njohura janë: “Njerëzit”, “Fëmijët e lumit tim”, “Era dhe kolona”, “Ëndrra e korbit”, etj.

Ndërroi jetë më 10 korrik 1975, në Prishtinë.



Hivzi Sulejmani
(1910 - 1975)


ANALIZË

◆ Analizo:

- Kohën e jetës së shkrimtarit dhe të personazheve në tregim!
- Vendin ku ndodh ngjarja dhe përshkruaj atë!
- Si është ndërtimi rrëfimor (narrativ) i tregimit?
- Bashkëbisedo dhe komento mbi një pjesë dialogu midis personazheve!
- Ndjesinë që jep kjo fjali: *“Kush është më i shpejtë, era apo fëmijët...”*?
- Në cilën vetë flet shkrimtari dhe narratori?
- Zhvillo një bisedë për pyetjen e shitësit drejtuar fëmijëve: *“Kush është më punëtor, unë apo ju”*?
- Personazhet e tregimit sipas ndërtimit të tyre psikologjik, flisni për cilësitë e tyre!

◆ Detyrë:

- Përshkruaj në fletore pjesët e tregimit, të cilat kërkohen sipas skemës së dhënë!



Mëso se...

Tregimet kanë një magji tërheqëse teksa e përshkojnë ngjarjen lehtëazi, pa sforcime. E kështu është edhe rrëfenja e shkrimtarit Moikom Zeqo, i cili përmes tregimit “Fyelli i gdhendur në gur” lexuesin e shpie drejt ndodhive të largëta në kohë.

Personazhi ilir, Altini, e njohu këtë magji të jetës kur e gjeti fyellin e barinjve me të cilin këndonte këngë të dheut të vet të lashtë. Në shenjë nderimi për të, njerëzit, mbi varrin e tij ngritën një lapidar të bardhë mermeri, ku një gurskalitës gdhendi figurën e një fyelli. Ai ishte fyelli i legjendës së madhe, i mrekullive që bënë shpirti i njeriut të thjeshtë, fyelli që i lulëzon stinët e lulet e pemëve i kthen në fruta, që ndez yjet e bardha e i rrit më shpejt fëmijët e vegjël, u jep shëndet të dobhtëve e fuqi të pafuqishmëve, pasi ai ishte fyelli i përjetshëm i këngëve të popullit.

Kompozicioni artistik ndërlidhet me subjektin, pasi e përcakton mënyrën sesi ndërtohet tregimi.

Fjala “**kompozicion**” vjen nga latinishtja **compositio**, që nënkupton radhitje dhe sistemim. Në kompozicion përfshihen: **karakteret, zhvillimi i ngjarjes, përdorimi i dialogëve, përshkrimi i mjedisit dhe organizimi i kohës e hapësirës.**

FYELLI I GDHENDUR NË GUR

(Në muzeun arkeologjik të Durrësit ruhet një lapidar i lashtë, ku është gdhendur një fyell)

Djaloshi ilir me emrin Altin qe një fyelltar i madh e i përmendur i qytetit Epidamn. Ai i binte fyellit aq bukur, sa askush nuk i rezistonte dot kureshtjes për të dëgjuar mrekullitë e tingujve të tij, që mbi të gjitha ngjallnin etjen e dëshirën për liri. Djaloshi luante për detarët e peshkatarët e varfër, për popullin e thjeshtë. Ishte përhapur fjala se fyelli i tij kishte veti magjike, se me anën e tingujve mund të gjelbëronte tokën e shkretë e të çelte gjethe e lule në pemët e zhveshura, se mund të bënte të frynte era për velat e barkave e të anijeve të qytetit për t'u kthyer në agim në breg, pranë familjeve.

Çfarë nuk tregonin njerëzit për fyellin e djaloshit ilir me emrin Altin!

Ai kishte mbetur jetim që në moshë të njomë, pa nënë e pa baba, pa njeri të afërm.

Fyellin e mësoi nga një bari që kulloste dhentë buzë lumit në verilindje të qytetit. Por shpejt ai mësoi kaq mirë t'i frynte, sa ua kaloi gjithë fyelltarëve të tjerë të qytetit. Fama e tij përhapej kudo. Altini i binte fyellit në molo, ku vinin anije nga të gjitha brigjet e Mesdheut.

Detarët e këtyre anijeve mallëngjeheshin kur e dëgjonin, u kujtohej zjarri i vatrës së tyre në atdheun e vet dhe u dukej se dëgjonin fjalët e ngrohta të të dashurve.

Altini ishte mjaft bujar. Edhe një fëmijë i vogël, po t'i lutej që t'i binte fyellit, ai nuk përtonte aspak dhe ia plotësonte dëshirën. Ai ishte mik i gjithë qytetit, i skllëvërve të kriporeve të Epidamnit, i gurëskalitësve, i kuajrritësve e tjegullbërësve. Të gjithë e donin shumë e krenoheshin për fyelltarin e dalë nga gjiri i tyre.

Në qytet rronte edhe patrici i pasur Klaud. Ai e kishte smirë dhe e urrente fyelltarin ilir Altin. Njëherë ai i kërkoi fyellin për t'ia blerë, por Altini s'pranoi. Atëherë Klaudi urdhëroi shërbëtorët e tij që t'ia rrëmbenin. Shërbëtorët e zbatuan urdhrin. Ata iu hodhën një ditë në befasi djaloshit Altin dhe ia rrëmbyen fyellin e çmuar. Patrici Klaud e mori në duar dhe provoi t'i binte. "Ky është fyell magjik dhe mua do të më bëjë të famshëm..." Ai urdhëroi njerëzit të mblidheshin rrotull për ta dëgjuar. Njerëzit u mblodhën e po prisnin.

Klaudi, duke u krekosur, i fryu fyellit. Por tingujt e tij s'kishin fare ëmbëlsi e melodia nuk ishte melodi. Njerëzit mbyllën veshët, se s'i duronin dot tingujt pa kuptim e të çjerrë që nxirte Patrici Klaudi. Ai, u inatos e përplasi fyellin përtokë, e shkeli me këmbë e pështyu mbi copërat e thyera.

- Ky qenka një fyell majft i keq, - tha dhe u largua.

Djaloshi Altin endej midis plebjeve e skllëvërve të qytetit Epidamn. Njerëzit i luteshin të luante për ta, por Altini s'kishte më fyell. Për ca kohë ai u zhduk nga qyteti. Kur u kthye, mbante në dorë një fyell të ri, që e kishte marrë tek barinjte e maleve. Ai filloi të luante.

I gjithë populli i thjeshtë u gëzua. Dëgjoji Patrici Klaud se djaloshi kishte gjetur një fyell të ri, me të cilin merrte ca melodi të mrekullueshme, që edhe gurët i bënë të ndjeshëm.

"Ah, - mendoi Patrici Klaud, - si nuk e kuptova se fyelli që mora unë s'ishte i vërtetë, por një kopje e keqe. Djaloshi ma ka hedhur. Por këtë radhë s'më shpëton dot".

Shërbëtorët e tij ia rrëmbyen prapë fyellin e ri djaloshit Altin e ia dhanë zotit të tyre. Klaudi e rrotulloi nëpër gishtat e duarve. Për çudi, edhe ky ishte njëlloj si i pari. Klaudi i fryu me sa fuqi që kishte. Por tingujt që nxori ishin përsëri nga ata tingujt që të kujtonin vetëm zhurmat pa kuptim. "Pra, edhe ky s'qenka fyelli magjik", - klithi i zëmëruar Klaudi dhe e hodhi përdhe, e shkeli me këmbë me një inat të patreguar...

Po me djaloshin Altin ç'u bë? Ai mbeti pa fyell, por shkoi te barinjte e maleve e solli një të tretë. Kaq bukur i binte, sa njerëzit e harronin urinë, s'e ndienin më etjen, të leckosurit në dimër s'e ndienin acarin. Patrici Klaud ia rrëmbeu dhe fyellin e tretë. Provoi t'i binte, por, si me dy të parët, nxori vetëm disa vërshëllima që s'dëgjoheshin dot. E shtypi me këmbë.

Fyelltari i qytetit gjeti një fyell tjetër të ri. Kënga e tij për të varfërit, si një thirrje kushtrimi për liri, nuk pushoi kurrë. Në të vërtetë, ai s'kishte pasur asnjëherë ndonjë fyell magjik. Ai luante me gjithë shpirt e ndjenjë, prandaj meloditë qenë aq të mira e i bënë njerëzit të ëndërronin.

Kaluan vite e vite. Djaloshi Altin u bë burrë e u bë plak. Gjithmonë me fyell në dorë. Ua mësonte mjeshtërinë e tij fëmijëve të popullit. Më në fund, nga pleqëria e vuajtjet e rënda që kishte kaluar në jetë, fyelltari plak, i zbehtë e i dobësuar, ndjeu se po vdiste. Mbi kokë i rrinte biri i vogël i një peshkatari, të cilit i kishte mësuar mjeshtërinë e tij.

- Sillmë fyellin, - tha plaku Altin i zbardhur nga thinjat. Fëmija ia solli. Plaku përmbloodhi forcat me sa mundi dhe filloi t'i binte. Nisi një nga meloditë që i pëlqente më shumë. Për fat të keq, koka iu rrëzua në krahëror, nga duart i ra fyelli e plaku vdiq pa e mbaruar melodinë. Fëmija, që i rrinte pranë, me lot në sy e me shumë dhimbje në zemër, ngriti fyellin. Ai e dinte si duhej ta nderonte fyelltarin e madh të popullit. S'kishte nderim më të madh për të se sa të vazhdonte melodinë e lënë përgjysmë. Kur djali i vogël e mbaroi melodinë, rreth tij qenë grumbulluar plebejtë, skllevërit e litarëve të anijeve, rremëtarët, peshkatarët e gurskalitësit e qytetit.

- Të lumtë! - i thanë ata djalit të vogël.

- Edhe ti do të bëhesh një fyelltar i madh!

Altinin e varrosën në dheun e kodrës së qytetit Epidamn. Mbi varrin e tij ngritën një lapidar të bardhë mermeri, ku një gurskalitës gdhendi në mermer figurën e një fyelli. Ai ishte fyelli i legjendës së madhe, i mrekullive që bën shpirti i njeriut të thjeshtë, fyelli që lulëzon stinat, që lulet e pemëve i kthen në fruta, që ndez yjet e bardha, që i rrit më shpejt fëmijët e vegjël, u jep shëndet të dobtëve e fuqi të pafuqishmëve. Fyelli i përjetshëm i këngëve të popullit.

Moikom Zeqo

Jetëshkrim

Moikom Zeqo lindi më 3 qershor 1949, në qytetin e Durrësit, në një familje me prejardhje nga Libohova.


Arsimin fillor dhe atë të mesëm e kreu në qytetin e Durrësit.

Në vitin 1967 i ndoqi studimet në Fakultetin e Filologjisë, duke diplomuar më 1971, në degën: Gjuhë - Letërsi.

Punoi si gazetar dhe redaktor letrar i gazetës "Drita". Ka ushtruar disa detyra publike, duke qenë edhe drejtor i Muzeut Kombëtar. Ishte Doktor i Shkencave dhe mori Urdhërin e Lartë "Mjeshtër i Madh".

Veprat letrare: "Qyteti fisnik" (1970); "Libër i hapur" (1986); "Panteoni ilir" (1995); "Princi i vjeshtës" (përralla, tregime dhe skica), 1996; "Meduza e dashuruar mban zyze dielli" (sonatë metaforash), 1997; "Kalorësit dardanë" (2007); "Klepsidra" (parabola misterit), 2011.

Ndërroi jetë më 15 qershor 2020, në Tiranë.



Moikom Zeqo
(1949 - 2020)

ANALIZË

◇ Interpretu përmbajtjen e tregimit:

- Në cilin qytet dhe në cilën periudhë kohore vendoset ngjarja?
- Si përshkruhet qyteti i lashtë dhe jeta në të?
- Përshkruaj personazhin kryesor!
- Krahso dy personazhet në mes vete dhe simbolikën e fyellit në duart e tyre!
- Me çfarë sakrificash përballej fyelltari?
- Pse fyelli dukej magjik në duart e Altinit dhe jo në duart e Patricit Klaud?
- Pse fyelli nxirrte tinguj të pakuptimtë kur i frynte Klaudi?
- Kush e trashëgoi dhuntinë e fyellit magjik?
- Pse Altini nuk iu nda fyellit deri në pleqëri kur e mori vdekja?
- A mendon se plaku fyelltar rron edhe pas vdekjes?
- A mendon se veprat e mira e bëjnë njeriun të përjetshëm?
- Çfarë përfundimi do të doje të kishte tregimi?

◇ Bën përshkrimin e personazheve:

(Shkruaj në fletore detyrën e dhënë!)

ALTINI	PATRICI KLAUD

◇ Detyrë:

- Përshkruaj në fletore se cila pjesë e tekstit duket më prekëse, më e ndjeshme?
- Si e shpreh mirënjohjen gurskalitësit ndaj fyelltarit Altin?
- Shkruaj hartim në lidhje me tekstin!

Mëso se...

Tregimi “Këpucëtari”, i shkrimtarit Murat Isaku, është ndër tregimet më të bukura nga vepra me tregime “Unaza e djerrinës”. Përmes personazhit të skicuar, xha Aliut, autori e përshkruan jetën e vështirë të malësorit, midis tjerash edhe me të papriturat e natyrës dhe jetës... *“Lumi gumzhiti, solli me vete angullimën e egër të qenve të barijve... Ama mbushej, me të shpejtë. Vrushkujt e parë, t’egër dhe të njimbasnjishëm iu vërsulën urës së gurtë - urë e vjetër, për të cilën katundarët kishin thurrë shumë gojdhana...”*

Kompozicioni i tregimit:

Parashtrimi - hyrja, pjesa hyrëse në një vepër letrare, që e lidh lexuesin me temën e veprës;

thurja- ngatërresa, ndeshja, përballja, kundërshtimi i personazhit kryesor me personazhet tjera;

kulminacioni - arritja e pikës kulmore (më të lartë) të ashpërsisë së konfliktit;

peripecia- paralajmërimi i mbarimit të ngjarjes;

zgjidhja - shthurja, pjesa përfundimtare (përfundimtare) e problemit apo subjektit të tregimit.

KËPUCËTARI

Atë ditë vjeshte, - si prore - mbasi u ngjesh e u mbath mirë e mirë, doli në dyqan.

Bryma i kishte zbardhue shpatet e Sharrit. Frynte një acar - një erë ndjellakeqe, që gjithmonë binte shi dhe rrenim. Mori një dy gaca zjarr të fëqinës së parë, i mbledhi turrë midis tagarit të truellit e u vu përmbi do lëmishte, kashta dhe krande. Mbasi i fryni disa herë djathtas e majtas zjarri u kall. I ngrofi pak duert e skuquna dhe e fërkoi fytyrën si me dashtë t'i derdhte gjakut pak ngrohtësi.

Përmbi pullazet e qytetit zhदारitej lodrueshëm tufa e sorrave.

-Ishalla me të mirë, - prozhmoi në vetëvete, dhe vazhdoi ta rrihte thumbin e këpucës së një zonje...

Ma vonë - aty kah drekët e mëdha ushtoi - bubullima. Fitilat e zjarrtë të vetëtimave, që shkrepshin varg, ja mirrshin sytë... në fillim ranë do kokrra të mëdha shiu, që i ngjajshin breshnit të pranverës. Njerëzit - kush hyni nëpër streha e kush vrapimthi u drejtue nga shtëpia - u rralluen në shesh. Xha Aliu e zgjati kryet në derë dhe sharoj në kujtimet e veta. Asnjëherë, si për inat, jeta s'i kishte përkëdhelë. Kishte qenë bari, rrogëtar, kallajxhi. Së fundit u vendos në këtë dyqan. Malit ja dinte fare mirë rrobet, e dinte se si merr frymë secili dru, si gjakon secili gur... Shiu vinte nga kreshta e Sharrit me rrëmbin. Paralajmëronte fatkeqësi... Këte e dinte mirë... Për pak gjethet fërfëlluen qiellit, era si dredhë i plapuriste dhe i mërgonte kushedi kah... Shiu ja grahi me rrëshekë. Ashklat, si të plyryna, pluskuen mbi ujë. Llofkata, disi si të përgjakuna, gurgulluen dhe çurgje-çurgje u mbledhën në shesh, prej kah dallgë-dallgë shpërndareshin qytetit. Të parën herë u mbushën brazat, hendeqet, mandej uji, pa kurrfarë përfilljeje dhe mëshire, nisi të gërmojë në temelet e shtëpive dhe dyqaneve...

Lumi gumzhiti, solli me vete angullimën e egër të qenve të barijve... Ama mbushej, me të shpejtë. Vrushkujt e parë, t'egër dhe të njimbasnjishëm iu vërsulën urës së gurtë - urë e vjetër, për të cilën katundarët kishin thurë shumë gojdhana...

Nji suvalë e rrufeshme i ra derës së dyqanit, ku këpucëtari i mblidhte këpucët, i bante dy nga dy dhe i varte nëpër gozhda të dërrasave, që të mos i mirrte uji. Veglat ma t'imita të punës i ngjeshin për rreth shokës. Çekanin e madh dhe mëkambëzënë i shtini rrëshqitas në shkekat e tirqve...

Njerëzit, pleq e të rij, vrapuen nga ura për ta mbrojtë, nga se po të shprishej ajo, fort randë kishte të shpëtonte jeta e lagjes së vogël, që gjindej mu në rranzë të lumit.

Këpucëtari i përvoi krahët deri mbi bërryla dhe iu kapërthye si bollë e vrame njanës dërrasë që po lakohej. Vendosi të zvarritej drejt përpyetë tue u zhagitë dërrasës, mbasi rrenimi gjithnji e ma tepër rritej dhe mbushte dyqanin me zall dhe degurina. Iu kujtue se çdo orvatje për të shpëtue jetën mbrenda në dyqan ishte e kotë. Prandej i mblodh edhe fuqitë e fundit dhe vendosi të hypte naltë në pullaz të tij, prej kah, nëse i kërcënohej rreziku, do të kalavarej në degët e mollës, të cilat prej frutit atë vjet ishin lakue deri në tjegulla. Dha e mori disa herë, por si të vepronte ndonji fuqi e mëshehtë kundra tij, trupin ia tërhiqukte kryengulthi teposhtë. Binte si trupth i sharruem në llokoçamën e ujit. Njiherë ai i mbërinte deri në kërcikë, por ma vonë rritej gjithnji e ma tepër. Të fundit herë kur ra, uji ja mbuloi kambët, ijet dhe nji pjesë të krahnorit... i zgurdulloi sytë dhe i këqyri si për të fundit herë këpucët që lundrojshin pizgërr nëpër rrenim.

-Hej, millet! - u shqerr gërhamë e tij e përmytun dhe pa kurrfarë, shprese. Kundrat e zeza me take të nalta janë të... nisi t'i numrojë pronarët e këpucëve tue ndjekë rendin e tyne përpara syve.

-The qafën, marroq iu ngërmue njeni prej qytetarëve, që vrapoi të shkepi ndonji dërrasë në dyqanin e tij për ta ndalë lumin.

- Dyqanin, dritën e synit, amanet ja la nipit!... - ja priti ai i kapun për dërrasë si kitër.

-Veni kambët mbi supët e mia dhe kapu në qoshin e kulmit briti qytetari me të shpejtë, tue mos ja shkepë sytë urës.

Këpucëtari, tue u shilarë pullazit, shikonte me supin e tij, mandej tue u kolovitë në pezullim, e vu edhe tjetrën dhe u kap për tabanin e kulmit.

-Bafsh hajr! - përshpëriti, tue shtue se me të dalë rrënimin nji palë këpucë pa kurrfarë page ka për t'ja arnue dhe meremetue.

Njeriu e luhati vetëm pashin e krahut të majtë në shenjë mospërfilljeje për këtë cikrrimë, dhe trupoi kah ura.

Këpucëtari, tue u shilarë pullazit, shikonte me tmerr rrënimin që bahej gjithnji e ma i tërbuem. I pështuem lemerie i ngriti duert përpyetë, tue e lutë qiellin që t'ja shpëtonte këpucët e myshterijve. Nji valë ruzgjer ja fërshëllini sytë. E fshiu mjekrën me jakën e këmishës dhe e trusi kësulën në puç të kresë.

Nji guri i madh dhe i rrumbullakët, ku pushojshin katundarët ditëve të pazarit, luejti vendit. U rrokullis rrëmbimthi dhe, mbasi bani disa rrukullisje, iu përplas me fuqi dyqanit. Çatmja u dridh si prej trandjeve të tërmetit, mandej, tue u luhatë si shtizë flamuri, nisi të lakohet nga kalldërmi i rrugës.

Plaku i hapi kambët dhe disi iu ngjit majës së degës, e cila përplasej prej njenës në tjetrën anë. Mbas nji kohe, kur dërrasat filluen të shkepen, ai u kap në majën e kulmit dhe i erdh mullarthi disa herë si të dëshironte të kërktojë ngushullim.

Njerëzit vazhduen punën e vet. S'ishte gjë e lehtë me vu penda dhe me i dhanë krye ujit nga krahu i majtë, nga ajo anë e cila ishte ma e naltë se kjo përpara dyqanit të këpucëtarit. Po të rrëzohej ura, atëherë tejet vështirë do t'ishte të mbrohej një pjesë e madhe e qytetit prej vërshimës.

Xha Aliu rrinte i shastisun dhe mendonte se si mundën aq fort t'i dalin zot urës e ta harrojshin atë që aq fort i kishte nderue dje, dhe s'u kishte ba asnjë të keqe. Kur i lau duert ma prej ndihmës, belbëzoi:

- Jo, këtu e tutje edhe unë do të mendoj soll për vete e s'do ta çaj ma kryet për ta!...

Kah e vona, shiu u ndal. Njerëzit, të pehatun nga stërmundimi, u renditën nën strehë, tue i fshi krahët dhe tue i shkundë rrobet.

Njenit i shkoi ndërmend xha Aliu dhe pyeti të tjerët, e ata i rrudhën krahët tue i ngulitë sytë në zallin e anit.

Tue rrëshqitë trungut të mollës teposhtë, Aliu zihej në vete:

Jo, jo, nuk vdes këpucëtari aq kullaj, që t'ua lajë miraz dyqanin. Edhe nëse vdes, njikaj ta qitni dhambin, nuk do të mund ta shtini dorën aty pari...

Murat Isaku

Fjalorth

dyqan - shitore;
brymë - vesë e ngrirë / reshje, si shtresë e hollë bore;
acar - ngricë;
zhagitë - zvarritë;
cikrrimë - gjë e vogël;
shilarë - rrëshqitur;
të pehatut - të stërlodhur;
soll - vetëm, veç (sall);
zallin - rërën;
kullaj - lehtë (lokalizëm);
i shastisun - i habitur;
miraz - trashëgim.

Jetëshkrim

Murat Isaku lindi më 15 prill 1928, në fshatin Gajre të Tetovës.


Shkollimin e ndoqi në Tetovë, Elbasan, Prishtinë dhe Prizren, ndërsa maturën e mbaroi në Normalen e Gjakovës. Studioi për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.

Punoi si mësimdhënës në Gjimnazin e Tetovës dhe më tej u emërua zëvendësudrejtor i kësaj shkolle. Punoi si redaktor i TV Shkupit, për emisionet në gjuhën shqipe, deri në pensionim.

Shkroi poezi, tregime e romane.

Veprat letrare: "Zani i malit" (1960); "Dielli e din rrugën e vet" (1965); "Plagët" (1975); "Etje" (1982); "Blana" (1982); "Shtjella" (1989); etj.

Ndërroi jetë në vitin 2005, në Tetovë.



Murat Isaku
(1928 - 2005)

ANALIZË

♦ Analizo tekstin:

- Bashkëbisedo në klasë për përmbajtjen e tekstit!
- Përshkruaj portretin e xha Aliut!
- Trego dhimbjet shpirtërore të personazhit!

♦ Rrëfimtari në tregim e përdor monologun e brendshëm:

- për t'ia rrëfyer lexuesit vështirësitë dhe telashet e jetës së personazhit kryesor;
- për ta zbrazur shpirtin e tij të ngarkuar nga brengat;
- për ta bindur lexuesin përmes mesazheve edukuese.

♦ Detyrë:

- Gjej në tekst paragrafët që tregojnë se rrëfimtari e përshkruan bukur ambientin!
- Rikujto ngjarje të ngjashme - fatkeqësi të natyrës, në qoftë se di apo ke përjetuar!
- Lexo me kujdes tekstin e dhënë dhe rishkruaj në fletore porosinë apo moralin e personazhit:

Xha Aliu rrinte i shastisun dhe mendonte se si munden aq fort t'i dalin zot urës e ta harrojshin ate që aq fort i kishte nderue dje, dhe s'u kishte ba asnji të keqe. Kur i lau duert ma prej ndihmës, belbëzoi:

- Jo, këtu e tutje edhe unë do të mendoj soll për vete e s'do ta çaj ma kryet për ta!...

Kah e vona, shiu u ndal. Njerëzit, të pehatun nga stërmundimi, u renditën nën strehë, tue i fshi krahët dhe tue i shkundë rrobet.

Mëso se...

Tregimi “Lypësi” i shkrimtarit Nonda Bulka, i cili me origjinalitetin e kohës së tij përshkruan një kohë të vështirë, kur varfëria ishte në kulm, temë me të cilën autori i godet shkaktarët e kësaj gjendjeje të mjerueshme. Përmes personazhit - djalit të vogël shtatëvjeçar, *me sytë si një pasqyrë e egër, e gjallë dhe e tmerrshme e varfërisë*, përshkruhet gjendja shpirtërore dhe psikologjia e brendshme e individit dhe shoqërisë së papërgjegjshme.

Fabula është mbarështrimi i ngjarjeve themelore dhe shënon vetëm rrjedhën e ngjarjeve më të rëndësishme të një vepre letrare.

LYPËSI

Më ndjek nga dita sa herë vete në shtëpi:

- Nëm një lek, zotni!

Është një djalë i vogël, shtatëvjeçar, i zi pisë nga fytyra, i thatë, i shkurtër, pa rroba, pa këpucë; si rron, as unë nuk e di. Sytë e tij janë pasqyrë e egër, e gjallë dhe e tmerrshme e fukarallëkut. Vuan nga uria, vuan nga të ftohtët, vuan nga çdo gjë. Por i ka mbetur aq fuqi, sa të thotë: - nëm pak bukë!

Të mendohesh thellë, më e mira që mund t'i bësh, është ta helmosh. Se helmi është ilaçi i fukarallëkut.

E di që feja dhe ligji më helmojnë mua, po të bëj një vepër të tillë. Se njeriu s'ka të drejtë t'ia marrë jetën njeriut. Po a ka vallë njeriu të drejtë t'ia shtojë vuajtjet tjetrit? Se lypësi me lekun tim s'bën tjetër veçse shton ymrin, domethënë jetën, domethënë fukarallëkun. Mëshira private nuk e zgjidh kurrë problemin shoqëror.

Por le të kthehemi te historia e lypësit. Ditë për ditë më kërkonte diçka... Se ditë për ditë kishte nevojë barku i tij. Herë i jepja, herë jo.

Një ditë nuk e pashë të më dalë rrugës! Dy ditë, tri, katër. Thashë me vete: - Ç'u bë vallë? Dhe shkoi një muaj, shkuan dy, po lypësin s'e pashë më!

Më erdhi keq, doja të dija ç'u bë; se fytyra e tij ishte simpatike, me gjithë shëmtimin tmerrues, ku pasqyrohej uria dhe vdekja e ngadaltë. Jo, s'e pashë më! dhe m'u bë si ide fikse! Doja të dija ç'u bë.

Dhe u enda andej - këtej. Në çdo cep takoja nga një lypës të vogël, si ai (të gjithë lypësit ngjasin, se ngjyra e urisë nuk ndryshon), por s'ishte ai.

Shkuan qysh atëherë katër muaj.

Fillova ta harroja lypësin tim.

Sonte befas m'u kujtua. E ku ta dish! Ndoshta ka vdekur...

Gazeta s'mund ta përmendë emrin e tij. Vdiq ndoshta... ndoshta rron i sëmurë. Nuk e di. E ku ta marrësh vesh sa korr përditë drapri hyjnor!...

Nanda Bulka

Fjalorth

Nëm - më jep /jepmë;
Lek - të holla, para;
i zi pisë - sterrë;
fukarallëkut - varfërisë;
ymrin - jetën;
ide fikse - mendim i ngulitur;
drapri hyjnor - vdekja (figurativisht).

Motivi është njësia më e vogël tematike e krijimit letrar. Është element shumë i rëndësishëm i krijimtarisë letrare, pasi është vetë shkak, nxitja, arsyeja, ngacmimi, që e ka shtyrë shkrimtarin të krijojë një vepër letrare.

Jetëshkrim

Nonda Bulka lindi më 18 maj 1906, në fshatin Leusë, në afërsi të Përmetit.

Mësimet fillestare i mori në vendlindje, të mesmet në Liceun frëng të Korçës (1929).

Studioi për drejtësi në Francë e më pas u kthye në atdhe, ku punoi si mësues në Korçë, Elbasan dhe Tiranë.

Njihet si: pedagog, përkthyes, publicist e satirist, duke trajtuar tema të ndryshme shoqërore, kurse më pas, si tregimtar e poet. Shkroi skica në prozë, me pseudonimin Chri-Chri.

Veprat letrare: "Kur qan e qesh bilbili" (skica dhe fejtone), "Thumba pa helm" (skica), "Sketches and short stories", përmbledhje skicash e përkthyer anglisht, në vitin 1984.

Ndërroi jetë më 14 nëntor 1972, në Tiranë.



Nonda Bulka
(1906 - 1972)

Shkruani ese - si frymëzim nga tregimi “Lypësi”

(Shkruaj në fletore detyrën e dhënë)!

Temat:

- *“Dinjiteti përballë varfërisë”*
- *“Mëshira dhe respekti për njeriun”*
- *»Vlerat njerëzore në tregimin “Lypësi”«*



ANALIZË

♦ Interpretoto:


- Si është dhënë portreti i lypësit të vogël që përmendet në këtë pjesë?
- Çfarë qëndrimi mban rrëfimtari ndaj shoqërisë dhe mënyrës së jetesës?
- Pse jeta për dikë është kaq e vështirë, a kanë faj fëmijët?
- Si mund të interpretohet kuptimi i kësaj pjese: *“E di që feja dhe ligji më helmojnë mua, po të bëj një vepër të tillë. Se njeriu s’ka të drejtë t’ia marrë jetën njeriut. Po a ka vallë njeriu të drejtë t’ia shtojë vuajtjet tjetrit? Se lypësi me lekun tim s’bën tjetër veçse shton ymrin, domethënë jetën, domethënë fukarallëkun. Mëshira private nuk e zgjidh kurrë problemin shoqëror”.*
- Çka simbolizon shprehja: drapri hyjnor?

♦ Rretho përgjigjet e sakta:

- a). Helmi është ilaçi i fukarallëkut.
- b). Fëmija i vogël ishte gjashtëvjeçar.
- c). Djali lozte dhe qeshte nëpër rrugë.
- c) Ai kërkonte para që të blente një lodër.
- ç) S’doja të dija ç’u bë!

♦ Detyrë:

- Çfarë tregon fjalia: *“Gazeta s’mund ta përmendë emrin e tij. Vdiq ndoshta... ndoshta rron i sëmurë. Nuk e di. E ku ta marrësh vesh sa korr përditë drapri hyjnor!...”*
- Shkrimtari e shkroi këtë ngjarje për të mos e harruar kurrë, po ti a i përshkruan ndodhitë tua ose të të afërmve tu?
- Shkruaj temën: *“Bota në sytë e fëmijëve”!*



Mëso se...

Romani është vepër e madhe tregimtare ose forma më e plotë e prozës epike ku zhvillimi i karaktereve, i ngjarjeve dhe i temave trajtohet në një formë të ndërlikuar, pasi përfshin një numër të madh personazhesh, duke pasqyruar realitete të ndryshme shoqërore, historike e psikologjike.

Novela - fjalë angleze për histori, ngjarje, lajm, që rrjedh nga latinishtja: *novella* (*novellus* - *novus*, që do të thotë “i ri”, pra zhanër i ri.

Romani është një vepër e zgjeruar e trillimeve narrative.

Njihen disa lloje: romani historik, aventuror, shoqëror, psikologjik, filozofik, detektiv, satiriko - humoristik, epistoral, pastoral etj.

Narracioni - rrëfimi është mënyra e rrëfimit të ngjarjeve në një vepër letrare, ku përfshihet përshkrimi i ngjarjeve, personazheve, vendit dhe kohës, në të cilën zhvillohet veprimi.

Format e narracionit janë: **Retrospeksioni** (kthimi pas në kohë, për të kujtuar ngjarje nga e kaluara (flashback), p.sh.: ngjarje nga fëmijëria, shkolla, lufta, etj; **Introspeksioni** (procesi i analizës së brendshme të mendimeve, ndjenjave dhe gjendjes shpirtërore të personazhit); **Prospeksioni** (parashikimi ose pritja e ngjarjeve që mund të ndodhin në të ardhmen).

GJERGJI, BIRI I ARBËRISË

Gëzohu, o Arbëri, se po të vjen dita e lirisë! Zbukurohu me kurora plot lule e dafina! Shpalosi flamurët e kuq me shqiponjën dykrenore në mes! Zhvishi rrobat e zisë që ke mbajtur veshur për aq vjet!

Mirë se na vjen, o verë, në viset arbërore!

Ardhsh përherë e gëzuar, për shekuj e shekuj të tërë, ashtu siç po vjen sivjet! Ngrehuni edhe ju, o të vdekur, nga varri dhe gëzoni tok me të gjallët, se Arbërisë po i buzëqesh liria!

Po vjen Skënderbeu, prandaj po zbardh fusha e po ndrit mali nga armët e trimërisë. Po vjen Skënderbeu, prandaj hingëllin kali e s'mbahet dot, se po sjell mbretin e Arbërisë në atdhe!

* * *

Skënderbeu me trimat e vet nga pas, hipur në kuaj e armatosur si jo më mirë, u futën në qytet me këngë në gojë dhe me britma gëzimi e hareje. Osmanët që ndodheshin në Krujë në fillim, deshën të mos i pranonin e t'i kundërshtonin, por kur morën vesh se cili kishte ardhur në krye të tyre, ngritën përpjetë flamurin e bardhë dhe po rrinin sus.

Pritnin me ankth si do t'u vinte filli...

Nga të katër anët e qytetit, u lëshuan si përrenj të vegjël krutanët dhe në qendër formuan një lumë të madh njerëzor, që po i ngjitej kalasë duke brohoritur:

- Rroftë liria!

- Rroftë atdheu!
- Rroftë Skënderbeu!

Nga gjithë vendi u nisën me qindra e mijëra vetë për në Krujë, për të parë mbretin, për të përshëndetur Gjergjin, për të përgëzuar shpëtimtarin, për të parë Skënderbeun, birin e madh të Arbërisë.

Pleqtë që e kishin njohur qysh kur ishte i vogël dhe e kishin përcjellë në Adrianopojë me lot në sy, vajtën dhe e puthën në duar dhe në ballë duke qarë. Fëmijët e rrethuan, e mbushën me tufa lulesh dhe morën valle tok me të. Gëzim e hare më të madhe s'kishte parë kurrë Kruja me sy. As këngë e as valle nuk kishte dëgjuar e parë si atë ditë!

Skënderbeu i priti, i ngjatjetoi e i falënderoi të gjithë me radhë, të mëdhenj e të vegjël, dhe pastaj tha:

- Më sillni këtu komandantin e fortesës!

Sakaq komandanti osman u dha në shesh kokulur e sypërdhe.

- Më dëgjo mirë, o Osman, - se kështu quhej. - Sulltani e hëngri fjalën që i dha tim eti dhe e pushtoi Arbërinë, - tha Skënderbeu.

- Vrau, dogji e shkretoi dhe mua nuk më rrëfeu asgjë. M'i mbajti të fshehta të gjitha mynxyrat që mbuluan Arbërinë. M'i mbajti të fshehta gjëmat që gjetën prindërit e vëllezërit e mi. Ja, kështu m'i goditi me thikë pas shpine! Më gjakosi e ma bëri me pabesi. Dhe e dini pse ndodhi kështu? Se sulltani për ligj ka djallëzinë, ligësinë dhe poshtërsinë.

Unë nuk jam si Murati. As pendë nuk do t'ju prek, po të më dëgjoni fjalën. Qysh nesër të ngriheni e të shkoni në punën tuaj, larg Arbërisë!

Dëgjove? Dhe mos guxoni të ktheheni më, se nuk do t'ju lë as nam, as nishan. Do t'ju hanë korbat e këtyre gërxheve!

Osmani nuk bëri as gëk, as mëk, po uli kokën dhe doli jashtë. Të nesërmen në mëngjes, mori rrugën për në Adrianopojë, në krye të ushtarëve të vet. Disa që nuk dëgjuan fjalën e Skënderbeut, po ngritën jataganin kundër tij, hëngrën dhe.

Sa morën vesh këtë lajm, edhe në fortesat e tjera të Arbërisë nuk mbeti më këmbë osmani.

Arbëria e hoqi shaminë e zezë, që e kishte të ulur gjer poshtë te sytë, dhe nisi të priste e të përcillte miqtë që po i vinin nga të katër anët e Evropës. Erdhën të dërguar nga të gjitha mbretëritë, me urime e kanisqe.

Kur u kthyen shoqëruesit në kështjellë, Skënderbeu tha:

- Më ka marrë malli për shtëpinë. Dua ta shoh edhe një herë. A është si e kam lënë, kur isha fëmijë?

E shpunë para shtëpisë, që ishte bërë gërmadhë, dhe në cep të syrit i ndriti një pikë lot.

U ul në gjunjë e puthi pragun, ashtu si do të kishte puthur të ëmën e të atin.

Sa u ngrit, përpara i dolën të pesë motrat, veshur këmbë e kokë me të zeza. E përqaftuan me mallin e madh të motrave, se vetëm ai u kishte mbetur, se atë e kishin si dritën e syve. Qanin e s'pushonin dot. I kishte mbytur mallëngjimi.

- O motra të dashura! - u tha Skënderbeu. - I fshini lotët, hiqni rrobat e zisë dhe merrni pjesë në këtë gëzim që ka tërë Arbëria. Gëzoni edhe për vëllezërit që na ikën. Gëzoni edhe për prindërit që na lanë.

Dhe ato në atë çast u veshën me të bardha, ashtu siç u vesh gjithë Arbëria atë ditë.

Në sheshin e kalasë u mblodhën të mëdhenj e të vegjël. Pa kishin ardhur edhe princat e komandantët nga e gjithë Arbëria dhe pritnin Skënderbeun. Kishin ardhur Lekë Dukagjini me nam e Zaharia Gropa trim, Tanush Topia i urtë e mendjeshumë dhe Gjon Shpata i dëgjuar. Pa kishin ardhur Lato Gjata nga Labëria, Maneshi nga

Berati, Moisiu nga Dibra, Kont Urani e Bashdar Nartioti, Pal Dushmani e Gjon Koka, të gjithë trima e të gojës, që u priste shpata e gjuha në të dy anët. Osmanët e njihnin mirë trimërinë e tyre, se e kishin provuar në kurriz.

A e keni parë diellin si ndriçon në qiell? Ashtu ndriçonte edhe mbreti i Arbërisë, Skënderbeu!

Skënderbeu erdhi e zuri vend në mes të tyre si i barabarti në mes të barabartëve, i thjeshtë e i dashur, i urtë e burrë i fjalës dhe i shpatës, si gjithë të tjerët që kishte përreth.

Tërë sheshi buluriti:

- Rroftë Skënderbeu!

Odise Grillo

-“Historia e Skënderbeut” është roman për fëmijë i shkrimtarit Odhise Grillo, që në thelb të përshkrimit të vet e ka kryetrimin kombëtar, Gjergj Katriotin - Skënderbeun.

Në fragmentin e shkëputur, rrëfihen ngjarjet e jetës së heroit nga fëmijëria, kur merret peng nga ushtria e Perandorisë Osmane, deri te kthimi i tij në Krujë, si dhe betejat e shumta që bën kundër pushtuesit otoman.

Jetëshkrim

Odise Grillo lindi më 21 mars të vitit 1932, në Vuno të Himarës.

Studioi Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Universitetin e Tiranës, në vitin 1962. Pas mbarimit të studimeve punoi si redaktor në revisten “Hosteni”, ndërsa më vonë i drejtoi revistat: “Bota e fëmijëve” dhe “Kultura Popullore”.

Ka shkruar: poezi, tregime, drama, romane, përkthime, etj.

Veprat letrare: “Shtatë ngjyrat” (vjersha), 1954; “Njeriu i natës” (novelë), 1972; “Zërat e fëmijërisë” (vjersha e poema), 1979; “Një zog dhe një lule” (vjersha e poema), 1982; “Erdhi Dita e Arbërit” (përshtatje për fëmijë), 1989; “Porsi kënga e zogut të verës” dhe “Mollëkuqja e fëmijërisë” (vjersha e poema), 2001; etj.

Ndërroi jetë në vitin 2003, në Tiranë.



Odise Grillo
(1932 - 2003)

ANALIZË

◆ Bashkëbisedo:

- Si e përjeton leximin e kësaj pjese romani?
- Portretizo figurën e Gjergj Kastriotit, duke i gjetur cilësimet për të, në tekst!
- Krahajo personazhet e Tanush Topisë dhe Gjon Shpatës!
- Kush ishte Osmani, pse erdhi në tokat e Arbërisë?

◆ Interpretu pjesën hyrëse të tekstit:

- Analizo fjalimin e Gjergj Kastriotit!
- Përshkruaj qytetin ku e mbajti fjalimin!
- Gjej pjesët më mbresëlënëse të fjalimit!
- Shkrimtari Naim Frashëri, gjithashtu e shkroi poemën: “Istori e Skënderbeut” dhe nëse të kujtohen vargjet epike:

“Kruj’, o qytet i bekuar!

Prite, prite Skënderbenë,

Po vjen si pëllumb i shkruar,

Të shpëtonjë mëmëdhenë”.

Krahajo vargjet e poemës me pjesën e tekstit që e lexuat!

◆ Në fjalinë e dhënë më poshtë, interpreto se kujt i drejtohet Gjergji:

- *“Unë nuk jam si Murati. As pendë nuk do t’ju prek, po të më dëgjoni fjalën. Qysh nesër të ngriheni e të shkoni në punën tuaj, larg Arbërisë!*
- *Dëgjove? Dhe mos guxoni të ktheheni më, se nuk do t’ju lë as nam, as nishan. Do t’ju hanë korbat e këtyre gërxheve”!*

◆ Detyrë: (Puno në shtëpi detyrën e dhënë)!

- Ritrego në vetën e parë pjesë nga teksti!
- Nënvizu fjalët më të pëlqyera të Gjergj Kastriotit!
- Shkruaj fjalët e Gjergjit të përdorura për:

luftëtarët arbërorë _____

_____.

ushtarët osmanë _____

_____.

Mëso se...

Romani “Shpella e piratëve” e shkrimtarit Petro Marko, rrëfen një ngjarje mjaft interesante për një grup fëmijësh, të cilët të yshtur nga kërshtëria e moshës, do të hyjnë në shpellën e njohur si *shpella e piratëve*... Pas aventurash të bukura, ata gjejnë një libër, që i përket lashtësisë së shkruar në gjuhën e vjetër të kohës së kryetrimt Gjonbaba.

Ngjarje fantastike të njëpasnjëshme e përshkojnë tërë romanin!

Narratori - rrëfimtari, është zëri ose figura që e rrëfen ngjarjen në veprën letrare. Ai mund të jetë pjesë e ngjarjes (narrator i brendshëm, në vetën e parë) ose dikush nga jashtë saj (narrator i jashtëm, në vetën e tretë). Narratori është ai që e sjell rrëfimin te lexuesi.

Fabula shënon vetëm rrjedhën e ngjarjeve, ndërsa vetë ngjarja, përshkrimet, ndjenjat mendimesh, qëndrimet, etj., e përbëjnë përmbajtjen e veprës.

MISTERET E SHKRIMIT TË VJETËR

(Emri i Rusman El Namsurit)

Kishim harruar sa ishte ora! Kishim harruar fare dhe ç'duhej të bënim para se të ngrysej! Ne kishim vendosur të dilnim para perëndimit të diellit, mirëpo nuk dinim ç'kohë ishte.

Unë që s'kisha besim te Fotua, tani e shikoja ndryshe. Më dukej si një plak i mençur. Sytë e tij dinakë, tani, më ishin bërë të dashur. Kur filloi t'i dhembte barku, unë kujtoja se barku e kish zënë nga frika. Po ai i shkrete ish ftohur dhe megjithëse të prerat i kish kaq të forta sa e bënin që të djersinte, prapsepapë duronte dhe na bënte për të qeshur. Tani ishte më mirë. Si të gjithë ne edhe ai shikonte plot kureshtje librin e madh që kish çelur Gjonbaba ynë.

Ai gati sa s'fluturoi nga gëzimi. Çeli disa faqe dhe u kthye nga ne:

- Është historia e shpellës së piratëve!

- Me kujdes! - tha Fotua. - Mos na bëhet shkrumb!

- Mirë e ka! - pohoi Gjonbaba. - Se me të vërtetë, gati të bëhet hi është! Dhe kush e di ç'vlerë ka... Po, pa dale të shohim, se mos nxjerrim ndonjë fjalë...

I pari që zbuloi emrin e Rusman El Namsurit, ish Fotua.

- Afroi më shumë fenerët! E mos e prekni librin! - urdhëroi Gjonbaba ynë dhe e ktheu, duke u nisur nga faqja e parë. - Shkronjat janë pak a shumë si tonat, po më të përdredhura...

“U Gion Nipi, Biri i Gion birit et nipi i zullumadhit kapedan Gionbaba shkruoj historia e ksaj spelle, liruo ka fundi vitit 999 kontra saraçenëve... Im zot gysi Gionbaba dëbou et mundi kursarin kapedan pirat Rusman El Namsur”...

- Shumë mirë! Shumë mirë! - thirri i entuziazmuar Jani. - Qenka shkruar shqip... E

kuptojmë mirë!

-Po - tha, gati për të fluturuar nga gëzimi, Fotua, - unë e kuptova. Megjithëse është shqipe e vjetër .

- Domethënë, im atë e paskish dëgjuar mirë që Gjonbaba kish mundur Rusman El Namsurin!

- Po ku e dinte ai? - pyeti Fotua.

- Nga gojëdhëna! - u përgjigj Gjonbaba ynë. - Që shekuj e shekuj me radhë. Po tani kini durim sa të nxjerrim këtë shkrim e këto fjalë të lashta...

- Domethënë këto i shkruan Gjonipi!

Po ç'është ky Gjonipi - pyeti Lulja.

- Ja, tani do të shohim. Pa shih se sa faqe ka ky libër. Këtu, patjatër do të jetë edhe jeta e Gjonipit.

- ...Saracenët munduon tepër popullatëninë. Pushtuon spellen et sulmuon vatratinë. Rrëmbyen et bijat et therën atët pleq. Piratë kursarë detit gjaksorë et mizëri ngritën fortesë këtë spellë për nënt vjet... Nënt vjet giak et ziarr... Kapedani zullumadh Gjonbaba rrethuo et zbuluo dalien kësaj spelle et hyri brenda vetë et spërngulo kapedan pirat Rusman El Namsur...

-Këndoje me ngadalë. Ç'thotë ashtu? - pyeta unë, i kredhur në ato që lexonte Gjonbaba ynë.

- Aman, mos e ndërpritni! - ulëriti Fotua.

- ... El Rusman El Namsur ndezi beleg tek Perrua horesinë, kur si rrufe flakrua kapedan zullumadh Gjonbaba et një dit et dy net përlesje strou përdhe Rusman El Namsur, uku i deteve et zjarri i stereve... I preu katinën me zverk të rumbullaktë sa të kaut et miekër të gjatë gjer te komba... Giaku rrodhi rrëke të përroo kië sot kiuhet Perruo Rusmanit...

Kjo fletë nuk lexohet dot.

- Me ngadalë se mos griset! Kur të dalim së këtejmi, do të përpiqemi ta lexojmë! - tha Fotua. [...]

[...] E kuptuat gjer këtu? - pyeti Gjonbaba ynë.

- Unë jo! - tha Lulja, që ish gjunjëzuar dhe mbante pranë librit fenerin e saj.

- Si s'e kuptove? - u hodha unë. - Shumë e qartë: Gjonbaba nxori nga shpella Rusman El Namsurin dhe e ndoqi dhe, pas një ditë e dy net lufte, e shtriu përdhe dhe i preu kokën aty ku sot quhet Përroi i Rusmanit.

-Se ç'domethënë hora? - pyeti Jani.

- Beleg, domethënë luftë! Hora, domethënë, qyteti. - u përgjigj i sigurt Gjonbaba ynë, si një njeri që i di të gjitha. - Pa dale, se këtu nga njëra anë përshkruhet si ka qenë Gjonbaba dhe nga ana tjetër si paraqitej Rusman El Namsuri...

- Ai e lexoi e pastaj u ngrit më këmbë dhe përsëriti:

"Gjonbaba, - shkruan Gjonipi, - ishte dy metra i gjatë. Peshonte sa një ka. Fellukët zhyteshin në ujë, kur hypte ai në to. Një sy e kishte humbur në betejë kundër piratëve. Në faqen e djathtë kishte shumë të çara thike. Syrin e humbur e mbante të lidhur me një pece të zezë. Mjekrën e kishte të dendur dhe të gjerë gjer te gjoksi i tij katror. Këmbët i kishte të shpejta. Mund të qëndronte edhe një javë pa ngrënë. Po kur hante, s'i dilte një dem i pjekur në hell. Verën e pinte si ujë dhe kurrë nuk dehej. Ditën që do të luftonte me Rusman El Namsurin, provoi forcat duke ngritur në krahë një kalë të gjallë dhe duke shkukur një lis të moçëm... kur kollitej, sikur bubullinte. Kur qeshte, sikur shqyheshin çatitë e shtëpive.

“Nëntë vjet gjersa shkuli piratët nga kjo shpellë, që e kish kthyer në kala të pamposhtur, jetoj si i tërbuar; nëntë vjet gjaku kish skuqur detin. [...]”

[...] Rusman El Namsurin, - tregonte pastaj Gjonbaba ynë, - ishte një ujk i detit. Thuhet se kishte lindur nga një magjistare këtej Maleve të Sinajës. Kishte trupin e një gjarpri, se me gjarpërinj ish rritur. Thonë se ushqehet me trutë e peshkut dhe mund të zinte të gjallë edhe peshkaqenin; thonë se kafshët i vinte në gjumë me një shikim dhe delfinët i shkonin si manarë; thonë se kur këndonte ai, flinin erërat e detit..., thonë se ishte martuar me të bukurën e Dheut që banonte në fund të detit..., thonë se asnjë rrufe nuk e godiste ...

thonë...

“Rusman El Namsuri gajasej, hante, pinte, plaçkiste, vriste, digjte... Ndërsa Gjonbaba e ftonte të dilte në mejdan e të provonte forcën e tij... Kryepirati ishte dhelpër. E kish parë nga shpella Gjonbabën dhe kish kuptuar se po të ndeshej me të, do të humbiste, do të vritej...

“Në kohën kur bota priste kiametin, se për pak ditë do të agonte viti 1000, gjë që e priste edhe vetë i biri i magjistares, gjarpri dhe ujku i detit, Rusman El Namsuri, ndodhi ajo që ndodhi: kryepirati duke u kapardisur doli me fellukë dhe sodiste malet tona... Gjonbaba, që për nëntë vjet, nëntë muaj, nëntë javë e nëntë ditë e ruante, dha urdhër që të bllokohej hyrja e shpellës dhe daljanë det të hapur. Dhe i doli përkundruall atij që i trembeshin dhe peshkaqenët e detit. Dhe bërtiti. Ku je, o pjell' e errësirës dhe ligësisë! Dil në fushë të mejdanit, o turp, o i lyer, i zhyer, i gërryer, o derr, o gjarpër, o hie...

[...] Përleshja zgjati nëntë orë! Luftonin bajlozi i zi me zotin e vendit! Dhe ku binin të dy të mbërthyer, rrokulliseshin shkëmbinjtë. E po të binin në trungjet e lisave apo të ullinjve, trungjet thyheshin sikur të ishin kashtë misri”.

“Piratët saraçenë ulërinin si çakej të tërbuar për t'i dhënë zemër kapedanit të tyre, që dukej si një bishë e trullosur... Kur ish duke perënduar dielli,

Gjonbaba e sulmoi me tërbim, e shtriu përdhe, nxori këllëçin dhe i preu kokën. Gjaku shkoi rrëke...dhe ai vend u bë përrua i gjerë... Ish gjaku i Rusman El Namsurit që e çeli atë përrua...”. Saraçenët, të tmerruar, ua hipën fellukëve të tyre dhe u zhdukën në horizontin e detit, që po errësohej”...

Vendosëm ta ndërprisim leximin. Gjonbaba ynë na hodhi një shikim, për të na parë se në ç'gjendje ishim.

Petro Marko

Fjalorth

kamare - hapësirë si dollap i vogël në mur, zakonisht në anë të oxhakut, ku vihen enë a sende të tjera të vogla;
potone - vend i ngritur prej guri anash portave, për t'u ulur;
kanavetë - arkë e vogël ku mbahen sende me vlerë;
pirat - kusar deti;
katinë - kokë;
fellukë - varkë druri e vjetër;
këllëç - shpatë ose thikë me dy tehe, që mbahet në brez.

Jetëshkrim

Petro Marko lindi më 25 nëntor 1913, në Dhërmi.

Shkollën filloren e kreu në vendlindje, ndërsa më 1924 e vazhdoi Shkollën Tregtare në Vlorë, të cilën e mbaroi në vitin 1932. Atje e pati mësues Ernest Koliqin.

Ishte arsimtar, publicist, gazetar e shkrimtar.

Vepra letrare: “Hasta la vista” (1958); “Horizont” (1959); “Qyteti i fundit” (1960); “Shpella e piratëve” (1964); “Një emër në katër rrugë” (1972); “Nata e Ustikës” (1989); “Stina e armëve” (2003), etj.

Ndërroi jetë më 27 dhjetor 1991, në Tiranë.



Petro Marko
(1913 - 1991)

ANALIZË

◆ Lexo dhe interpreto tekstin:

- Përgjigju, si të duket ngjarja në këtë pjesë romani?
- Trego disa paragrafë ku gërshetohen ngjarjet reale dhe ato imagjinare?
- Për cilin qytet bëhet fjalë?
- Çfarë i nxiti fëmijët që të futen në shpellë?
- Çka zbuluan brenda shpellës, pse quhej shpella e piratëve?
- Me çka u përballën fëmijët në shpellë, çfarë zbuluan aty?
- Përshkruaj ndjesitë e fëmijëve gjatë zbulimit të arkës!

◆ Çfarë zbuluan fëmijët në shpellë:

- a). thesar gurësh të çmuar,
- b). fara të thara bimësh,
- c). lule të rralla,
- ç). një libër të vjetër,
- d). njerëz shkurtabiqë,
- d). perla guacash.

◆ Detyrë:

- Tipizo personazhet, përshkruaj karakteristikat e tyre!
- Në veçanti përshkruaj personazhin e Gjonbabës dhe Rusaman El Namsurit - çka përfaqësojnë ata?
- Çfarë mesazhi përcjell pjesa e deshifrimit të shkrimit?
- Bën përpjekje të shkruash një temë të shkurtër, duke i përdorur fjalët sipas gjuhës së librit të gjetur!

Mëso se...

Fragmenti i shkëputur nga romani për fëmijë “Hekurani në Artas” i shkrimtarit Abdylaziz Islami, rrëfen për imagjinatën dhe aventurat e Hekuranit, djaloshit nga Malësia e Sharrit. Është një personazh plot imagjinatë, guxim dhe kureshtje për të zbuluar të panjohurat e botës e për të udhëtuar nëpër vende çudirash.

Imagjinata është proces psikik që ka të bëjë me aftësinë e vetëdijes së njeriut në ndërrimin, përtërirjen dhe gërshetimin e përfytyrimeve të mëparshme, duke i kthyer ato në përfytyrime të reja.

VRERI I GJYSHES

Ishte koha kur ato ditë qenë mbyllur shkollat. Hekurani, i kënaqur me rezultatin e shkëlqyeshëm që kishte arritur në vitin e parë të klasave të larta të shkollës së mesme, në një ditë të bukur të qershorit kishte dalë te shpati i Fëllanzave dhe e vështronte mbarë fushën e Pollogut, si ndonjë det të gjelbër mu në pëllëmbë të dorës.

Frynte një erë e lehtë. Gjethet dridheshin me fëshfërimë. Gjékundi, me një zë gati të prishur, nga të kënduarit e gjatë në muajt e pranverës, u paraqit qyqja në një degë të një lisi të madh.

Hekuranit me atë kukamë i dukej se qyqja i thoshte se ka mbetur kukuqyqe vetëm, iu duk se qyqja e përkillte. Ofshante dhe përpara vetes i këpuste kullosat e gjata, si të donte të bënte shtrak në zabel, për të trasuar ndonjë rrugë përgjékundi. Por ai nuk e kishte mendjen aty. Atë punë e bënte instinktivisht. Me mend fluturonte gjithkrah: herë mendonte për babanë, tek i cili dëshironte të vinte që ta shihte, se kishte vajtur kohë e gjatë prej dhjetë muaj e ca që kur s'e kishte parë. Por, herë edhe te Mirushi, të cilit e që afruar gati t'i mbushte nëntë muaj që kur kishte vajtur e i duhej edhe një vjet e cazë të bënte për t'u kthyer në shtëpi. Por, më së shumti mendtë e tij fluturonin te legjendat, që i mësoi nga Ora e ujërave. I kujtoheshin se legjendat mund të ishin të trilluar nga populli që nga lashtësia, porse në atë trillim i dukej se kishte gjëra më se të vërteta, çudibërëse dhe mjaft bindëse. Nga ato njeriu mund të mësonte shumë gjëra

të vlefshme e të rralla. Thellohej dhe i binte ndërmend se ato legjenda i ka trilluar vetë jeta dhe i shërbejnë për të mirë prapë vetë jetës. “Nuk është se nuk duhet t’u kushtohet kujdes” - mendonte me vete Hekurani.

“Shih, shih, ti sikur nuk u beson legjendave, ë?” - iu qas Floçka Hekuranit, i cili u habit, kur e pa pranë vetes.

“Për legjendat që kam dëgjuar, moj Floçkë, aspak nuk e luhas mendimin tim”.

Megjithatë, ti the se nuk është se nuk duhet t’u kushtohet kujdes. Kjo do të thotë se megjithatë ti dyshon në vërtetësinë e legjendave. Nuk je aq i sigurt, Hekuran”.

“Floçkë e nderuar, jam tepër i kënaqur me shpjegimet e tua në pallatin nënujor të kënetëzës”.

“Domethënë shpjegimet e mia të kanë lënë mbresë, apo jo?”

“Posi, madje shumë, shumë”.

“A dëshiron edhe diçka tjetër prej meje?”

“Kisha dëshirë të dëgjoj ende dhe për harrim, moj Floçkë e dashur”.

Floçka e shikoi me habi Hekuranin, u përqendrua gjëkundi me shikimin e vet e mandej i tha:

“Mbylli sytë dhe mendo diçka pakëz më gjatë”.

Hekurani i mbylli sytë dhe gjatë kohë mbeti duke menduar, po si i tekej ç’të mendonte, i tha:

“Nuk më bie ndërmend, nuk di”!

“Po ku je tash? A s’e sheh se nuk je në vendin e parë, ku rrije vetëm?”

“Nuk e njoh këtë vend. S’e di ku jam, - u habit Hekurani.

Një plak që i kishte mbushur të nëntëdhjetat, vajti para derës së mbretit, po nuk kërkoi të hynte brenda. Tri ditë e tri net shëtiti para derës së tij. Këtë gjë e kishte vërejtur mbreti, dërgon një roje dhe e thërret të vejë në pallat. Atëherë plaku vete te mbreti, e ai e pyet:

“Pse ke ardhur o ti njeri?”

“S’kam ardhur unë, ti më thërrite”.

“Hëm, qenke dhelparak! Ata që kanë ardhur e më kanë kërkuar diçka, nuk janë kthyer më këtej. Thuamë se çka të mundon, o plak i mençur?”

“Meqë ti më thërrite dhe tash po më pyet, unë po të tregoj. Populli është shumë ngushtë. Kërkon që ta zbutësh sadopak ligjin që të marrë frymë pakëz më lirisht”.

“Lidhur me këtë po të tregoj një anekdotë. Disa njerëz të pakënaqur me sundimin e mbretit, ikin nga mbretëria e vet dhe shkojnë e vejnë te një mbretëri tjetër. Atje, mbreti i pyet: pse keni ikur nga mbretëria juaj? Ata thonë: Mbreti ynë na çonte malin ta bënim fushë, gjë që nuk është e mundur, o mbret i mirë. Mbreti i huaj i shikon e u thotë me ironi: “Po mirë, këtu tek unë do ta keni pakëz më rehat, përpiquni këtë fushë ta bëni mal”!

“Sipas kësaj anekdote po më duket se do të vazhdojë edhe më tutje sundimi, e”? – pyeti plaku i urtë.

“Kur populli t’i përmirësojë sjelljet e veta: të mos vjedhë, të mos shajë, të mos gënjejë, të mos spiunojë, të mos tradhtojë, të mos vrasë, të mos shkatërrojë pasurinë, të mos

bëhet lugë çervishi e shkop xhehenemi, atëherë unë do ta zbus ligjin, po atëherë edhe unë do të vdes”.

“Domethënë, ti kërkon që njerëzit t’i përmirësojnë sjelljet e veta negative, të bashkohen e të jetojnë në harmoni?!”

“E ditur, o plak i mençur”.

“Kjo punë do të kryhet” - tha plaku dhe vajti t’i bëjë të njohur njerëzit se kërkonte mbreti nga ata, që ai ta zbuste ligjin.

Fshat më fshat mbajtën mbledhje pleqnarët e fshatrave; kurse pleqnarët e qytetit Pelion nëpër lagjet e tyre. U besatuan se do të bëheshin të sjellshëm. Dhe me të vërtetë u bënë.

Që atëherë nuk u pa më asnjë njeri të varet në mes të qytetit.

Mbreti u bë tevdil, kalëroi atin dhe vajti të shihte se ç’po ndodhte në popull.

Në një vend qenë mbledhur të gjithë fshatarët e fshatrave përreth, që dikur i kishin bërë të nëntëdhjetat, dhanë besën se më s’do të vepronin ashtu. Atje në një lëndinë kënduan e vallëzuan dhe mbretëroi harmonia e vërtetë.

Kur i pa mbreti se ata më nuk do të bënin të këqija, e më cyku kalin të vetë për në qytetin Pelion, po kali u pengua e mbreti ra në një kënetë me kokë në rërë të gjallë. Mbretin e përbiu dalëngadalë rëra e gjallë. Bashkë me të edhe ligjin e tij të ashpër.

Këto ngjarje i shikoi Hekurani e Floçka tha: “Si të duket kjo legjendë”?

“S’ishte legjendë. Kjo ishte realitet”.

“Kjo është vetëm një legjendë e gjallë. Ta kam bërë të mundur ta shikosh, duke e kthyer kohën prapa, në një kohë të moçme”.

“Po tash ku gjendemi”?

“Mu në atë kohë të dikurshme. Mbylli sytë e shohim”.

Hekurani i mbylli sytë dhe ndenji derisa i tha Floçka që t’i çilte. Kur i hapi sytë pa se gjendej në shpatin e Fëllenzave, prej nga koliku e vështronte mbarë fushën e Pollogut.

“Si mendon, a kemi qenë dikund, apo jo”?

„Me gjasë se kemi qenë”.

“Jo. Ke qenë mu këtu. Po si të thashë e kam kthyer kohën mbrapsht, bashkë me atë vendin, ku qe krijuar legjenda”.

Kur i tha Floçka këto fjalë, u zhduk. Hekurani mbeti duke u hamendur.

“Mos u hamend. A nuk ka gjë të vërtetë kjo legjendë”? - e pyeti Floçka, pasi u paraqit përsëri.

“Shumë të vërteta, madje. Këto mbase janë mbajtur në jetë, në teatrin e jetës. Mbase mund të ndodhin tash, po edhe në kohën e ardhme”.

“Ja pra, edhe kjo të qe prej meje, Hekuran. Të falem nderit, Floçkë! Më në fund prej teje e mësova edhe një legjendë, e cila më qe vizuele, posi ajo që ma tregove te pallati nënujore te kënetëza Pasinë e Afrasit”.

I kënaqur Hekurani deshi ende ta pyeste, po Floçka më qe larguar, kushedi se ku.

Filloi të mendonte se a thua ia tregoi Floçka këtë legjendë, apo mbase ia ka treguar dikush tjetër e tash mundësisht, qe dremitur dhe këto gjëra i ka riprodhuar në gjendje të pavetëdijshme, duke iu dukur se pranë tij ka qenë Floçka. Kushedi.

Kishte filluar të pushonte era. Gjethet më nuk fëshfërinin e as qyqen nuk e dëgjoji të këndonte me atë zë të ngjirur, që i ndolli asociacione të zymta për jetën. Para vetes pa një grumbull bari, që e kishte ndukur - ku në gjendje të vetëdijshme, ku instinktivisht. U çua nga vendi dhe u nis dhiarës, që lakadredhej për në fshat. Hapin e qiste në mot njëherë dhe përpara i shtynte guralecët me këmbë, si të donte brengat e veta t'i përzinte nga vetja..."

Dhiarja për nga shtëpia pothuajse nuk kishte mbarim me ato lakadredha dhe me atë hap të rëndë plumb të Hekuranit. Pothuajse të gjitha kujtimet i reprodukoi gjatë asaj rruge, derisa më në fund arriti në shtëpi. Atje i gjeti nënën e vet, Samirën dhe dajeshë Emirën, duke i qëndruar mbi kokë gjyshes Hanë. Atë shpeshherë e zinte vreri. I vinin kompresa në ballë. Pas një kohe ajo u çua në krah e u tha:

"Mori bija, po ç'u paskam bërë kështu, ë"?

"Të ka zënë vreri, moj nënë", - i tha Samira.

"Sot diçka më shumë se para një jave", - i tha Emira e brengosur. "Po shyqyr tash je mirë", - shtoi ajo.

Hekurani shpejtoi te fqinj i shtatë, mori pelin në kopshtin e tyre, pasi ua lypi për gjyshen e vet. Ia solli gjyshes e i tha:

"Gjyshe, të kam sjellë pelin. Duhet ta ziesh si çaj e ta pish pa sheqer. Kurrë më nuk do të zërë vreri", - i tha Hekurani, i cili kishte lexuar në një libër se pelini e derdhka vrerin e mbledhur në stomak.

"Të lumtë, o bir, do ta pi pse është prej teje", - i tha gjyshja dhe e puthi Hekuranin në të dy faqet.

Abdylazis Islami

Fjalorth

përkillte – mallkonte;
çervish - qull;
tevdil - u dorëzua;
xhehenemi - ferri;
lakadredhej - lakohej, përdridhej.

Një nxënës i edukuar, i zellshëm e plot dije nuk konkurron me të tjerët, ai e tejkalon të djeshmen, duke ecur drejt ëndrrës së radhës.

Fryma krijuese artistike dhe shoqërore e Abdylazis Islamit

Romani “Hekurani në Artas” e rrëfen jetën dhe përjetimet e djaloshit Hekuran, i cili rritet me ndjenja të forta dashurie për familjen, shokët dhe vendlindjen. Përmes ngjarjeve të ndryshme, ai përballlet me sfida që e ndihmojnë të piqet dhe ta forcojë karakterin e tij.

Vepra e pasqyron botën e fëmijëve me singëritet, ngrohtësi dhe shpresë, duke përcjellë vlera si: miqësia, ndershmëria, puna dhe dashuria për atdheun. Me gjuhën e thjeshtë dhe rrëfimin tërheqës, romani zë një vend të rëndësishëm në letërsinë shqipe për fëmijë.

Jetëshkrim

Abdylazis Islami lindi më 29 korrik 1930, në fshatin Gajre të Tetovës.

Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse gjimnazin e ulët e kreu në Tetovë, ndërsa Shkollën Normale dhe Akademinë Pedagogjike, drejtimi: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, i kreu në Shkup.

Qysh në shkollë të mesme merrej me shkrime, shkroi: poezi, tregime, drama, romane, eseistikë e kritikë letrare

Veprat letrare: “Këngët e zgjuara” (vjersha), 1968; “Era dhe vargjet” (vjersha për të rritur), 1964; “Oaza” (poezi), 1973; “Gurgurina” (poezi), 1974; “Fatiana” (roman), 1975; “Korrieri Artan Arta” (poemë), 1976; “Agullina” (sonete), 1978; “Përralla popullore nga Sharri”, 1985; “Vajza e panjohur” (roman për fëmijë), 1985; “Hekurani në Artas” (roman për fëmijë), etj.

Ndërroi jetë më 16 gusht 2002, në Tetovë.



Abdylazis Islami
(1930 - 2002)

ANALIZË

♦ Analizo:

- Situatën reale dhe imagjinare në këtë tregim!
- Çfarë figure paraqet gjyshja në fragmentin e dhënë dhe në letërsinë shqipe?
- Si do ta përshkruaje Hekuranin?
- Ndalo pak te patronimet (emrat e njerëzve) dhe toponimet (emrat e vendeve) të përmendura në fragment!
- Si paraqitet mjedisi jetësor, nënvizo disa përshkrime në tekst!

♦ Detyrë:

(Shkruaj në shtëpi detyrën e dhënë)!

A të duket interesante historia që lexove, nëse po, atëherë plotëso pjesët kryesore të përmbajtjes:

Hyrja: _____

Zhvillimi: _____

Kulminacioni: _____

Zgjidhja _____

Përfundimi: _____

♦ Trego:

- Një ngjarje të dëgjuar që ju ka lënë mbresa!
- Trego histori personale nga fëmijëria yte. Dëgjoni njëri - tjetrin (në klasë) dhe vlerësoni historitë e treguara, duke iu përgjigjur pyetjeve të parashtruara.

Mëso se...

Kjo pjesë është marrë nga libri "Udhëtimet e Guliverit" i shkrimtarit anglez Xhonatan Suift. Në ngjarje flitet për udhëtimet e personazhit kryesor, Guliverit, të cilit i përmbytet anija dhe ai gjendet në një ishull ku jetonin liliputët, njerëz me shtat shumë të shkurtër.

Personazhi i skalitur nga shkrimtari, shfaqet si mjeshtër i gërshetimit të ngjarjeve reale me ato fantastike.

Personazhet, të tipizuar me mjeshtëri, përfaqësojnë ide dhe qëndrime të caktuara të autorit për jetën, për këtë arsye, shpesh thuhet se personazhet janë bartës të formës së përmbajtjes. Karakteret, mund të jenë si pozitivë, ashtu dhe negativë, gjë që e reflekton realitetin individual dhe shoqëror, pikërisht se njeriu është pjesë aktive e shoqërisë dhe e shpalos me saktësi këtë realitet.

Heroi a protagonist – është personazhi kryesor, rreth të cilit zhvillohet krejt veprimi i epit.

NË QYTETIN E LILIPUTËVE

Nuk e di se ç'u bënë shokët e mi të barkës, ata që iu qepën shkëmbit, dhe ata që mbetën në anije; po besoj se u mbytën të gjithë: sa për mua, notova më tym dhe për fat më shtyu era nga ana e tokës. U shtriva në një lëndinë, ku bari ishte fare i njomë dhe i butë, si mëndafshi; dhe pas një çikë më mbërtheu një gjumë i rëndë, që s'e kam bërë kurrë në jetë; dhe fjeta pothuaj nëntë orë, sa kur u zgjova, dielli ishte ngritur lart. Bëra të ngrihem, po nuk u ngrita dot; i shtrirë siç isha në kurriz, ndjeva këmbët e krahët i kisha lidhur nga të dy anët për tokë; po kështu ishin lidhur edhe flokët, që i kam pasur të gjatë e të trashë. Madje pashë plot fije shumë të holla rreth trupit, nga sjetullat e gjer te kofshët.

Papritmas ndjeva se më lëvriu diçka te këmba e majtë, nga ku më kaloi ngadalas në krahë e po më ngjitej pak nga pak në mjekër. Pashë një njeri të gjallë, që nuk e kishte shtatin as gjashtë gishtërinj të gjatë që mbante në duar një hark e një shtizë. Po në këtë kohë pash se e ndiqnin pas edhe të paktën një dyzet të tjerë. I habitur siç mbeta, lëshova ca britma aq të forta, sa të gjitha ato krijesa të vockla u larguan të llahtaritura.

Kur pushuan britmat, dëgjova njërin prej tyre që thirri: -Tolgo Fonak- dhe në atë çast ndjeva se ma shpuan dorën e majtë më se njëqind shigjeta të vockla e të holla si gjilpëra. Pastaj lëshuan në erë një breshër tjetër shtizash që më binin në trup, sido që nuk i shikoja, dhe plot të tjera më nguleshin në fytyrë, që përpiquesha t'i largoja me dorën e djathtë.

Kur e panë ata kocomicë se po rrija urtë, i prenë të shtënat, po nga zhurma e poterja, që sa vinte e shtoej, kuptova se edhe ata po roitnin si bleta. Përballë veshit të djathtë, për më tepër se një orë, dëgjova zhurmë njerëzish që punonin. Kur ktheva kokën nga ajo anë, aq sa më lejonin kunjët e kordonat, pashë se kishin ngritur një tribunë ndonjë këmbë e gjysmë të lartë që mund të nxinte nga këta xhuxhmaxhuxhër - dhe nga dy a tri palë shkallë për t'u ngjitur. Së andejmi njëri prej tyre, që dukej njeri me rëndësi, më mbajti një ligjëratë të pasosur, që nuk e kuptova fare.

Iu përgjigja me pak fjalë, po me një theks të përlur, duke ngritur dorën e majtë dhe sytë ndaj diellit, sikur t'i qaja hallin se po vdisja urie, meqë s'kisha vënë gjë në gojë prej shumë orësh, para se të mbytej anija.

Ai zbriti nga tribuna, udhëtoi të vendosnin plot shkallë në të dy brinjët e mia, nëpër të cilat u ngjitën ndo njëqind veta, që pastaj m'u drejtua nga goja, të ngarkuar me kofina plot me mish, që ishin grumbulluar e dërguar atje me urdhër të mbretit, me t'u marrë vesh se kisha arritur unë. Vura re se kishte çdo lloj mishi, nga kafshë të ndryshme, po nuk i dallova dot se ç'ishin kur i shijova. Kishte kofshë, shpatulla, brinjë që dukeshin si prej dashi, të gatuar mirë, por më të vockla se krahët e një lareshe. Gllabëroja njëherësh nga dy a tri të atilla bashkë me tri bukë të mëdha, sa plumbat e pushkës. Tek m'i binin gjithë këto të ngrëna, ata dukeshin shumë të habitur e të mahnitur, që shikonin trupin tim sa një mal dhe atë urinë time të pasosur.

Bëra një shenjë tjetër për t'u treguar se kisha etje; duke parë se s'kisha të ngopur në të ngrënë, ata menduan se edhe etja ime nuk mund të shuhej lehtë dhe gjetën një marifet të bukur: ngritën me mjeshtëri një nga vozat më të mëdha që kishim sjellë me verë, e rrokullisën gjer te dora ime, pastaj e ngritën më këmbë dhe i hapën grykën. E rrëkëlleva njëherësh pa mundim, se nuk kishte më tepër se një gjysmë litër; i përngjante disi verës së Burgonjës, por ishte edhe më e shijshme. Më sollën një fuçi tjetër, e piva dhe ua bëra me shenjë të më binin ca të tjera, po i kishin mbaruar. Si panë që bëra gjithë këto mrekullira, zunë të thërrisnin nga gëzi mi dhe të hidhnin valle mbi kraharonin.

Pas një copë here, kur panë se isha ngopur, para meje doli një nga të parët e vendit, që e kishte dërguar Madhëria e tij, mbreti. Ai e mori vesh që i lutesha të më zgjidhnin, më dha të kuptoja se do të më shpinin ashtu siç isha, po duke m'u zotuar me ca shenja të tjera se do të më jepnin të haja e të pija sa të më shihnin sytë, dhe se do të më mbanin shumë mirë.

Pas pak kohe dëgjova një breshër duartrokitjesh, që ndërpritej dendur nga brohorimat.

Ai popull e ndan qimen më katërsh në matematikë e në mekanikë, shkenca që mbreti i tyre i nxiti e i përkrah. Perandori ka ca makina të mrekullueshme për mbartje, që mund të ngrenë anije lufte (nganjëherë nëntë këmbë të gjata) dhe t'i shpien nga pyjet ku janë ndërtuar, gjer në bregdet. Pesëqind inxhinierë e zdrukthëtarë u ngarkuan të stisnin një prej këtyre makinave, që të më mbartte mua. Ishte një qerre shtatë këmbë e gjatë e katër e gjerë, që mbahej mbi njëzet e dy rrota, e ngritur një gjysmë këmbë nga dheu. Një mijë e pesëqind nga kuajt më të mirë të perandorit më tërhoqën gjer në kryeqytet, sipas nesh, nga gjysmë milje më tutje.

Ecëm pa reshtur tërë ditën e ditës dhe natën e gdhiva në fushë, me pesëqind roja përqark, gjysma me pishtarë dhe gjysma me harqe dhe shigjeta, gati të më gjuanin po të merrja arratinë. Ndaj të gdhirë vazhduam udhën dhe aty nga dreka arritëm afër kryeqytetit. Gjithë oborrtarët, me perandorin në ballë, kishin dalë të më shikonin, po

oficerët madhorë nuk e lanë Madhërinë e tij ta vinte kokën në trastë, duke hipur mbi trupin tim.

Nuk e them dot me fjalë habinë e poteren e popullit, kur më panë që u ngrita e po barisja. Meqë vargonjtë e këmbës së djathtë ishin afro gjashtë këmbë të gjata, jo vetëm mund të veja e të vija në një hapësirë gjysmë rrethi, po kisha mundësi të hyja barkas gjer te dera e madhe dhe të shtrihesha në faltore.

Xhonatan Suift

Fjalorth

liliput-i - njeri me trup të vogël;
gishto iu qepën shkëmbit - u ngjitën shkëmbit
pas një çike,
poter/e-ja - zhurmë e madhe, shamatë;
po roitnin - këtu: po shtoheshin;
kocomi-u - personazh përralle, një fëmijë i
zgjuar, por trupvogël;
tribun/ë-a - vend i ngritur e i zbukuruar para
një sheshi, ku rrinë udhëheqësit
kofin/i - kosh i madh i thurur me purteka;
marifet – mjeshtëri, mënyrë;
faltor/e-ja - vendi ku falen besimtarët;
këmb/ë-a - masë gjatësie, një këmbë është e
barabartë me 30,5 centimetra.

Jetëshkrim

Xhonatan Suift lindi më 30 nëntor 1667, në Dublin (Irlandë).

Qysh si fëmijë, mbetet pa prindër (pas vdekjes së babait, nëna e lë te disa kushërinj) dhe rritet bonjar.

Studioi në Kilkenny, pastaj në Dublin, në Trinity College.

Më 1679, me këshillën e nënës së tij, shkoi në Angli. Ai punoi si sekretar i Sir William Temple. Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Londër.

Veprat letrare: Udhëzime për shërbëtorët” dhe “Ditari i Stelës” (1766 - 1768) iu botuan pas vdekjes.

Krijimtaria e tij ishte plot ndërtime fantastike dhe aftësi imagjinative drejt lexuesit. Prandaj, ironia e dukshme që satira më mizore dhe e përpunuar kundër njerëzimit ka pasur sukses si një libër për lexim të këndshëm dhe është bërë, me prerjet e duhura, një klasik për fëmijët.

Ndërroi jetë më 19 tetor 1745.



Xhonatan Suift
(1667 - 1745)

ANALIZË

◆ Analizo:

- Në çfarë rrethanash Guliveri përfundoi në qytetin e liliputëve?
- Me çka udhëton ai, kush e ndihmon të dalë në breg?
- Cili është reagimi i liliputëve kur e shohin djaloshin?
- Cilat janë disa nga rregullat e liliputëve?
- Çfarë roli i japin Guliverit?
- Krahaso dhe përshkruaj atë me liliputët!
- Çfarë simbolizon qyteti i tyre në raport me botën reale?
- Si e përdor autori satirën për të krijuar shoqërinë dhe pushtetin njerëzor përmes liliputëve?

◆ Detyrë gjuhësore dhe stilistike:

- Çka simbolizon “Qyteti i liliputëve”?
- Gjej shembuj të ironisë ose hiperbolës në tregim dhe shpjego funksionin e tyre!
- Si ndikon gjuha përshkruese e autorit në krijimin e atmosferës në tregim?

◆ Detyrë krahasuese:

- Krahaso figurën e Guliverit si i huaj në Liliput me një person që ndihet “i ndryshëm” në shoqërinë e sotme!
- Krahaso shoqërinë e liliputëve me një shoqëri moderne!
- Çfarë ngjashmëri dhe dallimesh vëreni?
- Përshkruaj virtytet dhe të metat e personazheve!

◆ Detyrë krijuese:

- Imagjino se Guliveri viziton një qytet tjetër, ku njerëzit janë edhe më të vegjël se liliputët. Çfarë mund të ndodhë?
- Krijë një tregim të shkurtër nga këndvështrimi i një liliputi që e takon Guliverin për herë të parë!
- Shkruaj dialogun midis Guliverit dhe mbretit të liliputëve mbi kuptimin e pushtetit dhe drejtësisë!
- Shkruaj ese me temë: “pushteti dhe vogëlsia morale në “Qytetin e liliputëve”.

Drama

Mëso se...

Drama është gjini e letërsisë artistike, që e pasqyron jetën përmes veprimit skenik të personazheve dhe të dialogëve dhe monologëve të tyre. Është njëra nga gjinitë kryesore të letërsisë artistike dhe ashtu sikurse përralla, tregimi e romani, edhe drama ka një ngjarje kryesore.

Drama është teatër i shprehur me fjalë.

Tematika e dramës është e afërt me atë të prozës: temë historike, shoqërore, e dashurisë, heroike, filozofike, etj.

Në kohët e hershme drama shkruhej në vargje, ndërsa sot shkruhet në prozë, pasi proza i ofron më shumë mundësi shprehëse sesa poezia.

Drama e parë origjinale e letërsisë shqiptare merret “Emira” (1885) e Anton Santorit.

Ndër dramat e para, gjithashtu përmenden: “Besa” e Sami Frashërit, “Sofonisba” e Jeronim de Radës etj.

Drama - vjen nga greqishtja dráma - “veprim”), e cila pos epikës dhe lirikës është shtylla e tretë e letërsisë.

Subjekti i dramës

Përmbajtja e dramës përbëhet nga kundërthëniet jetësore midis personazheve, të cilët përmes interpretimit të tyre synojnë zgjidhjen e konfliktit. Këto realizohen në skenë nëpërmjet aktorëve, sipas pikëpamjeve të regjisorit, skenografit dhe kostumografit.

Drama duhet të përmbushë tre elemente të domosdoshme:

- njësinë e veprimit;
- njësinë e kohës dhe
- njësinë e vendit.

Konfliktet e dramës janë konflikte të zakonshme, që dalin nga jeta e njerëzve.

Fazat e zhvillimit të veprimit dramatik

Zhvillimi (kompozicioni) i veprës dramatike përbëhet nga pesë elemente:

1. Parashtrimi (ekspozicioni; nga lat. expositio), pjesa hyrëse në një vepër letrare, që e lidh lexuesin me temën e veprës (prolog).
2. Thurja (kolizioni; nga lat. collisio) përballja, kundërshtimi i personazhit kryesor me personazhet tjera.
3. Kulminacioni - arritja e pikës kulmore të konfliktit dramatik.
4. Peripecia - është kthesa vendimtare e ngjarjeve, që e drejton veprën drejt zgjidhjes (fitorja/triumfi ose humbja e personazhit kryesor).
5. Zgjidhja - shthurja (epilogu) pjesa përmbyllëse e subjektit të veprës letrare, ku zgjidhet konflikti dhe përmbyllet veprimi dramatik.

Vepra dramatike ka përmbajtje konkrete, ku gjithçka përjetohet përmes artit skenik.



Parashtrimi (prologu)
Thurja (konflikti)
Kulminacioni (kulmi)
Peripecia (kthesa)
Zgjidhja (epilogu)

Llojet e dramës

Vepra dramatike, sipas përmbajtjes tematike ndahet në:

- dramë - vepër me karakter serioz (ngjarje historike);
- tragjedi - vepër me karakter tragjik;
- komedi - vepër me karakter komik - qesharak.

Drama është ndërlidhje e veçorive karakteristike të poezisë lirike dhe epike, e krijuar për t'u vënë në skenë, gjë që e lidh ngushtë me artin skenik ose teatrin.

Skena - pjesë e ngritur e teatrit, ku luajnë aktorët a valltarët; tërësia e dekoreve që paraqet vendin ku zhvillohet veprimi i një pjese teatrale.

Dramaturgu është autori i veprës dramatike që krijon dialogë mes personazheve, për të ndërtuar situata të forta dramatike, plot tension dhe ndonjëherë edhe komike, ku gjithçka sillet rreth një ngjarjeje qendrore.

Personazhet janë bartës të veprimit, të ndjenjave dhe të konfliktit, përmes të cilëve zhvillohet ngjarja, që kuptohet si një realitet i drejtpërdrejtë nga publiku.

Vepra ndahet në akte dhe secili akt përmban një seri skenash, që fillojnë me hapjen e perdes dhe mbylljen e saj.

Dramaturgë të njohur të letërsisë sonë janë: Shtjefën Gjeçovi, Mihail Grameno, Kristo Floqi, Andon Z. Çajupi, Sami Frashëri, Gjergj Fishta, Kolë Jakova, Spiro Çomora, Anton Pashku, Hivzi Sulejmani, Kasëm Trebeshina, Teki Dervishi etj.

Mëso se...

Vepra “Emira” njihet si drama e parë shqipe, e shkruar nga Anton Santori.

Ngjarja e dramës tipizon një ambient fshati arbëresh, në Shën Katerinë (Itali), ku autori frymëzohet nga jeta e thjeshtë e fshatarëve të përvuajtur.

Subjekti e trajton dashurinë e dy vajzave të reja fshatare, Emirës dhe Kalinës, të cilat dashurojnë të njëjtin djalë, Mirianin, mirëpo të cilit i rrah zemra për të parën, po këtë e lakmon edhe bariu i derrave të fshatit, Kallonjeri. Midis tyre lindin konflikte, si: përpjekja e Fumelit për zbulimin e bandave të cubave, pengesat ndaj dashurisë së Emirës dhe Mirianit, zilia e Kallonjerit dhe e Kalinës, etj. Të gjitha intrigat realizohen nga Kallonjeri, si personazh negativ, ndonëse në fund triumfon e vërteta dhe mirësia. Kallonjerin e vrasin vetë cubat për poshtërsitë e tij, ndërsa Miriani dhe i ati i tij lirohen nga burgu (të burgosur nga shpifjet e Kallogjerit), si dhe dhjetë cuba pushkatohen.

Drama mbyllet me një fund të lumtur: vendi shpëton prej grabitjeve dhe vrasjeve; Emira dhe Miriani martohen, sikurse edhe Kalina me Albencin.



Drama është një lloj letrar (në rreshta ose në vargje) që shkruhet në formë dialogu për t'u shfaqur në teatër. Ajo përbëhet nga fjalët që thonë personazhet, dhe nga të dhënat për skenën, mënyrën se si flasin dhe si sillen personazhet etj.

EMIRA

Fragment nga drama "Emira" e Anton Santorit

EMIRA (*Kalina u jep ujë dhenve në Krojin e Ftohtë dhe po i këndon një qingji të porsalindur, pastaj vjen Emira*)

Skena 1

KALINA: I lumi ti, Që pa u trëmbur Këcen, o shqerr! Qumshtin dhe barin Saher' e do E gjen, e merr: Njerin dhe tjetrin, Kur s'të pëlqen, E lë tek është Vihe lodron Me bark të ngopur. Plot me hare Ditën e shkon. I par' ti leve...

EMIRA: Ohi, ndrikull Kalinë, Uh!

KALINA: Kush po më thërret?

EMIRA: Ndrikull Kalinë!

KALINA: Dëgjojmë, dëgjojmë!

EMIRA: Ku je?

KALINA: Këtu te Kroj.

EMIRA: Kur erdhe? Nuk të pashë të zbritshe këtej poshtë.

KALINA: S'ka një copë herë që jam këtu. Te ky bar, ja delet po kullosin.

EMIRA: E po si, pa furkë gjënde? Jot ëmë s'të shtërngon të punosh gjithnjë si imja më?

KALINA: Ç'thua, diç zotin edhe ti Emirë? Ajo është një kulshedër, që nuk ngopet kurrë. Po t'ish si thotë ajo, do të donte të përgatis ja një palë çorape ditën. Çdo herë, kur mblidhemi në mbrëmje, të parën të pyetur që më bën është kjo: Punove sot, apo fjete e shtruar në diell, apo në ndonjë hije? Ku e ke çorapin që ke bërë? Unë rri e qetë se po t'i përgjigjesha edhe një gjysmë fjale, m'atë çast do të zihej lufta.

EMIRA: Eh, motra ime, ashtu është bërë jeta, ka më shumë thartira se ëmbëlsira.


KALINA: Veçse thuhet se kush vuan më shumë, e kush më pak.

EMIRA: Moj po kush e di? Më kujtohet se kur isha, të të them, nja tetë a nëntë vjeç, Tata më shpuri ndër Sheshe, atje tek kishim arën; atje ishin burrat që korrnin. Pasi hëngrëm e pimë mezdite, atje nën hijen e një lisi degëgjërë dhe plot fletë, ashtu si ishin, ata zunë të flisnin për mjerimet e kësaj bote dhe, kush duke qeshur, kush duke u tallur, kush duke folur me tamam, për secilin mjerimet e veta ishin më të rënda se të të tjerëve. Kur ja ku ja arriu Eremiti i Shën Pantaleut Motëmadhi.

KALINA: Motro, mba mënd se ku qëndron, dhe ndjemë se po të pres fjalën, po unë do të të rrëfej një të pësuar me këtë; unë tani jam e madhe.

EMIRA: Mëma më tha se ke lindur dy vjet para meje.

KALINA: Sa vjeç je ti?



EMIRA: Mbaroj tetëmbëdhjetë në muajin që po hyn.

KALINA: Popo, ç'thua, moj motër? Unë jam shtatëmbëdhjetë vjeç.

EMIRA: Atëhere, në unë jam dy vjet më e vogël se ti, sa vjeç mund të jem?

KALINA: Njëzet vjeç.

EMIRA: Ah! Ah! Ah! vjetët u nëmëruakan së prapëthi!

Anton Santori

Fjalorth

gjënde - mbete (pa furkë u gjënde);
kulshedër - kuçedër (fig. mitologjike -
gjarpër me 2-13 kokë që hante njerëz dhe
bënde dëme);
në mēruakan - u numēruakan
(numērohen).

Jetëshkrim

Françesk Anton Santori lindi më 16 shtator 1819, në Santa Caterina Albanese, një qytet arbëresh në provincën e Kozencës, në Italinë jugore.

Më 1835, në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, vendosi të bëhej prift për çka edhe u shkollua.


U kthye në vendlindje, ku jetoi dhe punoi si mësues. Më 1885 u caktua si prift në San Giacomo di Cerzeto, një fshat i Cerzetos, ku punoi deri në fund të jetës.

A. Santori shkroi: poezi, romane, shfaqje dhe tregime të shkurtra, gjithashtu i përshtati 112 fabulat e Ezopit dhe një gramatikë shqipe.

Shkroi poemën "Canzoniere Albanese" (Këngëtorja shqipe), një poezi e gjatë lirike kushtuar dashurisë dhe natyrës, pastaj melodramën "Alessio Dukagino", ku rrëfen për jetën e Lekë Dukagjini, një princ shqiptar i cili luftoi kundër Perandorisë Osmane.

Drama "Emira", mendohet se është drama e parë origjinale shqiptare. Në poemën "Vallëzimi i gëzimit të madh", i përshkruan elementet folklorike të kulturës shqiptare si këngë dhe valle popullore.

Ndërroi jetë më 7 shtator 1894, në San Giacomo di Cerzeto, Kalabri.



Anton Santori
(1819 - 1894)

ANALIZË

◆ Kuptimi i përgjithshëm:

- Jep disa të dhëna për shkrimtarin Anton Santori!
- Përshkruaj shkurtimisht ngjarjen kryesore të dramës!
- Pse drama u titullua “Emira”?
- Portretizo personazhin e Emirës!
- Shpjego dialogun midis Emirës dhe Kalinës!

◆ Analizo:

- Konfliktin kryesor të dramës dhe situatat tjera!
- Personazhet tjerë të dramës!
- Bën krahasime midis personazheve!
- Analizo dialogun midis personazheve, ndalo në shpjegimin e konfliktit kryesor!
- Si e përdor autori dialogun për të ndërtuar karakteret dhe për ta avancuar ngjarjen?
- Si ndërlidhen temat në konflikt: dashuria, xhelozia, zilia, miqësia, tradita...?

◆ Detyrë:

- Përshkruaj dramën “Emira”, duke ndërhyrë në disa raste me ndryshime, sipas një logjike personale!
- Monologun e ndonjërit nga personazhet ktheje në ditar (shënim të ndodhive të një dite)!



Mëso se...

Tragjedia, rrjedh nga fjala greke “tragos”, që do të thotë cjac. Si një nga gjinitë më të lashta, e ka prejardhjen nga festat e organizuara në nderim të Perëndisë Dionis, ku përfshiheshin këngë rituale, që simbolizonin përballjen e njeriut me fatin, shpeshherë me fund të dhimbshëm, tragjik.

“Kjo bot’ u çthur! O prapësi o dreq,
Që unë paskam lindur të të ndreq!”
Shekspiri

Qëllimi i tragjedisë, nuk ishte thjesht të tregonte një ngjarje, por të zgjonte ndjenja të fuqishme te njerëzit, duke nxitur përjetime të frikës dhe mëshirës, që i shtynte drejt pastrimit shpirtëror, proces i njohur si katarzë (katharsis).

Subjekti i tragjedisë u ndërtua mbi bazën e këngëve dhe motiveve folklorike, të cilat interpretoheshin nga aktorët dhe kori, që i komentonte veprimet. Temat merreshin nga mitet, përrallat dhe rrëfimet heroike, të cilat përçonin porosi të thella për jetën, vdekjen, nderin dhe drejtësinë.

Tragjeditë trajtonin konflikte të mëdha midis individit dhe forcave të jashtme, si fati, hyjnitë apo shoqëria dhe përballjen e individit me veten në çaste vendimtare.

Tragjediani më i njohur është Eskili, i cili në antikitet, trajtoi shtrirje të madhe tematike, sikurse edhe Shekspiri në kohën e tij.

Në letërsinë shqipe, tragjedia përfaqësohet me poetët dhe dramaturgët si: Andon Z. Çajupi “Burri i dheut”, Mihail Grameno “Vdekja e Pirros”, ndërsa më vonë, në kohën e dy luftërave botërore, do të dallohet Ethem Haxhiademi, me veprat: “Uliksi”, “Akili”, “Abeli”, “Aleksandri”, “Pirrua”, “Diomedi”, “Skënderbeu”, të cilët trajtuan tema kombëtare e historike.

Tragjeditë janë shkruar në vargje dhe në prozë,
me një gjuhë të zgjedhur e stil të lartë.

Rrëfeni një ngjarje tragjike

- përdori elementet përbërëse të veprës dramatike -

(Shkruaj në fletore detyrën e dhënë)!



Mëso se...

Në qytetërimin e lashtë njerëzit u besonin zotave, sikurse në antikitet, që ishte ngritur kult ndaj kryezotit Zeus dhe fronit të tij, në Malin Olimp.

Prometeu, një gjysmëperëndi, edhe pse ishte zotuar se nuk do të tregonte fshehtësi të perëndive, duke e parë gjendjen e mjeruar të njerëzve, u tregoi atyre për përparësitë e zjarrit dhe shumë njohuri tjera për jetën dhe natyrën.


Veprimi i Prometeut e hidhëroi shumë Zeusin (sidomos aftësia e tij për ta parashikuar të ardhmen), pasi nuk i tregoi se kush do ta rrëzonte atë nga froni. Në mllef e sipër, urdhëroi që ta mbërthenin në pranga rreth një shkëmbi, derisa trupin e tij ta dëmtonte dielli e ta shqyenin shqiponjat.

Monolog quhet biseda, të cilën e zhvillon personazhi kur flet me veten (shfaqja e unit personal).

PROMETEU I LIDHUR

- Fragment nga tragjedia "Prometeu i lidhur" e Eskilit

Dhe hesht, veç hesht! Nevojë ju nuk keni
Tani do t'ju rrëfej veç për mjerimet
e njerëzve e shkretë. Si çilimin
dikur nga mendja qenë dhe i bëra
të mjerët njerëz, jo, por që ta dini
ç'dhuratë të vyer atyre u kam bërë.
Më parë njerëzit kishin sy dhe s'shihnin,
i kishin veshët dhe asgjë s'dëgjonin,
si hije ëndrrash krejt të mjegulluara,
të turbullta, të mjera zvarriteshin
nga njëri brez, në tjetrin. S'linin gjë
pa ngatërruar. Nuk dinin as shtëpi
qerpiçi të ndërtonin, se punimin
e drurit nuk e njihnin. Nëpër shpella,
nën dhë, ku s'futej dielli kurrë dergjeshin
si milingonat. Nuk i njihnin shenjat
që stinët i dallojnë në mes tyre:
as dimrin e acartë, as pranverën
plot lule, as edhe verën frutaplotë.
Kështu dikonin djersën kot me kot,
gjersa i pari u tregova lindjen



dhe perëndimin e yjeve, numrat,
që janë shkenc' e shkencave, i shpika
për ta. U dhashë shkronjat, të renditura
pas radhës, duke u forcuar kujtesën,
që është mëma e të gjitha muzave!
I pari unë vura kafshët e egra
në zgjedhë, i mësova si ngarkesa
të mbajnë dhe si t'u shërbejnë njerëzve,
nga punët e rënda duke i shpëtuar.
Dhe kuajt i zbuta e nën frë i vura
për të tërhequr karrot që luks janë
për pasunarët. Jo, askush veç meje
nuk i ka shpikur lundrat krahëlira
që çajnë detin me vërtik. Medet!
Sa shpikje të dobishme bëra unë
për njerëzit, ndërsa për vete s'gjej
mjet për të shpëtuar nga ky kob i madh!

KORI

Mjerim i madh të paska rën' në kokë
dhe s'di të gjesh aspak shpëtim për veten.
Si mjeku që kur vet' e zë sëmundja,
nuk di ç'ilaç i bën atij më mirë.

PROMETEU

Dëgjo më tej dhe fort do të çuditësh
sa mjete dhe mjeshtri të tjera shpika.
Më e madhja është kjo: kur nga sëmundjet
të shkretët njerëz vuanin, kur as barna,
as lëngje për të pirë, as përzierje
për t'u fërkuar nuk kishin që të hiqnin
sëmundjet dhe lëngonin dhe vdisnin
krejt pa mjekim, atyre u tregova
mënyrat, lëngjet se si t'i përziejnë
dhe t'i përdorin kundër çdo lëngatë.
U kam shpjeguar si të parashikojnë
atë që vjen dhe cilat ëndrra dalin
e cilat s'dalin, fjalët që të yshtin;
Kuptimin e shenjave që shikon
një udhëtar kur ecën rrugës dhe
nga ai i prapt i zogjve sqepmëdhenj
me kthetra. U shpjegova tërë huqet
e zogjve, si ushqehen, armiqësohen
dhe duhen; si vallëzojnë tufa-tufa.

e zjarri dhe që fare s'i kuptonin
më parë, ua shpjegova un' atyre.
Po arin, bakrin, hekurin, argjendin
dhe gjithë zejet e dobishme kush
veç meje mund të thotë se i nxori
nga gjiri i nëntokës për dobi të njerëzve?
Askush nuk mund të thotë, po nuk desh
të mburret krejt pa turp. T'i bie më shkurt,
të gjitha artet dhe mjeshtëritë njerëzit
e vdekshëm i mësuan nga Prometeu.

KORI

Sa shumë njerëzit i ke ndihmuar!
Tani nga gjëma veten e shpëto!
Kam shpres' se kur nga prangat të çlirohesh,
me Zeusin vet' do matesh në fuqi.

PROMETEU

Oh, fat' plotfuqishëm s'ka caktuar
nga prangat e mallkuara të çlirohem
më parë se ky trup e shpirt nga mija
mundime e tortura të robtohet.
Se mendja kurrë s'matet dot me fatin.

KORI

Po fatin, cila forcë e drejton?

PROMETEU

Tri Moirat dhe Eriniet që s'harrojnë.

KORI

M'i dobët është Zeusi se ato?

PROMETEU

As Zeusi s'i shpëton dot fatit të tij.

KORI

Më thuaj, për Zeusin fati ç'ka caktuar,
përveç sundimit që s'do sosë kurrë?

PROMETEU

Nuk e them dot, prandaj mos pyesni kot.

KORI

E shoh se një të fshehtë të madhe ke.

PROMETEU

S'ka ardhur ende koha që ta them.

Një rrëfim interesant, që përmendet nga autorët antikë është legjenda se, një shqiponjë hodhi mbi kokën e Eskilit një breshkë, duke e ngatërruar kokën e tij tullace me një shkëmb. Megjithatë, kjo merret si një legjendë, jo një fakt historik i vërtetuar!

Fjalorth


qerpiç - tullë balte e tharë në diell, plitha;
lëngatë - vuajtje e mëdha;
muzat - 9 bijat e Zeusit, që i frymëzonin njerëzit për art e dituri;
Moirat - tri hyjnesha, parashikueset e fatit të njerëzve dhe perëndive;
Erinitë - hyjnesha të hakmarrjes.

Jetëshkrim

Eskili lindi në Eleuzinë, një fshat afër Athinës, rreth vitit 525 p.e.s. Ai është konsideruar si babai i tragjedisë antike, si dhe është quajtur poet i së drejtës.

Veprat e Eskilit janë 90 tragjedi, prej të cilave kanë ngelur: “Lutëset”, “Persët”, “Të shtatë kundër Tebës”, dhe “Agamemnoni”, “Koeforet”, “Eumenidet”, që janë pjesë përbërëse të trilogjisë “Orestia”.

Tragjedia “Prometeu i mbërthyer” është vepër madhështore nga mitologjia, si pjesë përbërëse e një trilogjie, bashkë me dy pjesët tjera: “Prometeu zjarrsjellës” dhe “Prometeu i çliruar”.



Eskili
(525 p.e.s.)

ANALIZË

◇ Bashkëbisedë:

*Lexo fragmentin e tragjedisë “Prometeu i lidhur” të Eskilit dhe rrëfe përjetimet e Prometeut, pas ndëshkimit nga Zeusi.

◇ Analizë:

- Popujt e lashtë besonin në forcën e fatit. Sa ishte e lidhur kjo me hyjnitë ose me natyrën? Vërtetoje këtë përmes vargjeve në tekstin e dhënë!
- Pse Prometeu qëndroi midis zotave dhe njerëzve, duke e nxitur hidhërimin e Zeusit?
- A veproi drejt Prometeu?
- Përshkruaj tiparet e figurës së tij!
- Kush e ngriti Prometeun në hero madhështor?

◇ Përshkruaj me fjalë (epitete) cilësitë e Zeusit dhe Prometeut

(Shkruaj në fletore detyrën e dhënë!)

ZEUSI	PROMETEU
zot/perëndi	gjysmëperëndi

◇ Detyrë:

1. Përshkruaj në fletore vuajtjen fizike dhe gjendjen shpirtërore të Prometeut pas dënimit nga Zeusi.
 - Punimit jepi një mbarështrim kronologjik të ngjarjes!

2. Çka përfaqëson kori, cili është roli i tij në dramë?

- Si i shpjegon vargjet e dhëna:

KORI

Sa shumë njerëzit i ke ndihmuar!

Tani nga gjëma veten e shpëto!

*Kam shpres' se kur nga prangat të çlirohesh,
me Zeusin vet' do matesh në fuqi.*

3. A luan rol kori në ndërgjegjësimin e personazheve për zgjidhjen e konfliktit?

Mëso se...

Vepra dramatike vepron mbi shikuesin me një fuqi të madhe dhe zgjon në vetëdijen e tij gjithfarë mendimesh dhe ndjenjash, e përmes idealit estetik të autorit, e edukon, ia zgjeron horizontin e dijes dhe ia fisnikëron ndjenjat.

Dialog quhet biseda që zhvillohet midis dy ose më tepër personazheve.

ANTIGONA

-Fragment nga tragjedia “Antigona” e Sofokliut

PERSONAZHET

ANTIGONA dhe ISMENA - bijat e Edipit

KREONI - mbreti i Tebës

EURIDIKA - gruaja e Kreonit

EMONI - i biri i tyre

TIRESIA - magjistar i verbër


KORI

ROJA

LAJMËTARI I PARË

LAJMËTARI I DYTË

(Ngjarja zhvillohet në Tebë përpara pallatit të Kreonit).



EPISODI I DYTË

SKENA E TRETË

(Hyn Ismena)

KREONI

(I drejtohet Ismenës.)

Ej, ti që u zvarrite me djallëzi në shtëpinë time,
e fshehurazi më thithe gjakun!

Dy armiq të mi paskam mbajtur pranë
tërë këtë kohë e s'e paskam kuptuar!

Shpejt, pra, më thuaj: more pjesë në atë varrim,
apo betohesh se as për të ditur s'e dije?!

ISMENA

Nëse motra më lejon,
edhe unë them se jam bashkëpunëtore në varrim,
pra edhe unë fajtoje jam.

ANTIGONA

Jo, do të ishte e padrejtë,
ti nuk deshe dhe unë të përbuza.

ISMENA

Përderisa ti motër vuan, unë gati jam
që bashkë me ty një det plot rreziqe të kapërcej.

ANTIGONA

Gjithë të vërtetën e dinë perënditë,
por për mua s'është i mirë ai që vetëm fjalë ka.

ISMENA

Ti, e dashur motër, për ndershmëri s'ma kalon,
ndaj me ty dua të vdes e tim vëlla të nderoj.

ANTIGONA

Ti nuk do të vdesësh me mua, s'ke përse.
Vetëm unë do të vdes, dhe kjo mjafton.

ISMENA

Po ç'e dua unë jetën nëse ty të humbas?

ANTIGONA

Pyet mbretin, ai e di më mirë.

ISMENA

Pse shpirtin me tallje ti motër ma sfilit?

ANTIGONA

Nëse këtë tallje e quan,
atëherë me vuajtjet po qesh.

ISMENA

Motër, si mund të të ndihmoj?

ANTIGONA

Shpëto veten, nuk të kam zili.

ISMENA

E gjora unë! Vallë moskokëçarëse jam
për fatin tënd?

ANTIGONA

Po nuk jemi njësoj,
ti zgjodhe jetën, unë vdekjen.

ISMENA

Unë nuk heshta, i thashë të gjitha.

ANTIGONA

Ne nuk u sollëm njëlloj ndaj së arsyeshmes.

ISMENA

Por të dyja njëlloj fajtores jemi.

ANTIGONA

Oh, bëhu më e guximshme! Ti jeton, ndërsa unë
me kohë kam vdekur e të vdekurve u shërbej.

KREONI

Njëra prej tyre luajti nga mendja,
tjetra e marrë ka lindur.

ISMENA

Mbret, edhe njeriu i mençur
në fatkeqësi e humb gjykimin.

KREONI

Duket që të ka ikur mendja
dhe punë të liga bën bashkë me të ligjtë.

ISMENA

Vallë si mund të jetoj e vetme pa të?

KREONI

Çdo të thotë "pa të"? Ajo tashmë s'është më!
Ti do të dënosh me vdekje nusen e djalit tënd?

KREONI

Ka lëndina të tjera që presin të punohen.

ISMENA

Po a do të puqen në të tillë mënyrë?

KREONI

Djalit unë s'mund t'i jap për grua
një femër të pabindur.

ANTIGONA

O Emon i shtrenjtë, sa poshtë ke rënë!

KREONI

Më turpërove ti dhe kjo martesë.

KORI

Vallë vërtet do t'ia vrasësh të dashurën tët biri?

KREONI

Po, martesës së tyre Hadi do t'i japë fund.

KORI

Me një fjalë, vdekja e saj është vendosur?

KREONI

Kështu them edhe unë, madje sa me shpejt.
(U drejtohet shërbëtorëve.)

M'i sillni, shërbëtorë, të dyja në pallat!

Lidhini dhe të rrinë nën mbikëqyrje,
se edhe trimat përpiqen t'ia mbathin
kur Hadi në jetën e tyre troket.

(Antigonën dhe Ismenën i futin në pallat.)

Sofokliu

Emri i dramaturgut të lashtë, **Sofokliut**, ka një kuptim shumë të thellë (nga bashkimi i dy fjalëve greke) “sophos”: i urtë, i mençur, i ditur dhe “kleos”: lavdi, famë, lavdi e fituar, që do të thotë “i mençur” dhe “i famshëm”.

Jetëshkrim


Sofokliu (Sophokles), lindi në vitin 497/496 p.e.s. në Athinë, pra disa vite para betejës së Maratonës. Për jetën e tij dihen pak gjëra, pasi shumë detaje kanë humbur bashkë me veprat e tij.

Ai është njëri nga tri dramaturgët më të mëdhenj të kohës së tij, bashkë me Eskilin dhe Euripidin.

Shkroi 123 drama, nga të cilat vetëm 7 kanë mbijetuar të plota: “Ajaksi”, “Antigona”, “Gratë e Trakisë”, “Edipi Mbret”, “Elektra”, “Filoktetët” dhe “Edipi në Kolonë”. Si shumë emra të tjerë të lashtë grekë, emri “Sofokli” ka një kuptim të veçantë.

Veprat e Sofokliut kanë një rëndësi të madhe sot për letërsinë, jo vetëm si dëshmi e kohës kur u shkruan, por edhe si vepra me përmbajtje dramash njerëzore dhe mesazhesh të rëndësishme humane.

Sofokliu vdiq në 406/405, në Athinë.



Sofokliu
(497 - 405 p.e.s.)

ANALIZË

◇ Shkruaj ese:

1. “Antigona - sinonin i mbrojtjes së nderit të vëllait”.
2. “Krahaso figurën dhe qëndrimin e Antigonës me ndonjë personazh nga letërsia jonë popullore!
3. “Kur mund të quhet vdekja e lavdishme - përjetësi”?

◇ Shkruaj karakteristikat e personazheve të tragjedisë:

(Puno në fletore detyrën e dhënë)!

ANTIGONA	KREONI	ISMENA	KORI

◆ Detyrë:

- Cili është konflikti kryesor në tragjedinë “Antigona”?
- Kush është Kreoni, shëno karakteristikat e tij?
- Çfarë simbolizon kërkimi i drejtësisë sipas qëndrimit të Antigonës?
- Çfarë ndikimi ka te njerëzit vendimi i Kreonit?
- Si paraqiten raportet midis Antigonës dhe Ismenës?
- Përmes personazheve si Kreoni dhe Antigona, trego si përballen ligji hyjnor dhe ligji shtetëror?
- Përshkruaj një monolog të brendshëm, para se Antigona të dënohet me vdekje!
- Nëse individi dhe pushteti janë gjithmonë në konflikt, atëherë çfarë mesazhi përcjell tragjedia?

Mëso se...

Komedia, sikurse tragjedia është lloj i lashtë i gjinisë dramatike, i njohur qysh në kohën e antikitetit. Rrjedh nga fjala greke komedios - lojë argëtuese, zbavitëse, që lidhej me këngët dhe vallet rituale që luheshin në nderim të Dionisit, perëndisë së verës e të gëzimit. Në fillim, komedia kishte karakter zbavitës, më vonë mori edhe karakter shoqëror.

Komedia i bën njerëzit të qeshin, por i lë të mendojnë.

Komedia është gjini letrare që karakterizohet me shpalosjen e situatave të përditshme në mënyrë humoristike, shpesh me një fund të lumtur. Në këtë mënyrë argëtohej publiku, veçmas kur dëgjonte barsoleta dhe shaka, nëpër festa të rrugës dhe shfaqje të improvizuara.

Qëllimi kryesor i komedisë ishte që ta zbaviste publikun, si dhe ta edukonte, duke vënë në pah të meta apo dukuri negative, si: dyftyrësia, gënjeshtria, xhelozia, koprracia, mendjelehtësia etj.

Komedia përshkruan edhe histori dashurie ose konflikte familjare, kurse personazhet ishin përgjithësisht të klasës së mesme ose të ulët.

Qeshja në komedi është mënyra më e butë për të thënë një të vërtetë të hidhur.


Skena komike realizohej nga aktorë të maskuar (comos - të veshur në mënyrë qesharake), të cilët interpretonin këngë kushtuar Dionisit dhe ripërtëirjes së pranverës që shoqëroheshin me gosti, ushqime e pije... pra këngë gastore dhe shpoti.

Komedia u zhvillua në teatrin romak gjatë Mesjetës dhe Rilindjes, kur dramaturgët evropianë shkruajtën shumë komedi.

Ritregoni një ngjarje qesharake

- përdori elementet përbërëse të veprës dramatike -

(Shkruaj në fletore detyrën e dhënë)!



Mëso se...

Në komedinë “Koprraci”, Molieri demaskon fuqinë shkatërruese të parasë dhe e godet koprracinë, si ves shumë i ulët njerëzor (antihuman) që ishte tipar karakteristik i borgjezisë në zhvillim. Ai e dënon si një ves me pasoja shumë negative për individin, familjen dhe shoqërinë.

Personazhi kryesor - Harpagoni ishte njeri koprrac e fajdexhi që jetonte nën ethet e parave. Nga lakmia për paranë, ai e kishte humbur dinjitetin dhe ndjenjat prindërore, njëkohësisht edhe dashurinë e fëmijëve. Fëmijët, jo vetëm që nuk ndjenin kurrfarë dashurie për të, por edhe e urrenin. Harpagoni mbetet një nga figurat më negative, antipatik e dorështrënguar, njëkohësisht edhe tepër qesharak, ndër më komikët që ka krijuar mendja dhe pena e komediografit francez, Molierit, si dhe një nga dramaturgët më të mëdhenj botëror.

Vepra dramatike ndahet në akte dhe secili akt përmban një seri skenash që fillojnë me hapjen e perdes dhe mbylljen e saj. Ngjarjet zhvillohen përmes monologëve dhe dialogëve midis personazheve.

KOMEDIA “KOPRACI” - MOLIERI

-Fragment nga komedia “Koprraci” i Molierit

Skena II

KLEANTI, ELIZA

KLEANTI. Sa gëzohem që po të gjej vetëm, motër!

Nuk më durohej sa të të shihja, se dua të të besoj një të fshehtë.

ELIZA. Folë, vëlla, po të dëgjoj, ç'ke për të më thënë?

KLEANTI. Shumë gjëra, motër, që përmbledhen në këtë fjalë: dashuroj.

ELIZA. Dashuron?

KLEANTI. Po, dashuroj. Por para se të zgjatem më tej, e di që varem nga një baba dhe që - si bir i tij - jam i detyruar t'i nënshtrohem vullnetit të tij. E di që nuk duhet ta japim zemrën tonë pa marrë pëlqimin e atyre që na nxuarën në dritë; që perëndia i ka bërë ata zotër të dëshirave tona dhe që këto s'mund t'i përdorim veçse me urdhër të tyre. E di që ata, pasi nuk nxiten nga ndonjë pasion i çmendur, janë në gjëndje të gabohen më pak se ne dhe ta shohim më qartë të mirën tonë; që i duhet besuar më shumë urtësisë së tyre se sa pasionit tonë të verbër; dhe që të nguturit që tregojmë ne të rinjtë mund të na përplasë nëpër gremina të rrezikshme. Po t'i them të gjitha këto, moj motër, që të mos marrësh mundimin e të m'thuash ti; sepse, në fund të fundit, dashuria ime nuk do të dëgjojë asgjë, dhe të lutem të mos më qërtosh aspak

ELIZA. A ja ke dhënë fjalën asaj që dashuron, vëlla?



KLEANTI. Jo, po e kam vendosur. Dhe po të lajmëroj përsëri të mos përpiqesh të më ndrosh mëndjen me arsye time.

ELIZA. Pse, vëlla, kaq tuafe më bën mua?

KLEANTI. Jo, motër, po ti nuk dashuron; nuk e njeh atë prangën e ëmbël që u ve zemrave tona dashuria e zjarrtë dhe dyshoj për urtësinë tënde në këtë rast.

ELIZA. Oh! vëlla. Le të mos flasim për urtësinë time. S'gjen njeri që të mos i mungojë, të paktën një herë në jetën e tij, e po të të hapja edhe unë zemrën, ndofta do të isha në sytë e tu shumë më pak e urtë nga ti.

KLEANTI. Ah! dashtë Zoti që edhe zemra jote si e imja...

ELIZA. Le të mbarojmë më parë punën tënde dhe më thuaj kush është ajo që dashuron ti.

KLEANTI. Një vajzë e re që banon prej pakë kohësh në lagjen tonë. Duket sikur ka lindur për t'u falur dashuri të gjithë atyre që e shohin. Natyra, moj motër, s'ka bërë krijesë më të dashur dhe unë u çmënda pas asaj qëkur e pashë. Quhet Marianë. Rron bashkë me nënën e saj plakë, që është pothuajse gjithmonë e sëmurë. Kjo vajzë e dashur përgjërohet aq shumë për të, sa s'mund ta marrësh me mënd. I shërben, i qan hallin dhe e ngushëllon me një butësi që të prek thellë në zemër. Çdo punë që të bëjë, i bije një nur i këndëshëm sa s'ka dhe lëvizjet e saja janë tërheqëse e plot hijeshi. Është aq e ëmbël sa s'të bëhet t'ikësh, aq zemërmirë sa të bën borxhli, aq e ndershme sa të vjen ta adhurosh... Ah! moj motër, veç ta shikosh.

ELIZA. - Nga gjithë sa më tregove, vëlla, e marr me mënd fare mirë dhe, për të kuptuar se si është, më mjafton që ti e dashuron.

KLEANTI. Kam dëgjuar nga të tjerët se nuk janë në gjendje fort të mirë dhe se me mundim të madh i përballojnë të gjitha nevojat. Merre me mënd, motër, sa gëzim të madh ndjen njeriu kur ngre lart gjendjen ekonomike të asaj që dashuron; kur i jep tërthorazi ndonjë ndihmë të vogël për t'i lehtësuar hallet e jetesës një familjeje të ndershme. Mendo se sa i dëshpëruar që jam, pasi nga

kopracia e tim eti, zemra ime nuk mund ta ndjejë e ta shijojë këtë gëzim; as, t'ia shprehë dot dashurinë e madhe që ushqen për të.

ELIZA. Po, e kuptoj fare mirë, vëlla, sa i madh është dëshpërimi yt.

KLEANTI. Ah! motër, është më i madh nga ç'mund të pandehet. Sepse, në fund të fundit, a ka gjë më të pashpirt nga ky kursim i ashpër që bëhet mbi kurrizin tonë. Nga kjo thatësi shpirtërore që na bën të lëngojmë? E ç'kuptim ka të kemi pasuri kur kjo nuk mund të na shërbejë në moshën më të bukur, kur jemi të detyruar, për të plotësuar nevojat më të ngutshme, të mbytemi në borxh, e kur, për t'u veshur si duhet, jam i shtrënguar të kërkoj, bashkë me ty, ndihmën e tregtarëve? Kam dashur të të flas, pra, që të më ndihmosh për t'i parë mëndjen babajt për këto ndjenja që të çfaq; e në qoftë se e shoh që s'bindet, kam vendosur të shkoj në vise të tjera me atë vajzë të dashur, në mëshirën e fatit tonë. Për këtë qëllim kam dërguar të kërkoj të holla borxh nga të katër anët. Në qoftë se punët e tua, motër, janë të njëllojta me timet dhe po qe se u dashka që babaj t'i kundërshtojë dëshirat tona, do ta braktisim që të dy dhe do të shpëtojmë nga ajo tirani, ku na mban prej kohësh koprracia e tij e padurueshme.

ELIZA. - Vërtet që ai po na e bën përditë e më të ahme vdekjen e nënës të gjorë, dhe...

KLEANTI. - Po i dëgjoj zënë. Le të largohemi pak, sa t'i japim fund bisedës sonë dhe pastaj do të bashkojmë forcat tona e do të vijmë të sulmojmë karakterin e tij të ashpër.

Molieri

Jetëshkrim

Zhan Baptist Poklen - Molieri lindi më 15 janar 1622, në Paris.

Është një ndër figurat më të ndritura të letërsisë botërore që hodhi themelet e komedisë franceze.

E formon trupën prej nëntë aktorësh, të cilën e quan "Teatri mbreteror". Ishte: aktor, regjisor, drejtues trupe dhe autor tekstesh. Jeta e tij ishte e lidhur ngushtë me teatrin.

Veprat dramatike më të njohura janë: "Tartufi", "Don Zhuani", "Mizantropi", "Kopraci" dhe "Borgjezi fisnik".

Molieri mbetet njëri nga dramaturgët më të mëdhenj botërorë.

Vdiq më 17 shkurt 1673, në Paris, Francë.



Zhan Baptist Poquelin
(1622 - 1673)

ANALIZË

◆ Analizo:

- Temën e lakmisë për pasuri në komedinë “Koprraci”!
- Si e përdor Molieri humorin për ta kritikuar tiparin e koprracisë?
- A ka ndikim Harpagoni me sjelljen e tij, te familja dhe njerëzit përreth?
- Cilat janë tiparet dalluese të koprracisë te personazhi i Molierit dhe përgjithësisht në jetë?
- Si mund të përshkruhet një njeri dorështrënguar si Harpagoni?

◆ Përshkruaj:

- Situatën konkrete ku shfaqet lakmia për pasuri e Harpagonit!
- Mesazhin satirik që përcjell autori për shoqërinë!
- Raportin e personazhit kryesor me personazhet tjerë!
- Si është marrëdhënia e Harpagonit me fëmijët, shpjego arsyen kryesore?
- Pse Molieri e përdor ironinë dhe sarkazmin, çfarë dëshiron të vërë në pah me kritikën e tij?
- Cila është porosia kryesore që përcjell vepra “Koprraci”?
- Virtytet dhe të metat e disa personazheve, duke u përqendruar në veprimet e tyre!

◆ Detyrë:

(Shkruaj në fletore detyrën e dhënë)!

Shkruaj ese me temë:

- “A është Harpagoni viktimë e vetes apo e shoqërisë”?
- “Individë si Harpagoni, a janë të rrezikshëm për shoqërinë”?
- “Paraja - burim i komedisë dhe i konfliktit në veprën “Koprraci”!



Mëso se...

Komedia “Pas vdekjes” e Andon Zako Çajupit është një komedi politike ku me anë të situatave komike, të gjetura në realitetin jetësor dhe të ndërlidhura bukur artistikisht, përshkruan me sarkazëm portretin e politikanit që bën lojën e xhonturqve, në gjirin e lëvizjes patriotike shqiptare.

Shkrimtari, me këtë komedi, solli një ndihmesë me vlerë në zhvillimin e këtij lloji në letërsinë shqiptare.

ZENELI, PASTAJ ZONJEZA LULUSHE

-Fragment nga komedia “Pas vdekjes” e Çajupit

ZENELI (vetëm): Adham-Uti dotë kënaqet fort: ca njers, kur shonë gjë-send të shtypur, e quajnë të vërtetë, si ungjill e koran... i marroftë Zoti!... (*Zonjëza Lulushe hyn duke thënë. Mirë dita Zenel!*).

ZENELI: Qofsh zonj' e madhe! im zot s'ka dhe ardhur, po rri t'a preç pakëz se mund të vijë. Dhe që të mos mërzitesh duke pritur, shko e rri pranë truezës dhe këndo do shkrime a gazeta, sa të ndërtoj pak odën.

ZONJA LULUSHE (*duke parë shkrimet, gjeti artikullin e Haxhi Aliut dhe briti*): Haxhi Aliu pa ska vdekur! fat ziu deputet! sa keq më vjen!

ZENELI: Mos të vijë kaqë rëndë zonjëzë, se kemi shpresë...

ZONJA LULUSHE: Shpresë! shëronjësit mos dot' a ngjallin përsëri!

ZENELI: A! në pritshin nga shëronjësit.

ZONJA LULUSHE: Po ahëre?...

ZENELI: Haxhi Aliu s'ka dhe vdekur!

ZONJA LULUSHE: Zoti e shpëtoftë! Burr' i mirë, si kam ndëgjuar të thonë. Po kur s'paska vdekur/pse kini bërë këtë shkrim vdekje?

ZENELI: Se është në buzë të varrit dhe ja bë më gati jetë-shkrimin që të mos ndodhemi gafil kur të vdesë!

ZONJA LULUSHE: Po n'u shëroftë?


ZENELI: Ahëre shkrimi vlonet këtu bashkë me të tjerë dhe botonet kur t'i vijë sëral... Duet të dish, moj zonjëzë se njerstë me rëndësi, burra a gra qofshin, kanë këtu gati shkrimin për ditën e vdekjesë, si mbretret, mbretëreshat, deputenjtë... se nukë diet kur e përdredhin... bishtin!

ZONJA LULUSHE (*me zëmërim*): I bukur zakon ky? U hiqni të mbarën!

ZENELI: S'u bëjmë të keqe... i lëmë të vdesën kur të duan. Neve kemi detyrë të bëhemi gati që të mundim t'i lëvdojmë pas vdekjes.

ZONJA LULUSHE: Thuaj si të duash: nukë dolë më vinte mirë fare, unë gjall' e me të gjallë, të kem gati shkrimin e vdekjes?

ZENELI: Oh! për një grua si zotnin tënde, mos pande se im zot s'ka bërë gati



një shkrim!

ZONJA LULUSHE: Ka shkruar dhe për mua?

ZENELI: S'ka dyshim se nukë je e pakët...

ZONJA LULUSHE (*me vetëhe*): Ç'mund të ketë shkruar për mua? më ka lëvduar? më ka sharë? Ç'mund të thonë për mua kur dotë mos jem në jetë? (*te Zeneli*): Beson ti Zenel se kanë shkruar dhe artiklin t'im që tani?

ZENELI: Në besoj, thotë! e di fort mirë... si bukën që ha...

ZONJA LULUSHE: Ndëgjo pra, të lutem!

ZENELI: Folë, zonjzë, ç'urdhëron?

ZONJA LULUSHE: A mund të m'a tregosh?

ZENELI (*shtiret se s'kuptëton*): Ç'të të tregoj?

ZONJA LULUSHE: Shkrimin e vdekjesë!...

ZENELI (*tund kokën*): Punë që s'bënet.

ZONJA LULUSHE: Pse?

ZENELI: Se dotë ndëgjoj fjalë të tharta!...

ZONJA LULUSHE: Të lutem, Zenel, për mua...

ZENELI: Kërko gjë-send tjetër, po këtë jo, kurrë! im zot dotë më kërrejë nga klubi! jo, jo!...

ZONJA LULUSHE: Qysh dot' a msojë? Vetëm t'a këndoij dhe pastaj vëre prapë ndë vend. Për këtë mundim ke pesë mexhite!

ZENELI: Pese mexhite, the? ndërron fjala! punë që bënet, paça Zonë!

ZONJA LULUSHE: Të lumtë! Më kënaqe! Tani vete me vrap të tboj qeren që më pret jashtë se sho një mike të sëmurë dhe ti kërko, kërko... mos humb kohën, më rrofsh! (*del*).

Andon Zako Çajupi



Përshkruani ngjarjen e komedisë “Pas vdekjes” të A. Z. Çajupit

- përdori elementet përbërëse të veprës dramatike -

(Shkruaj në fletore detyrën e dhënë!)

Temat:

- Shpjego gjendjen shoqërore të kohës së autorit dhe faktorët ndikues.
- Përshkruaj formimin psikologjik të personazheve.
- Analizo porosinë e shkrimtarit, duke treguar rëndësinë e saj.



ANALIZË

◆ Lexo fragmentin dhe përgjigju:

- Ku zhvillohet ngjarja e fragmentit të dhënë?
- Cilët janë personazhet që marrin pjesë në dialog?
- Çfarë lajmi lexon Zonja Lulushe në gazetë?
- Përshkruaj reagimin e Lulushes kur e kupton situatën e pazakonshme!

◆ Analizo:

- Pse kjo vepër konsiderohet komedi satirike?
- Çfarë kritikon Çajupi përmes personazhit të Zenelit?
- Si paraqitet figura e gazetarit, çfarë duhet të përcjellë ai për shoqërinë?
- A mendon se është e drejtë që të përgatitet paraprakisht shkrimi për vdekjen (nekrologjia) e një personi?
- Nëse do të ishe në vend të Zonjës Lulushe, si do të reagoje?
- Cili nga personazhet të pëlqen?

◆ Gjuha dhe stili:

Gjej në tekst:

- një dialog,
- një ndërhyrje skenike,
- një shprehje ironike.

◆ Diskuto:

- A duhet gazetaria të udhëhiqet gjithmonë nga e vërteta dhe etika, apo ndonjëherë mund të “rrëmbehet” nga trendi dhe risitë e ngjarjeve?
- Bashkëbisedo me shokët e klasës!

◆ Detyrë:

(Shkruaj në fletore detyrën e dhënë)!

- Krijë në mënyrë individuale
- Shkruaj një dialog të shkurtër (7-10 kundërvënie) midis Zenelit (në rolin e një gazetari) dhe një personazhi tjetër, të cilit gazetari do t’ia shkruante nekrologjinë!
- Shkruaj shkurtimisht (5-6 fjali) çfarë porosit morët nga ky fragment?

Të shprehurit dhe krijimtaria

Shkrimi artistik shndërrohet në univers të veçantë, ku fjala është më shumë se mjet shprehës, është art i fjalës!

Të shprehurit dhe krijimtaria, nuk është vetëm një rubrikë e veçantë, por është proces i vazhdueshëm në krijimtarinë letrare. Ajo njeh hartime ose shkrime, të cilat kanë afri të madhe me letërsinë dhe shkencën, prandaj edhe janë quajtur lloje letrare - shkencore, pasi përmbajnë veti të letërsisë dhe të shkencës.

Këto lloje shkrimesh, me artin letrar, i përafron pasqyrimi i ngjarjeve dhe dukurive të ndryshme dhe përfytyrimi i personave. Ky pasqyrim, përshkruhet me ndjeshmëri dhe gjallëri, plot përjetime e ndjesi të fuqishme.

Shkrimi është një akt krijimi me fjalë të zgjedhura e të bukura, që synon të prekë ndjenjat dhe mendimet, përtej të zakonshmes. Kjo e bën gjuhën të jetë artistike, apo poetike, pra e veçon nga llojet tjera shkencore.

Dallojmë një tog shkrimesh: letra, kronika, fjalimi, ditari, memoaret, udhëpërshkrimi, reportazhi, biografia, nekrologjia, autobiografia, fejtuni, eseja etj.

Shkrimtari/autori - është krijuesi i këtyre shkrimeve, në të cilat përshkruan individë, ngjarje ose dukuri të ndryshme, ku i shpreh ndjenjat, mendimet dhe kujtimet e veta. Krijimet letrare, duhet të jenë përshkrime ngjarjesh reale dhe jo trillime, siç mund edhe të sajojë shkrimtari, pra imagjinata e tij nuk e ka lirinë e plotë sikurse në tekstin letrar artistik.

Gjuha dhe stili i këtyre krijimeve, sikurse edhe i veprave letrare, duhet të jenë reflektim i plotë i realitetit. Ato shkruhen me gjuhë të zgjedhur, të stolisur me një varg tropesh dhe figurash stilistike.

22 Nëntori
Dita e Alfabetit

TË SHKRUAJMË LETËR

Të shprehurit me shkrim është i shumëllojshëm.

Letra - është një mënyrë e zakonshme e komunikimit, si përvojë e hershme njerëzore, e cila është përdorur me qëllim njoftimi për disa ndodhi (për veten, për të tjerët në mjedisin shoqëror dhe për shumë arsye të ndryshme jetësore).

Sipas përmbajtjes dallojmë:

- Letër personale - jozyrtare (letra miqësore drejtuar njerëzve të afërt: farefis, miq, shokë);
- Letër - dokument zyrtar, që kryesisht janë letra pune dhe i dërgohen dikujt zyrtarisht apo një institucioni, për të shkëmbyer të dhëna/informacione (lutje/kërkesë, ankesë, reagim, letërshoqëruese, letër falënderimi etj).

Letrat personale - jozyrtare

Letrat personale - jozyrtare shkruhen në mënyrë të kujdesshme, pasi ato e shfaqin personalitetin e atij që shkruan. Përmbajtja e tyre duhet të ketë një renditje logjike, nga hyrja deri në përfundim, të shkruhen me kujdes dhe bukur, me gjuhë të zgjedhur artistike, dhe të vendosen përshëndetjet përkatëse në fillim dhe në mbarim të letrës.

Letrat personale fillojnë me shprehjet: *e dashur/i dashur dhe mbarojnë me shprehjet: me dashuri, përqafime, përzemërsisht...* etj.

Letër

Pranverë, 15 maj 1699

I dashur shok,

Po të shkruaj nga një vend i çuditshëm, i quajtur Liliput, ku gjithçka është e vogël, përveç krenarisë dhe dëshirës për pushtet. Banorët këtu janë sa një pëllëmbë, por sillen sikur sundojnë botën. Më kanë lidhur si gjigant, por njëkohësisht më trajtojnë si mjet për interesat e tyre.

Ky qytet më ka mësuar se madhësia e trupit nuk ka lidhje me madhësinë e mendjes apo të shpirtit. Njeriu mund të jetë i vogël në shtat, por i rrezikshëm në ambicie.

Me shpresë se do të kthehem së shpejti,
Guliver

Letër falënderimi

Tetovë, 10 qershor 1992

E nderuar mike,

Dëshiroj të të shpreh falënderimet e mia të singerta për ndihmën, mirësinë dhe mikpritjen që tregove!

Mbështetja jote ka qenë e çmuar për mua dhe do ta kujtoj me respekt e mirënjohje.

Me respekt,

Agnesa F.

Letrat zyrtare

Letrat zyrtare shkruhen me një përmbajtje më të formësuar, të prerë e konkrete, pasi ato ndryshojnë nga letrat miqësore. Në to, shpesh vendosen fjalë të caktuara, veçmas të përshëndetjet.

Këto letra, zakonisht u shkruhen institucioneve ose përfaqësuesve të tyre, për të marrë ose dhënë informacione të duhura. Është e domosdoshme që në krye të letrës të vendoset emri i institucionit, të cilit i drejtoheni, adresa e faqes (e-mail, fax ose numër telefoni). Ndryshe, këto quhen “letra me kokë”, pasi në krye të tyre shpesh vendoset edhe stema ose logoja e institucionit. Poshtë, vendoset data, marrësi i letrës dhe përshëndetja.

Letrat zyrtare fillojnë me shprehjet: *e nderuar/i nderuar ose z./znj.* _____ dhe në fund shkruhet: *Me respekt* _____.

Kuvendit të Qytetit
Zyra e lojërave

I nderuar zotëri,

Po ju drejtohem me një ankesë për këndin e lojërave në rrugën “Iliria”. Vetëm javën e fundit kanë ndodhur dy aksidente. Vëllai im Albi, ra nga rrëshqitësja dhe e theu krahun.

Do të isha shumë e kënaqur, po të bënit diçka për këndin tonë të lojërave.

Me respekt,
Jeta Martiri

→ adresa

→ përshëndetja

→ përmbajtja
e ankesës

→ mbyllja
dhe nënshkrimi

Letër - dokument zyrtar (lutje - kërkesë)

UNIVERSITETI I TETOVËS
FAKULTETI I FILOLOGJISË
GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

Nr. _____, Tetovë
Tel. _____ Fax. _____

KËRKESE / LUTJE

Shkrimtari, meqenëse merret me shkrime, ndryshe quhet - letrar.

Letërkëmbimi - është proces i këmbimit të letrave me dikë, pra tërësia e letrave që është shkëmbyer (dërguar - pranuar) nga dy e më shumë njerëz. P.sh.: Letërkëmbimi i shkrimtarëve të ndryshëm, si: Fan Noli, Sami Frashëri, Asdreni, Migjeni, De Rada etj.

Letërpërcjellëse - fletëshoqëruese - quhet një lloj letrë shtesë që i bashkëngjitet një dokumenti.


Letërprurës (postier - bartës i letrës) - quhet personi që e dërgon apo e sjell letrën.

Formati i letrës - letra zakonisht ka format A4 (sa një fletë e madhe fletoreje).

Telegrami

Telegrami është njoftim ose lajm që jepet me anën e ndërlidhjes telegrafike; fletë që përmban një njoftim a lajm të shkurtër.

Mund të jetë telegram përshëndetjesh, urimesh, falënderimesh, ngushëllimesh etj.



NANË E DASHTUN!

Rruga e jetës na pruni deri këtu. Zor sa të duesh. Po kollaj, s'ka qysh bahet ma kollaj. Ti vetë sa e sa herë, në prag të gjumit, kur ishim fëmijë e kur kishim dalë prej lojname të fëmijës, na ke kallxue përralla që kanë të njëjtin përfundim: rruga e nderës asht ma e zorshmja, po ma e mira dhe e vetmja rrugë e vërtetë për njeriun. Dhe, kush u mundue për nder, nder ka gjete! Sot, në vjeshtën e kësaj rruge, kur spo kemi qysh me i dhanë gjevap bereqetit kaq të pasun, farën e të cilit e kemi mbjellë vetë, kush lodhet i pari mundet me thonë: a vyen me luftue për nder, tuj i ngarkue vetit kaq të liga në shpindë?!'

Unë, besoj, nanë, se ti nuk je ajo që thotë kështu. Ti gjithmonë u ke përballue burrnisht rrebeshëve të mëdha. Unë besoj se ti nuk je lodhë. Rruga jonë, mendja e shpirtit ynë kanë pasur strofull fjalën tande, dashurinë e kujdesin tand të pashoq. Kur i kujtoj këto, më del se ti, në vend se të mërzhitesh, duhet të gëzohesh e të përtërihesh. Ma në fund, veç tuj mos u dorëzue në këtë kohë të vështirë, ti nanë, do ta qitësh edhe hapin tand të fundit burrnor, që të bon si të gjitha si të gjitha ato nana trimnesha e fisnike shqiptare, të cilat, kur e ka lypë puna e vatanit, s'e kanë kursye e s'e kanë kaptë me lot jetën e djemve të tyre dhe kanë këndue kur kanë kukatë qyqet.

Jam shumë i lumtun që për këtë pikë, pra, për mërzhinë tande, shpirtin e kam të fjetun. Ti je një lis, që nuk don me ditë për fërflazat e forta. Bile, një lis, madhështia e të cilit del në pah bash kur merr mot me fërflazë. As bora, as ngricat e mëdha nuk të kanë ba kurrë shejë.

Pse, pra, dridhesh aq fort prej lagshite e prej bryme?

Në përfytyrimet e mia të gjalla, këtu në tretdhë, të shoh tuj ecë me atë krejninë tande të pashoqe, sa herë që nisesh me e pa djalin tand në burg, e rrugës të bjen me u shpërndrue me anmiq të mëdhenj e të vegjël të pjellës sate. Le të pëlcase anmiku, gjithë ai që e ka ba synin qorr e veshin shurdh kur e do puna me luftue për nderën, për ato që ti jau ke kushtue jetën e shëndetën. Dhe dije se krejnia jote përballë fërflazës së sotme, asht helmi ma i fortë për anmikun.

Jusuf Qërwalla

(Letër e dërguar nënës, nga poeti e atdhetari shqiptar Jusuf Qërwalla).



ANALIZË

◇ Shpjego përmbajtjen e letrës:

- Kush është autori/dërguesi i letrës, portretizo atë!
- Për kë është shkruar ajo letër?
- Ku ndodhet djali që i shkruan nënës?
- Si fillon dhe si mbaron letra?
- Çka të pëlqen më shumë në këtë shënim?
- Trego ngjashmërinë e kësaj nëne me nënat tjera shqiptare!
- A ka përdorur autori stil të veçantë, nënvizo pjesët që e dëshmojnë stilin e tij!

◇ Gjuha:

- Në cilin dialekt është shkruar letra, nënvizo disa fjalë!
- Sa prej atyre fjalëve i përdor edhe ti?
- Gjeni figurat krahasuese që e përshkruajnë figurën e nënës!

◇ Në letër përdoren shprehje të veçanta e të ndërlidhura këndshëm, sikur krijojnë një bashkëbisedim midis nënës dhe djalit

- Gjej disa nga këto shprehje dhe shëno në fletore, pastaj me fjalët e njëjta formëso pesë (5) fjali!
- Cilat janë fjalët përshëndetëse, të cilat vendosen në fillim dhe në fund të letrës miqësore?

◇ Detyrë: (Shkruaj në fletore detyrën e dhënë)

Përdore imagjinatën dhe shkruaj një letër shoqes/shokut apo ndonjë anëtar të familjes tënde!

TREGIMI DHE RITREGIMI

Për shkrimtarin, kënaqësia më e madhe s'është shkrimi në vetvete, por muzika e brendshme që krijonë fjalët.

Tregimi - është vepër e shkurtër në prozë, përgjithësisht trajton një ngjarje të vetme, me një ose disa personazhe. Ngjarja e tregimit nuk është shumë e ndërlikuar, zakonisht përmban vetëm ndonjë episod të jetës së njeriut dhe nuk zhvillohet më.

Tregimi ka përmbajtje më të formësuar, më të lidhur e të qëndrueshme dhe realizohet me këto pjesë kryesore:

- hyrja,
- zhvillimi i përmbajtjes dhe
- përfundimi.

Ritregimi - Ritregimi është *rrëfimi i një sërë ngjarjesh e përvojash* të mbetura në kujtesë pas një copëze leximi, tregimi apo libri të tërë.

Ngjarja e lexuar mund të ritregohet kur jeni të vëmendshëm ndaj pikave kryesore të ngjarjes, si: hyrja, zhvillimi dhe përfundimi, koha dhe vendi i ngjarjes, fjalët kyçe, personazhet dhe konflikti midis tyre, dialogët etj., të cilët mund të ndihmojnë edhe në ruajtjen e intonacionit të ritregimit.



TË ÇELEN ARKAPIJAT

Në tregimin “Të çelen arkapijat”, Migjeni skicon një ngjarje reale, mbase të zakonshme në kohën e tij, kur prapambeturia dhe fanatizmi e vështirësonin shkollimin e vajzës shqiptare dhe e pengonin dukshëm përparimin dhe ngritjen e saj.

E vërtetë, me tamam! - pëshpriti Oso Bakalli, tue ndejë përpara dyqanit të vet. U çue, hyni mbrenda, nuk i lëshoi syt si përherë mbi mall, të cilën në kohët e fundit e kishte shtue, por me mërzi u rras mbas banakut. Aty e pushtoi një ndjesi, si me iu zhgatruë qenia e tij. Tashti ma nga helmi as nuk mejtonte gja. Donte të shkojë të dyqanxhiu ngjitë dhe ta marri vesht mirë punën, por s’kishte guxim, mbasi e dinte se çka do t’i thoshte. Por mjafton me pa dhe me ndëgjue at kopil me gazeta që po bërtet, si po çirret anembanë dhe po shtie çerekët e lekut në xhep.

- E vërtetë, me tamam, - i erdhi tue thanë dyqanxhiu ngjitë, me gazetë në dorë dhe me buzqeshje të helmueme.

- Mos ma këndo! S’ke se ç’ma këndon! A s’po ndëgjon si po çirret ai kopil përjashta?! Më bahet me ia ble të gjitha gazetatat që ka në dorë, veç mos me bërtite ma.

Ishte pranverë. Dyqanet e pazarit mbylleshin n’orën shtatë. Por Oso Bakalli i mbylli hesapet në gjashtë, dy blesve që erdhën mandej nuk desht t’u shesi, e mbylli dhe dyqanin dhe u nis për në shtëpi.

Pranvera e kësaj pranvere nuk ra në sy. Nuk u shijue as aroma e pemve të lulzueme, as që u admirue bukuria e tyne. Truni dhe shpirti i një pjese të madhe të qytetit ish zanë me do mendime krejt tjera, e pranvera që aq pritej, erdhi dhe po kalon si një udhtare pa randsi. Njerzit tonë janë shumë shpirtngushtë; kur u kërcnohet ndoj rrezik mbi krye, mejtojnë vetëm at rrezik që të jenë vetëm e vetëm ma të deshpruem, nuk mejtojnë sadopak ndër gjana tjera. E pra, sa shpresa e sa dëshira përfton pranvera nëpër kopshtie, ku enden varzat dhe gratë e mshehuna tue mshehë ndjesitë e tyne.

E motra shtatmdhetvjeçare e Oso Bakallit i thote shoqes mbrapa gardhit:

- E vërtetë! Ka dalë edhe në gazetë - dhe qeshej me një za të mbytn.

- Haj, moj! - dhe shoqja gjeti një vrimë në gardh, nëpër të cilën kaloi dhe e rroku shoqen.

- Ty të kande... Dritë?

- Pse? Ty a nuk të kande?

- Nuk dij, besa... Por Osja ka ardhë i idhtë si zehri, ka thirrë nanën, dhe unë prigjova kur i tha që mos me dalë asnjena prej shtëpie.

- Mue, besa, më kande, Hajrie. Pse mos me dalë edhe ne si dalin dhe varzat e botës, - tha Drita tue u kuqë. Mendoj pak dhe vazhdoi: ti që je aq e bukur, pse me u mshehë, moj Hajrie? Hajria e shtërngoi fort për supit shoqen, e kjo e puthi në skaj të buzve. Nga njena anë gezimi pse do dalin të zbulueta, nga tjetra anë friga e një pasigurie përftoi një ndjesi, të cilën kurr s’e kishin ndie.

- Ka me të pa ai, Hajrie, tamam njashtu si je, kur të dalim bashkë.

- Si flet edhe ti, Drite... Si s'ke marre... Mundet me të ndegjue kush... Natën e mirë,
- i tha në mnyrë të ftohte, tue u skuqë në fytyrë.

-Drita, tue dalë nëpër birë të gardhit n'oborr të vet mendonte dhe i erdh keq pse shoqja e saj asht aq e pasinqertë.

-E Hajria kur hyni në shtëpi, shkoi para pasqyrës mbsheftas, Shikoi veten, u pendue pse i tha ashtu shoqes dhe po t'ishte tash shoqja aty, do ta përqafonte dhe do ta puthte me gjithë zemër.

Në tanë shtëpinë një heshtje, sikur ndodhet ndokush n'agoni të vdekjes. Po, ka agoni, por jo mjerim. Si në këtë shtëpi dhe me qinda e qinda shtëpia tjera kanë diçka si agoni vdekje. Po vdes një e kalueme shekullore aq e ndjeme dhe aq e jetueme. Po i hiqet guri i qoshes kështjellit mijëvjeçar dhe zemrat e njerëzve po helmohen nga rroposja e tij. (Disa, përkundra, gëzohen si me u pas vramë një shtazë përbindshe që rronte dhe helmonte jetën nëpër shtëpia). Gazeta, reforma, zbulimi i grave ishin stihitë që mundojshin trutë e ngathët të njerëzve, të cilët nuk ishin mësue të mendojnë mbi ato gjana. Krenave, të mundueme vetëm me hallet ma të thjeshta të familjes, vetëm të shtëpis, tash përnjehere u bien me mendue mbi dicka të përbashket, mbi një problem kolektiv dhe pronarët e atyne krenave gjinden si peshqit në ranë.

Me zbulue gratë! - Këtë s'e kanë mendue se do t'u bahet për së gjalli.

Osja rri në minder, pin cigare mbas cigares, dhe mendon gjithçka dhe asgja nuk mendon. Po, mendon se si mashkujt janë me të vërtetë të këqij, si kanë qejf me e pa gruen e huej, dhe të shokut të vet, si i shkon mendja mandej të puna ma e keqe. I din Osja mendimet e mashkujve se dhe vetë asht mashkull. Dhe ai vetë mendon ashtu, me gjithë të katërdhetë vjetët e tij dhe me gruen pranë.

M'u hiq syve! - i bërtiti grues kur kjo iu avit dhe me xheloz e mati me sy që nga kambët deri në krye.

- Çfare fajit i kemi na, as na s'kemi qejf me dalë të zbulueme, - i tha e reja vjehrrës.

- Praj, mos fol, ka të drejtë! - iu përgjegj kjo plot zemrim tue mendue se bukuria e së resë ka me u pa sheshit nëpër rugët e qytetit.

Si me pasë ardhë ditët e fundit të jetës mbi tokë. Njerzit të njoftun, miqët, shikoheshin tërthorazi, me bisht të synit, njeni me tjetrin dhe mezi përshëndeteshin. Si me dashtë mos t'ia kujtojnë shoshit se po përmbysen bota. Në të vërtetë në ndërgjegje ndjejshin se bota nuk po përmbysen, vetëm se do t'u zbulohen gratë, por për ata njësoj, bile ma mirë t'u përmbyste bota, se atëhere gratë nuk do zbuloheshin.

E gratë? Disashikoheshin ndër pasqyra të vogla, mshehtas, për të pa dhe konstatue a janë në të vërtetë të deja qe të dalin të zbulueta. Plakat rënkojshin, "merrshin hallallet" njena nga tjetra, e disa shtyheshin dhe aq sa ia nisshin lotve si të sheqerit. Nuk qajshin pse do t'ua hanë burrat fytyrat: një pakice shum e vogël qante se do humbin xhenetin (parajsin) e një pjesë, shum ma e madhe, qante pse kishte nevojë të qaje, si ka nevojë dhe të qeshi. Varzat e reja, kur të mfshehuna nga pleqët e shtëpisë, ecshin ma krenisht, stërviteshin si do ecin rugave pa perçe, në fantazi, e emocionoheshin dhe jetojshin çaste lumnie. Përgjithsisht, shpirtënt rrojshin do çaste të pajetueme deri tash. Ishin

qitë në harresë të gjitha hallet e përditshme të jetesës; vobegësia kish harrue urinë, mjerimi kish harrue vuetjet, pse dikush diku, larg nga shpirti dhe mendësia e këtyne njerzve, kishte vendosë me vdekë sentimentalizma e mykun. E kjo sentimentalizëm që asht e lidhun për perçen e grave asht një kusht me randsi për jetën e këtyne njerzve në kët gjendje që gjenden. Prandej një pakënaqsi! Prandej një kundërshtim - ndoshta jo i sheshit, por - thellte në ndërgjegje. Dhe ai kundërshtim nuk pëlçet vetëm e vetëm pse s'ka fuqi. Prandej dhe qytetarë të ndershem, shtetarë besnikë. Prandej telegrame urimi, përgëzimi, entuziazmi, të buruem nga zemra të prekuna thellë - me hipokrizi apo llogari tregtare?

Dy net para se t'u vente në zbatim ligja e dekretueme për zbulimin e grave, mbasdarket, erdhi te Oso Bakalli vllau i tij me të githë pjestart e familjes. Erdhën për me u pa gratë për së mbramit herë, se kushedi kur kanë për t'u pamë ma. Burrat u ndanë në një anë të dhomes, gratë në një skaj tjetër, e varzat dhe fëmijtë një nga një iken në dhomen tjetër, për me gëzue ma tepër liri. Gratë flitshin për vete e burrat për vete, vetëm nganjëhere merrshin pjese në bisedën e njeni-tjetrit.

- A me të vërtetë i kish dalë emni në gazetë dhe Hakes t'Ali Isufit-a?

- Po pse i ka dalë në gazetë?

- Demek, i ka thane mbretit se do me dalë e zulueme... - pyetshin gratë njena-tjetrën dhe syt i silleshin kah burrat për me kërkue shpjegim.

- Po, allahu ma marroftë! Une i çuditem Alis, pse ai githmon m'asht dukë burr, e këtu ma len gruen me i dalë ne gazetë, - tha Osja me za që ta ndëgjojnë edhe gratë.

- U! punë e madhe... Kishin dalë dhe Rrukia e Brahim agës, Adija e Shaqir efendis, Gonxhja e Hysen Tahirit..., - filloi me numrue me zili njena prej grave.

- Po duhet me u dalë dhe resmja në gazetë, - tha tjetra me tallje.

Nga dhoma ku shkuen fëmijtë, u ndëgjue një potere gazit dhe fjalësh. Çka asht kjo? - tha Osja dhe u çue me rrëmbim. Në dhomë e gjet Hajrijen të veshun dhe të gaditun "allafranga", me diçka si kapele në krye, dhe tue ecë "mbas modet". Bukuria e trupit të saj vizohej bukur ndër rrobe të shtërngueme dhe pozat e saj ishin ngacmuese. Ajo s'e shifte Oson përmbra, por vazhdonte me imitue gratë "allafranga" dhe përdredhej si "mbas modës". Fëmija qesheshin dhe brohoritshin tue u argëtue. Kur Osja, me një pllamb të plotfuqishëm i ra Hajrijes kresë, kjo, u përplas për mur - e fëmijtë përnjherë heshtën të tmerruem. Mund tu ndëgjoreshin zemrat e tyne si rrifshin. Ma i vogli filloi të qajë. Hajria vetëm që lëshoi një za të pakontrolluem, si një dele në të cilën ndesh automobili. Mbas dy çastesh u çue si e hutueme, nga hunda dhe balli i pikonte gjaku. Osja, tue murmurue si qen i tërbuem, doli nga dhoma dhe vetem iu merreshin vesht fjalët: "si kurvë... si kurvë". E Hajria, ma e zbetë se muri për të cilin u përplas, shkoi me la fytyrën prej gjakut që përzejhej me lotët e heshtëshme të vujejtjes.

Kur u kthye Osja në dhomën e të mdhajave, njena nga gratë i tha se të Dan Hoxhes kishin çelë arkapinë e vjetër me kojshin, të cilën e kishin mbyllë para tridhetë vjetve pse ishin idhnue dy familjet. Tash e kishin çelë at arkapi për me muejtë, nëpër oborr të kojshis, me shkue te kushrinët, nga të c ilët, prap me anë t'arkapive, mujshin me shkue nëpër shum familje të njoftuna të lagjes pa i pa kush dhe pa pasë nevojë me dalë në rrugë. Osja u kap për këto fjale si i dejuni për hu dhe, mbasi mendoj do kohe,

iu suell grave:

- Po këta këtej, - tue shenjue me krye kojshit djathtas, - a kanë arkapi?

- Po, - iu përgjegj e shoqja.

- Po këta këtej?

- Po.

- Po ju në shtëpi a e keni arkapinë, - pyeti të vllanë Osja.

- Jo, por po thrras nesër puntorin me e çelë.

- Mirë, thirre, edhe unë po e thrras nesër. Dhe ftyra e Osos mori një dukje tjetër, si me iu shkundë një barrës së madhe. Gjithashtu, vllau filloi të qeshi e gratë u gëzuen se tashti nëpër arkapia mund të shifen ma shpesh me shoqet, mund të marrin vesht se cila ka dalë e zbulume, e cila ka bamë ndoj gja për t'u përfolë, përgjithësisht si qëndron lagja në pikëpamje të reformave. Me anë t'arkapive mund të bahen dhe shumë gjana tjera, hanëmet dhe hakët e dijnë, por çka me bamë kurse nuk guxon me dalë në rrugë me perçe. At natë Osja ra kondend, pothuej i kënaqun, në dyshek, tue thanë me vete: nuk po i shef, nuk po i shef gratë si mashkull i keq fodull që pret përjashta në rrugë. Mendim i krijuem nga xhelozia e tij fantastike.

Millosh Gjergj Nikolla - Migjeni

Fjalorth

zhgatrue - shkatërrue/shkatërruar;
mejtonte - mendonte;
më kande - ma ka ënda, dëdhiroj;
varzat - vajzat;
zehri - helmi;
arkapi - derë e vogël;
prigjova - përgjova, dëgjova;
krenave - krerëve, kokave;
ma krenisht - më krenarë;
gesheshin - qesheshin/ qeshnin.

ANALIZË

♦ Ritrego:

- Qëndrimin e shkrimtarit rreth heqjes së mbulesës së gruas shqiptare!
- Ngjarjen sipas radhës së veprimeve!
- Si ndihet shkrimtari/narratori dhe si ndihen personazhet në këtë tregim?
- Në ç'kohë dhe në cilin qytet zhvillohet ngjarja?
- Si e përjeton tregimin, si ngjarje reale dhe e vështirë apo thjesht, si një problematikë e kohës:
 - e pazakonshme,
 - normale,
 - situatë shumë e vështirë.

Shpreh mendimin tënd dhe ilustro me shembuj konkretë!

♦ Gjuha:

- Si është shkruar tregimi, në cilin dialekt?
- Analizo disa paragrafë të tekstit dhe nënvizo fjalë kyçe!
- Duke u mbështetur në tekst, vendos disa tipare/cilësi të personazheve:

♦ Detyrë:

(Shkruaj në fletore detyrën e dhënë!)

- Krahason dy vajzat shqiptare dhe deshifro qëndrimin e tyre përballë konfliktit shoqëror dhe kohës, në të cilin kanë jetuar!
- Pse janë emërtuar Drita dhe Hajrija, çfarë simbolike kanë emrat e vajzave?
- Shkruaj një punim me shkrim rreth kësaj ngjarjeje!
- Ndahuni në grupe dhe zgjidhni formën e ritregimit, pastaj flisni për ngjarjen, sipas formave të dhëna:

ngjarje e lexuar

ngjarje e parë

ngjarje e dëgjuar

HARTIMI I NJË FJALIMI

Gjuha, nuk është vetëm argëtuese, por ajo synon të bindë, të magjepsë, të ndriçojë dhe të frymëzojë.

Fjalimi - është ligjëratë, e cila mbahet në një mbledhje të gjerë, tubim apo prezantim gojor.

Është lloj i veçantë letrar, që ka për qëllim të shprehë: ide, ndjenja ose bindje përpara një grupi njerëzish.

Realizohet me gjuhë të qartë dhe të kuptueshme, ritëm dhe intonacion, si dhe argumentim logjik.

Fjalimi mund të jetë: formal, informues, motivues, argumentues.


- Formal: shpreh ndjenja, reflektim, përjetime, përvoja, kujtesë.
- Informues: tregon informacion të saktë dhe të qartë për një temë të caktuar.
- Motivues: i nxit dhe i frymëzon njerëzit të veprojnë ose të mendojnë ndryshe.
- Argumentues: dëshmon fakte bindëse për një pikëpamje ose qëndrim.

Fjalimi ka tri pjesë:

Hyrja (prezanton temën dhe e tërheq vëmendjen e dëgjuesve).

Pika zhvillimore (paraqet dokumente, dëshmi ose ide të rëndësishme, në mënyrë të qartë dhe të radhitur me logjikë).

Përfundimi (përmbledh mendimin dhe jep një porosi të fortë për dëgjuesit-lexuesit).



FJALIMI I SKËNDERBEUT

“Etër dhe princër fort të nderuar,

Unë sot sigurisht do të turbullonja qetësinë e atdheut, si një iniciator, ndoshta, i urryer i një lufte të re, dhe nuk do t'u shtynja ju me ngut në këtë vështirësi dhe rreziqe të luftë për interesat e larta, sikur Gjon Kastrioti, babai im i dëgjuar e nga ana tjetër një princ shumë i urtë, të mos i kish zënë aq fort besë dikur këtij Murati të pabesë, kur, nën pretekstin e paqës, arriti t'ia merrte rob e peng për siguri të bijtë menjëherë pasi i kërkoi... Vetëm për një gjë më vjen keq, për fatin e popullit tim, që kam nën sundim dhe për gjakun e pafajshëm të qytetarëve; s'ma duron zemra që ata të mbeten pa krye, pa mbrojtës, dhe t'i shkojnë armikut si kurban për t'u therur e unë të harroj besën që ata treguan para pak kohe kundrejt meje dhe që s'e kanë shkelur kurrë. Por pse, për perënditë e pavdekshme, të vepronja kështu, që të flas më si lirisht me ju? Mos do të ishte, pra, më e drejtë që bashkëqytetari juaj të qëndronte përgjithmonë i mërguar larg atdheut, në skllavëri pranë Muratit, në mes gjithë atyre rreziqeve e në një fe të dënuar apo mos do t'i duhej më mirë ta ngryste jetën në Epir dhe të shikonte të përlyhej e të poshtërohen edhe më gjatë atdheu i stërgjyshërve, mbretëria atërore, varret, tempujt, vetë perënditë nën sundimin e barbarëve? Më në fund ç'mendoni për Krujën? A mos vallë një qytet kaq i fortifikuar, kaq i përmendur për mjetet dhe fuqinë e tij, ka qenë për t'i lënë në duar të armikut, sikur të mos kishim pikë dashurie për atdhe? Kruja, zemra e fuqisë së Arbërit dhe e vetmja që është ndërtuar nga të parët tanë me të gjitha avantazhet si për luftë e për paqë. Këtë sigurisht në rast se unë s'ia bëj qefin vetes, zor që mund ta mohoni, o etër fort të nderuar... Por, sidoqoftë në këtë mes, ne të pakën s'kemi për t'u penduar për qëllimin tonë, sepse unë, gjatë gjithë asaj kohe që jetova bashkë me armikun, ia mësova dhe ia di shumë mirë lëkurën, dhelpëritë, mashtrimet e gjithë zakonet me radhë, gjë që konsiderohet zakonisht shumë e rëndësishme në punët e luftës...

Ejani, pra, kryetrima, merrni hakun, mbroni me lavdinë më të madhe atdhenë, gratë, fëmijët dhe të mirat tuaja, silluni atyre qetësinë e vërtetë të lirisë. A e ndjeni se në ç'turp po jetoni? Se cili mund të jetë fundi për lirinë dhe për ju? Në qoftë se, megjithkëtë, ju duket e durueshme gjendja juaj, atëherë me shumë të drejtë duhet t'i rrokni armët për mua jo si për ndonjë arbëror, jo si për një bir princi, jo si për një të gjakut tuaj por si për një të krishterë, si për të një të ikur. Unë nuk flas, o princër, me njerëz që i mohojnë luftrat e drejta... Por, o etër të kuvendit, edhe ju, siç kujtoj unë, kini për t'i dalë zot mbrojtjes. Dhe me të vërtetë, përse jeni mbledhur këtu të ftuar me kaq zjarr veçse për luftë? Dhe unë po i shoh tani zemrat e të gjithëve të ndezura dhe brenda në këto zemra të ndezura urrejtjen për armikun. Po vërej me admirim fytyrat krenare dhe më duket se po ju shoh që tani të armatosur. Mos prisni, veç ju lutem, atë gjendje të vështirë, mos prisni gjersa të jetë ndoshta vonë për t'jau kërkuar juve këtë ndihmë, tani t'i bashkojmë forcat dhe armët tona dhe kështu ta presim armikun, do të vërsulet shumë shpejt, ose t'i vërsulemi vetë. Dhe, kur të na shikojë të bashkuar, ai ose do të pendohet për planin e vet, ose, po vazhdoi të bëjë këmbë përpara, do të heq dorë nga lakmia e vajtuar për të dalur fitonjës me kërدين që do të pasojë.

Ndonjëri nga ju ka frikë dhe kolovitet nga dyshimi se Murati nuk do të dërgojë kundër nesh ushtri të vetme e të dobët, por më tepër e shumë të fuqishme, se, ndoshta, do të vijë edhe vetë me qëllim që të shpaguhet për këtë goditje të tmerruar, kurse ushtria jonë s'barazohet me forcat e tij; megjithëkëtë, unë ruhem t'u zotohem diçka njerëzvet që dyshojnë; sepse e ardhmja nuk duket sheshit dhe çdo përfundim i saj qëndron i fshehur. Për sa i përket veç mendjes dhe gjykimit njerëzor, unë mund ta tregoj se ato janë një mjet i sigurt për të gjitha punët, sepse asgjë s'është aq e vështirë, sa që të mos mund të zgjidhet nga mendja e njeriut...

Ngrihuni, pra, o etër të pathyeshëm, tregohuni më në fund të denjë para të gjithë brezave që do të vinë këtej e tutje. Falenderimet nga unë për mirësinë e sotme pritni të armatosur, me përkrenare në krye, para flamujvet, në djersë, në pluhur, dhe do t'i kini sipas ndihmavet, që do të jepni për luftë”.

Me t'i dhënë fund fjalës Skënderbeu, princërit të gjithë u drejtuan nga ai dhe, duke ia afruar me gojë dhe me zë të qartë mendimin, po e lavdëronin fort e po e ngrinin në qiell si shpëtimtarin e lirisë dhe të të gjithë lavdisë. Dhe kështu, pasi i lanë atij të gjithë me radhë dhe me vullnet të lirë dhe ia kaluan gati si me dorë pushtetin, popujt, ushtritë, dhe pasi i besuan drejtimin suprem të të gjithë gjendjes dhe kujdesin e luftës, e zgjodhën kryetar dhe kapidan të tyre të vetëm...

Marin Barleti



ANALIZË

◆ **Bashkëbisedo:**

- Përpiku të risjellësh në kujtesë njohuri për heroin kombëtar Gjergj Kastriotin - Skënderbeun dhe shkëmbeji ato!
- Ndaje në tri pjesë kryesore “Fjalimin e Skënderbeut”, duke e analizuar sipas pjesëve të ndërtimit strukturor!
- Si është hyrja e fjalimit, çfarë fjalësh përdor Skënderbeu për ta tërhequr vëmendjen e masës?
- Çfarë argumentesh përdor: veçoji disa prej tyre!
- A të duken të qarta dhe bindëse fjalët e kryeheroit tonë?

◆ **Analizo:**

- Përshkruaj portretin e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, me të gjitha tiparet e tij, si:
 gjuha _____ ;
 veshja _____ ;
 qëndrimi _____ .
- Shkruaj virtytet e kryetrimt shqiptar!
- Si i flet Gjergji të birit, Gjonit?
- Në cilin vit filloi mbretërimi i Gjergjit dhe kur përfundoi?
- Si e përshkruan Skënderbeu atdheun dhe si pushtuesit e huaj?
- Pas leximit të fragmentit, bashkëbisedoni për gjithçka që ju ka bërë përshtypje!

◆ **Detyrë:** (Shkruj në fletore detyrën e dhënë)

- Provo të shkruash një fjalim, duke zgjedhur ndonjërin nga festat tona të mëdha kombëtare!

Kujdes! Përpara se të shkruash gjej disa ide interesante që t'i ndërlidhësh në fjalim, që të jenë tërheqëse për ata që do ta lexojnë ose dëgjojnë prezantimin tënd!

SI TË SHKRUHET ESE

Dora që shkruan dhe do të vazhdojë të shkruajë, është më e fortë se ai që guxon të fshijë qoftë edhe një rresht të vetëm!

Shkrimtari, përpos që e shpreh mendimin dhe ndjesinë, në realitetin e vet krijues përpiqet ta bëjë lexuesin ta përjetojë ndryshe botën dhe jetën.

Eseja është lloj i veçantë i shkrimit letrar, ku trajtohen mendime, reflektime e këndvështrime mbi një temë të caktuar. Karakterizohet me lirinë e shprehjes në gërshetimin e ndjenjës, përvojës dhe arsyes.

Fjala “ese” vjen nga frengjishtja, që nënkupton “të provosh”, “të përpiqesh”.

Tematika e esesë është shumë e gjerë. Trajton çështje nga jeta e njeriut dhe veprimtaritë shoqërore të tij, zakonisht niset nga një dukuri e caktuar, të cilën e shkoqit dhe e argumenton nga çdo pikëpamje.

Kornizën fillestare të esesë mund ta mendojmë të përbërë nga pesë (5) paragrafë:

- një hyrës,
- tre të pjesës zhvillimore dhe
- një përmbyllës.

Llojet e esesë:

- Eseja përshkruese (krijon një imazh vendi, personi ose ngjarjeje);
- Eseja shpjeguese (informon saktësisht dhe qartë për një temë);
- Eseja argumentuese (e bind lexuesin për një qëndrim a pikëpamje);
- Eseja reflektuese (paraqet mendime dhe përvoja personale për një ngjarje);
- Eseja kritike (analizon dhe vlerëson një tekst, veprimtari apo dukuri).

Eseist - quhet hartuesi i esesë. Stilin e eseistit e karakterizon forca e fjalës dhe nota e thellë personale, plot mendime dhe përsiatje.

Gjuha e esesë është e zgjedhur dhe e stolisur me një varg tropesh, figurash dhe shprehjesh të fuqishme emocionale.

GRUAJA SHKRIMTARE

-Fragment i shkëputur nga eseja “Profesioni i grave”, të shkrimtares Virxhinia Vulf-


Arsyeja pse gratë kanë arritur sukses si shkrimtare më parë se në profesionet e tjera është natyrisht çmimi i lirë i letrës së shkrimit.

Por, t’ju rrëfej trgimin tim, ai është fare i thjeshtë. Paramendoni një vajzë me laps në dorë në dhomën e fjetjes. Të vetmen gjë që duhej të bënte - të lëvizte lapsin nga e majta në të djathtë prej orës dhjetë në një. Pastaj asaj i kujtohet të bëjë një gjë të thjeshtë e që në fund të fundit edhe mjaft e lirë - t’i fusë disa nga ato faqe në një zarf, t’i vërë një pullë postale. Në këtë mënyrë u bëra gazetare, munda im u shpërblye ditën e parë të muajit që pasoi. Për t’ju treguar se sa e meritoja të quhesha grua profesioniste, se sa i njihja vështirësitë dhe përpjekjet e jetëve të tilla, më duhet të pranoja se në vend se t’i harxhoja paratë e fituara për bukë e gjalpë, qira, këpucë e çorape apo t’i paguaja llogarinë mishshitësit, unë bleva një mace, një mace të bukur, mace persiane, e cila më futi në sherr me fqinjët.

Mirëpo ishte një përvojë e vërtetë: ishte përvoja që do t’i përcjellë të gjitha gratë shkrimtare të asaj kohe. “Vrasja e Engjëllit të Shtëpisë” ishte pjesa e profesionit të gruas shkrimtare.

Por ta vazhdoj tregimin. Engjëlli vdiq - çka mbeti pastaj? Mund të thoni se ajo që më mbet ishte një objekt i thjeshtë e i zakonshëm - një grua e re në dhomë të fjetjes me një shishe ngjyrë shkrimi. Me fjalë të tjera, tash kur u çlirua prej gënjeshtërisë s’i mbetej tjetër pos të ishte e vetes. Oh, por çka është vetja? Mendoj çka është gruaja? Ju siguroj se nuk e di. Nuk besoj ta dini as ju. Nuk besoj se ka ndonjë që mund ta dijë derisa të mos e ketë shprehur vetveten në të gjitha artet dhe profesionet që janë të hapura ndaj mjeshtrisë njerëzore.

Virxhinia Vulf



KUR MUNGON ATDHEU

Aty diku të bëhej se ishte De Rada ose pak para se të shkelja në Maki, ai kishte dalë në ballkonin e dhomës së punës e vështronte në horizont. Nuk dëshironte t'ia prishte qetësinë askush. Në kujtesën e arbëreshëve poeti ishte gjallë dhe çdo fjalë, mesazh e lëvizje e tij ishte kyçur në ndërdijen e tyre. Kjo disi na përkujton atë thënien e Gerard Genettit: “hapësira letrare është kujdesja e njerëzve”. Dhe sapo ishte gjetur në ballkon, njëri nga të afërmit, kishte pëshpëritur: maestro ishte bërë nevrik. Ka rënë mjegull e dendur tash e sa kohë dhe nuk mund ta shihte Arbërinë tej detit. Tek e kisha dëgjuar këtë, më ishte parafytyruar një vëllam yni Serembe. Tërë kohën u kallëzonte arbëreshëve një histori të dhembshme:

Arbëria matanë detit, na kujton

Se ne të huaj jemi te ky dhe.

(vrull)

Mua udha shpesh më ka qitur tek arbëreshët. Më vonë isha ambientuar me ta. Mbaja mend kangjela nga lashtësia, historira për Motin e Madh e deri ndonjë fjalë të rrallë, që i kishte shpëtuar harresës. Më fascinonin ngjyrat e rrobave, rregullimi e pastërtia e fshatrave, mikpritja, por më tmerronte vetmia e tyre. Kisha bërë gjumë edhe te ndonjëri. Dhe nuk mund ta harroj një mik, që në një poezi timen hyri si Zef. Kishte rënë nata dhe ai kishte kyçur derën dy herë. Si duket, një rrotullim i çelësit nuk kishte mjaftuar. Pse ai çelës ishte sjellë ashtu, pakëz me nervozizëm. E kisha kuptuar tek kisha kujtuar prapë vargun tragjik të Serembes: “se ne të huaj jemi tek ky dhe...”

Në rastin e parë kur nga prania e De Radës ndaheshim vështirë, kemi të bëjmë me gjakimin e krijuesit për rrënjën e vet, hulumtimin e prejardhjes, të origjinës. Në të dytin shtrohet problemi i identitetit: se kush janë e nga janë? Pra, ç'është ajo që në grumbullin e madh njerëzor i dallon popujt? Dhe, duke u kujtuar vazhdimisht arbëreshëve se rastësia i kishte qitur aty ku janë, në të vërtetë Serembe forconte identitetin e tyre, që, fatkeqësisht, vendi amë kontribuoi pak për arsye që na janë të njohura. Ndërsa ai çelësi, që Zefi ynë e kishte sjellë dy herë në derë, simbolizon frikën, ankthin. Mund të përballej me ndonjë të papritur? Arbëreshët u gjetën në një qytetërim krejt tjetër, që i kishte kanunet e veta dhe që vepronin ashtu siç dëshironin ndaj një kolektivi njerëzor, që detin e kishin kaluar edhe me një gjysmë trapi. E, Shqipëria ishte vetëm një nocion gjeografik. E varfër, e thyer, e shkelur dhe e derdhur nën mbretërinë e hënës anadollake, ku përsëpëritej ose shënohej ndonjë ngjarje nga kohët e lavdisë. Dhe, një Zot e shpëtoi. Mungonte organizimi, shkolla shqipe, krijuesi që do ta bënte çështje çdo rrënim. Pra, në një situatë kllapie, mund të bënte gjë Shqipëria për degët e shkëputura? Fqinj të gllabërues e kishin hedhur në ruletë, duke u falënderuar fuqive të mëdha, dhe ia vidhnin historinë, ia nëpërkëmbnin gjuhën e dinjitetin. Shkurt, Shqipëria ishte tokë për kusuritje, ndërsa përreth formoheshin shtet kombet në dëm të saj. Tej detit arbëreshët jetonin në ankth:

si ta ruanin atë që e kishin shpëtuar nga vendi amë. Kishin probleme me kujtesën, sepse duhej përcjellë diçka brezi brezit. Krijuesi arbëresh qëndronte përballë vetvetes. Dhe raporti ndërmjet tyre e Evropës ishte i njëjtë siç ishte me Shqipërinë: një zhgënjim që patjetër më vonë do të lëvizë gjërat. Pra, kthimi nga vetja dhe rikrijimi i të humburave nga kalvari historik, ku ngjarjet merrnin përmasa mitike. Dhe e vetmja gjë që bënte të shpresojnë ishte kujtesa, shpalimi i saj, hedhja e parë e dridhjeve shpirtërore në fletën e bardhë. Megjithatë shqiptari edhe më mbeti iluzionist dhe vështirë krijoi miq. Naim Frashëri i kishte kushtuar poezi Francisko Krispit, sapo ky kishte hipur në karrigën e Presidencës Italiane. Besonte se Shqipëria më në fund dilte në dritë, po poeti ynë kishte harruar se karrigia Shqipërinë shpesh e solli buzë humnerës.

Mirëpo, vetëdija kombëtare kishte zënë të zgjohej: kur nuk fliste Shqipëria, flisnin gjymtyrët e saj të derdhura, ku kontribut të madh do të japin pa dyshim edhe arbëreshët. Gjaku i shprishur kishte filluar të dëgjohej. Çështje e tyre u bë edhe mbiekzistenca e Shqipërisë, e Kosovës dhe çdo skaj i etnisë. Nga Moti i Madh ishte shfaqur vizioni i atdheut të ardhshëm. Ky ishte një libër që vazhdonte të shkruhej nga lashtësia e nuk dihej se kur do të mbyllej. Sidoqoftë, shqiptarët iu kthyen vetes dhe krijojnë raporte të tjera me Evropën

Ali Podrimja

ANALIZË

◇ Bashkëbisedo rreth tekstit të parë, të shkrimtares Virxhinia Vulf!

- Si janë ëndrrat tua për të ardhmen?
- Shpjego kuptimin e mendimeve të V. Vulfit rreth profesioneve të grave dhe gruas shkrimtare!

◇ Detyrë:

Shkruaj ese: “Ëndrra ime për të ardhmen” dhe “Dua të bëhem... mjek/e, mësues/e, pilot/e, aktor/e, piktor/e, shkrimtar/e” !

◇ Bashkëbisedo rreth tekstit të dytë, të shkrimtarit Ali Podrimja:

- Komento titullin simbolik të esesë!
- Si përshkruhet malli apo mungesa e atdheut?
- Çfarë lloji të esesë ka paraqitur autori?
- Çka e frymëzoi shkrimtarin për ta shkruar esenë?
- Si është kujtesa e shkrimtarit, si e përshkruan lidhjen me atdheun?

◇ Detyrë: (Shkruaj në fletore detyrën e dhënë)!

Shkruaj një ese të ngjashme për vendlindjen tënde dhe përpiku t'i japësh:

- përmbajtje,
- strukturë,
- mesazh.

TË SHKRUARIT KREATIV

Ditari - është lloj i krijimit letrar-shkencor, ku shënohen ngjarje të përditshme, që i përkasin një kohe më të shkurtër ose më të gjatë të jetës së autorit, në varësi të vullnetit apo dëshirës së tij. Në ditar shkruhet rregullisht, pothuajse gjithçka që ka ndodhur dhe është pjesë e mendimeve dhe ndjenjave të shkruarit. Zakonisht, ditari shkruhet në mbrëmje, pasi në atë periudhë të ditës veç më janë shtresuar një grumbull ngjarjesh.

Gjuha e përdorur në ditar mund të jetë e thjeshtë, pa ndërhyrje stilistike, pasi në këtë mënyrë ruhet pastërtia ndjesore dhe çiltërsia e përjetuesit (autorit), pra për të qenë pasqyra më besnike e tij.

Në ditar, në çdo përshkrim të ngjarjes, në çdo fletë shënohet edhe data dhe vendi (ku realizohet ditari), që më vonë të shërbejë si një lloj dokumenti për jetën, ndodhitë dhe përjetimet e një njeriu.


Rëndësia e ditarit varet prej aftësisë përshkruese të autorit dhe rolit që ai luan në jetën shoqërore. Nëse ka kryer ndonjë funksion të rëndësishëm në jetë, atëherë ditari i tij mund të shërbejë si dokumentim apo arkivim ngjarjesh të një periudhe të caktuar. ("Ditari i Ana Frankut" dhe ngjarjet për luftën).

Memoare - janë rrëfimet e një personaliteti të rëndësishëm, për ngjarje të ndryshme të kohës së vet, në të cilat ka marrë pjesë aktive ose ka qenë dëshmitar i tyre.

Fjala memoar - rrjedh nga fjala frënge *mémoire*, që do të thotë kujtim.

Memoaret shkruhen në formë kujtimesh (pa përdorur material arkivor), ku në formë të skicuar përshkruhet: jeta, ngjarjet, koha dhe ambienti ku ka jetuar memoaristi. Zakonisht, shkruhen nga fundi i jetës, kur njeriu ka më shumë kohë t'u rikthehet kujtimeve nga e kaluara, siç ndodh me personalitete të rëndësishme: burra shteti, kryeministra, diplomatë, gjeneralë, historianë, albanologë, artistë e profile profesionale të ndryshme.

Memoaret, si shkrime letrare-shkencore kanë vlerë të madhe dokumentare, si për njohjen dhe studimin e historisë kombëtare, kulturore, politike dhe shoqërore të një populli. (Janë të njohura memoaret e Jul Cezarit, apo nga letërsia shqipe, vepra "Kryengritja shqiptare" e Mihal Gramenos).




DITARI I ANA FRANKUT

Në orën shtatë hyra në dhomën e prindërve dhe pastaj në sallon, që ta shihja dhuratat: të parin të pashë ty o ditar im, dhe për mua ti ishe një nga dhuratat më të bukura. Aty ishte edhe një tufë trëndafilash, një kaktus, dy lulegjaku dhe një bimëz e brishtë. Këto qenë të parat dhurata, por më vonë më erdhën edhe të tjera.

Babai dhe mamaja më dhuruan një bluzë të kaltër, një lojë që luhet me shumë veta dhe një shishe me lëng rrushi, që për mendimin tim ngjan me verën (në fund të fundit, vera nga rrushi bëhet), një pazëll, një kavanoz me krem, një zarf me 2.5 gluden dhe një bono për të blerë dy libra. Pastaj edhe një libër tjetër, që e ka dhe Margoja, kështu që e ndërrova aty për aty me një vazo me biskota shtëpie (nga dora ime, sepse këto kohë, më dalin shumë të mira), karamеле pa hesap dhe një tortë me luleshtrydhe, vepër e mamasë. Një letër nga gjyshja (kuptohet, krejt rastësisht!), kishte mbërritur tamam në kohë.





Pastaj Haneli erdhi të më merrte dhe ne shkuam në shkollë. Gjatë pushimit i qerasa me biskota mësuesit dhe shokët e mi dhe pastaj erdhi koha t'i futeshim përsëri punës. Arrita në shtëpi vetëm në orën pesë, meqë shkova në orën e gjimnastikës me pjesën tjetër të Masë. (Mua nuk më lejohet të marr pjesë, sepse krahët e mia janë delikate). Meqenëse kisha ditëlindjen, mund të vendosja unë se çfarë loje do të luanin shokët e mi të klasës. Zgjodha volejbollin. Pastaj të gjithë vallëzuan rreth meje dhe kënduan “Shumë urime për ty”.

Kur arrita në shtëpi, Sana Ledermani po më priste. Ilza Vagneri, Hanel Goslari dhe Zhaklinë van Marseni erdhën me mua në shtëpi pas gjimnastikës, meqenëse jemi në të njëjtën klasë. Dikur paneli dhe Sana ishin dy shoqet e mia më të ngushta. Njerëzit që na shikonin së bashku, thoshin: “Ja Ana, Hana dhe Sana”. Zhaklinë van Marsenin e kam njohur në liceun hebraik. Tani ajo është shoqja më e ngushtë e Hanelit, Icurce Sana shkon në një shkollë tjetër dhe atje ka shokët e saj. Ata më sollën një libër fantastik....!

Ana Frank

ANALIZË

- ◇ Provo të shkruash ditar, lexoje atë me shokët dhe shoqet e klasës!
(Shkruaj në fletore detyrën e dhënë)



DEBATI

Debati - është bisedë (diskutim) e organizuar, sipas një teme të caktuar dhe strukture të qartë, ku marrin pjesë dy ose më shumë palë me qëndrime të kundërta, të cilat paraqesin argumente për/pro dhe kundër.

Qëllimi i debatit nuk është vetëm kundërshtimi i palës tjetër, por edhe analizimi i çështjes në mënyrë kritike dhe me argumente të sakta.

Të jesh i/e aftë për të debatuar, do të thotë të dish të përdorësh logjikën dhe argumentin, duke arsyetuar në mënyrë të qartë dhe të qëndrueshme.

Një debatues i mirë duhet:

- ta kuptojë drejt dhe të jetë i qartë rreth temës së shtruar;
- të flasë me logjikë dhe artikulum të duhur;
- ta dëgjojë palën tjetër - "kundërshtarin";
- ta ruajë qetësinë dhe të përgjigjet me maturi;
- të mos hyjë në çështje personale.

Thelbësore në debat është: zhvillimi i mendimit kritik, oratoria e nxënësit dhe aftësia krijuese. Jo vetëm kaq, por debatimi e nxit nxënësin që të afrohet me mendimet e çdo pale, ndonëse disa mund të jenë të kundërta, dhe të krijojë bindje, me bazë në arsyetim dhe reflektim të duhur, në atë se çfarë beson.

Debatet ndahen sipas: formës, mjedisit dhe numrit të pjesëmarrësve.

- Për nga forma, debatet ndahen në:

1. Debate formale, që zhvillohen sipas rregullave të paracaktuara, me kohë të saktë për të gjithë pjesëmarrësit.

2. Debate joformale, që zhvillohen lirshëm, pa ndonjë rregull të rreptë. Këto lloje të debateve janë më shpeshta, sidomos në mes shokëve, dhe zakonisht ndodhin në rrethana të paplanifikuara.

- Për nga mjedisi, debatet ndahen në:

1. Debate shkollore, zhvillohen në rrethin e shkollës, nën mbikëqyrjen e një arsimtari. Këto lloje debatesh kanë veçanërisht qëllim informativ dhe edukues.

2. Debate parlamentare, zhvillohen në institucione shtetërore, me qëllim vendimmarrës dhe për tema që janë të lidhura me çështjet shtetërore.

3. Debate publike, zhvillohen para publikut ose në medie, zakonisht nëpër programe televizive, radio, podkaste.

- Për nga forma, debatet ndahen në:

1. Debate dypalëshe - përfshijnë dy palë, të cilat janë kundërshtuese ndaj njëra - tjetrës.

2. Debate shumëpalëshe ose diskutime, përfshijnë dy ose më shumë grupe njerëzish ose individë, që bien në kundërshtim me njëri-tjetrin rreth temës së debatit.

Për shembull: temë debati mund të japim se a është teknologjia e dobishme për të rinjtë, apo e dëmshme ku njëra palë vë në pah të mirat që i sjell përdorimi i teknologjive të reja, ndërsa pala tjetër paraqet pasojat e përdorimit të shumtë të teknologjisë.

Përdorimi i telefonit, internetit, rrjeteve sociale, përdorimi i GPT etj.

ANALIZË

Teksti i dhënë është shkruar nga shkencëtari Nikolla Tesla

◇ - Lexo me kujdes dhe zhvillo një debat rreth temës së dhënë!

SHPIKJET E MIA

Zhvillimi përparimtar i njeriut varet përjetësisht nga shpikja. Ai është prodhim i rëndësishëm i trurit të tij krijues. Qëllimi përfundimtar i saj është sundimi i plotë i mendjes mbi botën materiale, vënia në shërbim të njeriut e forcave të natyrës.

Ky është një mision i vështirë për shpikësin, i cili shpesh keqkuptohet dhe nuk shpërblehet. Mirëpo, ai gjen ngushëllim të mjaftueshëm në ushtrimin e këndshëm të aftësive të tij dhe në vetëdijen sa i përket asaj klase, jashtëzakonisht të privilegjuar, pa të cilën njerëzimi do të ishte zhdukur prej kohësh në luftën e ashpër kundër elementeve të pamëshirshme.

Metoda ime është e ndryshme. Nuk nxitoj të kaloj menjëherë në punë praktike. Kur më vjen një ide, filloj menjëherë ta formësoj në imagjinatën time. Për mua nuk ka aspak rëndësi, nëse e vë turbinën time në lëvizje në mendje apo në punishten time. Madje, mund të kuptoj edhe nëse nuk është në balancë. Nuk ka dallim: rezultatet janë të njëjta.

(Vepra "Shpikjet e mia", Nikolla Tesla).

◇ Detyrë:

- "Shpikjet e mia" është një tekst informues nga i cili mund të bëni prova, duke krijuar: ditar, biografi, kronikë, apo ndonjë lloj tjetër të formave letrare shkencore!
- Shkruaj ese me temë "Ëndrra e jetës"!

NJOHURI MEDIATIKE



TITUJT DHE MASHTRIMET PËR KLIKIME (KLIK-BEJTI)



BESUESHMËRIA E INFORMACIONIT



HAPAT E KONTROLLIT



SHPËRNDARJA ME PËRGJEGJËSI



PASOJAT E SHPËRNDARJES SË PAPËRGJEGJSHME

NJOHURI MEDIATIKE

TITUJT DHE MASHTRIMET PËR KLIKIME (KLIK-BEJTI)

Qëllimi i njësisë

Në këtë njësi nxënësit do të mësojnë:

- çfarë është përmbajtja mediatike;
- si ndërtohen dhe përdoren titujt;
- çfarë është titulli mashtrues (klik-bejti);
- si vlerësohet besueshmëria e informacionit;
- çfarë do të thotë të shpërndash me përgjegjësi.

Përmbajtja mediatike

Përmbajtje mediatike quhen të gjitha mesazhet që qarkullojnë përmes televizionit, gazetave, internetit dhe rrjeteve sociale. Përmbajtja mediatike përfshin lajme, fotografi, video, reklama dhe postime.



Media ka rol të rëndësishëm në shoqëri, sepse ndikon në mënyrën se si njerëzit e kuptojnë botën, formojnë qëndrime dhe marrin vendime. Prandaj qytetari i sotëm duhet të dijë jo vetëm të lexojë, por edhe ta kuptojë dhe ta vlerësojë median.

Roli i titullit



Titulli është fjala, togfjalëshi ose fjalia që qëndron në krye të një lajmi ose postimi. Ai e përmbledh temën dhe i jep lexuesit një ide për përmbajtjen. Një titull i rregullt duhet të jetë:

- i qartë,
- i saktë,
- në përputhje me tekstin.

Kur titulli nuk pasqyron përmbajtjen, ai nuk e informon lexuesin, por e çon në keqkuptim.

Titulli mashtrues (klik-bejti)

Në gjuhën e medias përdoret termi klik-bejti (nga anglishtja *clickbait*), që në shqip do të thotë titull mashtrues ose titull joshës. Titulli mashtrues është një formë e veçantë e titullit që synon të ndikojë më shumë te emocionet e lexuesit sesa te arsyeja. Ai ndërtohet për të ngjallur kureshtje, frikë ose habi, pa e paraqitur qartë përmbajtjen e lajmit. Këta tituj shpesh:

- shmangin informacionin e saktë;
- e theksojnë anën sensacionale (tronditëse dhe joshëse) të ngjarjes;
- ose e lënë qëllimisht të paqartë thelbin e lajmit.

Qëllimi i tyre nuk është informimi, por tërheqja e vëmendjes dhe rritja e klikimeve.

Shembuj titujsh mashtrues:



Ky titull nuk tregon se çfarë po ndodh, por vetëm nxit kureshtje.



Ky titull ngjall frikë, por nuk jep burime ose prova.

BESUESHMËRIA E INFORMACIONIT

Besueshmëria e informacionit tregon shkallën në të cilën një lajm, fotografi ose postim mund të merret si i vërtetë dhe i saktë.



Në botën digjitale, ku çdokush mund të publikojë përmbajtje, është e domosdoshme që lexuesi të mos mjaftohet vetëm me leximin, por ta vlerësojë informacionin. Një informacion konsiderohet i besueshëm kur:

- vjen nga një burim i njohur dhe i verifikueshëm (pra, nga një burim që mund të kontrollohet dhe të vërtetohet);
- mbështetet në fakte, shifra (numra dhe të dhëna të matshme) ose dëshmi;
- është i publikuar në një kohë të përcaktuar;
- përputhet me burime të tjera serioze.

Vlerësimi i besueshmërisë është pjesë e mendimit kritik dhe është një aftësi thelbësore e edukimit mediatik.

HAPAT E KONTROLLIT

Pyetje	Çfarë kontrollojmë
Kush e ka botuar?	burimin
Kur është botuar?	datën
Me çfarë argumentohet?	faktet dhe provat
A është fotografia e vërtetë?	pamjen dhe kontekstin



SHPËRNDARJA ME PËRGJEGJËSI



Shpërndarja e informacionit është një veprim publik. Çdo përmbajtje e shpërndarë hyn në qarkullimin e mendimit shoqëror dhe ndikon në mënyrën si njerëzit mendojnë dhe veprojnë. Të shpërndash me përgjegjësi do të thotë:

- të mendosh para se të veprosh,
- të kontrollosh të vërtetën,
- të respektosh të tjerët,
- të mos përhapësh informacione të pavërteta.

PASOJAT E SHPËRNDARJES SË PAPËRGJEGJSHME

Kur informacioni shpërndahet pa u verifikuar:

- gënjeshttrat dhe keqinformimi përhapen më shpejt se e vërteta;
- dëmtohen individë, grupe ose institucione;
- krijohet pasiguri dhe mosbesim në shoqëri.



Në disa raste, përhapja e lajmeve të rreme ose e shpifjeve mund të ketë edhe pasoja ligjore, sepse cenon të drejtat dhe dinjitetin e njerëzve.



Mbani mend

- Titulli duhet të pasqyrojë përmbajtjen.
- Titulli mashtrues synon klikime, jo informimin e saktë.
- Informacioni duhet vlerësuar.
- Çdo shpërndarje ka pasoja.

USHTRIME ME SHPJEGIME

◆ Ushtrimi 1 – Lexo titujt dhe trego cili prej tyre është mashtrues:

- a) Shkolla organizon garë sportive për nxënësit
- b) Nuk do ta besoni çfarë ndodhi sot në këtë shkollë!
- c) Nxënësit e klasës VIII do ta vizitojnë bibliotekën e qytetit

✓ Përgjigjja: b)

Pse?

Sepse titulli b) nuk tregon se çfarë ka ndodhur. Ai përdor paqartësi dhe kureshtje për të tërhequr vëmendjen, gjë që është tipike për titujt mashtrues.

◆ Ushtrimi 2 – Cili është burim i besueshëm?

Rretho përgjigjen e saktë:

- a) një postim anonim në rrjetet sociale
- b) një faqe interneti pa autor
- c) një institucion i njohur

✓ Përgjigjja: c)

Pse?

Sepse institucionet e njohura mbajnë përgjegjësi për informacionin që publikojnë dhe janë të detyruara ta ofrojnë atë në mënyrë të saktë dhe të verifikueshme.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:811.18(075.2)

SULEJMANI, Berton

Gjuhë shqipe për klasën e tetë të arsimit fillor / Berton Sulejmani,
Zejnepe Alili Rexhepi. - Tetovë : Arbëria Design, 2026. - 278 стр. :
илустр. ; 30 см

ISBN 978-608-236-496-4

1. Alili Rexhepi, Zejnepe [автор]

COBISS.MK-ID 69127941

ISBN 978-608-236-496-4



9 786082 364964

www.arberiabooks.info